



ANALIZË



**e gjendjes me të drejtat e
personave me aftësi të
kufizuara në Republikën e
Maqedonisë së Veriut - 2021**



ANALIZË E GJENDJES

**me të drejtat e personave
me aftësi të kufizuara
në Republikën e Maqedonisë
së Veriut - 2021**

Financuar nga: UNPRPD MPTF

Përgatitur nga:

Elena Koçoska

Bojana Jovanovska

Tomislav Ortakovski

Natasha Stanojkovska-Trajkovska

Sofija Georgievska

© 2022 Kombet e Bashkuara

Botimi është në dispozicion me qasje të hapur duke respektuar licencën Creative Commons krijuar për organizatat ndër-qeveritare, që mund të gjendet në: <https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/igo/>

Fotokopjet dhe riprodhimet e ekstrakteve lejohen me referencë adekuate të burimit.

Botuesit duhet të fshijnë emblemën e OKB-së nga botimi i tyre dhe të krijojnë një dizajn të ri kopertine. Botuesit duhet këtë botim të tyre ta dërgojnë në publications@un.org.

Gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura këtu janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Kombeve të Bashkuara ose zyrtarëve të saj ose shteteve anëtare.

Mbështetja financiare për të kryer hulumtimin u siguroi nga Fondi Multi-Partner Trust (MPTF) i Partneritetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNPRPD), megjithatë ai nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të UNPRPD MPTF. Ky botim mund të përdoret lirisht për qëllime jo-komerciale dhe adekuate, duke i përmendur partnerët dhe MPTF të UNPRPD.

Publikim i Kombeve të Bashkuara botuar nga Kombet e Bashkuara në Maqedoni.



Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	6
2. Sfondi	8
3. Qëllimi i analizës së gjendjes	8
4. Metodologjia	9
5. Analiza e gjendjes dhe gjetjet	10
5.1 Analiza e palëve të interesuara dhe koordinimi	10
5.2 Barazia dhe mosdiskriminimi	12
5.3 Qasshmëria	16
5.4 Shërbimet inkluzive për personat me aftësi të kufizuara	18
5.4.1 Qasje në sigurimin social dhe shërbime sociale	19
5.4.2 Qasje në kujdesin shëndetësor dhe shërbimet shëndetësore	20
5.4.3 Qasje në arsim	21
5.4.4 Qasje në punësim	23
5.5 Përfaqësimi dhe pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara	24
5.6 Përgatitja e buxhetit (buxhetimi) në përputhje me KDPAK	26
5.7 Llogaridhënia dhe menaxhimi	28
6. Analiza	32
7. Pikat kritike dhe mundësitë për veprim	35
8. Konkluzione dhe rekomandime	38
9. Rekomandime për analizë/mbledhje e të dhënave të mëtejshme	42
10. Rekomandime për veprime të mëtejshme programore	43
11. Aneks	45
Aneks 1. Lista e pjesëmarrësve ne fokus grupe dhe takime individuale	46
Aneks 2. Procesverbal nga fokus grupet me persona me aftësi të kufizuara	49
Aneks 3. Informacione nga takime me njerëz që kanë lëshuar IS Demir Kapi	55
Aneks 4. Informacione shtesë me të cilat merren parasysh shërbimet inkluzive për personat me aftësi të kufizuara	56
Aneks 5. Përgjigje të ardhura nga agjencitë e OKB-së dhe një pjesë e komunitetit ndërkombëtar	68
Aneks 6. Boshllëqe kritike, knkluzione dhe rekomandime	78
Aneks 7. Bibliografia	89

Lista e shkrutesave

KDPAK	Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KPMD	Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
QPS	Qendra për punë sociale
ZRrK	Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë
AA	Asistentët Arsime
APRMV	Agjencia për punësim në Republikën e Maqedonisë së Veriut
PPRS	Programa për punësim dhe reforma sociale
DhGj	Dhuna gjinore
FSSHRMV	Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut
KNF	Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
MPM për KDPAK	Mekanizmi i Pavarur Monitorues për zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
LPPAK	Ligji për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara
LAL	Ligji për Arsimin e Lartë
LSSH	Ligji për Sigurimin Shëndetësor
LMSH	Ligji për mbrojtje shëndetsore
LP	Lista e pyetjeve
LMF	Ligji për mbrojtjen e fëmijëve
LAF	Ligji për Arsimin Fillor
LMDP	Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve
LMP	Ligji për Marrëdhëniet e Punës
LMS	Ligji për Mbrojtjen Sociale
LPMD	Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi
LAM	Ligji për Arsimin e Mesëm

RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPTF	Fondi i Mirëbesimit Multiparter
TKK për KDKAK	Trupi Koordinues Kombëtar për Zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KKOAK	Këshilli Kombëtar i Organizatave të Aftësisë së Kufizuar
PAP	Programi për Asistencë Personale
OPAK	Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
SZhQ	Synimet për Zhvillim të Qëndrueshëm
KSHZ	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
EShKB	Ekipi Shtetëror i Kombëve të Bashkuara
KPS	Korniza për Punë Strategjike (2020 - 2025)
ESHS	Enti Shtetëror i Statistikave
KB KDKAK	Kombet e Bashkuara, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
OKB	Kombet e Bashkuara
UNPRPD	Partneriteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara i Kombeve të Bashkuara
WG	Grupi i Uashingtonit mbi Statistikat e Aftësisë së Kufizuar
WG-SS	Pyetje të shkurtra nga Grupi i Uashingtonit mbi Statistikat e Aftësisë së Kufizuar
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

1. Përmbledhje ekzekutive

Republika e Maqedonisë së Veriut e ratifikoi Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) në vitin 2011. Në periudhën vijuese, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara u avancuan si rezultat i reformave të vazhdueshme në fushën e mbrojtjes sociale dhe arsimit, dhe zhvillimet në fushat e mosdiskriminimit, shërbimeve inkluzive të punësimit, deinstitutionalizimit, qasjes në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues, parandalimit të dhunës me bazë gjinore dhe promovimit të barazisë gjinore. Vullneti politik për të siguruar pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara është i dukshëm dhe i njëjti është reflektuar edhe në kornizën legjislative.

Ligji për Mbrojtjen Sociale i vitit 2019 promovon parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit në ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes sociale, të cilat bazohen në trajtimin e barabartë dhe të drejtë, duke përfshirë aftësinë e kufizuar si bazë për diskriminim. Ligji i ri për Mbrojtjen Sociale dhe rishikimi i gjerë i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve rishikuan dhe konsoliduan sistemin e ndihmës financiare, ndër të tjera, për të siguruar mbulim dhe përshtatshmëri më të madhe. Reforma prezantoi gjithashtu shërbime të reja për mbështetjen dhe kujdesin social për personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestarët e tyre.

Me reformat e ndërmarra në arsim, shteti përpiqet që të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara të përfshihen në arsimin e rregullt fillor. Shteti gjithashtu ka siguruar burime financiare dhe ka punësuar 500 asistentë arsimorë për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara përmes shkollave fillore me një qendër burimore.

Sistemi i vlerësimit sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionimit (KNF) për fëmijët dhe të rinjtë deri në 26 vjeç ka filluar së fundi të zbatohet me sukses, në katër nga tetë rajonet e planifikimit. Megjithatë, kalimi në vlerësimin e bazuar në KNF si pikë e vetme hyrëse në sistemin e përfitimeve financiare dhe shërbimeve mbështetëse nuk mund të përfundojë derisa organet e vlerësimit të krijohen në të gjitha rajonet. Procesi i deinstitutionalizimit është në vazhdim e sipër, ndonëse jo në përputhje me nenin 19 të KDKPAK. Procesi ka përfunduar për fëmijët, pa lënë asnjë fëmijë në institucione të mëdha në vend. Fëmijët pa kujdes prindëror janë ose në familje kujdestare, ose në shtëpi të vogla grupore. Megjithatë, në institucione ka ende persona me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç. Në përgjithësi, procesi i deinstitutionalizimit duhet të devijojë nga qëllimi përfundimtar i mbylljes së institucioneve të mëdha dhe të shkojë drejt ofrimit

të banesave të qasshme dhe të përballueshme, asistencës teknike moderne, asistentëve personalë dhe mbështetjes së kolegëve, të cilat do të përmirësojnë vetëbesimin e personave me aftësi të kufizuara dhe kapacitetin e tyre për t'u integruar plotësisht në shoqëri

Duke marrë parasysh zhvillimet dhe arritjet e mëparshme, kjo analizë e situatës përdor këndvështrimin e KDKPAK-së për të identifikuar shtatë pengesat dhe sfidat kryesore në realizimin e të drejtave themelore të njeriut të personave me aftësi të kufizuara, si dhe parakushtet bazë për përfshirjen e aftësisë së kufizuar në shoqëri.

Së pari, për sa i përket kornizës ligjore, analiza tregon se qasja e bazuar në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara nuk është zbatuar në mënyrë konsistente përmes ligjit dhe se qasja mjekësore ndaj aftësisë së kufizuar ende mbizotëron. Edhe pse Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi është i rregulluar në përputhje me KDKPAK, Kushtetuta dhe korniza ligjore ekzistuese janë të ngarkuar me terminologji mjaft nënçmuese, kryesisht me aplikimin e qasjes mjekësore ndaj aftësisë së kufizuar. Dallimet ndërmjet vetë komunitetit me aftësi të kufizuar nuk pasqyrohen dhe nuk merren parasysh në ligje, strategji, plane dhe buxhete. Korniza ligjore për krizat humanitare dhe gjendjen e jashtëzakonshme nuk është harmonizuar me KDKPAK. Në kushte pandemie, njerëzit me aftësi të kufizuara janë përsëri të marginalizuar nga rrjedhat kryesore, pa përgjigje adekuate ndaj nevojave të veçanta të personave me aftësi të kufizuara.

Së dyti, është ende e nevojshme të promovohet më mirë KDKPAK në të gjitha nivelet e shoqërisë, të përmirësohet disponueshmëria dhe qasshmëria e statistikave bazë dhe të dhënave të tjera për të krijuar politika të qëndrueshme dhe efektive për aftësinë e kufizuar, për të ndryshuar perceptimin dhe qëndrimet sociale ndaj aftësisë së kufizuar – duke përfshirë kuptimin e përgjithshëm të aftësisë së kufizuar, dhe tejkalimin e stigmës ekzistuese. Vendimmarrësit kryesorë, aktorët e sektorit publik, publiku i gjerë, madje edhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara nuk janë mjaftueshëm të njohur me KDKPAK dhe angazhimet përkatëse që vendi ka ndërmarrë për ta zbatuar atë. Në nivel qendror dhe lokal nuk mund të gjendet një person me aftësi të kufizuara në një post politik, e as edhe në postin e këshilltarit në një komunë. Korniza ligjore ekzistuese nuk kontribuon në pjesëmarrjen efektive të personave me aftësi të kufizuara në politikë dhe në jetën publike. Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara mund të shihet kryesisht në organizatat e personave me aftësi të kufizuara (OPAK).

Së treti, hapësira publike dhe infrastruktura, si dhe informacioni për personat me aftësi të kufizuara janë kryesisht të paqasshme. Gjuha e shenjave nuk njihet si gjuhë zyrtare dhe programet e medias janë përgjithësisht të paqasshme për personat me aftësi të kufizuara. Dizajni universal si standard nuk njihet dhe nuk përfshihet në detyrimet ligjore. Ekziston një mungesë njohurish për konceptin e qasshmërisë nga të gjitha palët e interesuara. Organet e ndryshme rregullatore për mbikëqyrjen inspektuese në fusha të ndryshme nuk kanë kapacitetin e duhur për të zbatuar detyrimet e që dalin nga KDPAK.

Së katërti, qasja në shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara bazohet kryesisht në modelin mjekësor të aftësisë së kufizuar dhe nuk mbulon të gjithë personat me aftësi të kufizuara në përputhje me nenin 1 të KDPAK. Shërbimet e habilitimit nuk njihen brenda kornizës ligjore. Mbështetja jashtëinstitucionale e ofruar për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara është mjaft kufizuese. Në nivel lokal, gama e shërbimeve është mjaft e kufizuar. Krahas vendosjes së plotë të një sistemi vlerësimi sipas KNF për fëmijët dhe të rinjtë, shteti duhet të fillojë të krijojë një kornizë institucionale për ngritjen e një sistemi vlerësimi të aftësisë së kufizuar për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht moshës. Ofruesit e shërbimeve kanë njohuri të ulëta për KDPAK. Personat me aftësi të kufizuara në procesin e deinstitutionalizimit janë të përfshirë vetëm si përfitues. Nuk është marrë asnjë masë për hapjen e debatit për aftësinë e punës të personave me aftësi të kufizuara.

Së pesti, me reformat e ndërmarra në arsim, megjithëse është bërë progres në arsimin fillor, mbetet të mbulohet edhe arsimi i mesëm, i cili mbetet i veçuar dhe kufizues. Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në arsimin e lartë nuk bie në sy. Edhe përkundër disa reformave pozitive, korniza ligjore në fushën e arsimit fillor duhet të harmonizohet më tej me KDPAK. Infrastruktura arsimore mbetet e paqasshme, ndërsa kapaciteti i palëve të interesuara është shumë i ulët. Personat me aftësi të kufizuara nuk janë të përfshirë në këto procese.

Së gjashti, kjo identifikon nevojën për ndryshime të nevojshme në nivel sistemik për të siguruar jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara dhe respektimin e të drejtave të tyre njerëzore në baza të barabarta me të tjerët. Koncepti i jetesës së pavarur nuk është kuptuar siç duhet dhe vendosja e personave me aftësi të kufizuara në shtëpi grupore nuk është në përputhje me KDPAK. Sistemi i punësimit nuk ofron

mundësi më të mëdha për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e hapur të punës. Nevojiten masa sistematike për të promovuar aftësitë e personave me aftësi të kufizuara, si dhe futjen e një sistemi kuotash punësimi me një qasje sistematike për të krijuar një sistem punësimi të dhënë. Përveç kësaj, personat me aftësi të kufizuara kanë qasje të kufizuar në drejtësi. Mungon analiza e çështjeve gjyqësore për aftësinë e kufizuar dhe zbatimin e KDPAK në vend, por është e qartë se gjykatave u mungojnë trajnimet, opinionet ligjore dhe takimet e specializuara për harmonizimin e praktikës gjyqësore në këtë fushë.

Së shtati, vendit i mungojnë statistikave të qëndrueshme dhe të krahasueshme për personat me aftësi të kufizuara. Burimet ekzistuese të të dhënave janë të fragmentuara dhe mungojnë të dhënat e ndara sipas gjinisë, moshës dhe vendndodhjes gjeografike dhe cilësia e të dhënave duhet të përmirësohet. Kjo e bën të pamundur monitorimin e zbatimit të KDPAK, si dhe krijimin, zbatimin dhe vlerësimin efektiv dhe efikas të politikave. Edhe pse shteti ka caktuar një trup koordinues nacional për të monitoruar zbatimin e KDPAK, akoma nuk janë ndarë burimet adekuate njerëzore dhe financiare për këtë qëllim. Përfshirja e OPAK-ve dhe organizatave mëmë në këtë organ duhet të forcohet më tej. Mekanizmi i Pavarur Monitorues është pjesë e Avokatit të Popullit dhe atij gjithashtu i mungon kapaciteti adekuat financiar dhe njerëzor për të kryer efektivisht rolin e tij sipas nenit 33 të KDPAK.

2. Sfondi

Pavarësisht nga ratifikimi i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (në tekstin e mëtejme: KDPAK) nga shumë vende, shumë prej tyre, për fat të keq, ende po luftojnë për ta përkthyer KDPAK në politika, sisteme, programe, veprime dhe shërbime specifike që do të mundësojnë jetën e pavarur dhe dinjitoze të personave me aftësi të kufizuara.

Për të lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të Kombeve të Bashkuara (në tekstin e mëtejme: OKB), u krijua Partneriteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Fondi i Partneritetit (në tekstin e mëtejme: UNPRPD, MPTF). Ky partneritet është një bashkëpunim midis agjencive të OKB-së, qeverive, organizatave të personave me aftësi të kufizuara (në tekstin e mëtejme: OPAK) dhe shoqërisë civile (në tekstin e mëtejme: OSHC) me qëllim promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në përputhje me KDPAK dhe synimet e zhvillimit të qëndrueshëm me përfshirjen e aftësisë së kufizuar, (në tekstin e mëtejme: SZHQ). Për të siguruar konsistencën midis palëve të interesuara të vendit dhe ekipeve të vendeve të OKB-së, dhe në përputhje me Kornizën Operacionale Strategjike 2020-2025 të UNPRPD dhe KDPAK, është planifikuar të analizohet situata në secilin vend dhe të zhvillohen propozime të përbashkëta programore për veprim.

3. Qëllimi i analizës së gjendjes

Agjencitë e OKB-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: RMV), kanë kryer aktivitete në përputhje me KPS-në për të bërë një analizë të situatës me çështjen e aftësisë së kufizuar (në tekstin e mëtejme: Analizë).¹ Pesë konsulentë u angazhuan për të përgatitur analizën përmes një thirrje publike. Thirrja për konsultime ishte e hapur për të gjithë ekspertët e interesuar, pavarësisht gjinisë, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar etj. Qëllimi i analizës është të identifikojë parakushtet bazë për përfshirjen e aftësisë së kufizuar në rrjedhat kryesore të shoqërisë dhe të identifikojë pengesat dhe sfidat kryesore në arritjen e të drejtave themelore të njeriut për personat me aftësi të kufizuara. Në të njëjtën kohë, analiza duhet t'i vë në pah prioritetet dhe aktivitetet kryesore që duhet të mbështeten dhe të iniciohen në vend në periudhën e ardhshme në drejtim të përmbushjes së të drejtave për jetë individuale dhe të pavarur të personave me aftësi të kufizuara sipas KDPAK.

¹ Shih KDPAK: Disponueshmëria e parakushteve të nevojshme për të siguruar përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në politika, shërbime dhe ndërhyrje të tjera publike

4. Metodologjia

Duke pasur parasysh qëllimin përfundimtar të analizës, konsulentët zgjodhën një qasje hulumtuese për përgatitjen e saj. Qëllimi i hulumtimit ishte të kontribuonte në identifikimin e prioritetëve kryesore në vend, sipas KDKPAK. Mbledhja e të dhënave u krye përmes një metode të kombinuar të mbledhjes së të dhënave nga literatura ekzistuese dhe hulumtimi në terren.

Literatura ekzistuese e shqyrtuar përfshinte dokumente ligjore (ligje vendore, marrëveshje ndërkombëtare), praktika të organeve të të drejtave të njeriut, praktika gjyqësore dhe literaturë akademike. Rishikimi i literaturës u krye përmes një sondazhi në zyrë të kryer në korrik 2021.

Hulumtimi në terren përbëhej nga tre aktivitete (Shih Aneksin 1):

1) Organizimi dhe realizimi i fokus grupeve

Janë organizuar gjithsej nëntë fokus grupe. Shtatë fokus grupe u realizuan përmes videokonferencave me përfaqësues nga fusha të ndryshme, si më poshtë: përfaqësues të agjencive të OKB-së dhe komunitetit ndërkombëtar, përfaqësues të Trupit Koordinues Kombëtar për Zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (në tekstin e mëtejshëm: TKK për KDKPAK), përfaqësues të OPAK-ve dhe OSHC-ve, përfaqësues të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe OSHC-ve që punojnë në këtë fushë, përfaqësues të përfshirë në sistemet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe përfaqësues të organizatave të prindërve me fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara. Në këto fokus grupe morën pjesë gjithsej 44 persona, nga të cilët 13 burra dhe 31 gra, nga të cilët nëntë ishin persona me aftësi të kufizuara, nga të cilët dy gra dhe shtatë burra.

Fokus grupet e tjera janë realizuar me persona me aftësi të kufizuara. Në këto fokus grupe morën pjesë gjithsej 30 persona me aftësi të kufizuara, nga të cilët 19 burra dhe 11 gra.

2) Janë realizuar intervista individuale me përfaqësues të përzgjedhur të institucioneve kombëtare dhe persona me aftësi të kufizuara të cilët janë larguar nga institucionet dhe janë vendosur në njësi me banim të mbështetur të mbështetura nga Qendra për Mbështetjen e Personave me Aftësi të Kufizuara "Poraka – Negotinë" në Vllkovë. Janë realizuar gjithsej 9 intervista individuale, prej të cilave 2 me gra me aftësi të kufizuara.

3) Përgatitja dhe dorëzimi i pyetësorëve - Bazuar në udhëzimet e UNPRPD-së, konsulentët kanë përgatitur një pyetësor i cili u është dërguar të gjitha ministrive, duke përfshirë edhe Qeverinë e RMV-së. Të dhënat janë përpunuar përmes analizës kualitative të përmbajtjes.

4) Punëtoritë e vlefshmërisë. Janë mbajtur tre punëtori për vlefshmëri, një me OPAK-të, një me palët e interesuara të qeverisë dhe një me agjencitë e OKB-së. Gjetjet nga analiza e situatës u prezantuan dhe u diskutuan në punëtoritë e vlefshmërisë me të gjitha palët e interesuara të pranishme. Palët e interesuara dhanë komente të cilat u pasqyruan më tej në rekomandimet e propozuara.

Numri i paraparë i faqeve të Analizës dhe koha e kufizuar në dispozicion janë marrë parasysh gjatë hartimit të metodologjisë dhe kryerjes së analizës. Janë marrë parasysh edhe kufizimet e nevojshme konceptuale, si gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të nevojshme, ashtu edhe gjatë përgatitjes së tekstit të Analizës.

5.

Analiza e gjendjes dhe gjetjeve

Në përputhje me udhëzimet e UNPRPD-së, analiza fokusohet në disa nga fushat vijuese:

1. Analiza e palëve të interesuara dhe koordinimi – fokusimi në kapacitetin e bartësve të të drejtave dhe bartësve të detyrave dhe identifikimi i boshllëqeve të mundshme në kapacitetin e palëve kryesore të interesuara dhe OPAK-ve. Barrierat për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK-ve në proceset vendimmarrëse janë analizuar në mënyrë më të detajuar.
2. Analiza e politikave të barazisë dhe mosdiskriminimit – duke u fokusuar nëse mjedisi ligjor siguron mbrojtje, promovim dhe përmbushje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
3. Shërbimet inkluzive dhe shërbimet mbështetëse – disponueshmëria e sistemeve të vlerësimit dhe referimit të aftësisë së kufizuar, disponueshmëria e shërbimeve mbështetëse për aftësinë e kufizuar dhe deri në çfarë mase shërbimet bazë janë inkluzive dhe si lidhen ato me shërbimet mbështetëse të aftësisë së kufizuar.
4. Qasshmëria – a e rregullojnë korniza ligjore dhe standardet ekzistuese çështjen e qasshmërisë si parakusht kyç për personat me aftësi të kufizuara për të jetuar të pavarur dhe për të marrë pjesë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë në shoqëri;
5. Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara – shkalla në të cilën personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë të konsiderueshme në proceset komunitare, lokale dhe qendrore të natyrës së ndryshme. Kjo qasje bazohet në vlerësimin e nevojës për pjesëmarrje politike të personave me aftësi të kufizuara dhe e zgjeron atë duke u fokusuar në pjesëmarrje të konsiderueshme në një mori fushash kyçe të jetës së personave me aftësi të kufizuara në më shumë nivele;
6. Buxheti dhe menaxhimi financiar në përputhje me KDPAK – me fokus në politikat buxhetore për personat me aftësi të kufizuara dhe kontributin buxhetor për promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në përputhje me KDPAK.
7. Llogaridhënia dhe menaxhimi – disponueshmëria e provave inkluzive dhe sistemeve të mbledhjes së të dhënave për të kuptuar situatën e personave me aftësi të kufizuara, pabarazitë që ata përjetojnë

dhe barrierat me të cilat përballen për të marrë pjesë në baza të barabarta dhe mjaftueshmëria e mekanizmave kombëtarë të llogaridhënies.

Në fusha të ndryshme, analiza merr parasysh gjithashtu çështjet ndërsektoriale të gjinisë dhe moshës. Analiza trajton gjithashtu sfidat që dalin nga pandemia COVID-19

5.1 Analiza e palëve të interesuara dhe koordinimi

Trupi Koordinues Kombëtar për Zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (TKK për KDPAK) u krijua në prill të vitit 2018. Megjithatë TKK bashkon ministritë përkatëse, përfaqësuesit e qeverisë, OPAK-të ombrellë dhe qendrat e resurseve, akoma nuk ka një koordinim me OPAK-të dhe OSHC-të e pavarura të bazuara në të drejtat që mbështesin personat me aftësi të kufizuara që nuk janë të përfshirë në punën e TKK-së. Për më shumë informacion mbi çështjet strukturore, kapacitetet dhe çështjet sistematike që lidhen me punën e TKK-së, shihni Kornizën Kombëtare për Monitorimin dhe Zbatimin më poshtë. Njëri nga përfaqësuesit e OPAK-ve brenda TKK-së u zgjodh me thirrje publike 2/2018 për të emëruar një anëtar të TKK-së për zbatimin e KDPAK-së nga data 19 prill 2018, ndërsa tjetri propozohet nga Këshilli Kombëtar i Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara. .

Palët e interesuara qeveritare

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale konsiderohet si siguruksi kryesor i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara pasi shumica e organeve përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar punojnë nën kompetencat ombrellë të kësaj ministrie.

Në kuadër të Departamentit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Personave me Aftësi të Kufizuara pranë Zyrës së Avokatit të Popullit, është krijuar një ekip për monitorimin e zbatimit të KDPAK në vitin 2019. Ekipi punon për rastet e shkeljes së të drejtave dhe diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, si dhe për analizën e legjislacionit dhe propozimin për reforma ligjore për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me KDPAK. Ekipi i Avokatit të Popullit vendosi bashkëpunim me disa nga OPAK-të dhe gjatë pandemisë filloi të organizojë takime koordinuese duke përfshirë të gjithë aktorët përkatës që punojnë në kuadër të çështjeve që lidhen me personat me aftësi të

kufizuara. Aktualisht ky grup përbëhet nga 17 palë të interesuara, përfshirë OPAK, OSHC, individë, etj., dhe planifikohet të ristrukturohet në grupe tematike më të vogla. Avokati i Popullit ka zyra rajonale në të gjithë vendin, por rastet e personave me aftësi të kufizuara dërgohen në selinë e Shkupit.

Në Kuvendin e Maqedonisë ekziston një grup parlamentar ndërpartiak për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Ky grup u inicua nga OPAK-të dhe u formua si grup joformal në vitin 2003. Aktualisht, në përbërjen e re parlamentare, grupi përbëhet nga 50 anëtarë nga përfaqësues të partive të ndryshme politike. Koordinimi teknik drejtohet nga Polio Plus mbi baza vullnetare. Megjithatë deputetët janë të përkushtuar për avancimin e legjisllacionit përmes KDPAK, ekziston një koordinim i dobët midis këtij grupi dhe mekanizmave të tjerë koordinues qeveritar. Megjithatë grupi filloi një sërë reformash ligjore, vetëm disa prej tyre ishin të suksesshme.

Komisioni i sapoformuar për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMD) filloi punën në shkurt të vitit 2021, pasi nuk ishte funksional për më shumë se një vit.² Që nga rithemelimi i tij, anëtarët e Komisionit kanë treguar entuziazëm të madh duke mbështetur punën e tyre përmes mediave dhe duke marrë pjesë në ngjarje publike, duke rritur kështu gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me palët e tjera të interesuara, gjë e cila u evidentua përmes bashkëpunimit të tyre me OSHC-të gjatë periudhës së disa muajve të parë nga fillimi i punës së tyre.³

Personat me aftësi të kufizuara përfaqësohen përgjithësisht përmes OPAK-ve, si dhe organizatave të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të ndryshme. Shumica e OPAK-ve kanë qenë aktive për një kohë të gjatë dhe janë vetëm disa organizata që janë krijuar vitet e fundit. Ekzistojnë gjithashtu OSHC-të (si Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë) që punojnë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, kryesisht në ofrimin e ndihmës juridike, duke përfshirë pozicionimin strategjik në proceset gjyqësore para organeve ndërkombëtare⁴, të cilat ofrojnë mbështetje për procesin e deinstitutionalizimit, por edhe punojnë në rrafshin e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe të drejtat e grave me aftësi të kufizuara.

Burimi më i mirë për të dhënat relevante të bazuara në të drejtat si dhe statistikave kombëtare dhe lokale janë

OPAK-të, OSHC-të dhe organizatat ndërkombëtare dhe ambasadat aktive në vend (agjencitë e OKB-së, OSBE, Delegacioni i BE-së, Ambasada Britanike, Ambasada Zvicerane, USAID, etj.). Njëpërmjet mbështetjes së fortë financiare nga donatorët ndërkombëtarë, OPAK-të dhe OSHC-të me bazë në të drejtat adresojnë mungesën e të dhënave zyrtare duke krijuar të dhënat e tyre, përmes një sërë aktiviteteve kërkimore, që mbulojnë një gamë të gjerë fushash. Megjithatë, këto aktivitete janë të kufizuara në mënyrë të konsiderueshme nga burimet e disponueshme të cilat janë në dispozicion të rreth 130 OPAK-ve dhe OSHC-ve shtesë të ofruara nga programet e donatorëve për aftësinë e kufizuar që janë prekur rëndë nga pandemia KOVID-19.

Personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht ata që jetojnë në zonat rurale⁵, nuk kanë informacionin e nevojshëm për punën e OPAK-ve apo OSHC-ve ekzistuese që punojnë në fushën e personave me aftësi të kufizuara. Disa prej tyre janë të njohur me punën e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Shoqatës së Juristëve të Rinj të Maqedonisë si ofrues të ndihmës juridike falas. Disa nga banorët e rajonit të Shkupit, edhe pse kanë informacione, deri më tani nuk kanë përdorur asnjë mekanizëm në realizimin e të drejtave të tyre.

Megjithatë fusha e aftësisë së kufizuar në përgjithësi nuk është një fushë konflikti, pra ka një konsensus për këtë çështje midis të gjithë aktorëve, ende ekziston një nivel i lartë i inercisë nga politikanët, që më së shumti vjen si pasojë e mosnjohjes së mjaftueshme të fushës përkatëse, por edhe si pasojë e përpjekjeve të pamjaftueshme të OSHC-ve për përfaqësim të përbashkët.

Për qëllime koordinimi, shumica e ministrive dhe departamenteve qeveritare nuk kanë persona kontakti/pika kontakti për personat me aftësi të kufizuara. Shumica e zyrtarëve qeveritarë në ministri të ndryshme, duke përfshirë gjykatat dhe Kuvendin, nuk kanë njohuri dhe mirëkuptim për KDPAK-në. Shumica e dokumenteve zyrtare, si ligjet, politikat dhe qarkoret, nuk mund të përdoren nga personat me aftësi të kufizuara. Shumica e zyrave qeveritare në nivel kombëtar dhe lokal nuk janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.

OPAK-të dhe OSHC-të

Ekziston një diversitet i konsiderueshëm në kuptimin e aftësisë së kufizuar brenda lëvizjes për aftësinë e kufizuar. Këshilli Kombëtar i Organizatave të Aftësisë së Kufizuar (KKOAK) është një OPAK ombrellë që përfshin shtatë sindikata të OPAK-ve, bazuar në llojin e situatës ose afinitetit/interetit (Këshilli Kombëtar për të Shurdhërit dhe Personat me Vështirësi në Dëgjim, Federata Kombëtare për Sportin dhe Rekreacionin e Personave me Aftësi të Kufizuara, etj.). KKOAK ka

² Komisionit të kaluar i ka përfunduar mandati më 22.08.2019.

³ Shih më shumë në kapitullin mbi barazinë dhe mosdiskriminimin.

⁴ Shihni më shumë në linkun e mëposhtëm: <https://mhc.org.mk/news/presuda-na-evropskiot-sud-za-chovekovi-prava-po-aplikacija-na-helsinshkiot-komit-et-prekrsheni-pravata-na-osumgodishno-dete-so-poprechenost-koe-beshe-vrzuvano-zaradi-negova-bezbednost/?fbclid=IwAR2Ef3oCDJQ5K7U1YoaU3SsE5KGrRmptzy3BQpRrEx-3AE2L5uCsuiUYCQ>

⁵ Fokus grupet me personat me aftësi të kufizuara.

një strukturë ombrellë shumë të centralizuar të bazuar në kuptimin tradicional të aftësisë së kufizuar, dhe kryesisht sillet rreth qasjes mjekësore dhe nuk përfshin OPAK-të të bazuara në të drejtat. OPAK-të e bazuara në të drejtat janë një fillësë relativisht e re zhvillimi në 25 vitet e fundit. Ato janë shumë të zëshme në kërkimin e të drejtave pavarësisht nga aftësia e kufizuar, afinitetet apo shkaku i aftësisë së kufizuar. Kjo qasje e bazuar në të drejta unifikuuese e të gjithë aftësive të kufizuara është një komponent kyç i këtyre organizatave të ndryshme, edhe pse kapacitetet e tyre të përgjithshme ndryshojnë dukshëm. Një lloj i tretë i OPAK-ve janë OPAK-të e prindërve dhe qendrat e resurseve, të cilat fokusohen kryesisht në ofrimin e shërbimeve. Së fundi, ka OSHC të bazuara mbi të drejtat që janë aktive në fushën e aftësisë së kufizuar, duke zbatuar projekte dhe duke zhvilluar programe që trajtojnë çështje të ndryshme që lidhen me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Në përgjithësi, bashkëpunimi ndërmjet organizatave që punojnë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, dhe OPAK-ve dhe OSHC-ve, vlerësohet si shumë i ulët nga të gjitha palët e interesuara të konsultuara gjatë punës në terren. Ndarja është e dukshme, veçanërisht midis OPAK-ve, e cila reflektohet tek përfaqësimi i tyre i pamjaftueshëm dhe suksesi i ulët i arritur në realizimin e ndryshimeve sistematike të udhëhequra nga disa organizata të pavarura.

OPAK-të e bazuara në të drejtat nuk kanë një platformë apo rrjet për të ndarë dhe koordinuar punën e tyre. Disa prej këtyre OPAK-ve kanë arritur të mobilizohen në grupe të vogla joformale, duke kërkuar kryesisht reforma ligjore, por këto nisma mbeten ende ad hoc, të organizuara dobët dhe të pamjaftueshme. Megjithatë nevojat dhe synimet e OPAK-ve janë pak a shumë të njëjta ose të ngjashme, nuk ka një synim të qartë për të krijuar një agjendë të përbashkët.

Nevoja për bashkëpunim dhe koordinim më të mirë të organizatave që punojnë në këtë fushë u theksua nga shumica e palëve të interesuara gjatë fokus grupeve dhe intervistave. Disa nga të intervistuarit u shprehën se mungesa e bashkëpunimit ndërmjet OPAK-ve në vend është shqetësuese dhe duhet marrë seriozisht, pasi mund të ndikojë në mbështetjen e dhënë nga donatorë të ndryshëm.

Shumë nga përfitimet e ofruara nga shteti lidhen drejtpërdrejt me anëtarësimin e personave me aftësi të kufizuara në shoqatat e KKOAK. ⁶ Këto dispozita kufizojnë të drejtën e asociimit të personave me aftësi të kufizuara, gjë që kontribuon gjithashtu në shfaqjen e antagonizmit ndërmjet OPAK-ve, sindikatave dhe organizatave mëmë dhe parandalon krijimin e një zëri të vetëm e të unifikuar.

⁶ Për më shumë shih Kapitullin 5.5. Përfaqësimi dhe pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuar

Nga OPAK thonë se kanë bashkëpunim të mirë me institucionet kur bëhet fjalë për paraqitjen e nevojave dhe kërkesave të tyre, por ajo që mungon është reagimi i duhur si dhe rezultatet e mëvonshme.

Meqenëse OPAK-të dhe OSHC-të që punojnë në këtë fushë financohen kryesisht nga donatorë ndërkombëtarë, duke përfshirë agjencitë e OKB-së në vend, është krijuar bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, por ajo që mungon është qëndrueshmëria, pasi disa nga organizatat figurojnë vetëm në mënyrë pasive sapo të ketë mbaruar mbështetja e projektit.

Agjencitë e OKB-së që veprojnë në vend kanë krijuar partneritete me të gjitha institucionet përkatëse, duke përfshirë ministritë, qendrat e punës sociale, komunat. Megjithatë, nuk ka një koordinim të strukturuar të punës së agjencive të ndryshme të OKB-së kur bëhet fjalë për aktivitetet në fushën e aftësisë së kufizuar.

Ka mungesë të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara në media. Punonjësit e medias nuk janë të sensibilizuar kur bëhet fjalë për aftësinë e kufizuar dhe shpesh nuk dinë të paraqesin përmbajtje në lidhje me personat me aftësi të kufizuara, përveçse përmes një këndvështrimi të dhembshurisë.

5.2 Barazia dhe mosdiskriminimi

Pavarësisht përmirësimeve të konsiderueshme legjislative, duke përfshirë harmonizimin me legjislacionin⁷, ende nuk ka pajtueshmëri të mjaftueshme me ligjet dhe aktet nënligjore dhe politikat në lidhje me personat me aftësi të kufizuara, siç është theksuar në rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara⁸, ndërkohë që zbatimi i dispozitave ligjore paraqet një pikë veçanërisht të dobët. Në të njëjtën kohë, dispozitat ligjore i referohen vetëm barazisë formale në bazë të aftësisë së kufizuar.

Nuk ka uniformitet të **terminologjisë**⁹ së përdorur për personat me aftësi të kufizuara dhe lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara, si në përdorim individual, ashtu edhe në dokumente zyrtare, duke përfshirë ligjet, strategjitë, rregulloret, etj. Shpesh përdoret terminologji e ndryshme dhe e vjetër, e cila bazohet

⁷ Komisioni Evropian. (2020). Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020.

⁸ Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. (2018). Vrojtimet përfundimtare mbi raportin fillestar të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

⁹ Legjislacioni ka shumë terma që i referohen këtij grupi njerëzish, nga invalidët dhe personat me invaliditet, personat me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike, e deri tek personat me aftësi të kufizuara etj. Kjo krijon një dikotomi juridike dhe kjo analizë nuk synon të rishqyrtojë çështjen. Autorët përdorin termin persona me aftësi të kufizuara si më afër modelit social të aftësisë së kufizuar, por jo modelin e të drejtave të njeriut. Kur citohen tekste ose politika ligjore, përdoret termi origjinal i dokumentit ligjor të cituar.

në modelin mjekësor.¹⁰ Përdorimi i përkufizimeve dhe kategorizimeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar në legjislacion nuk është në përputhje me modelin e aftësisë së kufizuar të bazuar në të drejtat e njeriut.¹¹ Për më tepër, përkufizimet e personave me aftësi të kufizuara të përdorura në dokumente të ndryshme nuk janë të unifikuara, ndërsa personat me aftësi të kufizuara psikosociale nuk njihen fare, duke përjashtuar kështu një komunitet të tërë nga sistemi i përgjithshëm i përfitimeve sociale bazuar në aftësinë e kufizuar.

Një pjesë e madhe e publikut ka qëndrim negativ ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe këto pikëpamje mbështeten përgjithësisht nga moskuptimi i aftësisë së kufizuar dhe ndaj personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi. Qeveria duhet të vlerësojë efektivitetin dhe ndikimin e strategjive dhe fushatave të saj që synojnë rritjen e ndërgjegjësimin të publikut.¹²

Vetëm një pjesë e vogël e personave me aftësi të kufizuara janë të njohur me KDPAK dhe asnjë nga të anketuarit që morën pjesë në fokus grupet nuk ka informacion për ekzistencën e TKK për KDPAK.¹³

E drejta për barazi dhe mosdiskriminim garantohet me nenin 9 të **Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut**,¹⁴ por aftësia e kufizuar ende nuk është përfshirë si bazë e veçantë për diskriminim.¹⁵ Gjithashtu, terminologjia (persona me aftësi të kufizuara, invalidë) e përdorur në Kushtetutë është e vjetëruar dhe nuk është në përputhje me KDPAK.

Strategjia Kombëtare për Barazinë dhe Mosdiskriminimin 2016-2020 parashikon tre synime të përgjithshme strategjike, nga të cilat, sipas informacionit të disponueshëm për periudhën e dhënë, i vetmi sukses i rëndësishëm është arritur në drejtim të përmirësimit të kornizës ligjore për mundësi të barabarta dhe mosdiskriminim, ndërkaq progresi më i vogël vërehet në ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e punës dhe koordinimin e mekanizmave institucionalë për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Një nga dobësitë e konstatuara në Strategji është buxheti i pamjaftueshëm i mjeteve të destinuara për zbatimin e

saj, gjë që rrezikon zbatimin e Strategjisë.¹⁶ Strategjia e re për 2021-2026 ende nuk është përgatitur.

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi¹⁷ rendit aftësinë e kufizuar si një nga shkaqet e diskriminimit,¹⁸ duke përfshirë përkufizimin e personave me aftësi të kufizuar si persona me çrregullime afatgjata fizike, intelektuale, mendore ose shqisore, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme sociale, mund të parandalojnë përfaqësimin e tyre të plotë dhe efektiv në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.¹⁹ Ligji ndalon të gjitha llojet dhe format e diskriminimit, duke përfshirë diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, dhe nxitjen për diskriminim, ngacmimin, viktimizimin dhe segregacionin, dhe format më të rënda të diskriminimit brenda ligjit nënkuptojnë diskriminim të shumëfishtë, diskriminim të kryqëzuar, diskriminim të përsëritur dhe të vazhdueshëm.²⁰ Ligji mbulon gjithashtu diskriminimin nëpërmjet asociimit, si p.sh. dallimi, përjashtimi ose kufizimi i një personi në bazë të marrëdhënies së atij personi me një person ose grup tjetër për çfarëdo bazë diskriminuese,²¹ që përfshin personat e prekur nga statusi i personave me aftësi të kufizuara. Ligji thekson se ndalimi i diskriminimit nënkupton edhe sigurimin e qasjes adekuate në infrastrukturë, mallra dhe shërbime, kryesisht nëpërmjet zbatimit të parimit të akomodimit të arsyeshëm, dhe se mohimi i akomodimit të arsyeshëm përbën diskriminim.²² Megjithatë, ekziston një problem i dukshëm që lind me kuptimin dhe zbatimin e parimit të akomodimit të arsyeshëm që sugjeron se ai është ende mjaft i paqartë dhe i interpretuar në mënyra të ndryshme. Shpesh barazohet me qasshmërinë, gjë që çon në aplikimin selektiv të tij, gjë që lë hapësirë për diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuara. Parimi i akomodimit të arsyeshëm nuk njihet nga vetë institucionet, gjë që dëshmohej nga mungesa e udhërrëfyesve për akomodim të arsyeshëm, të cilat çdo institucion është i detyruar t'i përgatisë dhe t'i zbatojë në punën e vet.

Qasja në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara është shumë e kufizuar. Të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara përballen me vështirësi në lidhje me qasjen në gjykata dhe drejtësi, gjë që kufizon të drejtën e tyre për një gjykim të drejtë dhe të barabartë në

¹⁰ Fokus grupe të OPAK-ve.

¹¹ Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. (2018). Vrojtimet përfundimtare për raportin fillestar të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

¹² K. Panajotova, E. Koçoska, Analizë: Ndihmë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara që largohen nga institucionet e përkujdesjes, 2020.

¹³ Fokus grupet me personat me aftësi të kufizuara.

¹⁴ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë. Me numrin e dispoziteës 08-4642 / 1.

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë. Me numrin e dispoziteës 08-4642 / 1.

¹⁶ Komisioni Europian. (2020). Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020.

¹⁷ Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 258/2020 datë 30.10.2020.

¹⁸ Ibid, Neni 5.

¹⁹ Ibid, Neni 4.

²⁰ Ibid, Neni 13.

²¹ Ibid, Neni 4.

²² Ibid, Neni 4.

kushte të barabarta.²³ Analiza e qasshmërisë së gjykatave në vend tregon se ato janë plotësisht jofunksionale për personat me aftësi të kufizuara (me përjashtim të Gjykatës Themelore në Manastir),²⁴ ndërsa njohuritë e gjykatësve në fushën e aftësisë së kufizuar janë ende shumë në nivel të ulët,²⁵ duke përfshirë njohuritë për të drejtat sipas KDPK.²⁶ Analiza e proceseve gjyqësore të nisura për mbrojtje nga diskriminimi në vitin 2020 tregon mungesën e mbajtjes së statistikave të qarta për fushat dhe shkaqet e diskriminimit, gjegjësisht gjykatat nuk përfshijnë bazën e aftësisë së kufizuar, gjë që sjell mungesë të të dhënave për tendencat e mundshme dhe dukuritë në këtë fushë.

Personat me aftësi të kufizuara shumë rrallë u drejtohen zyrtarisht rajonale të Ministrisë së Drejtësisë për ndihmë juridike falas, e kjo vjen si pasojë e informacionit të pamjaftueshëm për këto shërbime, por edhe për shkak të trajnimit të pamjaftueshëm të nëpunësve civilë për të punuar me personat me aftësi të kufizuara.²⁷ Për më tepër, organizatat që ofrojnë ndihmë juridike falas kanë kapacitet të pamjaftueshëm për të komunikuar me personat me aftësi të kufizuara.²⁸ Tarifa e ofruar nga shteti për ndihmën juridike falas është relativisht e ulët, duke marrë parasysh standardet evropiane, ndërsa shteti nuk ka mekanizma adekuat për monitorimin e cilësisë së ndihmës juridike falas, si nga ofruesit e ndihmës juridike parësore ashtu edhe nga ofruesit e ndihmës juridike dytësore.

Ligji i ri për mbrojtjen sociale²⁹ i cili u miratua në maj 2019, promovon parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit në ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes sociale, të cilat bazohen në trajtimin e barabartë dhe të drejtë, duke përfshirë aftësinë e kufizuar si bazë për diskriminim. Disa nga të drejtat dhe shërbimet e përfshira në ligjin e mëparshëm janë ndryshuar dhe/ose riformuluar në këtë ligj dhe në të njëjtën kohë janë ofruar një numër i konsiderueshëm të drejtash dhe shërbimesh të reja nga mbrojtja sociale, për të mbështetur procesin e deinstitutionalizimit.

Personat me aftësi të kufizuara nuk janë mjaftueshëm të

informuar për ndryshimet e parashikuara nga ligji i ri dhe disa prej tyre mendojnë se u janë mohuar disa të drejta që kanë pasur në ligjin e mëparshëm,³⁰ veçanërisht në aspektin e përfitimeve financiare³¹ dhe në të njëjtën kohë përballen me vështirësi në ushtrimin e të drejtave të tyre për shkak të kohëzgjatjes së vendimmarrjes nga Qendra për Punë Sociale (QPS).³² Gjithashtu, interpretime të ndryshme të dispozitave ligjore janë vërejtur edhe nga nëpunësit civilë në QPS të ndryshme,³³ gjë që tregon për njohuri të pamjaftueshme të dispozitave ligjore dhe pabarazi në interpretimin e tyre. OSHC-të dhe KMD kanë regjistruar raste në lidhje me ndryshimet në ligj që u referohen shfrytëzuesve të cilët duhet të ri-aplikonin për të drejtat që i kishin shfrytëzuar sipas ligjit të mëparshëm.³⁴

Ligji i ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, i cili ka hyrë në fuqi në maj 2021, përfshin parimin e mosdiskriminimit, sipas të cilit masat, aktivitetet dhe shërbimet e parashikuara me ligj duhet të zbatohen pa diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.³⁵ Ligji parashikon që institucionet kompetente gjatë marrjes së masave dhe aktiviteteve duhet të kenë parasysh pasojat e dhunës me bazë gjinore ndaj kategorive të cënueshme të grave, ku përfshihen gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë me fëmijë me aftësi të kufizuara,³⁶ si dhe përshtatjen e duhur të masave, aktiviteteve dhe shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore ndaj nevojave specifike të grave me aftësi të kufizuara.³⁷ Është e rëndësishme të theksohet se aktet nënligjore për këtë ligj janë duke u përgatitur. Të gjitha këto dokumente do të përfshijnë komponentin e personave me aftësi të kufizuara. Shumica e strehimoreve/shellterëve janë të paqasshme për gratë me aftësi të kufizuara, që do të thotë se ato nuk përmbushin standardet minimale të Konventës së Stambollit.³⁸ Vetë ligji nuk parashikon masa dhe nuk e trajton dhunën në shtëpi dhe institucione grupore që shihen si njësi familjare dhe forma të reja të organizuara jetese, që do të thotë se nuk është në përputhje të plotë me KDPK.

²³ Petrovska N. dhe Avramovski, D. (2021) Qasja juridike, financiare dhe fizike në drejtësi në gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Koalicioni 'Të gjithë për një gjyqësor të drejtë'.

²⁴ Fokus grupe me përfaqësues të mekanizmave mbrojtës.

²⁵ Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. (2018). Vrojtimet përfundimtare mbi raportin fillestar të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

²⁶ Fokus grupe me përfaqësues të mekanizmave mbrojtës.

²⁷ Jovanovska B. (2020). Fuqizimi ligjor i komunitetit në procesin e deinstitutionalizimit: Raport. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

²⁸ Petrovska N. dhe Avramovski, D. (2021) Qasja juridike, financiare dhe fizike në drejtësi në gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Koalicioni 'Të gjithë për një Gjyqësor të Drejtë'.

²⁹ Ligji për Mbrojtjen Sociale. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20 dhe 311/20.

³⁰ Jovanovska, B. (2020). Fuqizimi ligjor i komunitetit në procesin e deinstitutionalizimit: Raport. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

³¹ Fokus grupet me personat me aftësi të kufizuara. Intervistë me përfaqësues të Avokatit të Popullit.

³² Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2021). Raporti vjetor për vitin 2020. .

³³ Fokus grup me ofruesit e shërbimeve, Intervistë me përfaqësues të Avokatit të Popullit.

³⁴ Fokus grupe me përfaqësues të mekanizmave mbrojtës.

³⁵ Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 24 nga 29.1.2021. Neni 5.

³⁶ Ibid, Neni 7.

³⁷ Ibid, Neni 8.

³⁸ Komisioni European. (2020). Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020.

Në gusht të vitit 2019 është miratuar **Ligji i ri për Arsimin Fillor**, i cili bazohet në parimet e barazisë, disponueshmërisë, qasshmërisë dhe inkluzivitetit të arsimit, dhe aty për herë të parë është inkorporuar aftësia e kufizuar si bazë për diskriminim. Megjithatë, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri në shtator 2019, është rritur numri i ankesave të parashtruara deri tek Avokati i Popullit, si dhe tek OSHC-të.³⁹ Prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara ankohen për numrin e kufizuar të mësuesve-asistentëve në arsim që ishte një nga format e mbështetjes për nxënësit që parashikon ligji i ri. Gjithashtu, shumë fëmijë me aftësi të kufizuara nuk janë përfshirë ende nga vlerësimi funksional për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm të Qendrave për Vlerësimin Funksional dhe Mbështetjen e Fëmijëve dhe të Rinjve, dhe për këtë arsye nuk mund të marrin mbështetjen e duhur arsimore sipas nevojave të tyre individuale.

Edhe pse arsimi i mesëm, ashtu si dhe ai fillor, është i detyrueshëm për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, ende nuk janë miratuar ndryshimet në Ligjin për arsimin e mesëm për të krijuar arsimin inkluziv.

Dënimet e parashikuara në **Ligjin për Ndërtim**, i cili rregullon qasjen deri te ndërtesat dhe brenda tyre, si dhe projektimin dhe ndërtimin e objekteve që ofrojnë qasje të papenguar, lëvizjen, qëndrimin dhe punën e personave me aftësi të kufizuara, janë të ulëta dhe kundërvajtëse, duke nxitur kështu kompanitë e ndërtimit që të mos respektojnë dispozitat ligjore për arsye përfitimi.⁴⁰

Pavarësisht rekomandimeve dhe përpjekjeve për të zbatuar qasjen ndërsektoriale në miratimin e ligjeve dhe politikave, personat me aftësi të kufizuara që i përkasin grupeve të caktuara të marginalizuara (në bazë gjinie, etnie, kombësie, etj.) akoma nuk njihen mjaftueshëm. Në të njëjtën kohë, gjatë raportimit të rasteve të diskriminimit, është e zakonshme të merren parasysh arsyet e diskriminimit. Është me rëndësi të përmendet se baza parësore për evidentimin e rasteve të diskriminimit të shumëfishtë apo ndërsektorial tek Avokati i Popullit është baza e aftësisë së kufizuar.⁴¹

Personat me aftësi të kufizuara nuk janë mjaftueshëm të **përfshirë në procesin e politikëbërjes**,⁴² gjë që ishte veçanërisht e dukshme gjatë pandemisë COVID-19. Personat me aftësi të kufizuara, apo OSHC-të që punojnë në këtë fushë, nuk janë përfshirë fare në procesin e miratimit të masave dhe politikave për

mbrojtjen dhe përballimin e pasojave të virusit dhe për këtë arsye të njëjtat nuk janë në përputhje me nevojat e tyre specifike, si dhe nevojat e kujdestarëve të tyre.⁴³ Nga gjithsej 250 dekrete të fuqizuara me ligj të miratuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, vetëm dy dekrete përmendin shprehimisht personat me aftësi të kufizuara.⁴⁴

Procesi i deinstitutionalizimit kontribuon në forcimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara të parashikuara në KDPK, për të siguruar jetë cilësore dhe dinjitoze dhe përfshirje sociale, që përveç mbylljes së institucioneve nënkupton edhe ngritjen dhe zhvillimin e shërbimeve në komunitet, por edhe pjesëmarrjen e shfrytëzuesve në vendimmarrje në nivele të ndryshme. Procesi i deinstitutionalizimit është në vazhdim, por është thelbësore të sigurohet cilësia e ofrimit të shërbimeve nëpërmjet monitorimit efektiv, si dhe krijimit të shërbimeve shtesë në komunitet për të identifikuar fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara që janë të ekspozuar ndaj rrezikut social dhe izolimit, dhe janë viktimat të diskriminimit dhe segregacionit.⁴⁵

Sipas rekomandimeve të fundit të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve dhe Ndëshkimeve Çnjerëzore ose Degraduese (KPT), përveç nevojës për aktivitete të rregullta në natyrë dhe rritje të aktiviteteve rehabilituese, të gjithë të mbrojturve në institucionin special në Demir Kapi, pavarësisht nëse u është hequr aftësia juridike, duhet t'u jepet e drejta efektive për të nisur procedurë për ligjshmërinë e akomodimit dhe qëndrimit të tyre, dhe t'u sigurohet rishikim dhe rishqyrtim i rregullt dhe i menjëhershëm i vendimeve të strehimit nga ana e gjykatave.⁴⁶ Me qëllim të përmirësimit të procesit të deinstitutionalizimit në spitalet psikiatrike në Demir Hisar dhe Negorci, KPT vë në pah mungesën e shërbimeve adekuate për të mbështetur shëndetin mendor dhe jetën e pavarur në komunitet. Në spitalin e Demir Hisarit, mundësitë për lëvizje dhe aktivitete në ambient të hapur janë të kufizuara dhe ka ende raste të detyrimit të shfrytëzuesve (duke i mbajtur ata lidhur) në të dy spitalet.⁴⁷

⁴³ Jovanovska, B. dhe Petkovska, N. (2021). Ndikimi i krizës së shkaktuar nga Covid-19 tek personat me aftësi të kufizuara në Maqedoninë e Veriut. Fondacioni Westminster për Demokraci.

⁴⁴ Ibid.

⁴⁵ Komisioni Evropian. (2020). Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020.

⁴⁶ Keshilli i Europës. (2021). Raport deri tek autoritetet e Maqedonisë së Veriut për vizitën në Maqedoninë e Veriut të realizuar nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruar (CPT) nga 2 deri më 10 dhjetor 2019.

⁴⁷ Ibid.

³⁹ Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2020). Raport i veçantë për hulumtimin e kryer për gjendjen e realizimit të së drejtës për arsimim të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

⁴⁰ Fokus grup me ofruesit e shërbimeve, fokus grup me OPAK.

⁴¹ Intervistë me përfaqësues të Avokatit të Popullit.

⁴² Fokus grup me OPAK.

5.3 Qasshmëria

Politikat dhe ligjet e vendit i referohen qasshmërisë thjesht si një koncept pa ndonjë zbatim apo strategji financimi.

Qasshmëria fizike

Ligji për ndërtim⁴⁸ rregullon të drejtën e qasjes fizike dhe hyrjes në ndërtesat publike dhe hapësirat publike, si dhe projektimin dhe ndërtimin e shtigjeve për këmbësorë për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara fizike dhe personave me shikim të dëmtuar. Në nivel lokal, planifikimi urban dhe dhënia e lejeve të ndërtimit është rregulluar me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale,⁴⁹ i cili nuk përfshin parimin e mosdiskriminimit dhe parimin e qasshmërisë. Pra, në nivel lokal nuk është e qartë se cili autoritet është përgjegjës për zbatimin e dispozitave të Ligjit për Ndërtim, dhe problemet lindin për shkak të interpretimeve të ndryshme të këtij ligji.⁵⁰ Obligimi për sigurimin e qasjes fizike është rregulluar në rregulloren për mënyrën e sigurimit të qasjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së papenguar të personave me aftësi të kufizuara deri te objektet dhe brenda tyre.⁵¹ Kjo rregullore thekson standardet minimale për mënyrën e sigurimit të qasjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së papenguar të personave me aftësi të kufizuara deri te objektet dhe brenda objekteve për përdorim publik, afarist, banesor dhe afarist-banesor. Rregullorja për standarde dhe norma në planifikimin urbanistik⁵² rregullon edhe të drejtën për hapësira për parkingje. Qasja në objektet hotelierike është e rregulluar me rregulloren për kategorizimin e objekteve hotelierike.⁵³

Megjithatë korniza ligjore dhe politikat e miratuara në këtë fushë janë mjaft të qarta, problemi lind me zbatimin e duhur të tyre në praktikë dhe interpretimet e ndryshme. Shumë institucione publike, madje edhe objekte të reja, nuk janë fizikisht të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.⁵⁴ Ligji për ndërtim aktualisht është duke u shqyrtuar nga qeveria dhe është mbajtur një konsultim me Këshillin Kombëtar të Organizatave të Aftësisë së

Kufizuar (KKOAK).⁵⁵

Pjesëmarrësit në fokus grupet theksojnë se objektet, si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale, janë të paqasshme. Studime të shumta kanë dalë gjithashtu në përfundimin se ndërtesat janë të paqasshme. Pavarësisht detyrimit ligjor, në praktikë, ndërtimi i një ndërtese të qasshme dhe të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara mbetet kryesisht një çështje e zgjedhjes individuale nga subjektet publike dhe private.

Pjesëmarrësit e fokus grupeve theksojnë se objektet, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, janë të paqasshme. Deklarata për paqasshmëri të plotë fizike të objekteve janë konfirmuar edhe nga studime të shumta. Edhe përkundër detyrimit ligjor, në praktikë, sigurimi i qasshmërisë dhe disponueshmërisë së objekteve për personat me aftësi të kufizuara mbetet një çështje e zgjedhjes personale të subjekteve publike dhe private.

Transport i qasshëm

Ligji për transportin rrugor⁵⁶ nuk siguron barazi thelbësore. Ligji ka vetëm dispozita për përfitimet për personat me aftësi të kufizuara në transport, të cilët duhet të jenë anëtarë të KKOAK. Një zgjidhje e ngjashme ligjore është paraparë edhe në Ligjin për rrugët publike,⁵⁷ i cili parasheh që personat me aftësi të kufizuara të mos paguajnë tarifa për shfrytëzimin e rrugëve publike, në përputhje me diagnozën dhe shkallën e invaliditetit të përcaktuar në aktin e komisionit kompetent të fondit të sigurimit pensional dhe invalidor (FSPI). Kjo zgjidhje ligjore është kopjuar edhe në Programin për shfrytëzim përfitues të transportit publik urban nga personat me aftësi të kufizuara,⁵⁸ ku personat me aftësi të kufizuara sërish përcaktohen në bazë të diagnozës dhe shkallës së aftësisë së kufizuar. Për më tepër, ky program përmban një kufi moshe prej 26 vjeç.

Ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor⁵⁹ nuk përcakton se cilat janë hapësirat e parkimit për personat me aftësi të kufizuara. Në të njëjtën kohë, ligjvënësit nuk kanë arritur të rregullojnë plotësisht përdorimin e automjeteve nga ndihmësit dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Ligjvënësit gjithashtu nuk kanë rregulluar lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara me qen udhërrëfyes. Dispozitat e këtij ligji nuk përmendin

⁴⁸ Ligji për Ndërtim, Gazeta Zyrtare nr. 130/09, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13.

⁴⁹ Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare nr. 5/02.

⁵⁰ Shih: Hendikep – Mozaiku i munguar, Deklaratë për Statusin e Personave me Aftësi të Kufizuara, Polio Plus, 2012, f.77, <www.polioplus.org.mk>

⁵¹ Rregullorja për mënyrën e sigurimit të papenguar të qasjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuara deri në objekte dhe brenda tyre, <http://www.mtc.gov.mk/new_site/images/storija_doc/115/pravilnici/25-2010.pdf>

⁵² Rregullorja për standardet dhe normat e planifikimit urbanistik, <http://mtc.gov.mk/new_site/images/storija_doc/1353/Pravilnik%20za%20standardi%20i%20normativi%20za%20urb.planiranje%5B1%5D.pdf>

⁵³ Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kushtet për kategorizimin e objekteve hotelierike. Në dispozicion në: <https://dejure.mk/zakon/pravilnik-za-uslovi-za-kategorizacija-na-objektite-za-vrshenje-na-ugostitelstva-dejnost>

⁵⁴ Deklaratat e fokus grupeve me OPAK-të dhe ofruesit e shërbimeve

⁵⁵ Deklaratat e fokus grupeve me përfaqësues të OPAK-ve

⁵⁶ Ligji për Transportin Rrugor, Gazeta Zyrtare nr. 68/04, 127/06, 114/09, 83/10, 140/10, 17/11, 53/11, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese: 01.02.2006; 14.05.2008; 10.11.2010.

⁵⁷ Ligji për rrugët publike, Gazeta Zyrtare nr. 84/08, 52/09, 114/09, 124/10, 23/11, 53/11, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese: 10.03.2010.

⁵⁸ Programi i Qytetit të Shkupit për vitin 2018 <http://ipserver1.skopje.gov.mk/e-skopje/sluzben%20glasnik%20so%20konverzija.nsf/82aa49069edfbbb780256a22004ba9e0/030cd9927ac366ecc1258370004336ce?OpenDocument>

⁵⁹ Teksti i konsoliduar i Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, <http://www.mvr.gov.mk>

parimet e qasshmërisë dhe disponueshmërisë në kushtet për marrjen e patentë shoferit dhe licencës për të operuar me autobusë, trena ose transport autotaksi, në mënyrë që të plotësohen së paku parakushtet minimale për sigurimin e transportit për udhëtarët me aftësi të kufizuara.

Informacioni dhe komunikimi

Sipas Ligjit për qasje të lirë në informacion me karakter publik,⁶⁰ poseduesit e informacionit janë të obliguar ta informojnë publikun për punën e tyre. Ligji nuk parashikon që informacioni publik duhet të jepet në formate të qasshme. Ligji për përdorimin e gjuhës së shenjave⁶¹ parashikon të drejtën e personave me dëmtim të dëgjimit për të përdorur gjuhën e shenjave në rolin e pjesëmarrësit ose palës në procedurat para autoriteteve shtetërore. Personat kanë të drejtë të përdorin gjuhën e shenjave për qëllime të tjera, por vetëm deri në 30 orë në vit, duke ushtruar kështu të drejtën e tyre për përkthyes. Vendimi për përdorimin e gjuhës së shenjave i është lënë QPS-së, gjë që vetëm e kufizon më tej përdorimin e gjuhës së shenjave

Personat me dëmtime në dëgjim dhe të folur theksojnë se përballen me vështirësi në ushtrimin e të drejtave të tyre për shkak të numrit të pamjaftueshëm të përkthyesve dhe interpretuesve të trajnuar në gjuhën e shenjave. Lista e përkthyesve⁶² të gjuhës së shenjave është vetëm 31, që është tregues i mungesës së përkthyesve. Nuk ka asnjë ligj të veçantë apo pjesë të ligjit në vend që do të stimulonte studimin e shkrimit Braj (Braille) dhe kjo duhet të parashikohet në të ardhmen.

Gjetjet nga hulumtimi i opinionit publik arrijnë në përfundimin se mediat nuk janë të interesuara për situatat që prekin personat me aftësi të kufizuara dhe se zakonisht e trajtojnë këtë çështje duke i paraqitur rastet individuale, më së shpeshti në mënyrë të papërshtatshme, dhe qasja është sensacionale, me patos dhe keqardhje.⁶³

Ligji për të dhënat në formë elektronike dhe nënshkrimin elektronik⁶⁴ ofron një përkufizim të nënshkrimeve elektronike që nuk është i harmonizuar me KDPAK. Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audio-vizuale⁶⁵ nuk ka

një ndalesë të qartë të diskriminimit në bazë të aftësisë së kufizuar lidhur me qasshmërinë dhe disponueshmërinë e transmetuesve dhe transmetimin e informacionit të qasshëm dhe të disponueshëm të llojit të ndryshëm.

Në përputhje me rekomandimet e dhëna në planin e veprimit të TKK për KDPAK-në, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës ka parashikuar aktivitete që synojnë zhvillimin e një plani veprimi për zhvillimin e faqeve të internetit në përputhje me standardet e qasshmërisë.⁶⁶ Edhe përkundër detyrimit për qasshmëri në faqet e internetit, faqet shtetërore të internetit ende nuk mundësojnë qasje.

Burimet e teknologjisë ndihmëse janë të kufizuara në dy faqe interneti dhe një pjesë të vogël printerësh me alfabetin Braj (Braille). Ekzistojnë dy faqe interneti (<http://nssrm.org.mk/> dhe <https://samoglas.mk>) me biblioteka të librave audio në gjuhën maqedonase, duke përfshirë letërsinë artistike, literaturën profesionale për ligjin dhe ligje dhe manuale të caktuara që kanë të bëjnë me personat me shikim të dëmtuar. Printerët e alfabetit Braj gjenden vetëm në Fakultetin Filozofik në Shkup, Shkollën Publike për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve me Pengesa në Shikim "Dimitar Vlahov" dhe Shoqatën Kombëtare të Personave të Verbër.

Komisioni për Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit në Fakultetin Filozofik krijoi fontin e parë cirilik për disleksikët, Dyslexic FZF, dhe në bashkëpunim me Shoqatën Einstein u promovuan lekturat e para lehtësisht të lexueshme.

Me iniciativën e MPPS-së, UNDP-së dhe Shoqatës Kombëtare të të Verbërve, u promovua mjeti i parë digjital, audiolexuesi "Kiko" – aplikacion falas i disponueshëm në gjuhën maqedonase, ndërsa versioni i tij në gjuhën shqipe aktualisht është duke u zhvilluar. Shumica e nismave të mësipërme mbështeten nga komuniteti ndërkombëtar dhe agjencitë e OKB-së në vend.

TKK për KDPAK e shndërroi KDPAK në format audio, në një format lehtësisht të kuptueshëm dhe i njëjti u printua në alfabetin Braj, por ky informacion dhe materiale akoma nuk i arrijnë personat me aftësi të kufizuara në të gjithë vendin. Vetëm tre pjesëmarrës të fokus grupeve të personave me aftësi të kufizuara ishin të njohur me dispozitat e KDPAK; dy prej tyre ishin nxënës të shkollave speciale ku ishte dhënë ky informacion dhe një person kishte marrë informacionin nga një edukim i UNDP-së.

Të gjithë personat e pranishëm në fokus grupet deklaruan se nuk kishin informacion se kishte një TKK për KDPAK. Personat me aftësi të kufizuara besojnë se shoqëria jonë nuk është e përshtatur për personat me aftësi të kufizuara. Ata nuk janë të njohur me termat "dizajn universal"

⁶⁰ Ligji për Qasje të Lirë në Informacione Publike, Gazeta Zyrtare nr. 6/10.

⁶¹ Ligji për përdorimin e gjuhës së shenjave, Gazeta Zyrtare nr. 105/09.

⁶² Shoqata Kombëtare e të Shurdhërve të R.së Maqedonisë, <http://www.deafmkd.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=55&Itemid=80>

⁶³ Shih: Zh. Poposka, E. Koçoska, Z. Shavreski. Raport holistik për personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë, 2015. Hapni dritaret, në dispozicion në: https://civicamobilitas.mk/wp-content/uploads/2018/02/0_holisticki_izvestaj_zh_licata_so_poprecenost_vo_makedonija-mk.pdf

⁶⁴ Ligji për të dhënat në formë elektronike dhe nënshkrimin elektronik, Gazeta Zyrtare nr. 34/01, 6/02, 98/08.

⁶⁵ Ligji për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizive, Gazeta Zyrtare nr. 184/13, 13/14, 44/14.

⁶⁶ Plani i veprimit për vitin 2021 i TKK për zbatimin e KDPAK, i disponueshëm në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/akciski_plan_zh_2021_godina_zh_implementation_na_konvencijata.pdf

dhe “akomodim i arsyeshëm”, por e dinë se përballen me problemin e qasjes në institucione dhe lëvizjes në mjedisin e tyre lokal. Asnjë nga pjesëmarrësit e fokus grupit me shikim të dëmtuar që përdorin alfabetin Braj nuk kishte material në këtë format në mjedisin ku ata jetonin. Gjithashtu, asnjëri prej tyre nuk e kishte parë materialin në një format lehtësisht të kuptueshëm, ndaj të afërmit i ndihmojnë të kuptojnë atë që marrin në formë gojore ose të shkruar si informacion. Të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre besojnë se punonjësit e institucioneve nuk kanë informacion të mjaftueshëm për mënyrën e trajtimit dhe komunikimit me personat me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara raportuan se kishin përjetuar dhe parë sjellje agresive të nëpunësve civilë ndaj tyre dhe të tjerëve në shumë raste.

Pjesëmarrësit e fokus grupeve theksojnë se njerëzit në institucione nuk kanë kohë dhe durim për t'u shpjeguar gjërat apo për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuara. Të gjithë pjesëmarrësit në fokus grupet rurale deklaruan se nuk kishin informacion se kishte OPAK që mund të luftonin në emër të tyre për të ushtruar të drejtat e tyre ose që ofronin ndihmë juridike falas.

Në fillim të gjendjes së jashtëzakonshme të pandemisë KOVID-19, konferencat për shtyp të qeverisë ishin i vetmi burim informacioni. Pas reagimeve të OPAK-ve, konferencat për shtyp janë shoqëruar me gjuhën e shenjave. Përveç këtij informacioni, të gjitha debatet publike përmes mediave ishin në një format të paqashtëm, duke përfshirë faqet e internetit të qeverisë dhe numrat e urgjencës të hapur për këtë qëllim. Në rrethana të tilla, personat me aftësi të kufizuara përballen me sfida serioze. Shumica e objekteve mjekësore janë gjithashtu të paqashtëm. Qendrat e testimit nuk ishin përjashtim. Masat me vendosjen e maskave të detyrueshme, kufizuan edhe personat me aftësi të kufizuara (të shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim).⁶⁷ Sipas hulumtimit, një nga vështirësitë më të mëdha me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë kanë qenë socializimi i kufizuar (21.5%) dhe lëvizja e kufizuar (20.9%), ndërsa 18.3% kanë hasur vështirësi në respektimin e masave mbrojtëse, gjegjësisht mbajtjen e distancës fizike, shmangien e grupeve dhe vështirësi në mbajtjen e maskës.⁶⁸ Shkollat fillore dhe të mesme kryesisht besojnë se fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara mund të ndjekin vetëm pjesërisht mësimin në distancë dhe se për të njëjtin nuk kishte burime dhe mbështetje adekuate nga anëtarët e familjes.⁶⁹

5.4 Shërbimet inkluzive për personat me aftësi të kufizuara

(Për më shumë informacion mbi shërbimet inkluzive për personat me aftësi të kufizuara, shih Aneksin 4)

Shërbimet në mbrojtjen sociale, arsimin, kujdesin shëndetësor dhe punësimin janë të lidhura ngushtë me qasjen e shtetit ndaj aftësisë së kufizuar, e cila është inkorporuar në sistemin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Sistemi ekzistues, si dhe infrastruktura ligjore për qasjen në shërbime për personat me aftësi të kufizuara, nuk përputhen me KDKPAK.

Vlerësimi (certifikimi) i aftësisë së kufizuar është kompleks duke përfshirë standarde dhe agjenci të ndryshme. Proceset e certifikimit, me përjashtim të vlerësimit funksional të prezantuar së fundmi, të kryer nga Trupi Kombëtar i Vlerësimit Funksional, kryhen paralelisht, në mënyrë të pakoordinuar, zgjasin shumë, përdorimi nuk është i përshtatur për klientët, nuk kanë mbikëqyrje dhe kontroll dhe janë joefikas. Vlerësimi aktual i aftësisë së kufizuar ofrohet në mënyrë të pavarur nga të paktën tre kanale. Proceset komplekse dhe mungesa e koordinimit ndërmjet agjencive kanë rezultuar në paralelizëm, dyfishim dhe administratë të ngarkuar gjatë gjithë procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Për çdo përfitim, individët duhet të kalojnë nëpër komisione të ndryshme mjekësore për të përcaktuar dhe vlerësuar aftësinë e kufizuar. Përkufizimi i aftësisë së kufizuar dhe një personi me aftësi të kufizuara, përveç kur bëhet fjalë për vlerësimin funksional, është rreptësisht mjekësor dhe nuk ka aspekte të funksionalitetit dhe një qasje të fokusuar tek nevojat.

Vendimet e qeverisë për të thjeshtuar, unifikuar dhe përmirësuar proceset paralele kanë rezultuar në krijimin e një Trupi Kombëtar të Vlerësimit Funksional.⁷⁰ Aktualisht janë themeluar dy organe regjionale, ndërkaq është planifikuar të themelohen edhe shtatë organe rajonale për aftësi të kufizuara funksionale për fëmijë dhe të rinj. Organet nuk përfshijnë personat me aftësi të kufizuara, ndërsa trajnimet që ndjekin personat kanë të bëjnë ekskluzivisht me Klasifikimin Ndërkombëtar të Aftësisë së Kufizuar (KNAK). Sipas planit të MPPS-së, në këtë fushë është planifikuar të inkorporohet një sistem për vlerësimin e aftësisë së kufizuar në një shtrirje më të gjerë.⁷¹

⁶⁷ Raporti i të Drejtave të Njeriut 2021, Fra, EPI, në dispozicion në: <https://fra.europa.eu/en/publication/2021/fundamental-rights-report-2021>

⁶⁸ Shih: Jovanovska, B. dhe Petkovska, N. (2021). Ndikimi i krizës së shkaktuar nga KOVID-19 tek personat me aftësi të kufizuara në Maqedoninë e Veriut. Fondacioni Westminster për Demokraci, 2021, në dispozicion në: <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2021/07/Vlijanieto-na-Kovid-19-vrz-licata-so-poprecenost-MK.pdf>

⁶⁹ <http://ombudsman.mk/upload/Posebni%20izvestai/2020/Poseben%20izvestaj%20-E%20nastava%20vo%20ucilista.pdf>

⁷⁰ Vendimet e Qeverisë Nr.45-5503 / 1 datë 20.08.2019 dhe Nr.45-8738 / 1 datë 26.11.2019.

⁷¹ MPSP ka renditur ndryshimet e planifikuara ligjore në këtë fushë në Planin e Angazhimit të Palëve të Interesuara, të publikuar në www.mtsk.gov.mk nën etiketën SIAP.

5.4.1 Qasje në sigurimin social dhe shërbimet sociale

Shërbimet e përshkruara në Ligjin për Mbrojtjen Sociale (LMS) ofrohen nga shteti, por që nga decentralizimi, si OSHC-të ashtu edhe organizatat private mund të veprojnë si ofrues të shërbimeve.⁷²

Pavarësisht barazisë formale, shërbimet dhe përfitimet për personat me aftësi të kufizuara bazohen në qasjen medicinale të aftësisë së kufizuar. Përfitimet dhe shërbimet janë të disponueshme për personat mbi moshën 26 vjeç, në varësi të llojit dhe shkallës së aftësisë së kufizuar. Nga këto përfitime përjashtohen personat me aftësi të kufizuara psikosociale, personat me aftësi të kufizuara intelektuale që nuk janë në karrocë invalidësh, si dhe personat me aftësi të kufizuara mbi 26 vjeç që vendosen në familje kujdestare. E njëjta qasje është kopjuar në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve (LMF)⁷³ ku të drejtën e kanë vetëm fëmijët me aftësi të kufizuara deri në 26 moshën vjeçe.

Programi i Asistencës Personale (PAP) nuk është i harmonizuar në përputhje me KDPAK dhe barazohet me kujdesin në institucione. Në këtë proces, personat me aftësi të kufizuara janë vetëm shfrytëzues, pa asnjë rol aktiv në procesin e vlerësimit, trajnimit dhe përcaktimit të kriterëve për përdorimin e shërbimit PAP. Bartësit e detyrave dhe OSHC-të e përfshira si ofrues të shërbimeve të PAP nuk kanë njohuri ose të kupuar adekuat për konceptin e PAP dhe të drejtën për jetesë të pavarur.

Nuk ka një legjislacion gjithëpërfshirës që merr parasysh të drejtat e personave/fëmijëve me aftësi të kufizuara në vend, pra një ligj i veçantë për qytetarët me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara deri në 26 vjeç në vend trajtohen si fëmijë. Matrica e kësaj qasjeje transferohet në të gjitha fushat dhe të drejtat.

Personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara përballen me pengesa administrative dhe burokratike dhe interpretime të ndryshme të dispozitave ligjore nga institucionet. Standardet ekzistuese për qendrat ditore nuk janë në përputhje me parimet e KDPAK dhe nuk marrin parasysh “interesat dhe vullnetin më të mirë të fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara”.

Mekanizmat ekzistues të monitorimit janë të orientuar drejt mbledhjes së të dhënave aktuale për sasinë e shërbimeve të ofruara dhe jo drejt vlerësimit të rezultateve dhe cilësisë së shërbimeve. Ka një mungesë të madhe të vlerësimit të nevojave të fëmijëve/

personave me aftësi të kufizuara. Ka mungesë të stafit të trajnuar, rrjetit dhe infrastrukturës së qasshme, si dhe standardeve të cilësisë të përcaktuara siç duhet për aftësinë e kufizuar.

Çështja e aftësisë së kufizuar nuk përfshihet në politikat që rregullojnë çështjen gjinore. Shërbimet dhe masat për asistencë dhe mbështetje për gratë me aftësi të kufizuara që janë viktime të dhunës në familje nuk ofrohen. Shërbimet e riintegritit dhe strehimoret që ekzistojnë aktualisht nuk janë të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara.

Ligji për invalidët civilë të luftës⁷⁴ dhe ligji për të drejtat e veçanta të anëtarëve të forcave të sigurisë dhe anëtarëve të familjeve⁷⁵ të tyre parashikojnë përfitime për personat me aftësi të kufizuara, por jo në bazë të aftësisë së tyre të kufizuar, por për shkak të rrethanave në të cilat është fituar aftësia e kufizuar.⁷⁶ Këto ligje janë vetëm një shembull se si shteti mund të sigurojë përfitime të ndryshme për të njëjtin lloj të aftësisë së kufizuar.

Vendiakomanukkamiratuarnjëplanveprimipërzbatinin e Strategjisë Kombëtare për Deinstitutionalizimin (2018–2027).⁷⁷ Deinstitutionalizimi kryesisht kuptohet si zhvendosje e personave me aftësi të kufizuara në kontekstin e shtëpive grupore.⁷⁸ Palët e interesuara, OPAK-të dhe OSHC-të, duke përfshirë këtu edhe vetë personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk e kuptojnë konceptin e jetesës së pavarur.⁷⁹ Stafi mbështetës është gjithashtu i fokusuar në aktivitetet bazë të kujdesit dhe ngjarjet kulturore të rastit. Nuk ka të dhëna për planifikim individual për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në komunitet. Shërbimet e nevojshme për të mbështetur jetesën e pavarur ende nuk janë zhvilluar.⁸⁰

⁷⁴ Ligji për invalidët civilë të luftës, MPPS, në dispozicion në: <https://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/civilniinvalidi_konsolidiran.pdf>

⁷⁵ Ligji për të drejtat e veçanta të pjesëtarëve të Forcave të Sigurisë së Republikës së Maqedonisë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, MPPS, i disponueshëm në: <https://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/braniteli_precisten.pdf>

⁷⁶ Shih: Hendikep – Enigma e munguar, Raport mbi Statusin e Personave me Aftësi të Kufizuara, Polio Plus, 2012.

⁷⁷ UNICEF-i, në koordinim me agjencitë e tjera të OKB-së dhe BE-së, mori pjesë në hartimin e Strategjisë për Deinstitutionalizimin 2018–2027 “Timjanik” dhe Planin e Veprimit shoqëruar. Është kryer një analizë e situatës dhe janë identifikuar sfidat dhe prioritetet dhe janë përfshirë në tekstin përfundimtar të Strategjisë. Procesi i deinstitutionalizimit është një proces i vazhdueshëm dhe UNICEF-i vazhdon ta mbështesë atë. Strategjia Kombëtare për Deinstitutionalizimin 2018–2027 “Timjanik”, MPPS, gjendet në: <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/strategji/Strategji%202018/Strategjia_deinstitutionalizacija_Timjanik_2018-2027.pdf>.

⁷⁸ K. Panajotova, E. Koçoska, Analizë: Ndhimë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara që largohen nga institucionet e përkujdesjes, 2020

⁷⁹ Ibid

⁸⁰ Ibid

⁷² PMKV, Raport për varfërinë dhe përjashtimin social në Republikën e Maqedonisë, 2010, <<http://bim.lbg.ac.at/de/socjalna-inkluzija-i-covekovite-prava-vo-makedonija/izveshta-za-siromashti-i-sotsi-alna-iskluchenost-vo-republika-makedoni-2010>>

⁷³ Ligji për mbrojtjen e fëmijëve, Gazeta Zyrtare nr. 23/13, 14/12, 44/14, 144/14.23 / 13, 12/14, 44/14, 144/14.

Për më tepër, deinstitutionalizimi i të rriturve me aftësi të kufizuara dhe shërbimet mbështetëse në komunitet nuk janë në përputhje me KDKPAK. Procesi nuk përfshin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të vendosur nëse duan të jetojnë jashtë institucioneve, si të marrin një vendim të informuar se ku dhe me kë duan të jetojnë në komunitet etj.

Koordinimi ndërmjet të gjitha palëve të interesuara është në nivel shumë të ulët. Mungesa e qasshmërisë i kufizon njerëzit me aftësi të kufizuara që të marrin pjesë në komunitet. Mungesa e vetëbesimit kontribuon që disa nga personat e deinstitutionalizuar të jenë të pasigurt në lidhje me rëndësinë dhe suksesin e vetë procesit.⁸¹ Aftësia juridike vazhdon t'u mohohet personave me aftësi të kufizuara. Në të njëjtën kohë, shumë persona me aftësi të kufizuara në përkujdesje institucionale, shtëpi grupe apo familje janë ende të privuar nga aftësia e tyre juridike dhe janë vënë nën kujdestari.

Në kuadër të COVID-19, Qeveria miratoi disa masa që prekin drejtpërdrejt burrat dhe gratë me aftësi të kufizuara, por ato nuk ishin në përputhje me KDKPAK.⁸² Ndallimet e udhëtimit dhe masat e karantinës kanë ndikuar negativisht tek personat me aftësi të kufizuara. Gjatë periudhës së karantinës lejoheshin përjashtime për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe personat me aftësi të kufizuara me ndihmësit e tyre, por vetëm nëse kanë një dokument që vërteton se janë me aftësi të kufizuara dhe një dokument që kanë të drejtën e asistentit. Transmetimi i aktiviteteve edukative nëpërmjet internetit krijoi një barrë shtesë për djemtë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, kështu që në praktikë nënet 24, 5 dhe 3⁸³ të KDKPAK u deroguan. Për shembull, orët edukative online të realizuara në TV nuk ishin të përshtatura dhe të disponueshme në formate të përshtatshme për djemtë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, me lloje të ndryshme çrregullimeve. Gjithashtu, fëmijët me aftësi të kufizuara që janë arsimuar në shkolla speciale nuk janë përfshirë nga asnjë masë edukative gjatë periudhës shkollare gjatë pandemisë nga data 10 mars deri më 10 qershor 2020. Në kuadër të mbrojtjes sociale dhe tregut të punës u miratuan katër masa, njëra prej të cilave lidhej drejtpërdrejt me aftësinë e kufizuar (ndihma për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit në 27 komuna për të përballuar më lehtë krizën duke përfshirë 200 të papunë si ofrues të shërbimeve). Këto masa, sipas disa studimeve, kanë rezultuar në uljen e intensitetit të kujdesit gjatë bllokimit, për shkak se asistentët personalë nuk respektonin protokollet e

veçanta të sigurisë, gjë që nxiti frikën nga infeksioni dhe transmetimi i mundshëm, si të marrësit e kujdesit ashtu edhe të asistentët. Vetëkujdesi i përgjithshëm individual dhe ndërprerja e shërbimeve dhe mbështetjes u raportuan si sfida për personat me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë COVID-19.

Promovimi i KDKPAK në të gjitha nivelet është i dobët. Palët e interesuara, si dhe publiku i gjerë, përfshirë komunitetin me aftësi të kufizuara, nuk janë mjaftueshëm të vetëdijshëm për ekzistencën e KDKPAK si marrëveshje ndërkombëtare, si dhe për detyrimet që rrjedhin prej saj.

5.4.2 Qasja në kujdesin shëndetësor dhe shërbimet shëndetësore

Korniza ligjore dhe politikat që rregullojnë qasjen në shërbimet shëndetësore nuk janë në përputhje me KDKPAK.⁸⁴ Procedurat për marrjen e kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe terciar nuk janë të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara.⁸⁵ Qasja në shërbimet shëndetësore bazohet në modelin mjekësor të aftësisë së kufizuar. Pavarësisht ekzistencës së legjislativioneve dhe strategjive të ndryshme, qasja në kujdesin shëndetësor për personat me aftësi të kufizuara mbetet një pengesë kryesore. Komunikimi mbetet një problem i madh për njerëzit që janë të shurdhër dhe të tjerët që mbështeten në gjuhën e shenjave, sepse personeli i kujdesit shëndetësor nuk është i përgatitur mirë dhe nuk e njeh gjuhën e shenjave.

Mungesa e trajnimeve për komunikim dhe qasje ndaj personave me aftësi të kufizuara çon në shkeljen e së drejtës për informim të pacientëve me aftësi gjykim të reduktuar përgjithmonë.⁸⁶

Qasja në mjetet dhe pajisjet ortopedike⁸⁷ është mjaft e kufizuar, përcaktohet nga mosha, shumica e participimit,

⁸¹ Ibid

⁸² Shih: Analiza e Ndikimeve të COVID-SARS-19 mbi gjininë dhe dallimet, Studimi i Politikave nr. 40, OSBE, 2021, në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/1/9/480413.pdf>

⁸³ Neni 24 rregullon zotimin se e drejta për arsim do të ushtrohet pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta. Neni 5 ka të bëjë me barazinë dhe mosdiskriminimin, ndërsa mosdiskriminimi është përcaktuar në mënyrë plotëse si një nga parimet e përgjithshme të rregulluara me nenin 3.

⁸⁴ Ligji për Kujdesin Shëndetësor. Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/2012, 145/2012, 87/2013, 164/2013, MSH. Në dispozicion në: < http://mz.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-zdravstvena-zastita-2_12_2012.pdf >; Ligji për Sigurimet Shëndetësore (tekst i integruar i konsoliduar Gazeta Zyrtare nr. 65/2012, 16/2013 dhe 91/2013), Fondi i Sigurimeve Shëndetësore. Në dispozicion në:

⁸⁵ Shih: Publikimi "KU LUNDRON KJO ANIJE" - demistifikimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Maqedonisë me rishikim të ligjit për kujdesin shëndetësor, 2018, në dispozicion në: <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/kade-plovi-ovoj-brod-en.pdf>

⁸⁶ Për shembull, ligji për ndërprerjen e shtatzënisë <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2018/01/ZAKON-ZA-PREKINUUVANE-NA-BREMENOSTA-zakluchno-so-br.-149-od-2015.pdf> Shih gjithashtu: "Të drejtat e pacientëve me fokus në personat me aftësi të kufizuara intelektuale" ESE, 2011, faqe 6. <http://www.esem.org.mk/pdf/Publikacii/ESE%20Intelektualna%20poprecenost.pdf>

⁸⁷ Rregullorja për indikacionet për ushtrimin e së drejtës për mjete ortopedike dhe mjete të tjera, FSSH MK, e disponueshme në: <http://www.fzo.org.mk/default.asp?ItemID=D42C5C3FA5A79548A0408B9FB59A9874>

afati i përdorimit të aparateve dhe për disa pajisje vlen statusi i punësimit të personit. E drejta për rehabilitim mund të përdoret vetëm si trajtim i zgjatur dhe është e kufizuar.

Mungojn shërbime dhe programe dhe shërbime të specializuara shëndetësore për parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, trajtimin e hershëm dhe rehabilitimin e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara. Aftësia e kufizuar nuk është pjesë e kriterëve për përgatitjen dhe ofrimin e programeve të formimit profesional në fushën e shëndetit publik.⁸⁸ Një trajner me aftësi të kufizuara ka marrë pjesë në zbatimin e aktiviteteve nga Plani i Veprimit për Shëndetin Riprodhues Seksual, duke përfshirë trajnimin e mjekëve familjar, punonjësve socialë dhe profesionistëve të tjerë përkatës (filologë, edukatorë specialë, etj.) për çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues (ShSR) dhe të drejtat dhe dhunën me bazë gjinore (DhGj), të cilat janë kryer në bashkëpunim me Qendrën për Mjekësi Familjare dhe me mbështetjen e UNFPA-së.⁸⁹ Disa nga temat e trajtuara në këto trajnime ishin: planifikimi familjar, kujdesi gjatë shtatzënisë (kujdesi neo-natal dhe post-natal), zbulimi i kancerit të qafës së mitrës, zbulimi i DhBGj, referimi etj. Përveç kësaj, me mbështetjen e UN Women, personat me aftësi të kufizuara të deinstitutionalizuar nga I.S. Banja Banskó u trajnuan në lidhje me DhGj dhe KDPAK.

Nuk janë paraparë mënyra për të marrë një leje nga gratë me aftësi të kufizuara, dhe as që ka mënyrë për të kështilluar gratë e vendosura në institucione, shtëpi grupore dhe/ose forma të reja të jetesës së mbështetur.⁹⁰ Stereotipet dhe bindjet janë një pengesë shtesë për ushtrimin e të drejtës për kujdes shëndetësor të personave me aftësi të kufizuara.⁹¹ Personat me aftësi të kufizuara janë lënë jashtë programeve të zbulimit dhe parandalimit të hershëm të sëmundjeve malinje. Për këto shërbime për personat me aftësi të kufizuara nuk është përcaktuar asnjë kosto nga shteti.

Një pengesë shtesë për qasje në shërbimet shëndetësore është paqashmëria si e objekteve shëndetësore publike ashtu edhe e atyre private.⁹² Këtë e plotëson paqashmëria e institucioneve gjinekologjike (publike dhe private). Standardet e qasshmërisë nuk janë të

përcaktuara në kriteret për vendosjen në treg të pajisjeve, produkteve dhe pajisjeve mjekësore.⁹³ Pavarësisht detyrimit ligjor për mbajtjen e evidencës së fëmijëve me aftësi të kufizuara,⁹⁴ as institucionet shëndetësore dhe as Instituti i Shëndetit Publik nuk mbajnë evidencë për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Përveç konferencave për shtyp të qeverisë të cilat u transmetuan drejtpërdrejt në gjuhën e shenjave, informacione të tjera lidhur me KOVID-19 nuk ishin të disponueshme. Faqja e internetit që përmbante informacione, si dhe faqja e internetit që fton qytetarët të aplikojnë për vaksinim, gjithashtu nuk ishin në format të qasshëm. Pikat e vaksinimit dhe pikat e testimit PCR janë të paqasshme.⁹⁵

5.4.3 Qasja në arsim

Korniza e përgjithshme ligjore në arsim nuk ofron një qasje gjithëpërfshirëse për ushtrimin e të drejtës për arsimim për personat me aftësi të kufizuara në përputhje me KDKPAK.

Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (LMF) i mungojnë shumë masa që do të çonin në barazi inkluzive.⁹⁶ Ligji është i ngarkuar me terminologji të ndryshme dhe ofron një kuptim mjekësor të gjendjes së aftësisë së kufizuar. Me LMF, të rriturit me aftësi të kufizuara deri në 26 vjeç trajtohen si fëmijë. Sistemi nuk ofron mbështetjen e duhur për prindërit që t'i pranojnë fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara, ndërsa edukatorëve u mungon përgatitja e duhur për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara.⁹⁷

Në vitin 2020, 0.34% e PBB-së ishte caktuar për arsimin parashkollor.⁹⁸ Sipas një raporti të BB të vitit 2015, "Përfaqësimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin

⁸⁸ Ligji për Shëndetin Publik, nr. 136/2011 <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-javno-zdravje-precisten.pdf>

⁸⁹ <http://iph.mk/wp-content/uploads/2019/08/Nov-tekst-na-AP-usoglasen-so-Sekretarijat-za-zakonodavstvo-11.09.2018.pdf>

⁹⁰ Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2018/01/ZAKON-ZA-PREKINUVANE-NA-BREMENOSTA-zakluchno-so-br.-149-od-2015.pdf>

⁹¹ Shih: "Shëndeti seksual dhe riprodhues dhe personat me aftësi të kufizuara - Raporti i vlerësimit të nevojave dhe shërbimeve - Hera, 2012, f. 61 - 62.

92 Shih: "Shëndeti seksual dhe riprodhues dhe personat me aftësi të kufizuara – Raporti i vlerësimit të nevojave dhe shërbimeve – Hera, f. 20, 2012., <http://hera.org.mk/wp-content/uploads/2014/02/izvestaj_popreceniz_vz.pdf>. I qasur më: 21.10.2014.

⁹³ Ligji për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore, 11/2012 <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-lekovi-i-medicinski-pomagala.pdf>

94 Ligji për mbajtjen e evidencës nga lëmia e shëndetësisë, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 20/09. Në dispozicion në: <http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon_za_evidencii_vo_oblasta_na_zdravstvoto_SL_Vesnik_na_RM,_br.20_od_16.02.2009_godina.pdf

⁹⁵ Raporti për të Drejtat e Njeriut 2021, FRA, EPI. Në dispozicion në: <https://fra.europa.eu/en/publication/2021/fundamental-rights-report-2021>

⁹⁶ Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve, MPSP. Në dispozicion në: <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/2018/198%202018%20ZAKON%20ZA%20ZASTITA%20NA%20DECATA%20%20%20D%0A%D%0B%D%0E%D%0BD%D1%81%D%0BE%D%0BB%D%0B%D%0B%D%0B%D%0B%D1%80%D%0B%D%0D%D%02%D%01%82%D%0B5%D%0B%D1%81%D1%82-converted.pdf>

⁹⁷ INKLUZIONI i fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor: raport kërkimor. – Shkup: Avokatit i Popullit, 2018, UNICEF në dispozicion: https://www.unicef.org/northmacedonia/media/4386/file/MK_CWDInKindergarten_Report_MK.pdf

⁹⁸ https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/republic-north-macedonia/early-childhood-and-school-education-funding_en

parashkollor është nën 5%.⁹⁹ Sipas raportit të vitit 2018, përqindja e fëmijëve me aftësi të kufizuara është 1,19% nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të cilët shkojnë në kopshte.¹⁰⁰

Progresi më i madh në raport me arsimin inkluziv mund të vërehet në reformën e ndërmarrë në arsimin fillor. Miratimi i Ligjit të ri për Arsimin Fillor, i mbështetur nga Koncepti për Arsimin Fillor, si koncept për arsimin inkluziv¹⁰¹ dhe një sërë aktesh nënligjore, hap rrugën për përfshirjen e të gjithë fëmijëve në arsimin e rregullt deri në vitin 2023. Gjithashtu, transformimi i shkollave speciale dhe mësimdhënies në qendra të resurseve dhe qendra mbështetëse mësimore është në vazhdim e sipër. Koncepti i arsimit fillor, pavarësisht nga të gjitha dokumentet dhe strategjitë ndërkombëtare, aspak nuk i referohet KDPK-së, kështu që vetë koncepti nuk e vëndos këtë çështje në rrjedhat kryesore nga aspekti i KDPK-së. LAF mbulon aftësinë e kufizuar nga aspekti i mbrojtjes nga diskriminimi.

Së bashku me synimin për të përfshirë plotësisht fëmijët me aftësi të kufizuara shqisore, korniza ligjore nuk rregullon përdorimin e gjuhës së shenjave dhe as alfabetin Braj. Mësimi i gjuhës së shenjave nuk parashikohet si lëndë e detyrueshme apo zgjedhore në konceptin e arsimit fillor. Kjo qasje kontribuon në dyshimin dhe pakënaqësinë e personave me aftësi të kufizuara për përfshirjen e tyre në arsimin e rregullt.¹⁰²

LAF rregullon përfshirjen e asistentëve arsimorë (AA) dhe asistentëve personalë (AP). Rregullorja për AA dhe AP¹⁰³ si dhe zvogëlimi i kufirit të moshës për AP nga 18 në 6 vjet në LMF vërteton se ligjvënësi nuk ka njohuri adekuate për konceptet e AA dhe AP. Gjetjet nga terreni tregojnë gjithashtu se asistentët personalë nuk i kanë qarta obligimet dhe përgjegjësitë ndaj nxënësve dhe personave tjerë profesional.¹⁰⁴ Përqindja më e madhe e mësuesve (59.9%) barazojnë detyrat e punës së asistentit personal me detyrat e punës së asistentit arsimor.¹⁰⁵

Ligji për Arsimin e Mesëm (LAM), Ligji për Arsimin e Lartë (LAL), si dhe Strategjia Kombëtare për Arsimin 2018-2025¹⁰⁶ nuk ofrojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe nuk janë në përputhje me KDPK. Trajnimi i personelit mësimor në lidhje me problemin e aftësisë së kufizuar zakonisht bëhet përmes projekteve dhe mbështetjes nga institucionet ndërkombëtare pa ndonjë strategji afatgjatë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe BZHA.¹⁰⁷ Programet arsimore nuk përmbajnë dispozita që i bëjnë formatet e qasshme të detyrueshme ose të dëshirueshme.¹⁰⁸

Qasshmëria fizike dhe komunikuese, si dhe qasja në teknologjinë ndihmëse është një problem madhor për personat me aftësi të kufizuara arsimore.¹⁰⁹ Asnjë institucion arsimor nuk mban evidencë dhe statistika për numrin e personave me aftësi të kufizuara të përfshirë në sistemin arsimor dhe as nuk merr parasysh aspektin gjinor.

Një sfidë tjetër, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, është mungesa e edukimit gjithëpërfshirës seksual (EGJS) në kurrikulat formale shkollore, gjë që i bën këto grupe më të prekshme ndaj dhunës, duke përfshirë dhunën me bazë gjinore, ngacmimin seksual, etj. Përveç kësaj, mungesa e informacionit mbi EGJS mund të çojë në zhvillimin e ankthit, depresionit dhe izolimit, veçanërisht te njerëzit me aftësi të kufizuara intelektuale dhe sjellje të papërshtatshme seksuale që shfaqen si rezultat i zhvillimit seksual, të cilat ndodhin në adoleshencë, por nuk shoqërohen nga socializimi dhe të kuptuarit e normave shoqërore që formojnë sjelljen e duhur seksuale të demonstruar nga persona tjerë të së njëjtës moshe.¹¹⁰

Vitet e fundit, nuk është marrë asnjë qasje sistematike për rritjen e aftësive arsimore dhe sociale të atyre që janë nën përkujdesje në institucione. Shumica e

⁹⁹ Banka Botërore. Zhvillimi i hershëm fëmijëror në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë: Raporti vendor SABER 2015

¹⁰⁰ INKLUZIONI e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor: raport kërkimor. - Shkup: Avokati i Popullit, 2018, UNICEF në https://www.unicef.org/northmacedonia/media/4386/file/MK_CWDInKindergarten_Report_MK.pdf

¹⁰¹ Koncepti për arsimin fillor, i disponueshëm në <https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20za%20inkluziv%20.pdf>

¹⁰² Deklarata e përfaqësuesve të fokus grupeve

¹⁰³ https://mon.gov.mk/stored/document/2021_Pravilnik_Nachin%20na%20pobaraovanje%20asistenti.pdf

¹⁰⁴ Paula Federica Hunt, botim kërkimor "Asistentë Arsimor dhe Personal. Tani edhe këtu - Perspektiva të hapura "UNDP, në dispozicion në: https://www1.undp.org/content/dam/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/docs/Educational%20and%20personal%20assistants%20-%20MKD.pdf

¹⁰⁵ Gjendja aktuale e fëmijëve me nevojë të veçanta arsimore në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2018, BZHA. Në dispozicion në: <https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2020/02/Aktuelna-sostojba-na-inkluzija-na-deca-so-posebni-obrazovni-MK.pdf>

¹⁰⁶ Ligji për Arsimin e Mesëm, në dispozicion në: http://www.mon.gov.mk/images/%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD_%D0%B7%D0%BO_%D1%81%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%BE%D1%82%D0%BE_%D0%BE%D0%B1%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%BE%D0%B2_%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D0%B507.pdf, Ligji për Arsimin e Lartë. Në dispozicion në http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/ZAKON_VISOKOTO_OBRAZOVANIE-final.pdf <http://mrk.mk/wp-content/uploads/2018/10/Strategija-za-obrazovanie-MAK-WEB.pdf>

¹⁰⁷ Raporti përmbljedhës i përgjigjeve shtetërore në pyetjet lidhur me raportin fillestar të Republikës së Maqedonisë për zbatimin e Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, 2018, në dispozicion në: https://tbineternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=INT%2FCRPD%2FCSS%2FMKD%2f31979&Lang=en

¹⁰⁸ Ligji për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm

¹⁰⁹ Aplikimi i teknologjisë informative ndihmëse në shkollat e rregullta fillore në Maqedoni, kushtet dhe nevojat aktuale, Hapni dritaret, 2011, Z. Shavreski, H. Amdiu, E. Koçoska, T. Ortakovski, ekipi i Juridika. Publikimi - Lidhja që mungon "- Demitizimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë me rishikim të së drejtës në arsim, 2018 Polio Plus. Në dispozicion në: <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/Alkata-sto-nedostasuva-B5-mk.pdf>

¹¹⁰ Fitzpatrick, Srivorakiat, Vink, Pedapati dhe Erickson, 2016; Evas dhe Ho, 1996

fëmijëve dhe të rinjve që janë të deinstitutionalizuar, që jetojnë me familje biologjike ose kujdestare, ose në shtëpi të vogla grupore, nuk janë pjesë e asnjë skeme arsimore sepse perceptimi është se ata nuk mund të mësojnë sepse kanë "aftësi të kufizuara të rënda dhe të thella" të kombinuara me "probleme shëndetësore".¹¹¹

Për sa i përket pjesëmarrjes dhe konsultimit, duhet theksuar se as OPAK-të, as personat me aftësi të kufizuara, as fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara nuk janë konsultuar dhe përfshirë aktivisht në hartimin e ndryshimeve ligjore në arsim.¹¹²

5.4.4 Qasja në punësim

Punësimi i personave me aftësi të kufizuara është në një nivel shumë të ulët në krahasim me personat pa aftësi të kufizuara, pothuajse i padukshëm. Në 10 vitet e fundit (2010-2020), mesatarisht janë regjistruar vetëm 1671 persona me aftësi të kufizuara. Sipas të dhënave ekzistuese statistikore, nuk ka të dhëna për numrin e personave me aftësi të kufizuara të vetëpunësuar, as për numrin e personave me aftësi të kufizuara të punësuar, jashtë Ligjit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, dhe as për numrin e personave me aftësi të kufizuara që janë të punësuar në administratën publike. Nga analizat rezulton se numri i personave të punësuar në kompanitë mbrojtëse është i vogël – rreth 2500 persona me aftësi të kufizuara në vitin 2019, me një qarkullim relativisht të vogël.

Korniza e përgjithshme ligjore në fushën e punës dhe punësimit nuk ofron një sistem koherent në përputhje me KDPAK.

Ligji për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara rregullon kushtet e veçanta për punësimin dhe punën e personave me aftësi të kufizuara dhe është i fokusuar kryesisht në punësimin në kompanitë private mbrojtëse.

¹¹³ Ligji parashikon një sërë masash nxitëse të financuara

¹¹¹ K. Panajotova, E. Koçoska, Analiza: Ndhimë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara që largohen nga institucionet e përkujdesit, 2020

¹¹² Raporti i të Drejtave të Njeriut 2021, FRA, EPI, Në dispozicion në: <https://fra.europa.eu/en/publication/2021/fundamental-rights-report-2021>

¹¹³ Ligji për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 87/2005 (tekst i konsoliduar), 113/2005, 29/2007, 88/2008, 161/2008, 99/2009, 136/ 2011, 129/15, 147/15 dhe 27/16. Në dispozicion në: <<http://www.mtsp.gov.mk>> dhe <<http://www.svesnik.com.mk>>
Shoqëria mbrojtëse përkufizohet si kompani me të paktën dhjetë punonjës, nga të cilët së paku 40% janë persona me aftësi të kufizuara, të regjistruar (si kompani mbrojtëse) në MPPS dhe APRMV. Në janar 2019 janë themeluar 224 kompani mbrojtëse të regjistruara, të cilat operojnë në përputhje me Ligjin për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Këto kompani mbrojtëse kanë punësuar 5677 persona, nga të cilët 2351 (41.4%) ishin persona me aftësi të kufizuara. Grantet/ stimujt e kompanive mbrojtëse për punësimin e personave me aftësi të kufizuara financohen nga Fondi i Posaçëm për Aftësinë e Kufizuar (FPI) i menaxhuar nga APRMV. Përveç granteve të FIP, kompanitë e mbrojtjes marrin një transferim të kontributeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit e tyre.

nga Fondi i Posaçëm për Aftësinë e Kufizuar.¹¹⁴ Megjithatë, duhet të jepet mundësia që ato të shqyrtohen nga një gjykatë kompetente në mënyrë që të vlerësohet nëse janë të përshtatshme për qëllimin apo jo, veçanërisht kur ekziston shqetësimi për abuzime të mundshme.¹¹⁵ Kjo do të thotë se një pjesë e mbështetjes financiare të paguar për kompanitë që punësojnë persona me aftësi të kufizuara në vendin e punës nuk përdoret për blerjen e pajisjeve të përshtatshme në lidhje me nevojat specifike të personit me aftësi të kufizuar, ose në raste të tjera personat me aftësi të kufizuara nuk përfshihen në proceset e punës, por shërbejnë si mjet për marrjen e mbështetjes financiare nga shteti, për të cilën personi me aftësi të kufizuar përfiton një kompensim minimal financiar.

Infrastruktura e paqasshme për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e hapur kontribuon në dekurajimin e numrit më të madh të personave me aftësi të kufizuara për të kërkuar punë ose trajnim. Niveli i evidentimit të personave të papunë me aftësi të kufizuara është shumë i ulët në krahasim me personat pa aftësi të kufizuara. Në mënyrë që një person të regjistrohet si i papunë, ai/ajo është i detyruar të paraqitet personalisht në ambientet e Agjencionit për Punësim (APRMV-së). Hapësirat e APRMV-së janë përgjithësisht plotësisht të paqasshme për personat me aftësi të kufizuara.¹¹⁶ Personat që jetojnë në institucione, shtëpi grupore dhe forma të tjera të organizuara të jetesës së mbështetur, si dhe të rriturit me aftësi të kufizuara që vizitojnë qendrat ditore, nuk mund të regjistrohen si të papunë.¹¹⁷

Një problem tjetër serioz për sigurimin e punësueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara është aftësia e tyre juridike. Shumë nga personat e deinstitutionalizuar janë të certifikuar si "të paaftë".¹¹⁸

Në nivel lokal, punësueshmëria e personave me aftësi të kufizuara nuk është e përfshirë në programet strategjike komunale dhe as çështja e aftësisë së kufizuar nuk është pjesë e planeve zhvillimore ekonomike të komunave.

Me reformat e reja, qeveria po përpiqet të ecë drejt zbatimit të rehabilitimit profesional dhe politikave të

¹¹⁴ Rregullorja për kushtet dhe mënyrën e dhënies së granteve nga Fondi special për përmirësimin e kushteve të punësimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuara, "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 156/2008.

¹¹⁵ Shih gjithashtu: Z. Poposka, publikim analitik "Udhëtoni larg - duke çmitizuar çështjen e aftësisë së kufizuar në fushën e punësimit dhe marrëdhënieve të punës", 2018, Polio Plus, disponohet në: <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/patuvaj-daleku-mk.pdf>

¹¹⁶ K. Panajotova, E. Koçoska, Analiza: Ndhimë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara që largohen nga institucionet e përkujdesit, 2020

¹¹⁷ Ibid

¹¹⁸ Ibid

punësimit aktiv.¹¹⁹ Plani i Qeverisë është që në vitin 2020 të nisë hartimi i një ligji të ri për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, i cili do të ketë një sistem kuotash dhe një sistem të ri për rehabilitimin profesional.¹²⁰

Sistemi i rehabilitimit profesional rregullohet nga disa ligje dhe politika.¹²¹ Dispozitat ligjore nuk janë në përputhje me qasjen në të drejtat e njeriut dhe nuk ofrojnë qasje adekuate për personat me aftësi të kufizuara në sistemet ekzistuese të trajnimit, rikualifikimit ose punës praktike.

Kriteri ekzistues për gjendjen e përgjithshme shëndetësore kufizon qasjen dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në administratën publike. Dispozitat e Ligjit për nëpunësit civilë që rregullojnë punësimin në sektorin publik përmendin *aftësinë e përgjithshme shëndetësore* si kusht për punësim. E formuluar në këtë mënyrë, dispozita, edhe pse në dukje neutrale, ka ende një ndikim negativ në mënyrë disproporcionale tek personat me aftësi të kufizuara, pasi i gjithë grupi apriori pengohet të aplikojë për punësim. Për këtë arsye, duhet bërë dallimi mes gjendjes shëndetësore dhe aftësisë për punë të personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të mos barazohen të dyja. Të njëjtat dispozita janë të formuluar në këtë mënyrë në ligjet për gjykata, avokaturë, polici, shërbim ushtarak, punë të jashtme etj. Edhe pse ky kriter nuk sjell gjithmonë diskriminim, ai duhet të rishikohet dhe të vihet nën kontrollin gjyqësor. Prandaj, ky raport propozon rishqyrtimin e këtij kriteri, i cili kufizon të drejtën e personave me aftësi të kufizuara në pozitë në administratën shtetërore, gjyqësorin dhe praktikën juridike, si dhe të jepen specifikimet në përputhje me nenin 25 të Ligjit për Marrëdhënie Pune, gjegjësisht vendosjen e këtij kushti në kontekstin e vetë pozitës (profesionit). Vetë përkufizimet e gjendjes shëndetësore dhe aftësisë së punës janë në kundërshtim me parimet, vlerat dhe dispozitat e KDPAK-së.

Inkorporimi i rehabilitimit të orientuar drejt punës dhe mbështetjes gjatë punësimit për personat me aftësi të kufizuara do të jetë në fazën pilot deri në tetor 2022. Qendra Topansko Pole në Shkup tashmë është pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale. Në dhjetor 2020, institucioni u shndërrua në një shërbim për rehabilitimin profesional dhe mbështetje gjatë punësimit për personat me aftësi të kufizuara. Një qendër tjetër është themeluar dhe pilotuar në kuadër të ndërmarrjes sociale Izbor, Strumicë, si qendër për rehabilitim të orientuar

drejt punës dhe mbështetje për punësim me Qendër për trajnime për aftësim profesional. Procesi dhe të dyja qendrat janë mbështetur nga UNDP dhe MPPS në kuadër të projektit "Krijimi i mundësive të punës për të gjithë – Faza kryesore" nga viti 2019-2022.

5.5 Përfaqësimi dhe pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara

Ushtrimi i të drejtës për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike të personave me aftësi të kufizuara është mjaft i kufizuar kur shikohet nga këndvështrimi i KDPAK.¹²² Shteti nuk ka arritur të sigurojë një mjedis të favorshëm ku personat me aftësi të kufizuara do të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar dhe për t'u votuar, pra për të kandiduar për një funksion me mbështetje.¹²³ Korniza ligjore aktuale nuk merr parasysh qasjen ndërsektoriale. Sistemi i kuotave për përfaqësim të barabartë gjinor, i parashikuar në legjislacion, nuk përfshinte çështjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara. Ushtrimi i të drejtës së votës nga shtëpia për këtë komunitet me aftësi të kufizuara, ka bazë mjekësore.¹²⁴

Iniciativat e ndërmarrja nga KSHZ-ja¹²⁵ në vitet e fundit janë përkrahur ekskluzivisht nga bashkësia ndërkombëtare, gjë që është një mangësi serioze në zbatimin dhe qëndrueshmërinë e tyre të vazhdueshme. Pavarësisht synimit të mirë për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në procesin e vëzhgimit, mbështetet krijimi i organizatave të veçanta të cilat do të përbëhen ekskluzivisht nga vëzhgues me aftësi të kufizuara dhe do të merren vetëm me vëzhgimin e zgjedhjeve.¹²⁶

Publiku i gjerë ka perceptime të ndryshme negative për personat me aftësi të kufizuara dhe gratë me aftësi të kufizuara janë veçanërisht të cënueshme. Vetëm 67% e partive politike do të pranenin një person me aftësi të kufizuara për lider, ndërsa mund të vërehet se personat me aftësi të kufizuara janë më të pranueshëm për partitë më të vogla se sa për ato më të mëdha. Për sa i përket

¹¹⁹ Qeveria, me ndihmën e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), ka pilotuar një model të ri rehabilitimi profesional për të rritur punësimin e personave me aftësi të kufizuara në tregun e hapur. Piloti aktual ka krijuar dy qendra rehabilitimi, të implementuara në dy lloje të ndryshme organizatash, të cilat duhet të ofrojnë njohuri dhe përvojë të dobishme për ngritjen e ardhshme të sistemit kombëtar të rehabilitimit.

¹²⁰ Raporti i MPPS-së nga 30 shtator 2019 në Qeveri

¹²¹ Ligji për sigurimin pensional të invaliditetit

¹²² Shih: Komiteti i OKB-së, Komenti i Përgjithshëm nr. 1 për nenin 12 të 1. KDPAK, 2014. Në dispozicion në: <https://undocs.org/en/CRPD/C/GC/1>

¹²³ Shih: Vërejtje përfundimtare për Raportin hyrës të Republikës së Maqedonisë nga Komiteti i OKB-së, 2018. Në dispozicion në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/MKD/CO/1&Lang=En

¹²⁴ Shih: Koçoška E., Klimoska J. Publikimi "Analizë e programeve politike në zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2020. kundrejt Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ", Westminster Foundation dhe Polio Plus, 2020, në dispozicion në: < <https://polioplus.org.mk/wp-content/uploads/2021/05/izgubenata-vrednost-niz-politichkoto-uchestvo.pdf>

¹²⁵ Shih: Koçoška E., Klimoska J. Publikimi "Analizë e programeve politike në zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2020. kundrejt Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ", Westminster Foundation dhe Polio Plus, 2020, E disponueshme në: < <https://polioplus.org.mk/wp-content/uploads/2021/05/izgubenata-vrednost-niz-politichkoto-uchestvo.pdf>

¹²⁶ Ibid

dimensionit gjinor, meshkujt me aftësi të kufizuara fizike janë më të pranueshëm si lider. Shumica e personave me aftësi të kufizuara 95% mbështesin sistemin e kuotave për pjesëmarrjen e tyre në jetën politike.¹²⁷ Perceptimet që kontribuojnë në diskriminimin e shumëfishtë janë të shumta dhe ato kryqëzohen midis gjinisë dhe aftësisë së kufizuar, veçanërisht për gratë me aftësi të kufizuara të shumëfishta për të cilat do të votonin vetëm 2%.¹²⁸

Mungesa e terminologjisë standarde është një pengesë shtesë për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara. Në programet politike të zgjedhjeve të fundit parlamentare, personat me aftësi të kufizuara janë përmendur 223 herë¹²⁹ me terminologji të ndryshme. Ka një tendencë për të krijuar terma të rinj, si “pengesa në zhvillimin mendor” ose “aftësi të kufizuara të veçanta”, “aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta” etj.

Në lëvizjen e aftësisë së kufizuar ka tensione midis OPAK-ve që marrin fonde publike (organizata tradicionale të bazuara në dëmtime dhe të bashkuara nën një ombrellë) dhe OPAK-ve të reja, si dhe organizatave prindërore të fëmijëve me diagnoza të ndryshme, të cilat janë fokusuar sërish në ofrimin e shërbimeve. Veprimtaritë dhe financimi publik për organizatat tradicionale rregullohen me ligj. Për më tepër, anëtarësimi në një nga OPAK-të tradicionale është një parakusht për të marrë disa nga përfitimet, si p.sh. kompensimin për një vend parkimi.

Nuk ka komunikim dhe koordinim mes OPAK-ve tradicionale dhe atyre të reja. Gjithashtu, prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara janë të fokusuar kryesisht në hapjen e qendrave ditore për fëmijët me diagnoza dhe aftësi të kufizuara të ndryshme të cilat financohen nga shteti. Numri i vogël i OPAK-ve të reja të fokusuar në rolin e kujdestarëve nuk financohet nga shteti.

Personat me aftësi të kufizuar që janë të deinstitutionalizuar nuk përfshihen në OPAK-të apo organizata të tjera. Në procesin e zbatimit të deinstitutionalizimit, personat me aftësi të kufizuara përfshihen ekskluzivisht si përfitues dhe nuk janë pjesë e ekipeve që zbatojnë projektin.¹³⁰

Personat me aftësi të kufizuara nuk përfshihen dhe nuk janë pjesë e ekipeve të tjera të OSHC-ve, duke përfshirë ato OSHC që ofrojnë ndihmë juridike,¹³¹ dhe gjithashtu nuk janë pjesë e OSHC-ve të tjera që ofrojnë shërbime të tjera në nivel lokal ose kombëtar. Disa OSHC që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuara përpiqen të punojnë dhe bashkëpunojnë me OPAK-të, po këto raste janë shumë të rralla. Disa nga OSHC-të që punojnë me target-grupet e cënueshme si pacientë me HIV, pjesëtarë të komunitetit LGBT, Romët, dhe gratë, deri më tani nuk kanë bashkëpunuar dhe nuk kanë përfshirë personat me aftësi të kufizuara, as si përfitues dhe as si pjesë e ekipeve të tyre.¹³²

Personat me aftësi të kufizuara nuk janë të përfshirë dhe as të përfaqësuar në Trupin Monitorues të KDPAK-së¹³³ apo në përbërjen e ekipit të Avokatit të Popullit. Edhe përkundër aplikimit të tre personave me aftësi të kufizuara për përbërjen e re të Komisionit për Parandalim dhe Mbrojtje nga Diskriminimi, asnjëri prej tyre nuk u zgjodh nga Kuvendi i RMV-së.

Statusi i OPAK-ve nuk është i qartë në legjislacionin e Maqedonisë. Pra, kur institucionet duhet të përfshijnë ose konsultojnë OPAK-të ose personat me aftësi të kufizuara, ata shpesh nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë.

Vetëm dy agjenci të OKB-së kanë përfshirë personat me aftësi të kufizuara në ekipet e tyre të projekteve. Agjencitë e tjera të OKB-së theksojnë se ata gjithmonë punësojnë konsulentë nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara për të kryer aktivitete që lidhen me çështjet e aftësisë së kufizuar.

Shteti nuk ka kryer asnjë konsultë me personat me aftësi të kufizuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme të KOVID-19. Korniza aktuale ligjore për krizat humanitare dhe gjendjen e jashtëzakonshme nuk është në përputhje me KDPAK të OKB-së. OPAK-të nuk janë përfshirë në mënyrë aktive në përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e ligjeve dhe politikave të emergjencës.¹³⁴ Masat dhe veprimet që u inicuan nuk ishin në përputhje me nenin 11 të KDPAK të OKB-së.¹³⁵

¹²⁷ Shih: Publikim. Agjenda e Humbur: Çmitizimi i çështjes së aftësisë së kufizuar në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, Polio Plus - 2018. Në dispozicion në: <<http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/izgubenata-agenda-mk.pdf>>

¹²⁸ Shih: Koçoska E., Klimoska J. Publikimi “Analizë e programeve politike në zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2020. kundrejt Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, Westminster Foundation dhe Polio Plus, 2020, E disponueshme në: <<https://polioplus.org.mk/wp-content/uploads/2021/05/izgubenata-vrednost-niz-politichkoto-uchestvo.pdf>>

¹²⁹ Shih: Koçoska E., Klimoska J. Publikimi “Analizë e programeve politike në zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2020. kundrejt Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, Westminster Foundation dhe Polio Plus, 2020, E disponueshme në <https://polioplus.org.mk/wp-content/uploads/2021/05/izgubenata-vrednost-niz-politichkoto-uchestvo.pdf>

¹³⁰ Deklarata e fokus grupeve të OSHC-ve që ofrojnë shërbime

¹³¹ Fokus grupi i përfaqësuesve të mekanizmave mbrojtës

¹³² Fokus grupi i përfaqësuesve të OSHC-ve që ofrojnë shërbime për kategori të tjera vulnerabël

¹³³ Intervistë me përfaqësues të Avokatit të Popullit

¹³⁴ Shih, Autori Marija Risteska, Hulumtuesit Ana Avramovska-Nushkova, Gordana Micova-Nestorovska, Sashko Jovanov, Liljana Jonoska, Elena Koçoska, Publikimi, Analiza e ndikimit të KOVID-SARS-19 mbi gjininë dhe dallimet, Studimi i politikave nr. 40, f. 47, 2021 OSBE, E disponueshme në: <https://www.osce.org/files/f/documents/1/9/480413.pdf>

¹³⁵ Shih: Biljana Kotevska, Nesime Salioska, Magdalena Lembovska, Gordana Lazhetiq, Aleksandra Bogdanovska, Simonida Kacarska, Maja Balsha, Vigilenca Abazi, Elena Koçoska, Raport mbi publikimin e të drejtave themelore të njeriut për vitin 2021, Instituti për Politika Evropiane dhe të Drejtat e Njeriut EU, në dispozicion në: https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/frr2021_north_macedonia-frr2021_en.pdf

Sa i përket pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në nivel lokal, 72.5% e të anketuarve në një studim të fundit në rajonin verilindor ashtu edhe në atë të Pollogut mendojnë se personat me aftësi të kufizuara nuk marrin pjesë në proceset vendimmarrëse në komunat e veta. Ndërsa 62.5% e të anketuarve në mënyrë kumulative, në të dy regjionet mendojnë se kryetari i komunës duhet të ketë një person me aftësi të kufizuara si këshilltar në kabinetin e tij.¹³⁶

Rezistenca dhe mospranimi ende i dukshëm i personave me aftësi të kufizuara si aktorë të barabartë në shoqëri, tregon se shumë pak është bërë në drejtim të ndërgjegjësimit dhe promovimit të respektimit të të drejtave dhe dinjitetit të personave me aftësi të kufizuara. Politikat dhe veprimet e ndërmarra nga aktorë të ndryshëm shoqërorë shpesh fokusohen te aftësia e kufizuar si një koncept unitar, dhe nuk i marrin parasysh aspektet e çështjeve gjinore. Për më tepër, nuk merret parasysh diskriminimi i shumëfishtë me të cilin përballen gratë për shkak të gjinisë së tyre, si persona me aftësi të kufizuara, si anëtarë të grupeve të ndryshme etnike duke përfshirë romët, grupin e moshës ose arsimit dhe që janë shpesh më të varfër dhe më pak aktivë se burrat me aftësi të kufizuara në rrethana të ngjashme.¹³⁷

5.6 Përgatitja e buxhetit (buxhetimit) në përputhje me KDKPAK

Qeveria e Maqedonisë së Veriut ka miratuar një Program ambicioz dhe gjithëpërfshirës për Reforma në Menaxhimin e Financave Publike (MFP). Megjithatë, sistemi i MFP-së ende nuk është përkthyer në një përgatitje reale të një buxheti, të bazuar në rezultatet në nivel qendror.

Një mënyrë për të vlerësuar koston e përjashtimit të personave me aftësi të kufizuara nga tregu i punës si një humbje në PBB të shkaktuar nga përjashtimi i lidhur me aftësinë e kufizuar është matja e hendekut midis asaj që ata fitojnë në të vërtetë dhe asaj që ata do të prisnin të fitonin nëse nuk do të ishin me aftësi të kufizuara, përmbledhur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara. Duke ndjekur këtë qasje, një studim i ONP vlerëson se humbja e PBB-së në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme është midis 1 dhe 7 përqind të PBB-së.¹³⁸

UN Women, Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim dhe organizatat e grave kanë bërë shumë përpjekje për të inkorporuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në Ligjin e buxhetit për 2018. Buxheti i përgjegjshëm gjinor tani është i detyrueshëm me ligj dhe janë duke u zhvilluar aktivitete për institucionalizimin e buxhetimit gjinor në krijimin e politikave dhe buxheteve kombëtare në nivel qendror dhe lokal.

Në këtë proces, një OPAK paraqiti edhe një iniciativë për të përfshirë përgatitjen e një buxheti (buxhetimi) i cili do të jetë i përgjegjshëm ndaj personave me aftësi të kufizuara, deri tek Ministria e Financave, Qeveria e Maqedonisë së Veriut dhe Trupi Koordinues Kombëtar për zbatimin e KDKPAK-së, por e njëjta përfundoi pa sukses. Nëpërmjet një projekti të mbështetur nga UN Women, Qendra për Hulumtim dhe Politikëbërje prezantoi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe buxhetimin për personat me aftësi të kufizuara për të integruar fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat e 4 komunave.¹³⁹ Në përgjithësi, njerëzit me aftësi të kufizuara janë të nënpërfaqësuar në buxhetimin në nivel kombëtar, sepse ata janë të grupuar së bashku me grupet e tjera "të cenueshme".

Edhe pse Maqedonia e Veriut po bën përparim në shumë aspekte të financimit ndërqeveritar, në 81 komuna akoma ka vështirësi në ofrimin e shërbimeve sociale adekuata dhe efikase. Sipas Bankës Botërore,¹⁴⁰ "Shpenzimet

¹³⁶ Shih: E. Koçoska, Z. Shavreski, Publikimi Analizë e politikave dhe gjendjes në rajonin verilindor dhe të Pollogut, Hendikep Plus, 2020.

¹³⁷ Shih: Z. Shavreski, E. Koçoska, V. Lazovski, V. Jovanovska. Analiza e gjendjes së personave me aftësi të kufizuara fizike, Komiteti i Helsinkit, 2017. Në dispozicion në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/%D0%90%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%BE%D1%98%D0%B1%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%BB%D0%B8%D1%86%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D1%81%D0%BE-%D1%84%D0%B8%D0%B7%D0%B8%D1%87%D0%BA%D0%B0-%D0%BF%D0%BE%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%87%D0%B5%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82-%D0%B2%D0%BE-%D0%A0%D0%B5%D0%BF%D1%83%D0%B1%D0%BB%D0%B8%D0%BA%D0%B0-%D0%9C%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0.pdf>

¹³⁸ Bakap, S "Kostoja e përjashtimit: Pasojat ekonomike të përjashtimit të personave me aftësi të kufizuara nga bota e punës." ILO, (2009)

¹³⁹ <http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2018/08/05.-Polio-Plus-Aerodrom-Final-Designed.pdf>

¹⁴⁰ <https://www.worldbank.org/en/country/northmacedonia/publication/sowing-Видидs-of-sustainable-future>

e ndihmës sociale në Maqedoninë e Veriut janë jo vetëm relativisht të ulëta, por edhe të fragmentuara, megjithëse shpenzimet për mbrojtjen sociale (përfshirë sigurimet sociale, pensionet) janë mjaft të larta. Ndihma sociale është e mangët në shumë fusha. Sfidë është edhe ekonomia, veçanërisht për programet siç janë shtesat prindërore, për të cilat rritja e shpenzimeve nuk pati ndikimin e planifikuar në rritjen e popullsisë. Përfitimet e asistencës financiare nuk janë të mjaftueshme, por ka pak stimuj financiarë për përfituesit e ndihmës sociale që të kërkojnë punë”.

Personat me aftësi të kufizuara nuk kanë marrë pjesë efektivisht në monitorimin dhe zbatimin e buxhetit. Një nga arsyet për këtë është mungesa e transparencës së buxhetit si në nivel nacional ashtu edhe në atë lokal.

Është e vështirë, nëse jo e pamundur, të merren të dhëna të besueshme për shpenzimet buxhetore për aftësinë e kufizuar nga organet përgjegjëse dhe shembujt e vetëm pozitiv janë transfertat sociale për personat me aftësi të kufizuara në lidhje me përfitime të ndryshme sociale. Shumë komuna nuk kanë kapacitete administrative dhe financiare për të zhvilluar shërbime për personat me aftësi të kufizuara për shkak të dispozitave jodetyruese të Ligjit për Mbrojtjen Sociale¹⁴¹ dhe decentralizimit të kufizuar fiskal në vend. Buxheti lokal i aftësisë së kufizuar zakonisht fokusohet në sigurimin e mbështetjes financiare për funksionimin e qendrave ditore dhe transportin për fëmijët me aftësi të kufizuara për në dhe nga shkolla. Shërbimet e përgjithshme të rregullta në nivel lokal nuk janë të disponueshme për qytetarët me aftësi të kufizuara, përveç rasteve kur ato u drejtohen personave me aftësi të kufizuara dhe të cilat zakonisht sigurohen me bazë mjekësore ose bamirëse, gjë që është në kundërshtim me dispozitat e KDPAK.

Gjatë punësimit, nuk ka buxhet të përgatitur në përputhje me KDPAK – shteti siguron fonde të mëdha për punëdhënësit, dhe nuk investon pothuajse asgjë në ofrimin e trajnimeve, mundësive të barabarta dhe forcimin e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara. Sistemi i punëdhënësve mbrojtës është mënyra kryesore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Fondi i Posaçëm për Përmirësimin e Kushteve të Punësimit dhe Punës së Personave me Aftësi të Kufizuara është një kanal përmes të cilit shteti shpërndan mbështetjen buxhetore për kompanitë mbrojtëse që punojnë për përfitime. Ky fond plotësohet kryesisht nëpërmjet TVSH-së dhe detyrimeve doganore të paguara nga kompanitë mbrojtëse në buxhetin kombëtar. Teorikisht, ky buxhet duhet të realizohet në katër fusha kryesore: 1) ofrimi i akomodimit të arsyeshëm në vendin e punës, 2) ofrimi i trajnimit për punë/aftësim profesional për personat me aftësi të kufizuara, 3)

prokurimi i pajisjeve dhe 4) ofrimi i subvencioneve financiare për punëdhënësit për mbështetjen e marrëdhënies së rregullt të punës të personave me aftësi të kufizuara. Dy fushat e para synojnë drejtpërdrejt promovimin e punësimit, punës dhe punësueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara, ndërsa dy të fundit synojnë punëdhënësit duke ofruar përfitime financiare për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Më pak se 0.04% e 3.3 milion euro nga buxheti mesatar vjetor i këtij Fondi nga periudha 2012-2016 është shpenzuar në dy fushat e para, ndërsa pjesa tjetër e buxhetit është dedikuar për blerje të pajisjeve (30.7%) dhe për subvencione financiare për punëdhënësit (50%). Pjesa e mbetur prej 19% është rialokuar për të mbuluar shpenzimet buxhetore që nuk lidhen me aftësinë e kufizuar.¹⁴²

Në arsim, shpenzimet buxhetore për aftësinë e kufizuar mund të shihen në transformimin e “sistemit të arsimit të specializuar” në një sistem burimesh dhe mbështetjeje mësimore për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në vitin 2019/2020 janë punësuar 321 asistentë (91-AP dhe 230-AA) në 35 komuna.¹⁴³ Në vitin 2021, Ministria e Arsimit dhe Shkencës planifikon të punësojë 500 AA. Për këtë qëllim nga buxheti janë siguruar 59 milionë denarë.¹⁴⁴ Megjithatë, kjo dotë mbulojë vetëm një pjesë të nevojave reale të sistemit arsimor, dmth. fondet buxhetore duhet të vihen në dispozicion për trajnimin dhe zhvillimin e AP-ve dhe AA-ve, për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve në njohjen e roleve të ndryshme të asistentëve të ndryshëm dhe të drejtave të aftësisë së kufizuar, për zhvillimin e programeve arsimore që të përfshijnë aftësinë e kufizuar në mënyrë që të jenë në dispozicion për të gjithë nxënësit, duke ofruar qasshmëri fizike dhe komunikuese dhe qasje në teknologjinë ndihmëse, etj.

Mjetet dhe pajisjet ortopedike sigurohen nga buxheti i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Kushtet e ndryshme në lidhje me moshën, participimin dhe datën e skadimit të afatit të pajisjeve ndikojnë gjithashtu në mundësinë që personat me aftësi të kufizuara të përdorin përfitimet e parashikuara financiare. Fondet buxhetore për rehabilitim janë të kufizuara, dhe përshtatshmëria për përdorimin e tyre është e kufizuar në një periudhë të caktuar kohore pas lëndimit, dhe këto mjete mund të përdoren vetëm për trajtim të vazhduar, gjë që përjashton një numër të caktuar të personave me aftësi të kufizuara.

¹⁴² Për më shumë shih: Analizë e vlerësimit të programeve dhe masave kombëtare për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, f. 52-59, Tomislav Ortakovski, OSBE, 2018

¹⁴³ Paula Federica Hunt, Publikimi Kërkimor “Asistentë Arsimor dhe Personal. Tani dhe këtu – Perspektiva të hapura “UNDP, në dispozicion në: https://www1.undp.org/content/dam/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/docs/Educational%20and%20personal%20assistants%20-%20MKD.pdf

¹⁴⁴ <https://www.fakulteti.mk/news/23072021/vo-tek-e-oglas-za-vrabotuvanje-500-obrazovni-asistenti-za-poddrshka-na-decata-so-poprechenost-na-uchilishte-kje-zemaat-plata-od-24-000-denari>

¹⁴¹ Shih: Mekanizmat për ofrimin e shërbimeve sociale në Maqedoni, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe GiZ, 2011, f. 24, <http://www.nacionalnakomisija.gov.mk/sites/default/files/prikachyvanja/studija_mehanizmi_za_obebeduvanje_na_socijalni_uslugi_vo_makedonija.pdf> I qasur më: 20.11.2014.

Organizatat e personave me aftësi të kufizuara, përveç organizimit të tyre ombrellë, nuk mbështeten sistematikisht nga buxhetet kombëtare dhe lokale. Ligji për organizatat me aftësi të kufizuara¹⁴⁵ dhe ligji për lojërat e fatit dhe lojërat zbavitëse¹⁴⁶ garantojnë mbështetje financiare vjetore prej pak më shumë se 1.2 milion euro për shtatë sindikata nën kujdesin e Këshillit Kombëtar të Organizatave të Aftësisë së Kufizuar (në tekstin e mëtejme KKOAK¹⁴⁷), pa asnjë shans de facto që OPAK-të e bazuara në të drejtat të mbështeten në të njëjtën mënyrë. Edhe përkundër konstatimeve nga revizioni shtetëror në vitin 2017 për keqpërdorim të fondeve të KKOAK, nuk u ndërmor asnjë sanksion nga shteti.

Investimi në zbatimin e synimeve për zhvillim të qëndrueshëm SZhQ-ve në vend është bërë nga 13 donatorë zhvillimi. Nga 870 milionë euro të dërguara ndërmjet 2016 dhe 2020, shumica më e lartë shkoi për SZhQ 11 (Urbanizimi i Qëndrueshëm). Sipas të dhënave nga Raporti "Zbatimi i Synimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm: Vlerësimi i Shpejtë i Integruar i Politikave Kyçe Kombëtare të Planifikimit Zhvillimor" në kuadër të SZhQ, në varësi të mandatit të donatorit, investimet janë injektuar veçanërisht në SZhQ të caktuara (p.sh. buxhetet e projekteve të DBE ishin të orientuar drejt synimeve në SZhQ (Qeverisja Inkluzive) dhe SZhQ 17 (Partneritetet), ndërsa agjencitë e OKB-së kanalizuan pjesën më të madhe të financimit të tyre në SZhQ 8 (Rritja Ekonomike dhe Punësimi). Sipas këtij raporti, projektet e finansuara nga DEU në kontekstin e SZhQ, alokuan mbi 193 milion euro, nga të cilat shumica e mjeteve, gati 70 milionë euro janë ndarë për SZhQ 16 (Shoqëritë Paqësore dhe Inkluzive), ndërsa Synimi 16 është financuar me rreth 33 milionë euro. Agjencitë e OKB-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut së bashku kanë ndarë rreth 106.5 milionë euro për SZhQ, nga të cilat pothuajse 24 milionë euro u ndanë për SZhQ 8 (Rritja dhe Punësimi). Nuk ka të dhëna se sa prej këtyre fondeve janë të destinuara për aftësinë e kufizuar dhe zbatimin e KDPAK, në vend nuk ka tregues të SZhQ që të ndahen sipas aftësisë së kufizuar.¹⁴⁸

¹⁴⁵ Shih: Ligji për Organizatat e Aftësisë së Kufizuar, MPPS, në dispozicion në: https://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/invorganizacii_konsolidiran.pdf

¹⁴⁶ Shih Ligjin për lojërat e fatit dhe lojërat zbavitëse, i disponueshëm në: <http://www.ujp.gov.mk/mk/regulativa/opis/25>

¹⁴⁷ Këshilli Kombëtar i Organizatave me Aftësi të Kufizuara është një shoqatë e shtatë organizatave kombëtare të aftësisë së kufizuar, si më poshtë: Këshilli Kombëtar për të Verbërit, Këshilli Kombëtar për të Shurdhërit, Këshilli Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara - Lëvizshmëria, Qendra Republikane për Mbështetjen e Personave me Aftësi të Kufizuara Intelektuale "Mesazhi", Këshilli Nacional i Civilëve me Aftësi të Kufizuara nga Lufta, Federata Kombëtare për Sport dhe Rekreativitet të Personave me Aftësi të Kufizuara të Maqedonisë - Komiteti Paralimpik i Maqedonisë dhe Sindikata Kombëtare e Punëtorëve me Aftësi të Kufizuara

¹⁴⁸ https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/1578Rapid_Integrated_Assessment_North_Macedonia.pdf

5.7 Llogaridhënia dhe menaxhimi

Zhvillimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente në të gjitha nivelet e qeverisjes është i integruar në Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030, siç është SZhQ 16.6. Forcimi i kapaciteteve për monitorim efektiv të këtij SZhQ kërkon veprim të mirëkoordinuar, të mirëfinancuar dhe komplementar në nivele të ndryshme.

Statistikat dhe mbledhja e të dhënave

Për sa i përket kuptimit të përgjithshëm të qasjes së të drejtave të njeriut ndaj aftësisë së kufizuar dhe qasjes mbizotëruese mjekësore/bamirëse, veçanërisht në ruajtjen e fondeve, bartësve të detyrave u mungon një të kuptuar i qartë i aftësisë së kufizuar. Përveç Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi,¹⁴⁹ i cili është në përputhje me përkufizimin e OKB-së për aftësinë e kufizuar sipas KDPAK-së, sektorë të ndryshëm përdorin përkufizime të ndryshme, por të gjithë udhëhiqen nga qasja dominuese mjekësore.¹⁵⁰ Bartësit kryesor të detyrimeve për mbledhjen e të dhënave janë Ministria e Punës dhe Politikës Sociale,¹⁵¹ Qendrat për Punë Sociale, Agjencia e Punësimit,¹⁵² Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor,¹⁵³ Ministria e Arsimit dhe Shkencës,¹⁵⁴ Ministria e Shëndetësisë¹⁵⁵ dhe Fondi i Sigurimeve Shëndetësore.¹⁵⁶ Të gjitha të dhënat janë njëdimensionale dhe plotësojnë nevojat e ngushta të atyre që i mbledhin. Më shpesh të dhënat ndahen sipas gjinisë, grupmoshës dhe përkatësisë etnike, por vetëm për të treguar numrin e burrave dhe grave me aftësi të kufizuara në secilin nga nëngrupet.

Enti Shtetëror i Statistikave (ESHs) grumbullon të dhënat e aftësisë së kufizuar të mbledhura nga

¹⁴⁹ Neni 4, pikat 2, 3, 4, 5 (Gazeta Zyrtare 101/2019)

¹⁵⁰ Për më shumë shih Ligjet dhe politikat në Republikën e Maqedonisë në fushën e aftësisë së kufizuar - Raport nga monitorimi sistematik i ligjeve dhe politikave, 2015, f. 14-17; Analizë - vlerësim i programeve dhe masave kombëtare për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, 2018, f. 20

¹⁵¹ Të dhëna për numrin e personave që marrin kompensim për aftësinë e kufizuar, kompensimin për kujdesin ndaj palës së tretë, shtesën e asistentit personal, numrin e personave që marrin kompensim për të ardhurat minimale të garantuara dhe të dhëna të tjera përkatëse

¹⁵² Të dhënat për personat e papunë me aftësi të kufizuara, numrin e kompanive mbrojtëse për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, numrin e personave me dhe pa aftësi të kufizuara të punësuar në kompanitë mbrojtëse

¹⁵³ Të dhëna për numrin e personave që marrin pension invaliditeti, shkalla e invaliditetit

¹⁵⁴ Numri dhe lloji i shkollave fillore dhe të mesme dhe qendrave burimore për fëmijët me aftësi të kufizuara, numri i nxënësve të regjistruar në këto shkolla, numri i asistentëve personalë dhe arsimor në shkollat e rregullta.

¹⁵⁵ Të dhëna nga komisionet që vendosin për shkallën individuale të paaftësisë dhe të dhëna të tjera përkatëse për aftësinë e kufizuar mjekësore

¹⁵⁶ Të dhëna për pajisjet për aftësinë e kufizuar të mbështetur nga Fondi, shumica e fondeve të siguruar për pajisjet për aftësinë e kufizuar, të dhëna të tjera relevante për aftësinë e kufizuar mjekësore

bartësit e detyrave në raportet e tij mujore, vjetore dhe tematike,¹⁵⁷ edhe pse është në gjendje të mbledhë të dhëna të ndara për aftësinë e kufizuar dhe të inkorporojë aftësinë e kufizuar përgjatë metodologjive të tyre. Programi pesëvjeçar i hulumtimit statistikor¹⁵⁸ është dokumenti kyç për përcaktimin e fushës së të dhënave që do të mblidhen gjatë asaj periudhe. Për arsye të ndryshme ndër vite, aftësia e kufizuar nuk është përfshirë në këtë program. Procesi i përcaktimit të nevojave dhe prioriteteve për programin 2023-2027 duhet të fillojë pas operacionit të regjistrimit në vitin 2021 dhe EShS duket se është e hapur për bashkëpunim për të zgjeruar qasjet metodologjike për vendosjen e aftësisë së kufizuar në rrjedhat kryesore.

Një dimension shtesë që luan një rol në krijimin e prioriteteve statistikore të EShS-së është numri i kërkesave që ata marrin çdo vit për nevojat e aktorëve të jashtëm, duke përfshirë edhe bartësit tjerë të detyrave, OPAK-të dhe OSHC-të, individë, studiues, studentë të doktoraturës, etj. Përveç disa OPAK-ve dhe OSHC-ve, nuk ka aktorë të tjerë që kërkojnë statistika të aftësisë së kufizuar, madje as qeveria. Numri i vogël i kërkesave drejtuar EShS-së për statistikat e aftësisë së kufizuar lidhet kryesisht me faktin tashmë të njohur se ato nuk kanë në pronësi të tyre të dhëna specifike për aftësinë e kufizuar ose të dhëna të aftësisë së kufizuar të përfshira në rrjedhat kryesore, përveç atyre të dhënave të siguruar nga bartësit tjerë të detyrave. Megjithatë, mundësia e presionit më të madh mbi këtë institucion nëpërmjet kërkesave të shpeshta dhe të drejtuara në mënyrë strategjike, mund të ndihmojë që çështjet e aftësisë së kufizuar të pozicionohen më lart në listën e tyre të prioriteteve. Kjo në fakt vlenë për të gjithë bartësit e detyrave.

ESHS-ja ka rolin kryesor në hartimin e pyetësorit të regjistrimit, i cili ofron vetëm hapësirë dhe kohë të kufizuar për pyetje për çdo temë, siç është aftësia e kufizuar. Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të përfshihen pyetje relevante dhe të formuluar mirë që mund të prodhojnë të dhënat më të mira për krijimin e politikave. Grupi i Uashingtonit për Statistikat e Aftësisë së Kufizuar (WG) zhvilloi grupe të shkurtra dhe të zgjeruara pyetjesh për aftësinë e kufizuar për t'u përdorur në operacione të tilla, një raport që vë në dukje përdorimin e grupit të shkurtër nga më shumë se 60 vende deri në mesin e vitit 2020.¹⁵⁹

I njëjti raport arrin në përfundimin se zbrërthimi i treguesve të SZhQ sipas aftësisë së kufizuar sipas standardeve ndërkombëtare është i realizueshëm

dhe në rritje dhe se zhblokimi i potencialit të plotë të ndarjes do të kërkojë më shumë asistencë teknike për të mbështetur zyrtarët kombëtarë të statistikave për të shfrytëzuar maksimalisht instrumentet e tyre ekzistuese dhe të dhënat.

Megjithatë, regjistrimi i popullsisë, banesave dhe amvisërive të vitit 2021 në Maqedoninë e Veriut nuk përfshin asnjërën nga grupet e pyetjeve të GW¹⁶⁰ edhe pse vendi pretendoi të kundërtën para KDPAK në vitin 2018 në përgjigjet e tij për listën e çështjeve të raportit fillestar.¹⁶¹ Një version shumë i kufizuar i grupit të shkurtër të pyetjeve të GW është përfshirë në pyetësorin e regjistrimit. Për më tepër, në procesin e konsultimit për pyetësorin e regjistrimit, asnjë nga ministritë dhe institucionet e tjera të përfshira në proces nuk e theksuan mungesën e grupit të shkurtër të pyetjeve të GW apo nuk bënë koment zyrtar për këtë çështje. Në të njëjtën kohë, përfaqësuesit e agjencive të OKB-së besonin se pyetësori i regjistrimit përfshinte grupin e shkurtër të pyetjeve të GW. Pa grupin e shkurtër të pyetjeve të GW, regjistrimi nuk do të prodhojë të dhëna të nevojshme për aftësinë e kufizuar, të cilat do të kenë një ndikim dërrmues negativ në cilësinë e politikave dhe masave të aftësisë së kufizuar në të gjitha nivelet. Asnjë nga bartësit e detyrave që u kontaktuan nuk duket të jetë në dijeni për këtë dhe as nuk duket se e kanë prioritet këtë çështje.

Hulumtuesit, OPAK-të, OSHC-të dhe organizatat ndërkombëtare përgjithësisht bien dakord se të dhënat dhe statistikat për aftësinë e kufizuar në vend janë të pakta.¹⁶² Zyrtarët e lartpërmendur mbledhën të dhëna dhe statistika për aftësinë e kufizuar në formë rudimentare dhe të izoluar, gjë që i bën këto të dhëna dhe statistika jo të plota, të pamjaftueshme dhe të fragmentuara. Të dhënat e aftësisë së kufizuar ndryshojnë në raport me përkufizimet e dhëna në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe fokusohen vetëm në sasi pa u thelluar në thellësinë e marrëdhënieve shkak-pasojë. Për më tepër, këto të dhëna zakonisht nuk janë të disponueshme për publikun dhe mund të merren përmes njoftimeve të miratuara më parë të administratorëve aktualë ose duke paraqitur kërkesa për qasje në të dhënat publike, gjë që shpesh rezulton me kërkesa të refuzuara dhe jo në kërkesa të pranuar. Më e rëndësishmja është se, aftësia e kufizuar nuk përfshihet në mekanizmat dhe metodologjitë e mbledhjes së të dhënave. Kjo përkeqëson padukshmërinë e këtij grupi të bartësve të të drejtave në sytë e politikëbërësve dhe minon fuqishëm përgjegjësinë e përgjithshme të bartësve

¹⁵⁷ <https://www.stat.gov.mk/PublikaciPoOblasti.aspx>

¹⁵⁸ <https://www.stat.gov.mk/pdf/Programa20182022.pdf>

¹⁵⁹ Shih <https://www.washingtongroup-disability.com/question-sets/>; Raporti i aftësisë së vendeve për të ndarë treguesit e SZhQ-ve sipas aftësisë së kufizuar, 2020, https://www.washingtongroup-disability.com/fileadmin/uploads/wg/Documents/WG_Implementation_Document_10_-_SDG.pdf

¹⁶⁰ Pyetësorët që do të përdoren në regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2021 (Gazeta Zyrtare 30/2021).

¹⁶¹ Lista e çështjeve në lidhje me raportin fillestar të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Përgjigjet e ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë në listën e çështjeve, 2018, Përgjigja në pyetjen 54

¹⁶² Analizë e gjendjes së personave me aftësi të kufizuara fizike në Republikën e Maqedonisë, 2017, fq. 63, 64.

të detyrave dhe shpjegon pse qeveria në përgjithësi nuk është në gjendje të hartojë dhe zbatojë politika, strategji dhe masa të qëndrueshme dhe koherente që bazohen mbi të drejtat në shumicën e fushave.¹⁶³

Korniza kombëtare për zbatim dhe monitorim

Pikat e kontaktit në qeveri për monitorimin e zbatimit ligjor dhe praktik të të drejtave të KDPK-së së OKB-së, si pjesë e kornizës më të gjerë trenivelëshe për zbatim, nuk janë krijuar në Maqedoninë e Veriut as dhjetë vjet pas ratifikimit. Kjo ngre shqetësime serioze për shoqërinë në tërësi, duke vënë në dukje mungesën e mundshme të të kuptuarit të koncepteve mbi të cilat bazohet KDPK-ja, si dhe mungesën e vullnetit politik për të vepruar metodologjikisht për çështjet e aftësisë së kufizuar të bazuara në të drejtat. Gjithashtu, kjo thekson mungesën e mirëkuptimit midis elitave politike për të ndërtuar sisteme dhe infrastrukturë të qëndrueshme për të mirën e qytetarëve.

Pas ndryshimeve në aktet nënligjore¹⁶⁴ që rregullojnë vendosjen në nivel kombëtar sipas nenit 33 të KDPK të OKB-së, Maqedonia e Veriut ristrukturoi organin kombëtar koordinues për zbatimin e KDPK, dmth. **mekanizmin koordinues kombëtar**, duke e pozicionuar atë në kabinetin e kryeministrit dhe duke forcuar përfaqësimin e institucioneve.¹⁶⁵ Ndërkaq dy ndërhyrjet pozitive janë theksuar edhe në vërtetimet përfundimtare në raportin fillestar të vendit të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.¹⁶⁶ TKK miratoi planin e veprimit të OKB-së për zbatimin e KDPK për 2021 në korrik të vitit 2021¹⁶⁷, i cili është një plan ambicioz me masa për ligjet, politikat, infrastrukturën dhe punën në terren, që do të zbatohet nga shtatë ministri.

Duke qenë se qëllimi kryesor i TKK-së është të forcojë bashkëpunimin ndërmjet ministrive dhe të shmangë miratimin e masave të izoluar nga politikëbërësit, mbeten çështje të rëndësishme. Ende

nuk janë përcaktuar nivelet minimale në hierarki të përfaqësuesve të institucioneve në këtë organ, duke pasur parasysh se nivelet më të larta janë të nevojshme për shpërndarjen dhe zbatimin e duhur të masave të miratuara përmes ministrive të linjës.

Përfaqësimi në këtë organ i organizatës ombrellë të personave "invalidë" dhe qendrës burimore për prindërit e fëmijëve me "aftësi të kufizuara" mund të konsiderohet problematik: së pari, nuk ka kritere me të cilat ata janë emëruar;¹⁶⁸ dhe së dyti, nuk ka përfaqësim të OPAK-ve të bazuara në të drejta. Së bashku me pikat e reja të kontaktit të krijuara në qeveri, konstatimi i mësipërm vë në pikëpyetje angazhimin për zbatimin e duhur të KDPK-së dhe përfshirjen e një qasjeje të bazuar në të drejtat në politika dhe cikle programore.

Kjo përforcohet edhe nga fakti se Ministria e Shëndetësisë nuk ka marrë ende përgjigje për kërkesat e TKK-së dhe AP-së për vaksinimin me prioritet kundër KOVID-19 për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, shqetësimi i përcjellë deri tek institucionet përkatëse për mosfunksionimin e komisioneve që japin kompenzime për aftësisë së kufizuar¹⁶⁹ nuk ka dhënë rezultate – çka rezulton në pamundësinë e personave me aftësi të kufizuar për t'i marrë kompensimet ose për t'i humbur ato që tashmë janë dhënë. Për më tepër, TKK nuk e mbështeti kërkesën e mekanizmit të pavarur të monitorimit për të përfshirë grupin e pyetjeve të shkurtra (WG-SS) ose të zgjeruara (WG-ES) mbi funksionimin e Grupit të Uashingtonit për statistikat e aftësisë së kufizuar në regjistrimit ardhshëm kombëtar të 2021. E gjithë kjo thekson rëndësinë e krijimit të pikave të kontaktit që do të lehtësojnë transpozimin e masave të KDPK-së në sistemin kombëtar dhe në jetën e qytetarëve.

Mekanizmi i pavarur për monitorim, në kuadër të Njësisë për të Drejtat e Fëmijëve dhe Personave me Aftësi të Kufizuara të Avokatit të Popullit, ka akreditim me statusin B, që tregon përputhshmëri të pjesshme me Parimet e Parisit.¹⁷⁰ Ky mekanizëm është vënë zyrtarisht në funksion që nga viti 2019, i përbërë nga tre anëtarë, asnjë prej të cilëve nuk është person me aftësi të kufizuara. Krijimi i tij është një hap pozitiv në zbatimin e KDPK-së dhe nevojiten përpjekje për ta forcuar atë. Kjo njësi i është drejtuar OPAK-ve dhe OSHC-ve për t'iu bashkuar mekanizmit nga të cilët 17 e kanë pranuar tashmë, por nuk ka rregulla të qarta për përfaqësimin e OPAK-ve dhe OSHC-ve apo procedurat për emërimin ose shkarkimin e anëtarëve. Në vitin 2021 dy takimet e para zyrtare u mbajtën me

¹⁶³ Për shembull, në korrik 2021, Qeveria ka transferuar 100.000.000 denarë nga Fondi special për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuar në një program tjetër (Gazeta Zyrtare 166/2021); 30.000.000 MKD në shtator 2020 (Gazeta Zyrtare 218/2020); 100.000.000 MKD në qershor 2020 (Gazeta Zyrtare 156/2020)

¹⁶⁴ Vendim për Krijimin e Trupit Koordinues Kombëtar për Zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (Gazeta Zyrtare 144/2012 - shfuqizuar; Gazeta Zyrtare 69/2018, 75/2019)

¹⁶⁵ Kabineti i Kryeministrit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Kulturës, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Sekretariati për Çështjet Evropiane, si dhe Këshilli Kombëtar i Organizatave të "Invalidëve" dhe Qendra Burimore për Prindërit e Fëmijëve me "Nevoja të Veçanta".

¹⁶⁶ Vërejtje përfundimtare për raportin fillestar të IRJ të Maqedonisë, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, nenet 4a, 4d

¹⁶⁷ https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/akciski_plan_z_2021_godina_z_implementacija_na_konvencijata.pdf.

¹⁶⁸ Shpallje publike për zgjedhjen e anëtarit në TKK, <https://vlada.mk/node/14502>, qasur më 24.07.2021

¹⁶⁹ <http://www.mobilnost.mk/index.php/2011-10-26-09-10-24/396-sednica-na-nacionalnoto-koordinativno-telo-za-implementacija-na-konvencijata-na-on-za-pravata-na-licata-so-invalidnost>, qasur më 24.07.2021

¹⁷⁰ <https://www.un.org/ruleoflaw/files/PRINCI~5.PDF>, qasur më 22.07.21

mbështetjen e Zyrës së Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së. Ekziston një mungesë e dukshme e strukturës dhe e prioritetëve të përcaktuara, si dhe një kuptim i përbashkët i nevojës për një qasje sistematike ndaj monitorimit.

Si rezultat i përpjekjeve të Avokatit të Popullit, fëmijët me aftësi të kufizuara u kthyen me sukses në klasat me prezencë fizike brenda sistemit të specializuar arsimor, duke iu përgjigjur kështu ndikimeve të shtuara dhe joproporcionale të KOVID-19 tek fëmijët me aftësi të kufizuara. Në bashkëpunim me OPAK dhe përmes procedurave të brendshme, Njësia ka paraqitur kërkesa për ndryshimin e neneve diskriminuese në disa ligje; kryesisht për përjashtimin e personave mbi 65 vjeç nga pagesa për aftësinë e kufizuar, kërkesën e anëtarësimit për të fituar të drejtën për transport preferencial me autobus dhe për përfshirjen e plotë të pyetjeve të Grupit të Uashingtonit në regjistrimin e ardhshëm. Këto dhe aktivitete të tjera të Njesisë në bashkëpunim me OPAK-të dhe OSHC-të mund të ofrojnë bazën për funksionimin e mekanizmit të monitorimit, i cili mund të zgjerohet më tej përmes ngritjes së kapaciteteve.

Lidhur me pavarësinë e mekanizmit monitorues, Mekanizmi Parandalues Kombëtar¹⁷¹ pranë Zyrës së Avokatit të Popullit dhe Mekanizmi i Kontrollit Civil¹⁷², janë themeluar në bazë të ligjit, por jo edhe mekanizmi monitorues. Buxheti vjetor i mekanizmit monitorues është në nivel të ngjashëm me dy mekanizmat e tjerë, por është i pamjaftueshëm për të kryer rolin e tij bazë. Gjithashtu, duhet të forcohen kapacitetet me burime shtesë njerëzore dhe njohuri për të drejtat e njeriut, që është një prioritet i lartë për stafin e këtij mekanizmi.

Ministri i Punëve të Jashtme kryeson **Panelin Ndërqeveritar për të Drejtat e Njeriut**¹⁷³ ndërkaq Sekretariati është pjesë e Drejtorisë për Marrëdhënie Multilaterale dhe Bashkëpunim të Sigurisë. Ky organ ka për detyrë të koordinojë gamën e plotë të të drejtave të njeriut me të gjitha ministritë dhe institucionet qeveritare; shkëmbimi i informacionit dhe i të dhënave për zbatimin e rekomandimeve të organeve për marrëveshjet; dhe propozon ndryshime për të përmirësuar kornizën ligjore për të drejtat e njeriut. Në thelb, ky organ koordinon zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga organet e marrëveshjeve ndaj subjekteve të ndryshme qeveritare, por vetëm në raport me koordinimin dhe ndjekjen. Ky organ përbëhet nga Ministri i Punëve të Jashtme, 12 sekretarë shtetërorë të disa ministrive dhe 4 udhëheqës të institucioneve qeveritare, si dhe 4 udhëheqës të mekanizmave

të pavarur si anëtarë të jashtëm.¹⁷⁴ Niveli i lartë i përfaqësimit mundëson një pasqyrë të mirë të progresit të bërë në lidhje me rekomandimet e zbatuara.

Së fundi, duhet theksuar **mungesa e plotë e strategjive të aftësisë së kufizuar dhe përfshirja e aftësisë së kufizuar në strategjitë ekzistuese** të të gjithë aktorëve bartës të detyrimeve. Kjo përfshin të gjithë mekanizmat sipas nenit 33, me përjashtim të Planit të Veprimit të TKK-së 2021, i cili fokusohet në përgjegjësitë e palëve të ndryshme të interesit për masa specifike - dhe nuk është një strategji gjithëpërfshirëse për përfshirjen e aftësisë së kufizuar në punën e tyre. Për më tepër, strategjive ekzistuese të bartësve të detyrave u mungojnë pothuajse plotësisht aspektet e aftësisë së kufizuar, me përjashtim të çështjeve të aftësisë së kufizuar që "i përkasin" fushës së punës së tyre.

Raportet deri te KDKPAK

Detyrimi për të paraqitur raporte periodike të aftësisë së kufizuar nënkupton një kërkesë që shtetet të kryejnë hulumtime transparente dhe proces të përgatitjes dhe të përfshirjen personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese në procesin e përgatitjes dhe përpilimit të raportit.¹⁷⁵ Nga njëra anë, qëllimi është të forcojë llogaridhënien e palëve të interesuara dhe të nxisë partneritetet menaxhuese ndërmjet qeverive dhe shoqërisë civile, nga ana tjetër.

Raporti i parë i Maqedonisë së Veriut për KDKPAK u përgatit nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe draft versioni përfundimtar iu dorëzua OPAK-ve për koment. Raporti u fokusua në dispozitat dhe politikat ligjore dhe nuk trajtoi situatën e personave me aftësi të kufizuara. Raporti i parë iu dorëzua Komisionit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në tetor 2014.¹⁷⁶ Pas këtij raporti qeveritar, koalicioni joformal i OPAK-ve dhe OSHC-ve paraqiti një raport të shkurtër si përgjigje ndaj listës së pyetjeve nga vendi.¹⁷⁷ Ai nuk përmbante vetëm përgjigjet e listës së pyetjeve për vendin, por mbulonte edhe një sërë çështjesh të tjera që nuk ishin përfshirë në listë, duke u bërë kështu një raport alternativ. Për më tepër, ai ka pasqyruar një të kuptuar diametralisht të kundërt lidhur me aftësinë e kufizuar midis bartësve të detyrave, nga njëra anë, dhe OPAK-ve dhe OSHC-ve, nga ana tjetër, por edhe një situatë krejtësisht e ndryshme në terren nga ajo e pasqyruar nga raporti qeveritar.

¹⁷¹ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit (Gazeta Zyrtare nr. 181/2016)

¹⁷² Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit (Gazeta Zyrtare nr. 35/2018)

¹⁷³ Vendimi për themelimin e një organi ndërqeveritar për të drejtat e njeriut (Gazeta Zyrtare 55/2012, 55/2015)

¹⁷⁴ Përfshirë Avokatin e Popullit dhe Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi

¹⁷⁵ KDKPAK e OKB-së, neni 35 paragrafi 4 në përputhje me nenin 4 paragrafi 3

¹⁷⁶ tinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD%2fC%2fMKD%2f1&Lang=en

¹⁷⁷ <http://www.nsiom.org.mk/konvencija/category/16-izveshtai-za-konvencijata>

6. Analiza

Megjithëse vendi ratifikoi KDPAK-në në vitin 2011, pak është bërë për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të jetojnë një jetë të pavarur me dinjitet. Mbizotëron stigmatizimi dhe diskriminimi i komunitetit me aftësi të kufizuara, i cili në kombinim me mjedisin e paqasshëm i kufizon mundësitë që personat me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë si anëtarë të barabartë të shoqërisë.

Gjatë këtyre 10 viteve të ratifikimit, vendi nuk i është afruar sistematikisht zbatimit efektiv të KDPAK-së. Korniza ligjore ekzistuese, duke përfshirë edhe Kushtetutën, që rregullon të drejtat civile dhe politike, si dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, është e ngurtë, kufizuese dhe diskriminuese dhe nuk është në përputhje me KDPAK-në e OKB-së.

Ligjet e reja të miratuara (Ligji për Arsimin Fillor, Ligji për Mbrojtjen Sociale, Punësim dhe një pjesë e ligjeve për të drejtat e kujdesit shëndetësor) vetëm e deklarojnë barazinë formale dhe nuk janë në përputhje me dispozitat e KDPAK-së. Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi njeh të drejtën për barazi dhe mosdiskriminim sipas neneve 3 dhe 5 të KDPAK-së. Ka njohuri të kufizuara për akomodimin e arsyeshëm dhe barazinë inkluzive nga të gjitha palët e interesuara, OPAK dhe OSHC.

Kur është fjala për infrastrukturën institucionale, Qeveria në vitin 2018 bëri përpjekje dhe krijoi një kornizë më të gjerë në tre nivele për zbatimin e KDPAK (TKK për zbatimin e KDPAK). Pika e kontaktit është emëruar në kuadër të Qeverisë dhe organit monitorues të themeluar në vitin 2020 në kuadër të Zyrës së Avokatit të Popullit. Përkundër kësaj përpjekjeje, kjo infrastrukturë e supozuar nuk është në përputhje me KDPAK (neni 33).

Ministri i Punëve të Jashtme kryeson Organin Ndërqeveritar për të Drejtat e Njeriut, me Sekretariatine vendosur në Drejtorinë për Marrëdhënie Shumëpalëshe dhe Bashkëpunim të Sigurisë. Sekretariati komunikon me një numër të kufizuar OSHC-sh, me shembuj pozitivë nga ciklet e fundit të raportimit sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe Rishikimit Periodik Universal. Megjithatë, lidhjet e dobëta me OPAK-të janë të dukshme, pa komunikim në lidhje me KDPAK të OKB-së, përveç lehtësimit në prezantimin e raportit fillestar në KDPAK të OKB-së. Organi duhet ende të përcaktojë modalitetet, ndoshta brenda grupit të tij të ekspertëve, për një bashkëpunim më të strukturuar me kuadrin më të gjerë të shoqërisë civile, përfshirë OPAK-të.

Ka një mungesë të të kuptuarit të KDPAK në qeveri, gjykata dhe parlament, duke përfshirë organe të tjera rregullatore në fusha të ndryshme, si dhe në mekanizmin kombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Vendi nuk ka një mekanizëm funksional dhe gjithëpërfshirës për koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve të aftësisë së kufizuar, si dhe zbatimin e KDPAK dhe SZHQ.

Lëvizja e aftësisë së kufizuar është e fragmentuar në OPAK-të tradicionale dhe OPAK-të e reja, si dhe në organizata prindërore për fëmijët me aftësi të kufizuara. OPAK-të dhe organizatat mëmë kanë mungesë njohurish në lidhje me dispozitat e KDPAK-së. Sipas pozitës dominuese të përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare në vend, komuniteti i personave me aftësi të kufizuara është thellësisht i ndarë dhe antagonist. Forcimi i partneriteteve brenda lëvizjes së aftësisë së kufizuar, nxitja e bashkëpunimit të ngushtë me OSHC-të për të drejtat e njeriut dhe forcimi i kapaciteteve të mekanizmit monitorues, krijimi i një zëri të unifikuar të bazuar në qasjen e aftësisë së kufizuar të bazuar në të drejtat e njeriut, duhet të vazhdojnë të jenë të mbështetura në mënyrë strategjike. Ndër rezultatet e tjera pozitive të një qasjeje të tillë është se ajo do të sigurojë një të kuptuar më të qëndrueshëm të aftësisë së kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor, i cili nga ana tjetër do të pasqyrojë cilësinë e rolit mbikëqyrës të trupit mbikëqyrës ndaj OPAK-ve dhe OSHC-ve, duke kontribuar në krijimin e gjeneratave të reja të organizatave të personave me aftësi të kufizuara të bazuara në të drejta me prapavijë të ndryshme.

Ekziston një mungesë e koordinimit për çështjet e aftësisë së kufizuar midis qeverisë, donatorëve, agjencive të OKB-së dhe OPAK-ve. Vendi nuk ka një Strategji Kombëtare të Aftësisë së Kufizuar dhe procedura standarde operative për përfshirjen e aftësisë së kufizuar dhe inkorporimin e saj në rrjedhat kryesore.

Të gjithë personat me aftësi të kufizuara përballen me sfida në raport me qasjen në drejtësi për shkak të informacionit të pamjaftueshëm për ekzistimin e shërbimeve që mund të ofrojnë qasje më të mirë, por edhe trajnimit të pamjaftueshëm të nëpunësve shtetëror për të punuar me personat me aftësi të kufizuara. Ka shumë pak informacion në dispozicion se çfarë duhet bërë në rast të dhunës dhe shkeljes së të drejtave.

Vendi përballlet me paqasshmëri në infrastrukturë

në vende publike (vendet e punës, shkolla, gjykata, kisha, stacione policore, burgje etj.), transport dhe informacione, gjëra që ndikojnë seriozisht në ushtrimin e plotë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Mungojnë standardet e qasshmërisë dhe procedurat operative, kapacitetet e organeve rregullatore në nivel kombëtar dhe lokal. Kushtet për qasje dhe mosdiskriminim nuk janë pjesë e rregulloreve të prokurimit publik.

Përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara (fëmijë, të rinj apo të moshuar) realizohen sipas modelit mjekësor. Personat me aftësi të kufizuara mund të kualifikohen për një sërë shërbimesh dhe përfitimesh (shëndetësore, sociale, arsimore) në varësi të shkallës së paaftësisë/aftësisë, diagnozës dhe moshës.

Vlerësimi i aftësisë së kufizuar është një sfidë e madhe. Për çdo përfitim, qytetarët me aftësi të kufizuara duhet të kalojnë përmes një sistemi të vështirë burokratik të përbërë nga komisione të ndryshme. Qeveria nisi dhe themeloi Komisionin e parë Kombëtar të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar duke përdorur modelin e Klasifikimit Ndërkombëtar të Aftësisë së Kufizuar (KNAK) për fëmijët dhe të rinjtë nën 26 vjeç. MPPS paralajmëroi fillimin e procesit të reformimit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të qytetarëve mbi 26 vjeç, që konsiderohet si një mundësi e mirë, duke marrë iniciativën për reformimin e punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Kjo reformë është një mundësi e mirë për të zbatuar një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut. Suksemi i kësaj përpjekjeje do të varet nga krijimi i një sistemi gjithëpërfshirës të pajisur me burime njerëzore të cilët janë plotësisht të njohur me dispozitat e KDKPAK.

Shërbimet sociale dhe infrastruktura nuk janë të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara. Kompensimet ekzistuese në të holla për qytetarët me aftësi të kufizuara janë të kufizuara sipas llojit të aftësisë së kufizuar, moshës dhe statusit të vendbanimit. Shërbimet jashtë-institucionale janë të kufizuara. Qytetarët me aftësi të kufizuara që jetojnë jashtë institucioneve shpesh janë në përkujdesjen e familjeve të mbingarkuara biologjike dhe kujdestare. Mundësitë për integrim social shpesh mungojnë, duke e bërë jetën familjare ndonjëherë po aq të izoluar sa dhe vetë jetesën në një institucion. Shërbimet e AP-ve dhe shërbimet e kujdesit, duke përfshirë edhe ndihmën e AA-ve, mbivendosen dhe nuk përputhen me dispozitat e KDKPAK.

Shpesh, jeta e pavarur keqkuptohet si mungesë e varësisë nga mbështetja nga një person tjetër. As palët e interesuara dhe as personat me aftësi të kufizuara nuk kanë kuptuar siç duhet konceptin. Procesi i deinstitutionalizimit nuk është në përputhje me nenin 19. Është thelbësore të theksohet se as personat me

aftësi të kufizuara dhe as ofruesit e shërbimeve (stafi nga Qendrat për Punë Sociale, OSHC-të e angazhuara si ofrues) nuk janë të njohur me KDKPAK-në. Personat me aftësi të kufizuara marrin pjesë vetëm si shfrytëzues në procesin e deinstitutionalizimit.

Një tjetër sfidë e madhe në vend është situata me aftësinë për punë të shumë personave me aftësi të kufizuara. Rregullat dhe procedurat për një veprim të tillë ligjor janë të vjetruara. Nga pikëpamja e të drejtave të njeriut duhet të rishikohen proceset vijuese (a) procedura për kujdestarinë dhe përzgjedhja e kujdestarëve, (b) mandati dhe përgjegjësitë e kujdestarëve dhe (c) vlerësimet periodike të aftësive të një personi me aftësi të kufizuara për të marrë vendime. Çështjet që lidhen me aftësinë për punë janë komplekse dhe ndikojnë ndjeshëm në shumë fusha të jetës si pronësia, krijimi i familjes, punësimi dhe shumë të tjera. Kështu që, është më se e nevojshme hapja e një debati dhe fillimi i planifikimit të krijimit të një sistemi të vendimmarrjes së mbështetur.

Shërbimet ekzistuese të themeluara në komunitet janë të fragmentuara, të pakoordinuara, të paplota dhe të pazhvilluara sa duhet dhe joinkluzive. Nuk ka shërbime të integruara inkluzive në nivel lokal. Shumica e aktiviteteve të lidhura me aftësinë e kufizuar në nivel lokal janë vetëm një pjesë e punës së departamenteve të mirëqenies sociale dhe shpesh ofrohet mbështetje financiare për qendrat e kujdesit ditor.

Shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara janë të paqasshme ose të cilësisë së dobët. Legjislacioni aktual nuk parashikon edukim të detyrueshëm për çështjet e aftësisë së kufizuar të profesionistëve shëndetësorë, drejtuesve dhe ofruesve të shërbimeve shëndetësore. Sistemi aktual për sigurimin e pajisjeve ortopedike nuk është në përputhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara, as në cilësi dhe as në të drejtën e zgjedhjes. Gratë janë në një pozitë veçanërisht të pafavorshme: shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues janë plotësisht të paarrtshme për gratë me aftësi të kufizuara.

Qeveria ka miratuar Ligjin e ri për shkollat fillore, sipas të cilit hapen shkollat e rregullta për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, por çështja e infrastrukturës së paqasshme akoma mbetet e hapur. Edhe pse ky ligj është afër harmonizimit me dispozitat e KDKPAK-së, sërish arsimi i mesëm mbetet i paqasshëm, i segreguar dhe i specializuar. Qeveria njoftoi se në vitet e ardhshme do të bëhen reforma ligjore në arsimin e mesëm. Legjislacioni aktual nuk parashikon arsimin e detyrueshëm në bazë të çështjes së aftësisë së kufizuar të mësuesve dhe personelit akademik.

Sistemi i punësimit aktualisht promovon vetëm punësimin e personave me aftësi të kufizuara në kompanitë mbrojtëse. Pjesëmarrja e personave me

aftësi të kufizuara në tregun e punës është shumë e ulët. Duhet rishikim i ligjit dhe rishikim i statusit të Fondit të Posaçëm për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara. Regjistrimi i të papunëve me aftësi të kufizuara është gjithashtu shumë i ulët. Ekziston nevoja për zhvillimin e shërbimeve të punësimit të mbështetur. Në këtë drejtim, një mundësi e mirë është pilot modeli i implementuar nga UNDP-ja me themelimin e dy qendrave: një në institucionin publik social në Shkup dhe një tjetër në ndërmarrjen sociale Izbor në Strumicë. Të dyja qendrat pilotojnë shërbime të ndryshme dhe testojnë një qasje të bazuar në përvojë për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Një tjetër mundësi e mirë në këtë segment është angazhimi i Qeverisë për miratimin e Ligjit të ri për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara me sistem kuotash. Në nivel lokal, punësueshmëria e personave me aftësi të kufizuara nuk merret parasysh në programet strategjike të komunave.

Vendi nuk ka një qasje të strukturuar për marrjen e statistikave për personat me aftësi të kufizuara. Zyrtarët në detyrë që mbledhin statistika të aftësisë së kufizuar e bëjnë këtë në mënyrë të fragmentuar, duke u fokusuar vetëm në nevojat e tyre imediate. Ekziston një mangësi e theksuar në komunikimin e autoriteteve në lidhje me të dhënat e grumbulluara, gjë që çon në izolimin e këtyre të dhënave dhe pazbërthyeshmërinë e tyre për krijimin e politikave të bazuara në të dhëna. Fatkeqësisht, regjistrimi i ri (në vitin 2021) nuk arriti që të mbulojë në mënyrë adekuate komunitetin me aftësi të kufizuara. Asnjë nga bartësit e detyrave nuk është i detyruar të mbledhë të dhëna për personat me aftësi të kufizuara. Vendi nuk e njeh dhe nuk e kupton konceptin e buxhetimit të bazuar në rezultate për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara. Dispozitat për aftësinë e kufizuar nuk janë pjesë e ligjit të ri të buxhetit apo në menaxhimin e financave publike. Ka kapacitete dhe njohuri teknike shumë të kufizuara në sektorin publik edhe në mesin e vetë donatorëve, duke përfshirë edhe agjencitë e OKB-së për përgatitjen e buxhetit inkluziv. Buxhetimi me inkluzion dhe akomodim të arsyeshëm nuk ofrohet në të gjitha programet dhe shërbimet.

Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike është e dobët. Legjislacioni aktual për përzgjedhjen dhe punësimin në administratën publike nuk është në përputhje me dispozitat e KDPAK. Partitë politike nuk janë të njohura me detyrimet që dalin nga KDPAK. Qeveria nuk konsultohet aspak me OPAK-të apo personat me aftësi të kufizuara, as fëmijët dhe gratë me aftësi të kufizuara, kur harton legjislacionin, politikën apo ofertat e politikave në nivel kombëtar apo lokal.

7. Pikat kritike dhe mundësitë për veprim

7.1 Pika kritike

- Ekziston një mungesë e koordinimit ndërmjet palëve të interesuara të cilët janë pak të informuar për KDPAK
 - Mekanizmat dhe koordinimi ndërmjet të gjitha palëve të interesuara në nivel kombëtar dhe lokal janë shumë të dobët. Ka mungesë koordinimi ndërmjet qeverisë, donatorëve ndërkombëtarë, agjencive të OKB-së dhe OPAK-ve
 - Ka mungesë të ndërgjegjësimit dhe mirëkuptimit ndaj KDPAK-së tek shumica e zyrtarëve qeveritarë në ministri të ndryshme, Kuvendi dhe gjykatësit, si dhe OPAK-të, OSHC-të dhe personat me aftësi të kufizuara në nivel kombëtar dhe lokal
- Personat me aftësi të kufizuara nuk perceptohen si të barabartë me të tjerët dhe diskriminohen sistematikisht
 - Kushtetuta dhe legjislacioni ekzistues nuk janë në përputhje me KDPAK. Nuk ka një strategji kombëtare për aftësinë e kufizuar. Kapaciteti i mekanizmit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe palëve të interesuara në sistemin gjyqësor është shumë i dobët duke pasur parasysh dispozitat e KDPAK
 - Sistemi aktual i kujdestarisë mohon ose kufizon aftësinë juridike të personave me aftësi të kufizuara, duke kufizuar të drejtën e tyre për të vendosur dhe të drejtën e tyre për të zgjedhur
 - Për shkak të mungesës së kapaciteteve financiare dhe institucionale, si dhe mungesës së partneritetit dhe bashkëpunimit ndërmjet OPAK-ve, nuk ka unitet mes tyre dhe ata nuk flasin me zë të unifikuar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
 - Akomodimi i arsyeshëm nuk kuptohet nga të gjitha palët e interesuara, përfshirë OSHC-të, OPAK-të dhe personat me aftësi të kufizuara
 - Ka kapacitete teknike dhe njohuri shumë të kufizuara midis bartësve të detyrave rreth konceptit të aftësisë juridike dhe nenit 12 të KDPAK
 - Shteti nuk pati sukses në krijimin e një mekanizmi për vendimmarrje të mbështetur që do ta kthente aftësinë juridike të personave me aftësi të kufizuara në institucion, duke përfshirë atë të personave që janë në proces deinstitutionalizimi të cilët janë zhvendosur në shtëpi grupe
- Personat me aftësi të kufizuara nuk mund të lëvizin dhe të komunikojnë të pavarur në mjedisin e tyre
 - Paqasshmëria e infrastrukturës në vendet publike (vendi i punës, shkolla, gjykata dhe kisha), transporti dhe informacioni ndikojnë seriozisht në gëzimin e plotë të të drejtave nga personat me aftësi të kufizuar. Mungojnë standardet e qasshmërisë dhe procedurat operative, kapaciteti dhe kadri përkatës për implementim në fushën e ndërtimit të transportit, informacionit dhe teknologjisë
- Shërbimet inkluzive
 - Vlerësimi i aftësisë së kufizuar si një portë për shërbimet dhe përfitimet
 - Nuk ka një vizion të qartë se si të krijohet një sistem i duhur i vlerësimit të aftësisë së kufizuar bazuar në nevojat e personave me aftësi të kufizuara
 - Shërbime sociale inkluzive për sigurimet sociale dhe reduktimin e varfërisë
 - Shërbimet sociale janë me bazë mjekësore dhe diskriminuese. Mungojnë mekanizmat rregullues për shërbimet sociale në nivel kombëtar. Ka mungesë të koordinimit ndërmjet QPS-së dhe AP-së
 - Nuk ka shërbime të integruara mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara në komunitetet e tyre lokale
 - Kapaciteti i ulët i komunave dhe OPAK-ve për t'u angazhuar në partneritete produktive dhe për të kontribuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe realizimin e prioriteteve lokale në përputhje me strategjitë zhvillimore
 - Ka mungesë të koordinimit dhe shërbimeve për zbatimin e duhur dhe efikas të procesit të deinstitutionalizimit. Plani i veprimit për deinstitutionalizimin për vitin 2021 nuk është miratuar nga Qeveria. Palët e ndryshme të përfshira në procesin e deinstitutionalizimit nuk janë njohur me KDPAK-në
 - Shërbime inkluzive për arsim inkluziv
 - Pavarësisht përpjekjeve të bëra për të krijuar arsimin fillor inkluziv, kapaciteti dhe njohuritë e palëve të interesuara dhe mësuesve ende mungojnë. Arsimi i mesëm është i segreguar dhe i ndarë. Ka mungesë të kapaciteteve mes mësuesve në të gjitha nivelet. Kurrikula ekzistuese e trajnimit për edukatorët nuk përfshinë mësimin e aftësive të nevojshme për të punuar me fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara
 - Punësimi i mbështetur
 - Politika e punësimit për personat me aftësi të

kufizuara nuk është në përputhje me KDPAK. Fondi i Posaçëm i Punësimit për Personat me Aftësi të Kufizuara nuk është transparent. Ligji nuk promovon dhe nuk rregullon asnjë formë të punësimit të mbështetur të personave me aftësi të kufizuara. Shkalla e regjistrimit të personave me aftësi të kufizuara si të papunë është shumë e ulët. Rregullorja për qendrat e rehabilitimit profesional nuk është në përputhje me KDPAK

- ⊙ Shërbime inkluzive për të gëzuar të drejtën për shërbime shëndetësore dhe ShSR dhe parandalim të DhGj
- Pavarësisht ekzistimit të akteve legjislative dhe strategjive të ndryshme, qasja në shërbimet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara mbetet një pengesë kryesore, është diskriminuese dhe e bazuar në një qasje mjekësore. Personat me aftësi të kufizuara kanë qasje të kufizuara në informacion në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues dhe parandalimin e DhGj (dhunës me bazë gjinore)
- ⊙ Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në kuadër të politikave gjinore
- Politikat gjinore si dhe politikat e tjera (fëmijët, HIV) nuk kanë dispozita për aftësitë e kufizuara sipas qasjes ndërsektoriale të KDPAK. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara kanë informacion dhe qasje të kufizuara në drejtësi dhe asistencë pas dhunës
- Personat me aftësi të kufizuara janë lënë jashtë shumicës së proceseve politike dhe sociale në të gjitha nivelet
- ⊙ Korniza ligjore nuk është në përputhje me KDPAK dhe nuk ofron mundësi për burrat dhe gratë me aftësi të kufizuara për të shprehur pikëpamjet e tyre për çështje që janë të rëndësishme për ta, si dhe mundësinë për t'u bërë udhëheqës. Personat me aftësi të kufizuara përballen me shumë pengesa për pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike, duke përfshirë mungesën e mbështetjes sociale, boshllëqet në arsim, kornizë ligjore kufizuese dhe mjedise fizike dhe metoda komunikimi të paqasshme, të ardhura të ulëta dhe papunësi, si dhe forma të shumëanshme të diskriminimit
- ⊙ Korniza ligjore dhe shpërndarja e fondeve shtetërore për OPAK-të tradicionale rregullohet nga një "Ligj i posaçëm për Organizatat e Invalidëve", i cili krijon një antagonizëm midis OPAK-ve tradicionale dhe atyre të reja, të cilat janë bashkuar në KKOI pasi disa përfitime dhe shërbime kushtëzohen nga anëtarësimi në KKOI
- ⊙ Nuk ka mekanizma për të siguruar pjesëmarrjen e personave (përfshirë fëmijët) me aftësi të kufizuara në proceset vendimmarrëse që ndikojnë në jetën e tyre, veçanërisht, e drejta e fëmijëve me aftësi të

kufizuara për t'u marrë parasysh pikëpamjet e tyre për çështjet që kanë të bëjnë me ta dhe familjet e tyre, duke përfshirë pjesëmarrje në të gjithë mekanizmat mbrojtës

- Përgatitja e buxhetit të harmonizuar me KDPAK
 - ⊙ Rregulloret ligjore ekzistuese në ministri dhe menaxhimi me financat publike nuk e përfshijnë çështjen e aftësisë së kufizuar, që do të thotë se çdo vit fondet publike shpenzohen për shërbime që nuk janë në dispozicion për personat me aftësi të kufizuara. Mungojnë konsultimet sistematike dhe transparente gjatë procesit buxhetor me OPAK-të. Ka kapacitete dhe njohuri teknike shumë të kufizuara në sektorin publik dhe mes donatorëve, duke përfshirë edhe agjencitë e OKB-së për përfshirjen e buxhetit inkluziv. Personat me aftësi të kufizuara nuk kanë njohuri për proceset e buxhetimit, formulimit, zbatimit dhe monitorimit dhe vlerësimit
- Bartësit e detyrave nuk janë përgjegjës për përfshirjen dhe zbatimin e të drejtave të aftësisë së kufizuar në rrjedhat kryesore
 - ⊙ Mungesa serioze e të dhënave specifike për aftësinë e kufizuar dhe të shtresuara në bazë të aftësisë së kufizuar tek të gjithë bartësit e detyrave, së bashku me mungesën e vullnetit për të integruar aftësinë e kufizuar në rrjedhën kryesore të metodologjive ekzistuese të mbledhjes së të dhënave, e bëjnë të pamundur trajtimin ose priorizimin e çështjes së aftësisë së kufizuar në politikë. Mungojnë të dhëna, për aftësinë e kufizuar, të ndara sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe dëmtimeve. Regjistrimi kombëtar i popullsisë, amvisërive dhe banesave i vitit 2021 nuk do të sigurojë të dhëna të nevojshme për të krijuar politika të qëndrueshme për aftësinë e kufizuar. Mekanizmi raportues sipas KDPAK-së nuk është i qartë dhe nuk ka një kornizë funksionale operative. Ka mungesë pjesëmarrjeje dhe konsultimi me OPAK-të në proceset e SZHQ-ve të qeverisë dhe KDPAK-së. Ka kapacitete dhe njohuri teknike shumë të kufizuara midis donatorëve, duke përfshirë agjencitë e OKB-së për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe dispozitat në KDPAK
- Pandemia e Covid-19 dhe ligji për krizat humanitare dhe gjendjet e jashtëzakonshme
 - ⊙ Legjislacioni ekzistues nuk është në përputhje me Nenin. 11 të KDPAK-së. I njëjti nuk parashikon asnjë konsultim me personat me aftësi të kufizuara dhe OPAK-të. Gjatë KOVID - 19 shteti nuk ka bërë asnjë konsultim me personat me aftësi të kufizuar dhe OPAK-të. Shumica e masave të ndëmarra gjatë KOVID-19 kanë cenuar të drejtat e personave me aftësi të kufizuar

7.2 Mundësitë për veprim

Ndërgjegjësimi i gjerë për nevojën për një mekanizëm të mirë për koordinimin e aktiviteteve lidhur me aftësinë e kufizuar në nivel kombëtar dhe lokal midis njerëzve brenda strukturave ekzistuese (TKK për KDPAK, Avokati i popullit, KPMD) tregon se ka një dritare mundësie për veprim. Ka gjithashtu disa OPAK dhe OSHC që po avokojnë në mënyrë aktive për zbatimin e KDPAK-së. Agjencitë e OKB-së dhe donatorë të tjerë ndërkombëtarë po avokojnë gjithashtu për përfshirjen e aftësisë së kufizuar në agjendën e qeverisë përmes kornizave të tyre të partneritetit. Rishikimi aktual i Ligjit për Shoqatat e Qytetarëve dhe Fondacionet i iniciuar nga Ministria e Drejtësisë, që pritet të përfundojë në vitin 2022, është një mundësi e mirë për të avokuar për rregullimin më të mirë të punës së OPAK-ve dhe ndarjen e fondeve shtetërore për të gjitha OPAK-të në përputhje me dispozitat e KDPAK-së.

Përvoja e bashkëpunimit me agjencitë e KE-së dhe të OKB-së gjatë regjistrimit të vitit 2021 mund të hapë rrugën për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të Byrosë Kombëtare të Statistikave. EUROStat ishte partneri kryesor i qeverisë në aktivitetet që lidhen me regjistrimin dhe agjencitë e OKB-së të udhëhequra nga UNFPA dhe UNICEF kanë kontribuar në hulumtimin e mundësive për krijimin e një baze të dhënash për popullsinë që do të mundësojë hartëzimin e pabarazive socio-ekonomike dhe demografike.

Angazhimet e fundit të donatorëve për të investuar në infrastrukturën e shkollave është një mundësi për t'i bërë shkollat të qasshme për personat me aftësi të kufizuara (PAK). Gjithashtu, rishikimi aktual i Ligjit për Ndërtim nga qeveria është një mundësi e mirë për ta përmirësuar këtë ligj në përputhje me dispozitat e KDPAK-së.

Mbështetja e UNICEF-it për Trupin Kombëtar të Vlerësimit Funkcional për fëmijët dhe të rinjtë nën 26 vjeç është një mundësi e mirë për të rritur kapacitetin e këtij organi dhe nëntë organeve rajonale të planifikuara për vlerësimin e aftësisë së kufizuar të funksionalitetit për fëmijët dhe të rinjtë. Megjithatë, kurrikulat e trajnimit duhet të përmirësohen me dispozitat e KDPAK-së. Gjithashtu, MPPS me mbështetjen e BB-së planifikon të fusë një sistem të ri për vlerësimin e aftësisë së kufizuar të personave mbi 26 vjeç. Ky proces lidhet edhe me nismën për ndryshime në Ligjin për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Në kuadër të Programit të Rishikuar për Punësim dhe Reforma Sociale (PPRS), 2022 Qeveria njohu sfidat për zbatimin praktik të sistemit të integruar për punë me raste në terren, duke përfshirë edhe bashkëpunimin efikas ndërmjet QPS-së dhe OPAK-ve dhe nevojën e zhvillimit të kapaciteteve të tyre.¹⁷⁸

Shërbimet e integruara të ofruara në kuadër të "Programit të Punës në Komunitet" të pilotuara nga UNDP në partneritet me MPPS dhe MSH dhe komunat lokale mund të shërbejnë si model për ofrimin e shërbimeve të integruara për personat me aftësi të kufizuara. Edhe pse këto shërbime synojnë kryesisht të moshuarit dhe personat e sëmurë kronikë, pasi të përforcohen me dispozitat e KDPAK-së, ky model mund të përdoret për të krijuar një sistem shërbimesh të integruara për personat me aftësi të kufizuara në nivel lokal. Gjithashtu, në kuadër të PPRS, qeveria ka njohur domosdoshmërinë e zhvillimit të shërbimeve për rehabilitimin profesional të personave me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve të asistencës personale, për të lehtësuar qasjen e tyre në sistemin arsimor dhe tregun e punës, si dhe për të siguruar përfshirje të plotë sociale.

Programi "Zbatimi i normave, ndryshimi i mendjes", i zbatuar nga UN Women, ofron një mundësi të mirë për përfshirjen e aftësive të kufizuara. Në mënyrë të ngjashme, programet që synojnë promovimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të shëndetit riprodhues mund të përmirësohen me dispozitat e KDPAK-së. UNFPA në bashkëpunim me Qeverinë dhe MSH punon për ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e ligjeve dhe politikave që avancojnë barazinë gjinore dhe të drejtat riprodhuese me theks të veçantë mbi integrimin më të madh të shëndetit seksual dhe riprodhues dhe eliminimin e dhunës me bazë gjinore. Programet e tyre të përforcuara me dispozitat e KDPAK mund të jenë një mundësi e mirë për të zhvilluar kapacitetet e palëve të interesuara në sistemet shëndetësore sociale dhe arsimore, duke përfshirë OPAK-të dhe individët me aftësi të kufizuara që jetojnë në institucione, shtëpi grupore, familje kujdestare dhe biologjike.

Përvojat dhe mbështetja e Agjencisë së OKB-së dhe OSHC-ve për mbikëqyrje gjinore në procesin e buxhetimit me bazë gjinore është një mundësi e mirë për bashkëpunim dhe rrjetëzim për OPAK-të të cilat mund të fillojnë një iniciativë për një buxhetim të përgjegjshëm ndaj aftësisë së kufizuar dhe KDPAK-së.

¹⁷⁸ https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/dokumenti/2020/1.4_esrp.pdf

8. Konkluzione dhe rekomandime

Personat me aftësi të kufizuara në Maqedoninë e Veriut nuk perceptohen si të barabartë me të tjerët në shoqëri. Ata janë të diskriminuar sistematikisht, nuk janë në gjendje të lëvizin dhe të komunikojnë në mënyrë të pavarur në mjedisin e tyre, shërbimet nuk janë plotësisht inkluzive ose të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, ndërkaq përfaqësimi dhe pjesëmarrja e tyre është e pamjaftueshme dhe e parëndësishme. Nuk ka pjesëmarrje efektive të personave të ndryshëm me aftësi të kufizuara dhe OPAK-ve në procesin e politikëbërjes, si dhe ka një ndërgjegjësim të ulët për personat me aftësi të kufizuara dhe kapacitete të dobëta organizative dhe financiare të OPAK-ve.¹⁷⁹

Rekomandimi 1: Ekipi vendor i OKB-së duhet të mbështesë sistematikisht ngritjen e kapaciteteve të bartësve të të drejtave dhe organizatave të tyre përfaqësuese për avokim jodiskriminues, inkluziv dhe të përgjegjshëm në ndërhyrjet e mbështetura nga OKB-ja, si dhe mbështetjen e kapacitetit të tyre për të ndërmarrë avokim proaktiv dhe për t'u angazhuar në dialog të rëndësishëm me bartësit aktual të detyrave (qeverinë) dhe OSHC-të që ofrojnë shërbime për politika inkluzive dhe shërbime inkluzive. OKB-ja duhet gjithashtu të angazhohet me bartësit aktual të detyrave (qeverinë) dhe partnerët e tjerë të zhvillimit për të përforcuar njohuritë dhe kapacitetin e tyre për t'u konsultuar me të gjitha grupet e personave me aftësi të kufizuara dhe për të ofruar akomodim të arsyeshëm për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të mirëfilltë.

Mekanizmat kombëtarë të zbatimit dhe monitorimit të KDPAK-së kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme. Ndërsa Trupi Koordinues Kombëtar për Zbatimin e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (TKK për KDPAK) është zhvendosur në Zyrën e Kryeministrit për një mbështetje më të mirë ekzekutive, mekanizma zbatues në terren, si p.sh. pika fokale të parashikuara nga KDPAK, nuk janë krijuar. Mekanizmi i pavarur monitorues i pozicionuar në Zyrën e Avokatit të Popullit nuk ka staf të dedikuar, strukturë të formalizuar apo kërkesa të qarta për anëtarësimin dhe kontributin e OSHC/OPAK-ve. Në koordinim të ngushtë me qeverinë dhe ministrinë e linjës, OKB-ja dhe agjencitë e saj mund të mbështesin një proces të identifikimit dhe përcaktimit të pikave të kontaktit në ministrinë përkatëse. Këto pika qendrore mund të jenë individë ose njësi, në varësi të rrethanave ekzistuese brenda përgjegjësi. Në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit, OKB-ja dhe agjencitë e saj mund të mbështesin procesin e formalizimit të TKK-së si pjesë e kësaj zyre, me burime të dedikuara për të mbështetur punën e saj të papenguar.

Së fundi, në partneritet me Avokatin e Popullit, OKB-ja dhe agjencitë e saj duhet të mbështesin zhvillimin e mëtejshëm të një mekanizmi të pavarur monitorues si një entitet i pavarur brenda Zyrës së Avokatit të Popullit, me burime të dedikuara financiare dhe njerëzore për Sekretariat. Kjo duhet të përfshijë mbështetjen për zhvillimin e rregullave dhe procedurave për menaxhim më të mirë të proceseve të brendshme, së bashku me mundësitë për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve për stafin e përhershëm dhe anëtarët e tjerë.

Rekomandimi 2: Agjencitë e OKB-së duhet të mbështesin zhvillimin e mëtejshëm të një mekanizmi të pavarur monitorues si një entitet i pavarur brenda Zyrës së Avokatit të Popullit, me burime financiare dhe njerëzore të alokuara në mënyrë të përshtatshme për Sekretariat. Kjo duhet të përfshijë mbështetjen për zhvillimin e rregullave dhe procedurave për menaxhim më të mirë të proceseve të brendshme, së bashku me mundësitë për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve për stafin e përhershëm dhe anëtarët e tjerë.

Duke qenë se akomodimi i arsyeshëm nuk kuptohet ende si element i barazisë, rekomandohet zhvillimi i procedurave standarde operative për zbatimin e akomodimit të arsyeshëm në nivele të ndryshme. Qeveria, me mbështetjen e TKK për KDPAK, Mekanizmin e Pavarur Monitorues dhe OPAK, duhet të përcaktojë përgjegjësitë dhe mekanizmat përkatës të zbatimit të ministrive përkatëse, agjencive publike, gjykatave, autoriteteve vendore dhe OSHC-ve për të siguruar akomodim të arsyeshëm të personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, gjykata dhe prokurorët publikë duhet të mbështeten në mbledhjen e provave përkatëse dhe regjistrimin e rasteve të diskriminimit në bazë të aftësisë së kufizuar, si dhe në shkeljen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara nga gjykatat.

TKK për zbatimin e KDPAK-së, me pjesëmarrjen dhe konsultimin e personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK-ve, dhe në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, duhet të mbështetet nga OKB-ja dhe partnerët e zhvillimit në proces, për eliminimin e të gjitha dispozitave të diskriminimit që lejojnë revokimin e aftësisë juridike në bazë të dëmtimit dhe zëvendësimin e tyre me mekanizma mbështetës të vendimmarrjes që respektojnë autonominë, vullnetin dhe preferencat e personit në fjalë. Nevojiten aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për nëpunësit civilë, për të drejtën për njohje të barabartë para ligjit të personave me aftësi të kufizuara dhe marrëveshje të mbështetura për vendimmarrje.

Rekomandimi 3: OKB-ja dhe partnerët e zhvillimit duhet të iniciojnë dhe të marrin pjesë në një debat rreth nenit

¹⁷⁹ Një pasqyrë më gjithëpërfshirëse e rekomandimeve është e disponueshme në "Aneksin 6 Boshllëqe kritike, konkluzione dhe rekomandime kritike"

12 të KDPAK. Për më tepër, agjencitë e OKB-së duhet të mbështesin procesin e ngritjes së kapaciteteve për zyrtarët publikë për të drejtën për njohje të barabartë para ligjit të personave me aftësi të kufizuara dhe marrëveshjet e mbështetura të vendimmarrjes sipas KDPAK.

Shërbimet bazuara në komunitet janë endet të fragmentuara, të pakoordinuara, të paplota, të pazhvilluara dhe joinkluze. Nuk ka një mirëkuptim të përbashkët midis palëve të interesuara, duke përfshirë lëvizjen e aftësisë së kufizuar, në lidhje me shërbimet ekzistuese dhe të nevojshme, dhe shumëllojshmërinë e shërbimeve mbështetëse të komunitetit që ende nuk janë zhvilluar. Autoritetet lokale në të gjithë vendin nuk kanë aftësi dhe burime për të vlerësuar nevojat në nivel lokal dhe për të mobilizuar burime për të zhvilluar shërbime të reja. Vlerësimi aktual i aftësisë së kufizuar që duhet të identifikojë shërbimet e kërkuara, bazohet në modelin mjekësor për të rriturit dhe është gjithashtu i fragmentuar dhe shumë i burokratizuar. Ka mungesë të njohurive dhe të kuptuarit të dispozitave të KDPAK dhe modelit të të drejtave të njeriut nga stafi i përfshirë në komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Për të adresuar këto gjetje, qeveria, MPPS dhe aktorë të tjerë, me pjesëmarrjen e OPAK-ve, duhet të mbështeten në procesin e forcimit të kapaciteteve të komisioneve ekzistuese dhe atyre të reja dhe të gjithë komisioneve të tjera për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, duke përdorur mjetet e vlerësimit funksional të bazuar në Klasifikimi Ndërkombëtar të Funksionalitetit. Qasja e re e bazuar në analizën funksionale duhet të miratohet nëpër komisione, duke siguruar kështu (i) fokusimin në nevojat individuale të personave me aftësi të kufizuara, në vend të dëmtimit dhe diagnostikimit; (ii) krijimin e të dhënave për mbështetjen që njerëzit kërkojnë, dhe jo vetëm për përshtatshmërinë për përfitimet dhe shërbimet ekzistuese; (iii) përdorimin e të dhënave nga vlerësimi individual i aftësisë së kufizuar për të informuar mbi ngritjen e një sërë shërbimesh në të gjithë vendin, si në nivel lokal ashtu edhe në atë kombëtar, dhe për të siguruar shpërndarjen e burimeve të mjaftueshme për zhvillimin e shërbimeve mbështetëse. Njëkohësisht, legjislacioni ekzistues në lidhje me shërbimet mbështetëse, si dhe sistemet rregullatore të shërbimeve mbështetëse, përfshirë sistemin e licencimit dhe monitorimit, duhet të forcohen bazuar në KDPAK, me pjesëmarrjen e OPAK-ve.

Punësimi i personave me aftësi të kufizuara është një praktikë relativisht e rrallë në tregun e hapur të punës dhe organizohet kryesisht në shoqëri të caktuara ("mbrojtëse"). Është e nevojshme futja e parimeve të mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe barazisë midis burrave dhe grave, duke filluar nga sistemi i arsimit teknik dhe profesional, përmes sistemit të punësimit. Është e nevojshme të rishikohet Ligji për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, me pjesëmarrjen e OPAK-ve dhe personave me aftësi të kufizuara, si dhe të hartohet një strategji e qartë për kalimin në punësim në treg të hapur, futja e një sistemi kuotash dhe mekanizmash të zhvilluar për zgjerimin e punësimit mbrojtës, parashikimin e

komponentëve për trajnim dhe kalim në punësim të mbështetur dhe më pas shndërrimi i tij në punësim me kohë të plotë (kyçe në rrjedhat kryesore) në tregun e hapur të punës. Struktura e financimit duhet të rishikohet për të përmirësuar fleksibilitetin e mbështetjes së vazhdueshme financiare dhe për të rritur disponueshmërinë dhe cilësinë e punësimit të mbështetur përmes rritjes së kapacitetit të financimit për një mbështetje afatgjatë.

Mungojnë shërbimet, programet parandaluese, zbulimi i hershëm, trajtimi dhe rehabilitimi i hershëm. Rehabilitimi dhe e drejta për lëvizshmëri personale, duke përfshirë qasjen në pajisjet ortopedike dhe pajisjet e ofruara përmes shërbimeve/sectorit shëndetësor, janë të kufizuara. Korniza ligjore dhe politikat që rregullojnë qasjen në shërbimet shëndetësore nuk janë në përputhje me KDPAK. Procedurat për qasje në kujdesin shëndetësor parësor, sekondar dhe terciar nuk janë të qasshme dhe të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara. Rekomandohet rishikimi i kornizës ligjore që rregullon shërbimet shëndetësore, duke përfshirë rehabilitimin mjekësor dhe lëvizshmërinë personale, në përputhje me dispozitat e KDPAK-së dhe me pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK-ve. Gjithashtu rekomandohet krijimi i shërbimeve dhe programeve për parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, trajtimin e hershëm dhe rehabilitimin e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara.

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në vend nuk janë në gjendje të arrijnë deri te shërbimet ekzistuese për parandalimin e dhunës gjinore (DhGj) dhe shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues (ShSR) për shkak të infrastrukturës së paqasshme dhe mungesës së informacionit. Palët e interesuara përkatëse në fushën e dhe DhF nuk janë të njohur me dispozitat e KDPAK për ShSR dhe DhGj. Rrjedhimisht, duhet t'i ofrohet mbështetje MPSP-së, MSH-së, komuniteteve lokale, OSHC-ve, në procesin e zhvillimit të kapaciteteve të përbashkëta teknike dhe operacionale dhe mekanizmave përkatës për shërbime të disponueshme dhe të qasshme për DhGj dhe ShSR për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, duke siguruar pjesëmarrje aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK-ve. Duhet të zhvillohen programe trajnimi për DhGj dhe ShSR (planifikimi familjar, kujdesi gjatë shtatzënisë, amësia, parandalimi i kancerit të qafës së mitrës) në përputhje me dispozitat e KDPAK, si dhe materiale informative në lidhje me temat e DhGj dhe ShSR, të cilat duhet të përgatiten në formate të qasshme, duke përfshirë materiale në formate "të lehta për t'u lexuar".

Rekomandimi 4: Lidhur me procesin sfidues të krijimit të shërbimeve të integruara inkluzive për personat me aftësi të kufizuara, duke marrë parasysh qasjen ndërsektoriale në nivel kombëtar dhe lokal, dhe bazuar në aktivitetet e ndërmarra tashmë nga agjencitë e OKB-së në këtë drejtim, fokusi duhet të vazhdojë të jetë si në vijim:

4.1. *Forcimi i kapaciteteve të komisioneve ekzistuese, të reja dhe të të gjitha komisioneve të vlerësimit*

të aftësisë së kufizuar, duke përdorur mjetet funksionale të vlerësimit. Ekziston gjithashtu nevoja që agjencitë e OKB-së të lehtësojnë procesin e krijimit të sistemeve të duhura rregullatore për shërbimet mbështetëse, duke përfshirë sistemin e licencimit dhe monitorimit.

- 4.2 *Lehtësimi i kontributit të dhënë nga aktorë të shumtë në zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale, shëndetësore, arsimore dhe të punësimit në mbështetje të aftësisë së kufizuar duke propozuar rekomandime politikash për legjislacionin përkatës dhe akte nënligjore që rregullojnë këto shërbime, më pas duke krijuar një sistem administrativ të mbledhjes së të dhënave për të ofruar informacion për përdoruesit e shërbimeve, si dhe për të zhvilluar kapacitetin e autoriteteve për të identifikuar dhe adresuar pengesat në financimin dhe buxhetimin e shërbimeve të synuara për shumicën e personave me aftësi të kufizuara, duke përdorur një qasje ndërsektoriale.*
- 4.3 *Mbështetje e vazhdueshme për politika efektive punësimi me fokus mbi personat me aftësi të kufizuara dhe masa shtesë në fushën e punësimit të mbështetur dhe zhvillimit të qendrave të punësimit të mbështetur.*

Rekomandimi 5: Agjencitë e OKB-së duhet të mbështesin procesin e zhvillimit të kapaciteteve të përbashkëta teknike dhe operacionale dhe mekanizmave përkatës për shërbimet e disponueshme dhe qasshme për parandalimin e dhunës gjinore (DhGj) dhe shëndetit seksual dhe riprodhues (ShSR) për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Kjo duhet të përfshijë zhvillimin e programeve të trajnimit për DhGj dhe ShSR (planifikimi familja, kujdesi gjatë shtatzënisë, amësia, parandalimi i kancerit të qafës së mitrës), në përputhje me dispozitat e KDPAK.

Për sa i përket qasshmërisë, gjendja e personave me aftësi të kufizuara është e tillë që ata persona nuk mund të lëvizin dhe të komunikojnë të pavarur në mjedisin e tyre. Shumica e ndërtesave publike nuk janë fizikisht të qasshme dhe agjencitë publike nuk janë të njohura me KDPAK dhe dispozitat e qasshmërisë. Standardet universale nuk njihen në legjislacion dhe barazia, mosdiskriminimi dhe qasshmëria nuk janë pjesë e rregulloreve të prokurimit.

Gjuha e shenjave nuk njihet si gjuhë dhe ka një numër të vogël përkthyesish të gjuhës së shenjave në vend. Aflabeti i shenjave Braj (Braille) nuk është i rregulluar në sistem. Për të adresuar këto çështje, Qeveria, OPAK-të, TKK-ja për KDPAK-në, Ministria e Financave dhe Byroja e Prokurimit Publik duhet të mbështesin përpjekjet për të përfshirë kërkesat e qasshmërisë dhe mosdiskriminimit në rregulloret e prokurimit publik, si dhe për të përfshirë OPAK-të në komisionet e prokurimeve publike që lidhen me çështjet e infrastrukturës (mjedis të qasshëm, transport dhe TIK) dhe shërbimet për të cilat qasshmëria është

kritike, si dhe shërbimet në nivel kombëtar dhe lokal. Nevojitet mbështetje për krijimin e rregulloreve për përdorimin e gjuhës së shenjave dhe njohjen e saj në vend si gjuhë, si dhe futjen e masave që do të nxisin studimin e gjuhës së shenjave. MASH-it dhe MPPS-së duhet t'i ofrohet mbështetje në krijimin e një mekanizmi për rritjen e shkrim-leximit të të verbërve dhe për të rregulluar më tej përdorimin e shkrimit Braj.

Rekomandimi 6: OKB-ja dhe partnerët e zhvillimit duhet të përfaqësojnë dhe/ose mbështesin zhvillimin e kapaciteteve të përbashkëta teknike dhe operacionale të organeve rregullatore dhe aktorëve të tjerë përkatës në lidhje me prokurimin, ndërtimtarinë, strehimin dhe hotelet dhe restorantet në nivel kombëtar dhe lokal, për ta kuptuar dhe zbatuar qasshmërinë sipas dispozitave të KDPAK-së.

Mungojnë masat efektive që do të lehtësojnë **pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara** në ushtrimin e të drejtës së tyre të votës, pjesëmarrjen e tyre politike dhe përfaqësimin. Korniza aktuale ligjore për pjesëmarrjen politike nuk është në përputhje me KDPAK. Personat me aftësi të kufizuara nuk kanë përfaqësim adekuat politik në nivel kombëtar dhe përfaqësim në nivel lokal. Mungojnë mekanizmat për të siguruar pjesëmarrjen e personave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara në proceset vendimmarrëse, përfshirë pjesëmarrjen në të gjithë mekanizmat mbrojtës. Përfaqësimi dhe pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në OSHC-të, ofruesit e shërbimeve dhe organizatat ndërkombëtare është në një nivel shumë të ulët dhe pothuajse të padukshëm në shoqëri.

Duhet të mbështetet zhvillimi i kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara, me fokus të veçantë tek të rinjtë dhe gratë; ai duhet të synojë bazat e vendimmarrjes demokratike, politikat, degët e pushtetit dhe mekanizmat për krijimin e legjislacionit dhe të synojë një përfshirje dhe integrim më të madh të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Masat dhe veprimet e synuara duhet të mbështeten për të siguruar një rrjetëzim dhe bashkëpunim më të madh të OSHC-ve, OPAK-ve dhe ofruesve të shërbimeve në fusha të ndryshme të veprimit social, si dhe për të motivuar dhe inkurajuar OSHC-të që të përfshijnë personat me aftësi të kufizuara në ekipet e tyre.

Rekomandimi 7: Një fushë tjetër e avokimit/mbështetjes për OKB-në duhet të jetë zhvillimi i kapaciteteve të OPAK-ve, personave me aftësi të kufizuara, të rinjve, grave me aftësi të kufizuara në lidhje me themelet e strukturave vendimmarrëse demokratike, politikave, degëve të pushtetit dhe mekanizmave për krijimin e legjislacionit dhe pjesëmarrje më të madhe dhe domethënëse të tyre në këto procese në planin afatgjatë.

Rregulloret ekzistuese të zbatueshme ligjërish nëpër ministri dhe menaxhimi i financave publike nuk janë në përputhje me dispozitat e KDPAK-së për buxhetimin dhe menaxhimin financiar. Kjo nënkupton që çdo vit fondet publike shpenzohen për shërbime që nuk janë të qasshme

për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, mungojnë konsultimet sistematike dhe transparente me OPAK-të gjatë proceseve buxhetore. Ka kapacitete dhe njohuri teknike shumë të kufizuara në sektorin publik dhe midis donatorëve, përfshirë edhe agjencitë e OKB-së për hartimin e buxheteve inkluzive.

Gjithashtu ka një nivel të ulët njohurish të personave me aftësi të kufizuara për procesin e formulimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të buxhetit. Rrjedhimisht, rekomandohet përfaqësimi në rishikimin e Ligjit të Buxhetit, me qëllim që të inkorporohet çështja e aftësisë së kufizuar dhe të detyrohen të gjitha ministritë dhe autoritetet vendore që të përgatisin buxhetet në një format të qasshëm ku do të përfshihet dimensionin e aftësisë së kufizuar.

Duke u mbështetur në përpjekjet e vazhdueshme me buxhetimin gjinor, pilotimi i buxhetimit të aftësisë së kufizuar mund të mbështetet bazuar në rezultatet për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në disa komunitete lokale. Projekti i OKB-së për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor mund të jetë një mjet fillestar për përfshirjen e aftësisë së kufizuar në buxhetin dhe menaxhimin financiar të qeverisë. Ky proces mund të bëhet nga OPAK-të në bashkëpunim me OSHC-të e tjera dhe komunat lokale. Rekomandohet zhvillimi i kapaciteteve të Qeverisë, OSHC-ve dhe OPAK-ve për buxhetimin në përputhje me KDPAK, si dhe trajnimi për personat me aftësi të kufizuar për të krijuar, zbatuar dhe monitoruar buxhetin dhe proceset e vlerësimit të buxhetit të mbështeten në një bazë afatgjatë, bazuar në modelin e projektit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.

Rekomandimi 8: Agjencitë e OKB-së duhet të mbështesin zhvillimin e kapaciteteve të Qeverisë, OSHC-ve dhe OPAK-ve për përgatitjen e buxhetit (buxhetimit) në përputhje me KDPAK, si dhe trajnimin për personat me aftësi të kufizuara në lidhje me përpilimin, implementimin dhe monitorimin e buxhetit dhe proceset e vlerësimit në një bazë afatgjatë, bazuar në modelin e projektit për buxhetim të përgjegjshëm gjinor.

Ekziston një mungesë e të dhënave specifike të ndara në bazë të aftësisë së kufizuar në të gjitha nivelet, krahas mungesës së vullnetit për të përfshirë aftësinë e kufizuar në rrjedhat kryesore të metodologjive ekzistuese të mbledhjes së të dhënave. Kjo pamundëson përpjekjet për të trajtuar dhe për t'i dhënë përparësi aftësisë së kufizuar në zhvillimin e politikave. Në vitin 2022 Qeveria duhet t'i japë përparësi një qasjeje strategjike për të përfshirë aftësinë e kufizuar në mbledhjen e të dhënave kryesore nga të gjithë bartësit e detyrave. Ajo duhet të udhëheqë me shembull dhe të miratojë një strategji për një përfshirje të tillë në rrjedhat kryesore, duke përfshirë të gjithë bartësit e detyrave dhe duke siguruar kontribut thelbësor nga OPAK-të, OSHC-të e bazuara në të drejtat dhe komuniteti ndërkombëtar. Enti Shtetëror i Statistikave duhet të nisë procesin e përfshirjes së aftësisë së kufizuar në rrjedhën kryesore të operacioneve statistikore, siç janë aktivitetet

mujore, vjetore dhe tematike. OKB-ja dhe organizatat e tjera zhvillimore duhet të mbështesin Entin Shtetëror të Statistikave (ESHS) dhe zyrtarët e resorëve përkates që mbledhin të dhëna për të përfshirë aftësinë e kufizuar në rrjedhën kryesore të proceseve të mbledhjes së të dhënave. Duhet të lehtësohet sinergjia me Programin për Barazi Gjinore të zbatuar nga UN Women për të maksimizuar ndikimin.

Rekomandimi 9: Agjencitë e OKB-së duhet t'i ofrojnë mbështetje teknike Entit Shtetëror të Statistikave (ESHS) në procesin e përfshirjes së aftësisë së kufizuar në operacionet kryesore statistikore të vazhdueshme, si aktivitetet mujore, vjetore dhe tematike, përmes aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve. Kjo duhet të përfshijë mbështetjen e ESHS-së për të kryer procesin e vlerësimit të nevojave dhe zhvillimin e Programit të Hulumtimit Statistikor 2023-2027, në mënyrë që të përfshijë siç duhet aftësinë e kufizuar në rrjedhën kryesore të pyetësorëve ekzistues dhe mjeteve të tjera statistikore. Kjo mbështetje strategjike duhet të shtrihet sa më shumë që të jetë e mundur për të gjithë mbledhësit e të dhënave në mënyrë që të inkorporojnë siç duhet aftësinë e kufizuar në metodologjitë e tyre, ndërsa organet e mbledhjes së të dhënave (siç janë organet e vlerësimit të KNF) duhet, nëse është e mundur, të zhvillojnë një sistem që automatizohet do t'i përpunojnë këto të dhëna në mënyrë që të ofrojnë dëshmi për politikëbërjen, zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve.

Boshllëqet në sistem në lidhje me situatën e personave me aftësi të kufizuara në kuadrin e një krize emergjente/humanitare u bënë të dukshme gjatë shpërthimit të pandemisë KOVID-19. Korniza ekzistuese ligjore për kriza humanitare dhe situata emergjente nuk është në përputhje me KDPAK dhe nuk garanton pjesëmarrjen dhe konsultimin e aktorëve me personat me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e OPAK-ve. Qeveria, TKK për KDPAK në bashkëpunim me personat me aftësi të kufizuara dhe OPAK duhet të iniciojnë dhe rishikojnë ligjet e emergjencës në përputhje me nenin 11 të KDPAK-së.

Duhet të sigurohet pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet e gatishmërisë, vlerësimit të nevojave humanitare, proceset përkatëse të monitorimit dhe në programet dhe projektet që lidhen me rrezikun dhe emergjencat humanitare, rreziqet klimatike dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë.

Rekomandimi 10: Duke marrë parasysh situatën e personave me aftësi të kufizuara në situatën emergjente gjatë shpërthimit të pandemisë KOVID-19, agjencitë e OKB-së duhet të inkurajojnë qeverinë të bashkojë burimet dhe kapacitetet e tyre për të trajtuar aftësinë e kufizuar në masat emergjente dhe të krizës humanitare. Gjithashtu, duke pasur parasysh njohuritë e tyre për dispozitat e KDPAK-së për situatat emergjente, agjencitë e OKB-së mund të ndërtojnë kapacitetet e organeve rregullatore në këtë fushë.

9.

Rekomandime për analiza të mëtejshme/ mbledhje të të dhënave

Zbatimi i mëtejshëm i KDKPAK-së dhe përfshirja e aftësisë së kufizuar janë të mundshme vetëm nëse politikat, programet dhe shërbimet informohen nga analiza e të dhënave përkatëse dhe të besueshme. Ka disa fusha kritike ku nevojiten analiza të mëtejshme për të ndihmuar qeverinë të përcaktojë zgjidhjet dhe veprimet e duhura.

Analiza ka vërtetuar qartë se personat me aftësi të kufizuara në vend raportojnë më pak rastet e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar të përgjegjësit përkatës dhe në vend të kësaj raportojnë diskriminimin tek OPAK-të lokale dhe/ose kombëtare, OSHC-të me bazë në të drejtat dhe organizatat ombrellë. Edhe pse roli i këtyre organizatave gjithmonë mund të forcohet, hulumtimet tregojnë mungesë të mirëkuptimit dhe informacionit brenda komunitetit të aftësisë së kufizuar në lidhje me sistemin për mbrojtjen e të drejtave. Prandaj, nevojiten analiza të mëtejshme për:

- Identifikimin e nevojave reale dhe arsyes për numrin shumë të vogël të raportimeve;
- Vlerësimin e nivelit të besimit të personave me aftësi të kufizuara ndaj bartësve përkatës të detyrave;
- Vlerësimin e njohurive të personave me aftësi të kufizuara se si të mbrojnë të drejtat e tyre;
- Vlerësimin e nivelit të përgjithshëm të disponueshmërisë së bartësve përkatës të detyrave; dhe
- Vlerësimin e ndërgjegjësimit të tyre për ngacmimin seksual dhe diskriminimin gjinor tek personat me aftësi të kufizuara.

Për më tepër, shërbimet mbështetëse, si një parakusht thelbësor për përfshirjen e aftësisë së kufizuar në shoqëri, janë të pamjaftueshme në nivel kombëtar dhe lokal dhe bazohen kryesisht në transaksione të zakonshme financiare nga bartësit e detyrave ndaj personave me aftësi të kufizuara. Për të zhvilluar shërbime në përputhje me KDKPAK-në dhe qasje të përgjithshme të bazuar në të drejtat ndaj aftësisë së kufizuar, duhet të kryhet një analizë shtesë në mënyrë që:

- të hartëzohen (identifikohen) shërbimet ekzistuese dhe të vlerësohen nivelet e qasshmërisë së tyre në përputhje me KDKPAK-në dhe nevojat individuale të personave me aftësi të kufizuara;
- të përgatitet një portofol shërbimesh për aftësinë

e kufizuar, bazuar në hartëzimin dhe vlerësimin e shërbimeve;

- të vlerësohet mjaftueshmëria dhe përgjegjshmëria e shërbimeve ndaj nevojave aktuale në terren;
- të vlerësohet se çfarë nevojash ka për shërbime të reja dhe për zhvillimin e atyre ekzistuese;
- të prodhohet analizë krahasuese për të prezantuar praktikën më të mira dhe transferimin e njohurive; dhe
- të identifikohen njohuritë, qëndrimet dhe praktikën e personave me aftësi të kufizuara në lidhje me mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të tyre, me synimin për të identifikuar shkaqet e raportimit mjaft të ulët të diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar;

Nevojiten analiza të mëtejshme për të siguruar prova për rritjen e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në planifikimin kombëtar, zhvillimin e prioritetëve kombëtarë dhe identifikimin e boshllëqeve që lidhen me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në vend. Kryesisht, barazia inkluzive nuk kuptohet në mënyrë uniforme nga zyrtarë të ndryshëm, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal në vend, si në kontekstin zhvillimor ashtu edhe në atë humanitar. Mbisundon një mungesë e evidente e të kuptuarit të vetë KDKPAK-së dhe rolit të zyrtarëve bartës të detyrave në përputhje me të. Nevojitet një analizë për të hartuar nevojat për zhvillimin e kapaciteteve të palëve të interesuara në lidhje me zbatimin praktik të KDKPAK-së dhe nevojat individuale të secilit bartës të detyrave në avancimin e politikave institucionale në përputhje me KDKPAK.

Për më tepër, pikat e kontaktit brenda Qeverisë dhe bartësve të tjerë të detyrave nuk janë themeluar akoma edhe 10 vjet pas ratifikimit të KDKPAK-së nga OKB. Mungesa e të kuptuarit dhe njohurive për ta bërë këtë në mënyrë adekuate është e evidente, dhe mungesa e vullnetit politik e thekson këtë gjendje. Mekanizmi i pavarur monitorues është krijuar në një formë shumë rudimentare nën Avokatin e Popullit dhe i mungon një strukturë dhe procedura të formalizuara për të zhvilluar më tej strukturën dhe funksionet e tij. Prandaj nevojiten analiza të mëtejshme për të gjetur mënyrat më të mira të mundshme për krijimin e (i) pikave funksionale të kontaktit (ii) një modeli të një mekanizmi të pavarur monitorues që do t'i përgjigjet çështjeve thelbësore të aftësisë së kufizuar.

10. Rekomandime për veprime të ardhshme programore

Nuk ka dyshim se nevojiten investime në shumicën e fushave të rëndësishme për avancimin e zbatimit të KDKPAK-së në vend. Megjithatë, përmirësimi i të kuptuarit të KDKPAK-së si për bartësit e të drejtave ashtu edhe për bartësit e detyrave, rritja e përgjegjshmërisë së bartësve të detyrave dhe siguri i pjesëmarrjes kuptimplotë të personave me aftësi të kufizuara në proceset e planifikimit dhe monitorimit të zhvillimit kombëtar janë identifikuar si pika fillestare thelbësore në këtë fazë të zhvillimit. Prandaj rekomandimet për veprimet e ardhshme programore fokusohen në këto tri fusha.

I. Ngritja e kapaciteteve të bartësve të të drejtave dhe bartësve të detyrave për ofrimin e shërbimeve jodiskriminuese, inkluzive dhe të përgjegjshme. Ofrimi i shërbimeve të bazuara në komunitet, rezulton ende i fragmentuar, i pakoordinuar, i paplotë, i pazhvilluar dhe jo inkluziv. Nuk ka një mirëkuptim të përbashkët midis palëve të interesuara, përfshirë edhe komunitetin e aftësisë së kufizuar, në lidhje me shërbimet ekzistuese dhe të nevojshme, si dhe gamën e llojeve të ndryshme të shërbimeve mbështetëse të komunitetit që duhet të zhvillohen. Autoritetet lokale në të gjithë vendin nuk kanë aftësi dhe burime për të vlerësuar nevojat në nivel lokal dhe për të mobilizuar burime për të zhvilluar shërbime të reja. Për të adresuar këto boshllëqe, Programi duhet të hartojë dhe zbatojë ndërhyrje gjithëpërfshirëse dhe të fokusuara në ndërtimin e kapaciteteve. Këto mund të përfshijnë trajnime të përshtatura dhe modele inkluzive të ofrimit të shërbimeve dhe sisteme administrative për mbledhjen e të dhënave të ndara dhe të bazuara në shërbime.

II. Forcimi i legjisllacionit ekzistues që rregullon hartimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve me bazë në komunitet. Një hap kyç drejt pajtueshmërisë me KDKPAK është përafrimi i legjisllacionit vendas ekzistues. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fushën e projektimit dhe ofrimit të shërbimeve, ku legjisllacioni i vjetëruar shpesh çon në shërbime që nuk janë krijuar së bashku me personat me aftësi të kufizuara, modele të njëjta për të gjithë të ofrimit të shërbimeve dhe procese monitorimi joekzistente ose të paqasshme. Për të adresuar këto boshllëqe, ndërhyrjet e programit mund të fokusohen në lehtësimin e kontributit të më shumë palëve të interesuara në hartimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale për mbështetjen e aftësisë së kufizuar, duke propozuar rekomandime politikash mbi ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë këto shërbime dhe hartimin e një sistemi të mbledhjes së të dhënave administrative për të ofruar informacion mbi përdoruesit e shërbimit.

Të gjitha ndërhyrjet e ndërmarra, siç u tha më sipër dhe gjetkë, duhet të pasqyrojnë diversitetin e plotë të nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Qasja ekzistuese neutrale gjinore ndaj zbatimit të KDKPAK duhet të zëvendësohet nga një qasje ndërsektoriale të bazuar në të drejtat, ku personat me aftësi të kufizuara nuk shihen si një grup i vetëm homogjen, por si individë me identitete dhe karakteristika të ndryshme. Të gjitha ndërhyrjet e fokusuara tek bartësit e të drejtave duhet të përfshijnë gra dhe vajza me aftësi të kufizuara dhe përfaqësues të grupeve më të marginalizuara të personave me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu edhe fëmijët. Pjesëmarrja e tyre e konsiderueshme duhet të sigurohet nëpërmjet zbatimit të metodave të zhvillimit inkluziv dhe të duhur (që do të dakordohen në fazën fillestare të programit së bashku me OPAK-të dhe OSHC-të që përfaqësojnë këto grupe).

III. Kontributi i mirëfilltë i personave me aftësi të kufizuara – nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese – në proceset e planifikimit dhe monitorimit të zhvillimit nacional. Personat me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e OPAK-ve janë kryesisht të përjashtuar nga proceset e planifikimit dhe monitorimit të zhvillimit nacional në Maqedoninë e Veriut. OPAK-të shpesh konsultohen për çështje specifike të aftësisë së kufizuar dhe disa vendime që prekin drejtpërdrejt njësitë e tyre elektorale. Megjithatë, ata nuk janë të përfaqësuar në konsultimet e politikave të nivelit të lartë për të ardhmen e vendit, duke përfshirë zhvillimin e analizës së përbashkët të vendit (APV). Për të adresuar këtë sfidë, Programi do të lehtësojë konsultimin me aktorë të shumtë të APV-së – duke përfshirë OPAK-të që përfaqësojnë diversitetin e plotë të personave me aftësi të kufizuara. Kjo do t'u mundësojë OPAK-ve të rishikojnë përparimin e Maqedonisë së Veriut në të gjitha fushat e përfshira në APV dhe do të sigurojë një pasqyrë më të plotë të kthesave zhvillimore dhe sfidave në vend.

Përfshirja e OPAK-ve dhe OSHC-ve, të cilat përfaqësojnë grupet më të marginalizuara të personave me aftësi të kufizuara, duhet të bëhet në përputhje me parimin “të mos lëmë askënd pas”. Ndërhyrjet do të synojnë mbështetjen e OPAK-ve dhe OSHC-ve, pavarësisht kapaciteteve aktuale teknike dhe administrative, për të marrë pjesë në proceset e planifikimit dhe monitorimit të zhvillimit kombëtar. Ata do të mbështeten nga OPAK-të me aftësi të kufizuara për të përfshirë grupet më të marginalizuara në strukturat e tyre – përfshirë personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe psikosociale – dhe për të analizuar problemet e zhvillimit përmes prizmit gjinor.

11. Aneket

Aneksi 1. Lista e pjesëmarrësve në fokus grupe dhe takime individuale

	Emri dhe mbiemri	Organizatrat / Institucionet / Personat me Aftësi të Kufizuara	Gjinia		Persona me aftësi të kufizuara
			Burra	Gra	
09.07.2021	Fokus grup me përfaqësues të agjencive të OKB-së dhe komunitetit ndërkombëtar				
	Marija Trifunovska	UNDP		x	
	Natasha Bulevska	USAID		x	
	Tanja Temelkovska	OHCHR		x	
	Milica Trpeska	IOM		x	x
	Maja Llazarevska	IOM		x	
	Vangell Trkallanov	UNICEF	x		x
	Jasmina Belçovska Tasevska	UNDP		x	
	Marija Matovska	UNFP		x	
	Vesna Ivanoviq	UN Women		x	

	Emri dhe mbiemri	Organizatrat / Institucionet / Personat me Aftësi të Kufizuara	Gjinia		Persona me aftësi të kufizuara
			Burra	Gra	
09.07.2021	Fokus grup me përfaqësues të Trupit Koordinues Kombëtar për Zbatimin e KDKAK-së				
	Lidija Krsteska Dojçinovska	Anëtare e TKK për KDKAK-përfaqësuese e Qeverisë		x	
	Vllado Krstovski	Anëtar i TKK për KDKAK-përfaqësues i KKOIM	x		
	Ljupka Arsovska	Anëtar i TKK për KDKAK - përfaqësues i Qendrës Burimore për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara		x	
	Tomislav Cvetkovski	Anëtar i TKK për KDKAK - përfaqësues nga Ministria	x		
	Mirjana Zllatanova	Anëtare e TKK për KDKAK - përfaqësuese nga Ministria		x	
	Mihajllo Kostovski	Anëtar i TKK për KDKAK - përfaqësues nga Ministria	x		

	Emri dhe mbiemri	Organizatrat / Institucionet / Personat me Aftësi të Kufizuara	Gjinia		Persona me aftësi të kufizuara
			Burra	Gra	
12.07.2021	Fokus grup me përfaqësues të komisioneve të ndryshme të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe Qendrave për Punë Sociale				
	Goran Petrushev	Anëtar i organit të ri kombëtar për vlerësimin e funksionalitetit sipas KNF	x		
	Lidija Krsteska Dojçinovska	Anëtare e organit të ri kombëtar për vlerësimin e funksionalitetit sipas KNF		x	
	Vesna Cekovska	Zapovim		x	
	Hristina Savevska	Zapovim		x	
	Marija Petkovska	Zapovim		x	
	Biljana Arizankoska Eftimova	Zapovim		x	
	Dr. Mijakoski	Zapovim	x		
	Tanja Mishevska	Qendra për Punë Sociale		x	

	Emri dhe mbiemri	Organizatrat / Institucionet / Personat me Aftësi të Kufizuara	Gjinia		Persona me aftësi të kufizuara
			Burra	Gra	
13.07.2021	Fokus grup me organizatat e personave me aftësi të kufizuara				
	Marija Puposka	Shenja e re - OPAK e personave me dëmtim të dëgjimit		x	x
	Martin Angelov	Shenja e re - OPAK e personave me dëmtim të dëgjimit	x		x
	Dimitar Illçov	Mendimi - Shoqatë e njerëzve me aftësi të kufizuara psikosociale	x		x
	Suzana Najdoska	Unioni i studentëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara		x	
	Sefer Hiseini	Shpresa - Shoqata e personave me aftësi të kufizuara	x		x
	Snezhana Gradosorlieva	Mobiliteti Ohër - Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara Fizike		x	x
	Zoran Jovanovski	Pa kuzifime....	x		x
	Branimir Jovanovski	Unioni Kombëtar i Personave me Aftësi të Kufizuara Fizike – Lëvizshmëria	x		x

	Emri dhe mbiemri	Organizatrat / Institucionet / Personat me Aftësi të Kufizuara	Gjinia		Persona me aftësi të kufizuara
			Burra	Gra	
13.07.2021	Fokus grup me përfaqësues të organizatave prindërore si ofrues të shërbimeve				
	Stefan	Inkluziva – Kumanovë	x		
	Anita Gagovska	Mesazhi –Struga e re		x	
	Daliborka Zllateva	Organizata e prindërve të fëmijëve me paralizë cerebrale		x	
	Verica Tasheva	Mesazhi - Negotinë		x	

	Emri dhe mbiemri	Organizatrat / Institucionet / Personat me Aftësi të Kufizuara	Gjinia		Persona me aftësi të kufizuara
			Burra	Gra	
15.07.2021	Fokus grup me përfaqësues të mekanizmit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ofruesve të ndihmës juridike nga OSHC-të				
	Igor Jadrovski	Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi	x		
	Natasha Petkovska	Komiteti i Helsinkit		x	
	Ivana Petkovska	Të gjithë për një “koalicion të qivkimit të drejtë”		x	

	Emri dhe mbiemri	Organizatrat / Institucionet / Personat me Aftësi të Kufizuara	Gjinia		Persona me aftësi të kufizuara
			Burra	Gra	
22.07.2021	Fokus grupi me ofruesit e shërbimeve				
	Vesna Matovska	Hera		x	
	Silvana Naumovska	HOPS		x	
	Biļjana Dukovska	Platforma maqedonase për luftë kundër varfërisë		x	
	Aleksandra	Kryqi i Kuq		x	
	Sashko Jovanov	Humaniteti		x	
	Elena Petrovska	Margjinat		x	

	Emri dhe mbiemri	Organizatrat / Institucionet / Personat me Aftësi të Kufizuara	Gjinia		Persona me aftësi të kufizuara
			Burra	Gra	
	Gjashtë fokus grupe me persona me aftësi të kufizuara				
06.07.2021	Ile Geçev	Aftësi të kufizuar fizike	x		x
06.07.2021	Dimitar	Person i verbër	x		x
06.07.2021	Arsen Stavrov	Person i verbër	x		x
06.07.2021	Vasil Radenovski	Person i verbër	x		x
07.07.2021	Jovica Petrovski	Aftësi të kufizuar fizike	x		x
07.07.2021	Rexhep Reshepi	Aftësi të kufizuar fizike të kombinuar	x		x
08.07.2021	Ivan Nacev	Aftësi të kufizuar fizike	x		x
08.07.2021	Tanja Neshevska	Aftësi të kufizuar fizike		x	x
08.07.2021	Trajçe Pançev	Aftësi të kufizuar intelektuale	x		x
08.07.2021	Natasha Taneva	Aftësi të kufizuar intelektuale		x	x
08.07.2021	Darjan Pançev	Aftësi të kufizuar intelektuale	x		x
08.07.2021	Slavica Dimovska	Aftësi të kufizuar fizike		x	x
08.07.2021	Ubavka Simonovska	Aftësi të kufizuar intelektuale		x	x
08.07.2021	Çedo Kostadinov	Aftësi të kufizuar intelektuale	x		x
08.07.2021	Adil Pashov	Aftësi të kufizuar intelektuale dhe shikim të dëmtuar	x		x
12.07.2021	Poposki	Aftësi të kufizuar fizike	x		x
12.07.2021	Gordana Mitankovska	Aftësi të kufizuar intelektuale		x	x
12.07.2021	Mara Trpeska	Aftësi të kufizuar intelektuale		x	x
12.07.2021	Mirfet	Aftësi të kufizuar fizike		x	x
12.07.2021	Ankica Markovska	Aftësi të kufizuar intelektuale		x	x
12.07.2021	Svetlana Markovska	Shikim të dëmtuar		x	x
15.07.2021	Marina Jovanova	Aftësi të kufizuar intelektuale		x	x
15.07.2021	Gordana Nikolova	Aftësi të kufizuar intelektuale		x	x
15.07.2021	Stançe Trajçev	Aftësi të kufizuar fizike	x		x
15.07.2021	Blagojço Mitrov	Shikim të dëmtuar	x		x
16.07.2021	Stefan Stefanovski	Aftësi të kufizuar fizike	x		x
16.07.2021	Gjoko Surlovski	Aftësi të kufizuar fizike	x		x
16.07.2021	Zlatko Mickovski	Aftësi të kufizuar intelektuale	x		x
16.07.2021	Iva	Aftësi të kufizuar intelektuale		x	x
16.07.2021	Berat Jakupi	Shikim të dëmtuar	x		x

	Emri dhe mbiemri	Organizatrat / Institucionet / Personat me Aftësi të Kufizuara	Gjinia		Persona me aftësi të kufizuara
			Burra	Gra	
	Intervistat individuale me pjesëmarrës të ndryshëm				
13.07.2021	Vlatko Llazovski	Këshilltar për Deinstitutionalizimin, MPPS	x		
14.07.2021	Elena Zdravkovska	Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria për Marrëdhënie Multilaterale dhe Bashkëpunim të Sigurisë		x	
20.07.2021	Dona Kosturanova	Fondacioni Westminster për Demokraci		x	
20.07.2021	Damir Neziri	Fondacioni Westminster për Demokraci	x		
22.07.2021	Anabela	Aftësi të kufizuar intelektuale		x	x
22.07.2021	Marica	Aftësi të kufizuar intelektuale		x	x
23.07.2021	Vesna Kostiq	Avokati i Popullit, Mekanizmi i Pavarur monitorues për zbatimin e KDPAK-së		x	
23.07.2021	Zhaklina Petkovska	Avokati i Popullit, Mekanizmi i Pavarur monitorues për zbatimin e KDPAK-së		x	
27.07.2021	Jovanco Sapunxhiski	Enti Shtetëror i Statistikave, Këshilltar Shtetëror	x		

Aneksi 2. Procesverbali i fokus grupeve me personat me aftësi të kufizuara

Në periudhën prej 06.07.2021 deri më 16.07.2021 janë mbajtur gjashtë fokus grupe me personat me aftësi të kufizuara me qëllim të diskutimit të situatës aktuale.

- Fokus grupi - Vlladevci me 06.07.
- Fokus grupi - Jegunovcë me 07.07.
- Fokus grupi - Llozovë me 08.07.
- Fokus grupi - M. Brod me 12.07
- Fokus grupi - Zrnovc me 15.07
- Fokus grupi - Shkup me 16.07

Në fokus grup morën pjesë 30 persona nga disa qytete/fshatra me shkallë të ndryshme të aftësisë së kufizuar, moshës dhe përkatësisë etnike. Nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve, 12 ishin femra dhe 18 meshkuj. Për sa i përket aftësisë së kufizuar, 7 ishin me dëmtim të shikimit, 1 me aftësi të kufizuara zhvillimore të kombinuara, 12 me aftësi të kufizuara intelektuale dhe 10 me çrregullime motorike.

Në disa nga fokus grupet erdhën edhe prindërit e personave me aftësi të kufizuara.

Informacion mbi Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Trupin Koordinues Kombëtar për zbatimin e Konventës

- Vetëm tre persona kishin informacion në lidhje me atë se çfarë parasheh Konventa, dy prej tyre ishin nxënës të shkollave speciale dhe aty e kishin marrë këtë informacion, një person e kishte marrë informacionin nga një trajnim i UNDP-së. Dy personat e parë janë nga Shkupi dhe janë të përfshirë në aktivitetet e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në Lojërat Paralimpike, kështu që këto organizata janë veçuar si organizata në të cilat merret informacion shtesë. Një person tjetër kishte marrë informacion nga një mik i cili është i përfshirë në aktivitetet e OJQ-së Solem. Të gjithë personat e tjerë që janë nga rajonet tjera dhe janë nga zonat rurale për herë të parë kanë dëgjuar për Konventën nga trajnimet e organizuara nga Federata Kombëtare e Fermerëve dhe We effect, ligjërues të cilëve janë profesorë nga Fakulteti Filozofik në Shkup. Të gjithë personat e pranishëm në fokus grupet deklaruan se nuk kishin informacion se kishte një TKK për zbatimin e KD-PAK-së.

Aftësitë për vetë-përfaqësim

- Në shumë raste, nuk janë personat me aftësi të kufizuara, por prindërit e tyre ata që flasin për aftësinë e kufizuar. Gjithashtu, ata kanë dëgjuar për herë të parë për vetë-përfaqësimin si term dhe për përdorimin e tij në këto trajnime. Vetëm dy persona janë anëtarë të organizatave dhe njihen si partnerë për mbledhjen e informacionit dhe asistencës për ushtrimin e të drejtave. Asnjë person nga zona rurale nuk është anëtar i një shoqate, OSHC-je apo sindikate. Ata luftojnë individualisht për të drejtat e tyre ose me ndihmën e anëtarëve të ngushtë të familjes. Personat që janë arsimuar në sistemin arsimor special janë më të zëshëm për të drejtat e tyre dhe shumë më të pavarur për sa i përket komunikimit dhe lëvizshmërisë. Ata ia atribuojnë këto aftësi faktit se kanë ndjekur shkollë speciale dhe kanë jetuar në konvikte. Këta persona, pavarësisht shkallës së aftësisë së kufizuar, mund të funksionojnë në mënyrë të pavarur.

Qasja në institucione dhe informacion

- Personat me aftësi të kufizuara mendojnë se shoqëria jonë nuk është përshtatur me nevojat e tyre. Ata nuk janë të njohur me termin dizajn universal dhe akomodim të arsyeshëm, por e dinë se përballen me problemin e qasjes në institucione dhe lëvizjes së lirë në komunitetin e tyre lokal. Asnjë nga personat me shikim të dëmtuar që përdorin alfabetin Braj nuk kanë materiale të këtij formati në mjedisin ku jetojnë. Gjithashtu, askush nuk ka parë materiale në një format lehtësisht të kuptueshëm, kështu që të afërmit i ndihmojnë ata të kuptojnë atë që marrin si informacion me gojë ose me shkrim.
- Të gjithë personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre ndajnë mendimin se punonjësit në institucione nuk kanë informacion të mjaftueshëm për mënyrën e veprimit dhe komunikimit të personave me aftësi të kufizuara. Në shumë raste ata, por edhe persona të tjerë të pranishëm në ambientet e institucioneve, kanë pasur situata të pakëndshme kur nëpunësit i kanë trajtuar në mënyrë agresive. Ata theksojnë se nëpunësit nuk kanë kohë apo durim për t'ua shpjeguar gjërat apo për t'i ndihmuar ata.
- Të gjithë pjesëmarrësit në fokus grupet nga zonat rurale theksojnë se para fillimit të projektit "From Disability to FoodAbility" nuk kishin informacion se ka organizata që mund të luftojnë në emër të tyre për të ushtruar të drejtat e tyre apo që ofrojnë ndihmë juridike falas. Pas fillimit të projektit, ata janë njohur me Federatën Kombëtare të Fermerëve si një organizatë të cilës mund t'i drejtohen për ndihmë. Këtë vit ata kanë kuptuar se ekziston Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Juristët e Rinj, por sërish i

drejtohen FKF-së për këshilla. Disa nga pjesëmarrësit nga rajoni i Shkupit kanë informacione, por deri më tani nuk i kanë shfrytëzuar mekanizmat për realizimin e të drejtave të tyre.

- Për sa i përket transportit, asnjë person nuk ka përdorur mjete të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara, por besojnë se nuk ka mjete të tilla në mjedisin e tyre. Personat me aftësi të kufizuara nuk kanë hasur në sinjalizim zanor apo drite, shtigje të prekshme, apo tualete të përshtatura në vendbanimin e tyre.

Cilësia e jetës

- Në zonat rurale nuk ka klube sociale apo aktivitete që përfshijnë personat me aftësi të kufizuara. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit e fokus grupit jetojnë në mikro botën e tyre, pa shumë komunikim dhe ndërveprim në mjedisin ku jetojnë. Autoritetet vendore nuk marrin iniciativë për t'i përfshirë ata në mjedisin jetësor.
- Të gjithë ndajnë mendimin se takimet e përbashkëta me persona që kanë probleme të ngjashme me ta, si dhe organizimi i trajnimeve, seminareve apo vizitave të ndryshme në vendbanimet e tyre ndikojnë ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre. Si shumë të dobishme ata përmendin edhe vizitat e profesorëve nga Fakulteti i Bujqësisë, të cilët u japin udhëzime se si dhe çfarë mund të prodhojnë dhe si të arrijnë prodhim më të madh. Të gjithë theksojnë rëndësinë e fshatit në një shoqëri dhe se si shteti duhet të ketë një strategji serioze për të mbajtur popullsinë në zonat rurale, dhe në të njëjtën kohë të inkurajojë prodhimin organik, i cili është gjithnjë e më i vështirë duke pasur parasysh ndryshimet klimatike dhe ndotjen.
- Personat që nuk janë të punësuar dhe prodhimet bujqësore janë të ardhurat e vetme të tyre, konsiderojnë se informacioni për prodhimin dhe tregtimin e produkteve të tyre është jashtëzakonisht i rëndësishëm për ta. Për më tepër, zhvillimi i ideve se si të përdoret hobi i dikujt si mundësi për të siguruar fitime dhe ndërveprim social duket interesant dhe i dobishëm. Idea për brendim dhe plasman më të madh i motivon ata dhe familjet e tyre që të përfshihen më shumë në aktivitetet e prodhimit.
- Të gjithë pjesëmarrësit në fokus grupet rurale theksojnë se nuk kanë qenë kurrë pjesë e ngjarjeve sportive apo kulturore. Aktivitetet e këtij lloji janë gjithnjë e më të rralla në fshatra, por edhe kur ka informacion, ata ose nuk kanë qasje në të, ose ndihen pamjaftueshëm të pranuar nga mjedisi.

- Të gjithë besojnë se duhet të ketë aktivitete më të shpeshta që do të nxjerrin në pah aftësitë e personave me aftësi të kufizuara dhe do të promovojnë aftësitë e tyre, në mënyrë që të pranohen më lehtë nga ana e personave me zhvillim tipik.

Pandemia Kovid-19

- Pjesëmarrësit e fokus grupeve deklaruan se lëvizja e lirë e fermerëve në vendbanimet e tyre, pra në vendet ku ndodhen fermat dhe serrat e tyre, ishte masa më e mirë. Si rrjedhojë e kësaj mase, ata si persona me aftësi të kufizuara mund të lëviznin lirshëm ndryshe nga të afërmit apo fqinjët e tyre.
- Si anë negative ata vënë në dukje pamundësinë e tyre dhe të familjarëve të tyre që janë shoqëruar të vazhdueshëm të tyre për të pasur prioritet për vaksinim. Disa prej tyre nuk kanë informacion të mjaftueshëm dhe ende nuk po mendojnë për vaksinimin, por ata që janë prekur nga informacioni mendojnë se reagimet duhet të ishin shumë më të shpejta. Shembull pozitiv i vaksinimit ishte pika e vaksinimit në Strumicë, ku mjeku për secilin person konsultohet individualisht për zgjedhjen e vaksinës dhe efektet e mundshme anësore. Të gjithë personat e vaksinuar kanë marrë informacion të kuptueshëm se si të sillen para, gjatë dhe pas vaksinimit.
- Problemi më i madh për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara që janë ende në procesin arsimor ishte mësimi në distancë. Prindërit nuk kanë kapacitet apo mundësi teknike për të ndihmuar në realizimin e procesit mësimor. Shumë fëmijë në zonat rurale nuk kanë internet ose kanë mbulim të dobët të rrjetit dhe nuk kanë as pajisje që mund të ndjekin mësimet në internet. Si problem shtesë që prindërit vënë në dukje është edhe mungesa e komponentit rehabilitues dhe punës korrigjuese që ka munguar që nga fillimi i pandemisë. Të gjithë theksojnë nevojën për staf profesional i cili duhet të ndihmojë vazhdimisht ose herë pas here fëmijët e tyre në mjediset familjare.

Diskriminimi

- Njohja e pamjaftueshme me termin diskriminim, mekanizmat për trajtimin e diskriminimit dhe pritshmëritë e ulëta të personave me aftësi të kufizuara çojnë në perceptimin e tyre të përgjithshëm se ata nuk janë të diskriminuar. Shumica e tyre e njohin mungesën e përfshirjes në komunitetin lokal si diskriminim. Të gjithë personat e përfshirë në fokus grupe përmendin se janë të përfshirë rregullisht në karvanet zgjedhore dhe përmbushin me besnikëri të drejtën dhe detyrimin e tyre të votës.

- Dy persona përmendën se kanë pasur një keqkuptim me punëdhënësit për lartësinë e pagës apo kërkesën për t'i kthyer punëdhënësit një pjesë të pagës, por ata nuk janë më në të njëjtat kompani dhe merren vetëm me bujqësi. Pjesëmarrësit e tjerë nga fokus grupet që janë të përfshirë në procesin e kompanive mbrojtëse anembanë vendit apo në veprimtari hotelierike në Shkup në Tavernën "Umbrella", deklarojnë se janë të kënaqur me kushtet e punës dhe paguhen në mënyrë të barabartë me kolegët e tyre të cilët punojnë në të njëjtin vend pune. Punonjësit theksojnë mundësinë e ndërveprimit social brenda dhe jashtë vendit të punës dhe besojnë se në këtë mënyrë ata janë shembull për personat e tjerë me aftësi të kufizuara, por edhe luftojnë kundër thyerjes së stereotipeve dhe paragjytimeve të drejtuara ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Konkluzione dhe rekomandime

- Personat me aftësi të kufizuara nga zonat më të vogla, veçanërisht nga zonat rurale, janë të përjashtuar nga komuniteti, ata ende nuk kanë mundësi të provojnë (dëshmojnë) aftësitë e tyre. Asnjëri prej tyre nuk është i përfshirë në aktivitetet e komunitetit, as në aktivitetet e sektorit joqeveritar apo organizatave ndërkombëtare. Personat nga rajoni i Shkupit kanë mundësi për ndërveprim social dhe përfshirje në më shumë aktivitete, gjë që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre, por edhe cilësisë së jetës së të gjithë familjeve të tyre.
- Kërkohej punë e mëtejshme për forcimin e aftësive të tyre për vetë-përfaqësim, njohjen e mekanizmave për mbrojtjen nga diskriminimi dhe ngritjen e kapaciteteve dhe promovimin e mundësive për personat me aftësi të kufizuara në të gjithë territorin e vendit.

Citime rreth problemeve të tjera të theksuara nga fokus grupet, të marra nga transkriptet

- Në shkollë ka një defektolog, por bëhet fjalë për një numër të madh të fëmijëve, dhe ka nevojë për logopedë, sepse defektologu punon në fushën e tij, logopedi në të vetën. Në zonën e Koçanit ka vetëm një ose dy logopedë dhe ka nevojë për shumë të tjerë. Ata flasin për logopedët dhe defektologët në kopshin e fëmijëve. Pra, fillimisht kemi pasur problem me regjistrimin në kopsht, nuk kanë dashur ta pranojnë në kopsht. Për shkak se fëmija ka pengesa të kombinuara zhvillimore, nuk mund të përshtatet në atë mjedis, mungojnë defektologët. Kishim alergji ushqimore. E ushqeva me oriz dhe patate për tre vjet. Unë investoj gjithë jetën në të, kam 10 vite me të, nga të cilat 4 vjet në shkollë, vetëm që të përparojë

dhe të ketë një përmirësim, kjo është situata reale. Nuk ka asistent personal. Ajo nuk lindi e tillë, ishte e shëndoshë, shkoi në shkollë deri në 10 vjet. Në moshën 10 vjeçare shfaqti epilepsi, mjekët thoshin se atë fushë të trurit e ka të djegur, nuk mban mend, nuk i kupton paratë, nuk njeh orën, numrat, shkronjat, nuk di asgjë. Pasi u zgjua, na pyeti sërish.. kush je ti, si quhesh, kush është ky...? Ajo është e tërhequr, nuk dëshiron të ketë kontakt me askënd, nuk shkon askund. Është e lidhur me mua pa ndërprerje, nëse shkoj diku ose duhet ta marr me vete ose nuk shkoj fare. E kam çuar te psikologu në Shkup në institutin për shëndet mendor, në Neuromedica bëjmë terapi se i është shtrembëruar kurrizi, marrim ilaçe në shtëpi, shkon në qendrën ditore që prej moshës 10 vjeçe, shkon që 14 vjet, dhe ky është i vetmi vend ku ajo dëshiron të shkojë. Kur vjen një mësues i ri nuk e do atë, do të jetë vetëm me atë që e ka afër, nëse vjen dikush tjetër ajo nuk do të flase, ka momente që nuk do të flase gjithë javën, nuk e di nëse nuk dëshiron ose nuk mund të flasë, nëse ne qeshim me diçka - ajo do të qajë, nëse ne qajmë - ajo do të qeshë, atëherë nuk e di sa do të qeshë ...

Ku shkojnë këta fëmijë pas moshës 18 vjeçare? Çfarë ndodhë me ta pastaj?

Personat me aftësi të kufizuara të rënda intelektuale nuk mund të punësohen me ligj, por punësohen si vullnetarë dhe punojnë në atë mënyrë.

Por ja, edhe ne me aftësi të kufizuara fizike mund të përfshihemi në punë.

Puna na ka ndryshuar.

Gjithashtu, pati një diskutim të rastësishëm për çështje të ndryshme

- Nuk ka mbështetje për këta fëmijë. Këta fëmijë hanë ushqim të veçantë, marrin vitamina të veçanta, humbasin gjak për shkak të pozicionit të tyre, organizmit të tyre kanë vërtet aftësi të kufizuara. Paratë nuk mjaftojnë për shpenzimet.
- Këta fëmijë hanë ushqim të veçantë, marrin vitamina të veçanta ata kanë aftësi të kufizuara me plot kuptimin e fjalës.
- Pati një iniciativë të qeverisë për të punësuar kujdestarë për personat me forma më të rënda të aftësisë së kufizuar, për të cilat shteti do të mbulonte koston.
- Ka një padrejtësi të madhe në përcaktimin e kompensimit. Shtesat renditen nga niveli më i ulët tek më

- i larti. Duhet të ketë disa shkallë. Unë për shembull kam dy gjyshe që më ndihmojnë (nëna dhe vjehrra). Unë kam një djalë tjetër, një adoleshent, një fëmijë të shëndetshëm, i cili është në një film krejtësisht tjetër. Përpiqem të qëndroj e qetë dhe gjithashtu ku jdesem për jetën time, nëse do të shkoj në fakultet, në punë ... që t'ua siguroj më të mirën fëmijëve të mi. Çfarë ndodh kur nuk ka ndihmës? Fëmija im ka 99% dëmtim të shikimit. Ai ka të gjitha diagnozat për të cilat mund të marrë një shtesë (kompensim) lëvizshmërie. Por ai nuk është 26 vjeç. Ky nuk duhet të jetë një kufizim.
- Një nënë foli për problemin me MPPS-në - Vajza ime ka diagnoza të verifikuara, por jo me shkrim. Dhe ata bënë një konstatim dhe dhanë një mendim në kohën e terapisë fizikale dhe ne morëm diagnozën: paaftësi të rëndë progresive fizike. Do të thotë, kjo gjendje do të kërkonte rehabilitim dhe nuk do të kishte përkeqësim të mëtejshëm. Tani ka skoliozë, distrofi muskulare, muskuj dhe gjymtyrë të pazhvilluara, hemiparezë në njërin anë, e humbet shikimin dhe dëgjimin në njërin anë si pasojë e hemiparezës. Më pas, gjetjet e Institutit të Shëndetit Mendor thonë se bëhet fjalë për një paaftësi kufitare me dëmtime të parëndësishme, dhe më pas një retardim i lehtë për t'u regjistruar në shkollë. Nuk kemi marrë ndihmë për fëmijën, e kam kuptuar rastësisht nga doktori, kur i kam marrë dokumentet... Për njërin bazë duhet të marr 8.000 denarë, për tjetrën 3.000 denarë. Kur pyeta pse vetëm për një bazë dhe jo për të dyja? Më thanë se nuk mund për të dyja. Thashë të paktën të marr për më të madhën, 8 mijë, më thanë se kam marrë tashmë për një bazë. Ata e anashkalojnë aftësinë e kufizuar fizike.
 - Kemi problem me të drejtën për një ndihmë financiare për përkujdesje nga një person tjetër.
 - Kemi problem me pagesën e ndihmës për aftësinë e kufizuar dhe problem kategorizimi. Nuk dimë ku të drejtohem
 - Punonjësit socialë kur ju drejtoheni për ndihmë, si t'i jepnin ato para nga xhepi i tyre. Hajde javën tjetër... Të humbet e gjitha dita, të heqin zvarrë. Ju nuk mund të shkoni derë më derë, një fëmijë ju pret në shtëpi. Nga një sportel në tjetrin, sill këtë-sill atë, të dërgojnë në një sportel tjetër, të vish javën tjetër. Më dërgojnë të shkoj atje t'i firmos dikush, të shkoj te numri 8, te numri 6, ndërsa ata vetë duhet ta bëjnë këtë. Kur të arrini në sportelin e fundit, do t'ju thuhet se nëpunësi tani është në pushim. Ato para do t'ia jap shtetit, nuk më duhen ato para nëse duhet të vazhdoj të endem nga një vend në tjetrin.
 - Nuk mund të endemi derë më derë, në shtëpi ju pret një fëmijë.
 - E marrim me vete, pret në makinë, mërzitet ...
 - Një kuti barna është 2500 denarë, më lirojnë 25 denarë, për të gjitha 6-7 barnat lirimi maksimal është 350 denarë.
 - Kemi marrë ankesa se mjekët pediatër nuk janë mjaft të informuar për këta fëmijë, nuk kanë njohuri elementare për fëmijët me aftësi të kufizuara? Këta janë mjekë, si nuk e dinë se çfarë është nevoja e veçantë dhe si t'i qasën atij fëmijë?
 - Problemet nuk zbulohen në kohë, p.sh. një fëmijë nuk flet, ka probleme me aftësitë motorike, nuk mund të mbajë kokën... Nëse mjekët familjar reagojnë në kohë, fëmijët do të kenë më pak probleme.
 - Nëse janë caktuar termine, kështu duhet të jetë. Është një fëmijë me nevoja të veçanta dhe duhet prituri në terminin e caktuar, por jo të prituri deri në orën 12. Funksionojnë vetëm spitalet private, por kjo kërkon mundësi financiare... dhe aty prituri..
- Këtyre fëmijëve duhet t'u jepet përparësi, nuk durojnë dot duke prituri. Për shembull, fëmija im. Unë do ta çoj deri në vend dhe në momentin që hyjmë në institucion, ai nervozohet, dhe menjëherë dëshiron të largohet. Ai fillon të ecë përreth, të shkojë nga një vend në tjetrin, bëhet hiperaktiv, fillon të djersitet, të qajë. Kjo ndodh kur shkon atje në orën 08:00 dhe largohesh në orën 12:00, ja çfarë ndodh me një fëmijë.
- Po, kam dy fëmijë, fëmija i madh është ... Shkoj në entin social të pyes. Nënë e vetme jam, çfarë të drejtash kam. Me refuzuan për çdo arsye. Fillimisht më thanë se nuk isha e punësuar dhe nuk kisha të drejtë për ndihmë - vetëm të punësuarit paskan të drejtë për ndihmë për fëmijë. Së dyti, më thanë ku jetoni? Po të ishe në rrugë mbase do të kishim bërë dicka.... nuk më takon asistencë sociale.... Nuk mund të marr ndihma për fëmijën sepse sipas vendimit marr alimentacion, të cilin përndryshe nuk e marr. Më thanë se për një familje tre anëtarëshe mjaftonin 3000 denarë për "mbijetesë", fjalë për fjalë e përdornin këtë shprehje. I kërkova të më bënin një recetë se si të mbijetoja me atë shumë, dhe do të ndjek recetën. Aty duhet bërë një ndryshim. Ligji për Mbrojtjen Sociale thotë se fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të kërkojnë ndihmë një herë. Çdo qeveri ka komision dhe askush nuk e ka parë komisionin, kompensimi është nga 3000 deri në 15000, në varësi të vendimit të komisionit.
 - Mua më nevojiten 7-8000 denarë vetëm për shpenzimet mjekësore për fëmijën. Nuk kam të ardhura të tjera përveç ndihmës për fëmijë.
 - Unë dhe burri nuk punojmë. Ne duhet të marrim ndihmë sociale sepse jemi të papunë. Pasi lindi fëmija,

jeta jonë ndryshoi krejtësisht. Shkova në entin social për të kërkuar ndihmë sociale. Më thanë se merrja një ndihmë të veçantë për fëmijë dhe se nuk kisha të drejtë për ndihmë sociale. I thashë më fal zotëri që unë duhet të jem ajo që do t'jua tregojë ligjin, fëmija im ka të drejtë për shtesë. Ai nuk e besoi atë që thoja dhe më pas shkova te drejtori. Pastaj, së bashku me drejtorin, të cilin nuk e njihja, shkuam ta shihnim dhe lexonim ligjin ...

- Sa herë më ka ndodhur në entin social që më kanë përplasur derën para hundës.
- Ne kemi dorëzuar dhjetra kërkesa për shkolla të mesme për fëmijët me aftësi të kufizuara në Qeveri dhe në të gjitha partitë politike. Në fund, një nënë më tha: "Çfarë kërkon? Kjo është për të patur qef të kesh një fëmijë me aftësi të kufizuara." Kërkuam që ai prind i cili është i papunë, ndërsa është i lidhur me fëmijën e tij 24/7 për 365 ditë në vit, të ketë një kompensim, sepse nëse ai prind nuk ka ndihmë, ai fëmijë nuk ka përparim... të ketë minimum 8 mijë denarë mbështetje për të fituar pension. Kërkesa e dytë ishte krijimi i qendrave që do të bashkojnë fëmijët, që nesër të jetojnë bashkë, siç thoni ju, jestede me mbështetje. Kërkesa e tretë - lirim i të gjithë prindërve për qëndrim në spital si shoqërues me fëmijën, pavarësisht se sa vjeç është fëmija. Kërkesa jonë e katërt ka qenë që të fshihet kufiri 26 vjeç sepse edhe këta persona jetojnë edhe pas moshës 26 vjeçe. Dhe pse na detyrojnë të dorëzojmë të njëjtat dokumente çdo vit... po t'i vonosh një ditë të fshijnë nga lista. Duhet të lehtësohet qasja në mjetet ortopedike dhe një kërkesë tjetër e rëndësishme - të krijohet një komision që të përcaktojë si duhet aftësitë e këtyre fëmijëve, apo aftësinë e tyre për punë, pra një komision për të siguruar kategorizimin e duhur dhe të detajuar. Këto ishin disa nga kërkesat tona.

Si kaloni në autobusë?

Shtyjme njëri-tjetrin, na bërtasin, i shohin në mënyrë të çuditshme

- Reagimi i tyre i parë është të shikojnë, e shikojnë fëmijën, dhe më pas të bërtasin, "dil jashtë", duke e shtyrë atë.
- Mua ma thirrën policinë, fëmija ishte i hutuar, ne prisnim autobusin, i pari që erdhi ai donte të hipte, por nuk duhej të hipnim në të dhe ai u nervozua, ishte shumë i mërzitur, u përpoqa të qetësoja fëmijën dhe unë nuk shoh se çfarë ndodh. Një e moshuar ka denoncuar në polici se unë po rriha fëmijën. Nuk pata kohë t'i them se nuk është ky problemi, më solli të gjithë policinë aty ... E qetësova fëmijën, imagjinoni çfarë njerëzish ka, në vend që të ndihmojnë. I them

punonjëses sociale në shkollë që nuk mund të udhëtoj me autobus urban, a mund të udhëtoj me autobus për fëmijët me aftësi të kufizuara. Nuk mundet më tha. Kam tre muaj që marr një taksì. Këto janë harxhime plus. Në shkollën ku mëson fëmija im, autobusi vjen vetëm për një fëmijë dhe ne nuk mundemi ta përdorim. Duhet që paraprakisht të informohet. Një fëmijë mund të hipë në ato autobusë vetëm nëse diagnostikohet me aftësi të kufizuar fizike. Fëmijën tim e zbritën nga autobusi.

Arsimi - përvoja nga shkolla fillore dhe të mesme

- Vajza ime ka shkuar në një klasë në Draçevë në "Zlaten Sremec". Doli një mësuese e mrekullueshme dhe edukatore speciale me përvojë. Funkcionoi si një klasë e kombinuar. Ne kemi fletore të shkruara, mund t'ua ofroj atyre të shkruajnë libra për fëmijë. Mësuam aq sa mundëm. Mendojmë se do të ruanim njohuritë e marra, të cilat janë shumë të rëndësishme për fëmijët tanë. Dhe befaz në shkollën e mesme vijmë në një mjedis ku nuk ka libra, nuk ka material të shkruar. Kur pyeta pse nuk ka libra, më thanë se vetë Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk ka program për atë shkollë, nuk ka ligj për të bërë libra. Nuk ka tekste për shkolla të mesme profesionale për personat me aftësi të kufizuara. Gjithmonë them që nuk punojmë mirë me fëmijët, duhet, por punojmë keq, ndoshta sepse mungojnë për shkak të sëmundjes, apo sepse nuk ka material, apo sepse vetë mësuesit nuk janë të motivuar. Këtu duhet bërë diçka, për të ndryshuar. Mund të mbetet i njëjti material nga fillorja, mund të zgjerohet vetëm gojarisht, mund të shpjegohet më tej.

Mungesa e lëndëve për zhvillimin e aftësive, arteve, pasi ky është interesi më i madh i tyre

- Ka programe për zanate profesionale, ka edhe gatim, automekanikë, ata janë ndihmës.... nëse është regjistruar si epilepsi, atëherë nuk mund të mësojë dhe të punojë në aktivitete që janë të rrezikshme për jetën. Edukatë fizike ka 2 orë, profesori nuk ka hyrë të luajë me ta. Janë një mijë e një aparate dhe nuk ka kush të punojë me to, duhet t'i përdorin vetë ose unë si prind të hyj dhe ta mësoj si të ngasë biçikletën.

A.K. - Në Zlaten Sremac, aty investohet, të gjithë janë defektologë. Me trajnime shtesë ... mungesa e motivimit është për shkak të arsimimit. Kualifikimet për defektologë. Këto probleme janë shumë të mëdha. Në shkollat e rregullta është edhe më e vështirë. Më e dhimbshme është me kopshtet.

- Nënë - Përfshirja është e rëndësishme, e mirë, unë jam e kënaqur, fillimisht fëmija përballet me botën

reale që e rrethon, përballet me fëmijët me zhvillim të duhur dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. I imi shkon ne grup me 10 fëmijë, pranohet perfekt....kur të jetë në klasën e 8-të me siguri do ta kuptojë që është ndryshe në raport me ta. Por ky është tashmë problemi ynë, nuk ka të bëjë me përfshirjen. Nëse i themi vazhdimisht në shtëpi se je si ata, ata të duan dhe të respektojnë

- Nga një mijë të anketuar, vetëm ju do të jeni të kënaqur, por kështu e keni gjetur veten në një mjedis të tillë që e ka pranuar fëmijën. Fëmija im shkoi në një kopsht të rregullt dhe në një çerdhe të rregullt. Përvoja ime është - të kem 16 fëmijë, nuk u jap as gjysmën. Në fillim ajo nuk u pranua nga mësueset, nga vetë mësuesja e kopshtit, nipi i së cilës e rrihte çdo ditë. Mësueses i thanë se fëmija ishte i veçantë dhe ajo e la të rrihej nga fëmijët e tjerë çdo ditë.
- Edhe kur të isha atje pranë saj, ata e rrihnin edhe pranë meje. Ishin 28 fëmijë në kopsht kur e regjistronim para se të fillonte në klasën e parë, 2 prej të cilëve me aftësi të kufizuara. Njëri nga fëmijët kishte hemoparezë nga një vaksinë dhe mësuesit i thanë ta mbante për dore, të mos zbriste vetëm nga shkallët dhe ne ishim në katin e tretë. E imja kishte dëmtime në shikim dhe ecje, duhej ta mbante për dore. Mësuesja i la të mbahen për dore vetë 3-4 herë, të zbresin nga lart dhe të humbasin shkallëve. Ata kishin zbritur në bodrum, vrapuam për t'i kërkuar, ndërsa ata kishin humbur, dhe u kishte rënë të fikët nga frika se mos humbisnin.

Fëmija duhet së pari të përfshihet dashurinë e mësuesit/ mësueses në derën e hyrjes.

- Jam kundër inkluzionit. Tani ata përmendën se çdo mësues duhet të ketë një program të veçantë për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara. Pse me një program të veçantë? Unë ju pyes si prind prindin. Keni menduar se fëmija juaj është njësoj si fëmijët e tjerë, pse me një program të veçantë, notat le të jenë dyshe, jo domosdoshmërisht pesëshe, por ai do të mësojë në shkollë të rregullt. Pse e regjistron në një shkollë të rregullt?
- E regjistron për t'u përshtatur me fëmijët tjerë, për ta ditur se i përket së njëjtës shoqëri.
- Ja një shembull - dy binjakë, njëri me zhvillim tipik dhe tjetri me aftësi të kufizuara. Ata janë në të njëjtën klasë, por nuk ndajnë të njëjtën bankë. Njëri prej tyre ulet pas tjetrit. Ata marrin të njëjtat nota. Njëri prej tyre i thotë mamasë së tij - Dua të jem me aftësi të kufizuara si vëllai im, ai nuk mëson fare dhe ka notat më të larta ndërsa mësuesi po më qorton mua.
- Unë pyes - pse kërkojmë kushte të veçanta, po të doja fusja atë në gojë të luanit, luani do ta përtypë.

- Atehere pse u kërkojmë atyre fëmijëve të shkojnë në punojnë, duhet të punojnë me njerëz normal, nëse e mbani në një shkollë për fëmijë me aftësi të kufizuara, nëse kërkon që të punojë në ambient të veçantë.
- Më falni, nëse ka kushte në shkollë të rregullta dhe unë do ta çoja, nuk kam ardhur nga Tetova në Shkup me qira për ta çuar në shkollë speciale.
- Varet nga shkollë në Gostivar kam dëgjuar se ka shkollë, me ashensorë, tualete speciale, klasa të vogla, defektologë.
- Duhet të dini se cili fëmijë mund të shkojë në shkollë të rregullt. Unë kam një fëmijë në Draçevë që nuk di ta thotë emrin, është në klasë të gjashtë dhe të gjithë fëmijët e rrahin çdo ditë. Por nëna donte dhe e regjistroi.
- Për mendimin tim, përfshirja e plotë kërkon një edukator të veçantë dhe terapist të të folurit në çdo klasë, i cili do të mund t'i kushtonte vëmendje çdo fëmijë.

Ligji është i qartë. Prindërit kanë të drejtë të pakontestueshme për të vendosur për shkollën e fëmijës. Ne mund ta diskutojmë më tej këtë çështje nëse duam. Përsa i përket fëmijëve që mund ose nuk mund të ndjekin shkollat e zakonshme, Instituti i Shëndetit Mendor jep vetëm një rekomandim. Dokumentet, si gjetjet dhe opinionet profesionale, përdoren vetëm për të aplikuar për ndihma. Prindi vendos, kjo është e drejta e tij/saj. Dhe kështu duhet të jetë. Megjithatë, praktikuesit duhet të marrin më shumë përgjegjësi. Ka fëmijë që definitivisht nuk mund të jenë pjesë e procesit të inkluzionit. Fëmijët agresivë, autoagresivë etj. Kur bëhet fjalë për të pasur një defektolog në çdo klasë, kjo ka të bëjë me një shkollë speciale. Duhet të zvogëlohen klasat, nuk mund të punohet në të njëjtën mënyrë me një klasë prej 30 fëmijësh, 2 prej të cilëve janë me aftësi të kufizuara. Këtu e kam fjalën për fëmijët të cilëve u janë dhënë diagnoza dhe mendime profesionale, çfarë të thuhet për fëmijët e tjerë....

Në Maqedoni funksionojnë paralelisht dy sisteme. Ka përvoja pozitive me të dy sistemet. Është mirë që prindërit mund të zgjedhin.

Nënë - problemi është se në klasën e fëmijës tim ishin 5 fëmijë, 1 mësuese dhe ajo duhej të ishte roje e fëmijës tim. Në klasën e gjuhës maqedonase janë 2 fëmijë dhe 2 arsimtarë (1 kujdestar). Nuk ka logoped në gjuhën shqipe dhe asnjë psikolog. Në klasën e pestë dhe të gjashtë janë 10 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe vetëm një mësues. Logopedi punon vetëm në gjuhën maqedonase. Aty kaloj 4 orë në ditë. Logopedi maqedonas nuk do të punonte me fëmijët tanë. Ai nuk mund të flasë shqip dhe fëmijët janë shumë për një logoped. Fëmija im ka autizëm, nuk e di nëse më kupton, vetëm tani më kupton

disi. Drejtori tha se Ministria e Financave nuk do të jepte para për punësime të reja. Dhe prindërit duhet të heshtin, të presin që ministria të ndajë para për punësime të reja. E lashë shtëpinë dhe jetën time në Tetovë dhe jetoj në një shtëpi të vjetër me qira në Shkup vetëm që ta çoj fëmijën në shkollë. Mësuesi nuk mund ta kontrollojë atë, ai thjesht ecën vetëm. Kemi kërkuar më shumë staf por thonë se ministria nuk e lejon. Mendoj se nëse drejtoresha do të kishte bërë përpjekje, mund të ishte siguruar kjo. Kam 4 vjet që po luftoj me këtë problem. Si prind do të sakrifikoj jetën time, kam ardhur këtu për kushte më të mira.

Situata me logopedët është shqetësuese. Në Institutin tonë nuk ka më një departament të veçantë për logopedët dhe ky është gabimi ynë. Në Fakultetin e Mjekësisë shkollohen vetëm logopedët klinikë dhe ata nuk mund të punojnë në shkollë.

- Të folurit tani po përmirësohet
- Fëmija im ka lëndë shkollore - gjuhën maqedonase. I lutem Zotit që fëmija im fillimisht ta mësojë gjuhën shqipe, e më pas unë t'ia mësoj maqedonishten.
- Çfarë ndodh pas shkollës së mesme, pa punësim, kush do t'i punësojë ata?
- Jetesë me mbështetje duhet të ekzistojë në çdo qytet, dhe kjo duhet të jetë në afërsi të prindërve.

Edhe sikur të kenë mundësi, do t'i pengojnë nga përparimi. Bëhen shumë gabime dhe jeta jonë konsiston në të përjetuarit e gabimeve të njëpasnjëshme. Kur kërkoja kartelën mjekësore në klinikë 10 vjet më parë, më thanë se duhet ta kërkoja në bodrum. Kur e gjeta, ishte e zbrazet. Kur lindi fëmija im dhe duke qëndruar në klinikën e sëmundjeve infektive gjatë 15 ditëve të para, ata i transferuan dokumentet nga klinika në Çair në klinikën universitare...Vetëm pas 20 ditësh arrita të lexoj se çfarë kishte fëmija im sepse askush nuk tha asgjë.... dhe me pas mesova që i pushoi zemra, se ishte reanimuar, se u vonuan me reanimacion, se kishte 6 vrima ne zemer, mpiksje gjaku, insuficiencë renale...me pasoja katastrofike. Problemi më i fundit është se doktoresha Pota na dha një dokument që ajo duhet të vaksinohet rregullisht. Në moshën 3 muajshe ajo ishte e vaksinuar dhe kishte temperaturë të lartë (41), qante gjithë ditën, nuk dinim çfarë të bënim. Në klinike na thane që kjo gjendje është fare normale....E kemi rikthyer dhe më pas filluan problemet me epilepsi, konvulsione... në vend të fenobarbitonit i dhanë Epiap.... niveli i sheqerit ra.... pati mungesa të vitaminave....kur rregullonin nivelin e sheqerit...

Aneksi 3. Informacion nga një takim me persona që janë larguar nga I.S. Demir Kapija

Të dyja pjesëmarrëset femra që u larguan nga Institucioni Special Demir Kapi (Vollkovë) ishin shumë të gatshme të bisedojnë dhe të ndajnë informacione.

Kënaqësia e tyre me qendrën ditore dhe strehimin në banesa të mbështetura ishte evidente, së bashku me cilësinë e jetës që kanë pas largimit nga institucioni në Demir Kapi.

Një person tha se ajo kishte kaluar nëpër të gjitha institucionet në jetën e saj – Demir Kapi, Banja Banskò, familje kujdestare dhe se më në fund po ndihet si vetvetja këtu. Ajo tha se punon si pastruese.

Sa i përket personit tjetër, pasi vjen nga Demir Kapija, ajo hyn në një fazë krejtësisht të re ku mëson shkrim e lexim, dhe aktualisht punon si asistente e një të moshuari, merr rrogë dhe ka një partner.

Të dy besojnë se kanë pavarësi të plotë dhe të drejtën e zgjedhjes personale në organizimin e aktiviteteve të tyre ditore në shtëpitë e tyre, si dhe një zgjedhje se me kë do të kalojnë kohën e tyre. Ata janë gjithashtu të lumtur që jetojnë në Shkup, ata janë plotësisht të pavarur në lëvizje dhe udhëtime përmes transportit publik nëpër qytet.

Ata rendisin si shembuj pozitivë aktivitetet që kanë pasur me vullnetarët e Korpusit të Paqes të SHBA-ve, të cilët u mësuan atyre shumë aftësi dhe bashkëpunimin me SOLEM ku mësuan për vetë-përfaqësimin. Përveç që mësuan se si të prezantohen dhe të sillen me mirësjellje, ata mësuan gjithashtu të punojnë dhe të komunikojnë përmes internetit, të përgatisin prezantime, video dhe janë shumë krenarë që mund t'ua tregojnë rezultatet e tyre studentëve të Institutit për Edukim Special dhe Institutit për Punë Sociale dhe Politikë Sociale. Ata janë të kënaqur që para pandemisë studentët i ftuan në festat e tyre dhe janë gjithashtu të lumtur që kur takojnë në qytet të gjithë njerëzit që vijnë në qendrën ditore i përshëndesin dhe duan të bisedojnë me ta.

Të dy e kanë theksuar si shumë të rëndësishme sigurinë financiare dhe se janë të kënaqur me punën dhe se kjo i bën të ndihen të lumtur – të kenë një rutinë të përditshme dhe detyrime të përditshme.

Të dy personat deklaruan se ishin të përfshirë në aktivitetet e SOLEM, duke shitur revistën "Ballë për Ballë".

Ata nuk do të ndryshonin punën e tyre, edhe pse sigurisht që janë të gatshëm të mësojnë gjëra të reja sipas nevojës.

Edhe pse e dinë se ekziston një dokument si KDPK, kanë dëgjuar për të nga SOLEM, nëse kanë ndonjë problem kontaktojnë me punonjësit e qendrës ditore PORAKA

NEGOTINO në Vollkovë – sepse besojnë se kjo është më e shpejtë dhe më e lehtë për ta.

Ata nuk mund të gjykojnë se cilat të drejta u janë shkelur, por dinë dhe kanë dëgjuar për diskriminim.

Ata dikur ishin më të ekspozuar ndaj diskriminimit, veçanërisht nga fqinjët e tyre kur jetonin në një pallat në Novo Lisiçe.

Ata e theksojnë Volkovën si një mjedis të shkëlqyeshëm në të cilin përshtaten shumë, i njohin fqinjët dhe ndihen të pranuar dhe të padiskriminuar.

Sa i përket votimit për zgjedhje, ata nuk kanë votuar deri më tani dhe besojnë se është humbje kohe dhe nuk jep rezultat.

Aneksi 4. Informacion shtesë mbi shërbimet inkluzive për personat me aftësi të kufizuara

Shërbimet në ofrimin e sigurimeve sociale, arsimit, shëndetësisë dhe punësimit janë të lidhura ngushtë dhe të përcaktuara nga procesi i vlerësimit të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara. Sistemi i vlerësimit në vend bazohet në një model mjekësor, ku lehtësitë dhe shërbimet në nivel kombëtar dhe lokal përcaktohen sipas nivelit të “defektit” dhe kufirit të moshës, mbi ose nën moshën 26 vjeçe, me përjashtim të sistemit të ri të vlerësimit funksional sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionalitetit (KNF).

Sistemi i vlerësimit sipas KNF duhet të zëvendësojë plotësisht sistemin e vjetër të vlerësimit, i cili bazohet në modelin mjekësor, ku shërbimet në nivel kombëtar dhe lokal përcaktohen në bazë të “shkallës së dëmtimit” dhe pragut të moshës 26 vjeçe. Aftësia e kufizuar tek fëmijët mund të zbulohet që në lindje, por komunikimi ndërmjet sektorëve është i pamjaftueshëm, kështu që edhe nëse fëmijët marrin ndihmën e nevojshme mjekësore në fillim, shërbimet e tjera, p.sh. përmes sektorit social, janë të padisponueshme. Nuk ka asnjë proces të përcaktuar se si infermierët e kujdesit të foshnjave të porsalindura dhe mjekët e përgjithshëm duhet t’i identifikojnë fëmijët në mënyrë që ata të kenë qasje në shërbimet e këshillimit dhe zhvillimit ose shërbime të tjera të specializuara.

Për sa i përket të drejtës së punësimit dhe punës, në nivel kombëtar funksionojnë tre komisione; njëri prej të cilëve rekomandon që personat me aftësi të kufizuara të kenë prioritet në punësim në përputhje me Ligjin për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara; i dyti përcakton shkallën e paaftësisë dhe përcakton nëse personi me aftësi të kufizuara mund të punësohet në përputhje me nenin 2 të Ligjit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara; dhe i treti, në MPPS (vlerësimi kryhet nga një ekip i ZAPOVIM-it) i cili përcakton se cili vend pune është i përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara, dhe i cakton ata në atë fushëveprim të detyrave të punës. Nëse një person i punësuar me aftësi të kufizuara do të donte të kalonte në një pozicion tjetër dhe të avanconte profesionalisht, do të duhej të shkonte përpara të njëjtit komision për të marrë një konstatim dhe mendim të ri. Puna e komisionit të fundit është diskriminuese, pasi nuk rekomandon akomodime të arsyeshme që do të ofrojnë kushte më të mira pune për personin me aftësi të kufizuara.

Në tre vitet e fundit shteti filloi zbatimin e sistemit të ri të vlerësimit përmes KNF për fëmijët dhe të rinjtë deri në 26 vjeç. Aktualisht janë në funksion dy organet rajonale në Shkup dhe organi kombëtar. Zyrat e këtyre organeve janë pajisur dhe rinovuar me mbështetjen e UNICEF-it. Tri qendra shtesë janë duke u themeluar në brendësi të vendit në Strumicë, Gostivar dhe Manastir. Lokalet aktualisht janë duke u rinovuar me mjete nga Ministria e Shëndetësisë (MSH). Këto organe përfshijnë persona të marrë nga institucione të tjera dhe përfshijnë një edukator

dhe rehabilitues special, psikolog dhe punonjës social dhe një mjek.

Personat e angazhuar në këto organe vlerësuese janë të detyruar të kalojnë trajnime për KNF. Trajnimet zhvillohen nga anëtarë të organit kombëtar të vlerësimit me përvojë shumëvjeçare.¹⁸⁰ Përbërja e organeve aktualisht nuk përfshin personat me aftësi të kufizuara. Trajnimet realizohen me mbështetjen e UNICEF-it. Këto organe japin rekomandime përfëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara për përfshirjen e tyre në sistemin arsimor dhe vlerësimin e nevojës së tyre për asistent personal dhe arsimor. Ka bashkëpunim të mirë mes këtyre organeve dhe komisioneve të ekspertëve që vlerësojnë fëmijët deri në moshën 26 vjeçe, por jo edhe me komisionet e tjera që vlerësojnë personat me aftësi të kufizuara mbi 26 vjeç. Pjesëmarrësit e fokus grupeve theksojnë se sistemi i vlerësimit duhet të zbatohet edhe për personat mbi 26 vjeç dhe se kjo duhet të prezantohet gradualisht. MPPS së bashku me BB njoftuan për inkorporimin dhe përfundimin e procesit të vlerësimit për personat mbi 26 vjeç duke filluar nga viti i ardhshëm. Për shkak të ngurtësisë së vetë sistemit dhe praktikës së vendosur mjekësore, pjesëmarrësit në fokus grupet deklaruan se është e nevojshme të sensibilizohen më tej dhe të forcohen kapacitetet e të gjitha organeve dhe institucioneve eksperte për KDPAK, në mënyrë që të gjithë palët e interesuara të kuptojnë qasjen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, nevojiten ndryshime në kurrikulat universitare për të njohur studentët me KNF dhe KDPAK.

3.1 Qasja në sigurimin social dhe shërbimet sociale

Shërbimet e parashikuara në LMS ofrohen nga shteti, por me shfaqjen e tendencave të pluralizimit dhe decentralizimit, si dhe të procesit të deinstitutionalizimit, si ofrues të shërbimeve¹⁸¹ paraqiten edhe OSHC-të dhe organizatat private. Shumë komunave u mungojnë kapacitetet administrative dhe financiare për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme për personat me aftësi të kufizuara, dhe komunat që kanë qendra ditore ende nuk i kanë marrë kompetencat mbi to, sepse nuk ka dispozita detyruese në ligj.¹⁸² Si rezultat i kësaj, në nivel lokal mbahen sisteme paralele: një për popullatën e përgjithshme dhe një tjetër për personat me aftësi

të kufizuara.¹⁸³ Pavarësisht nga respektimi i barazisë formale, shërbimet e ofruara për personat me aftësi të kufizuara bazohen në qasjen mjekësore. Nga pikëpamja e mbulimit personal të shërbimeve të ofrimit të sigurimeve sociale, ato janë në kundërshtim me dispozitat e KDPAK. Përfitimet monetare ekzistuese për personat me aftësi të kufizuara realizohen në bazë të një vlerësimi të bazuar në shkallën e aftësisë së kufizuar dhe kufirin e moshës. Në ofrimin e këtyre përfitimeve nuk përfshihen personat me aftësi të kufizuara psikosociale, si dhe një pjesë e madhe e personave me aftësi të kufizuar intelektuale që nuk janë të kufizuar në një karrocë për invalidë.

Nga këto përfitime monetare përjashtohen edhe personat me aftësi të kufizuara mbi 26 vjeç të akomoduar në familje kujdestare. Ndërsa për personat e moshës madhore mbi moshën 26 vjeçare, e njëjta zgjidhje ligjore është kopjuar edhe në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve (LMF)¹⁸⁴ ku përfitimet monetare janë të përcaktuara sipas llojit dhe shkallës së aftësisë së kufizuar dhe diagnozës. Dallimi midis këtyre shtesave është shuma e mjeteve financiare. Sigurimi i mbështetjes për familjet përsëri ndahet varësisht nëse njëri është prind i vetëm i një personi mbi ose nën 26 vjeç. Megjithatë, në të dy ligjet, në vend që këto fonde të përdoren si përfitime që mundësojnë aktivizimin më të madh të fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara, ato shërbejnë vetëm për plotësimin e buxhetit të familjes. Kjo qasje tregon se ligjvënësit kanë njohuri të pamjaftueshme për sistemin e jetesës së pavarur për personat me aftësi të kufizuara. 98.5% e personave dhe prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara besojnë se këto përfitime nuk kontribuojnë në aktivizimin e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.¹⁸⁵

Sipas të dhënave të ESHS-së, janë 2987 të mitur përfitues të mbrojtjes sociale (nga 7 deri në 26 vjeç), 1142 prej të cilëve janë vajza me aftësi të kufizuara. Nga këta përfitues, 265 janë persona me shikim të dëmtuar, 266 janë persona me dëmtim të dëgjimit, 107 janë persona me vështirësi në komunikim verbal, 1272 janë persona me aftësi të kufizuara mendore, 127 janë persona me autizëm dhe 950 janë persona me aftësi të kufizuara të kombinuara të zhvillimit.¹⁸⁶ Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që nuk janë në kontakt me shërbimet sociale është afërsisht 10% e numrit total të fëmijëve, përfitues, të regjistruar nga shërbimet.¹⁸⁷

¹⁸⁰ Deklaratë e përfaqësuesve të fokus grupit për vlerësimin e çështjes së aftësisë së kufizuar

¹⁸¹ PKVM, Raport për varfërinë dhe përjashtimin social në Republikën e Maqedonisë, 2010, <http://bim.lbg.ac.at/de/socijalna-inkluzija-i-covekovite-prava-vo-makedonija/izveshta-za-siromashti-i-sotsi-alna-iskluchenost-vo-republika-makedoni-2010>

¹⁸² Shih: Mekanizmat për ofrimin e shërbimeve sociale në Maqedoni, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe GIZ, 2011, f. 24, <http://www.nacionalnakomisija.gov.mk/sites/default/files/prikachyvanja/studija_mehanizmi_za_obezbeduvanje_na_socijalni_uslugi_vo_makedonija.pdf> Пристапено на: 20.11.2014

¹⁸³ K. Panajotova, E. Koçoska, Analizë: Ndihmë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara që largohen nga institucionet e përkujdesjes, 2020

¹⁸⁴ Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve, Gazeta Zyrtare nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14.

¹⁸⁵ Shih: F. Koçoska, J. Klimoska. Publikimi "Terra Incognita" - demistifikimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Maqedonisë me rishikim të së drejtës për mbrojtje sociale, 2018, Polio Plus, në dispozicion në: <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/terra-incognita-mk.pdf>

¹⁸⁶ Shih Mbrojtja sociale e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve 2019, Rishikimi statistikor Nr. 2.4.21.01/914 për vitin 2019, ESHS.

¹⁸⁷ Strategjia Kombëtare për Deinstitutionalizimin, 2018 – 2027, MPPS, e disponueshme në: <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/strategji/Strategji%202018/Strategjia_deinstitutionalizacija_Timjanik_2018-2027.pdf>

Për më tepër, vlerësohet se rreth 6,400 deri në 9,600 persona me aftësi të kufizuara të moshës 18 deri në 65 vjeç nuk janë në kontakt me shërbimet sociale (d.m.th. midis 1/3 dhe 1/2 e numrit të personave të regjistruar).¹⁸⁸ Numri i përfituesve të moshës madhore të mbrojtjes sociale sipas gjinisë dhe moshës (nga mosha 26 deri në 65+) ishte 30271 në vitin 2019, prej të cilëve 12908 janë gra me aftësi të kufizuara. Nga këta përfitues, 3.228 janë persona me shikim të dëmtuar, 3.098 janë persona me dëmtim të dëgjimit, 16.125 janë persona me aftësi të kufizuara fizike, 4.016 janë persona me aftësi të kufizuara mendore dhe 3.804 janë persona me pengesa të kombinuara zhvillimore.

Të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave (ESSH) nuk japin një pasqyrë të plotë të çështjes së aftësisë së kufizuar dhe tregojnë se fëmijët dhe të rinjtë me vështirësi në komunikim verbal, si dhe fëmijët dhe të rinjtë me autizëm, nuk ekzistojnë në statistikën e përfituesve të rritur dhe humbasin në sistemin e mbrojtjes sociale.

Nuk ka një legjislacion specifik në vend që të marrë parasysh të drejtat e personave/fëmijëve me aftësi të kufizuara, pra një ligj të veçantë për qytetarët me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara deri në 26 vjeç në vend trajtohen si fëmijë. Kjo matricë e të menduarit transferohet në të gjitha fushat dhe të drejtat.

Situata është e ngjashme me sigurimin e të drejtës për asistencë personale. Kriteret e propozuara se kush mund ta ofrojë këtë shërbim dhe mënyra e organizimit dhe përcaktimit të orëve, çfarë duhet të bëjë asistenti personal, janë kriteret për personat që duhet të ofrojnë kujdes në institucione dhe jo dikush që duhet të ofrojë mbështetje për jetesë të pavarur. Sistemi i asistencës personale barazohet me dhënien e kujdesit. Edhe në këtë proces, personat me aftësi të kufizuar janë vetëm përdorues të fundit pa një rol aktiv në procesin e vlerësimit, trajnimit dhe përcaktimit të kriterëve ku, si, kur, nga kush dhe me kë. Ky shërbim mund të merret në bazë të shkallës së aftësisë së kufizuar, moshës dhe statusit nëse jeni një person me aftësi të kufizuara që është deinstitutionalizuar apo jo. Personat mund ta përdorin këtë shërbim deri në 80 orë në muaj në jetën e tyre të përditshme, por ata që janë larguar nga institucionet mund të marrin asistencë personale deri në 160 orë në muaj, në varësi të shkallës së aftësisë së kufizuar dhe kriterëve të përshtatshmërisë të parashikuara në LMS dhe rregulloret për ndihmë personale.

Mendimet e disa pjesëmarrësve të OSHC-ve të përfshira në procesin e deinstitutionalizimit dhe që janë ofrues të asistencës personale janë se personat me aftësi të kufizuara kërkojnë kujdes, prandaj ky sistem është i mirë dhe zhvillohet në përputhje me programin. Mendime të tilla vetëm konfirmojnë indikacionet se edhe OSHC-të e përfshira si ofrues të shërbimeve të asistencës personale nuk e kuptojnë konceptin e asistencës personale.

Paralelisht me këtë, ofruesit e shërbimeve deklarojnë se nuk kanë kaluar trajnime për KDKPAK dhe qasje në të drejtat e njeriut.

Gjatë realizimit të të drejtave, personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara përballen me pengesa administrative dhe interpretime të ndryshme të dispozitave ligjore nga institucionet. Për shembull, nëse prindi nuk ka punuar dhe ka plotësuar stazhin për shkak të kujdesit për fëmijën e tij dhe nuk e ka vendosur fëmijën/personin në institucion, ka të drejtë për pension prej 8.000 denarë. Mirëpo, nga këta persona kërkohet që të sigurojnë vërtetime mbi pasurinë e tyre dhe pagën mesatare, gjë që nuk parashikohet aspak me ligj, pasi pavarësisht nga të ardhurat e tyre ata e kanë këtë të drejtë. Kështu, asnjë prind ende nuk e ka realizuar këtë të drejtë.¹⁸⁹

Standardi ekzistues për qendrat ditore fokusohet tek të rriturit dhe nuk përfshin parimet që kanë të bëjnë me “interesin më të mirë të fëmijës” dhe “vullnetin më të mirë të personit”.

Mekanizmat ekzistues për monitorimin e shërbimeve janë të orientuara drejt mbledhjes së të dhënave aktuale dhe jo drejt rezultateve të shërbimeve të ofruara. Mungon vlerësimi i nevojave në terren për fëmijët/personat me aftësi të kufizuara. Ka mungesë të stafit të trajnuar, mungesë të rrjetit dhe infrastrukturës dhe mungesë të standardeve të cilësisë të përcaktuara siç duhet për aftësinë e kufizuar. Nuk ka të dhëna për fëmijët me aftësi të kufizuara, me përjashtim të atyre që janë përfitues të shtesave të veçanta. E vetmja shtesë që komunat (sipas gjykimit dhe vullnetit të tyre) ofrojnë për fëmijët me aftësi të kufizuara është shtesa për transport nga shtëpia në shkollë.¹⁹⁰

Kryesisht, personat me aftësi të kufizuara kanë vështirësi për të arritur fizikisht në institucione. Gjetjet e fokus grupeve tregojnë se QPS-të nuk kanë ambiente të përshtatshme për ofrimin e asistencës/këshillimit profesional. 82.5% e personave me aftësi të kufizuara dhe prindërve të personave me aftësi të kufizuar besojnë se institucionet e politikës sociale nuk janë të qasshme dhe të disponueshme.¹⁹¹

Çështja e aftësisë së kufizuar nuk përfshihet në politikat që rregullojnë çështjet gjinore. Shërbimet dhe masat për asistencën dhe mbështetjen e grave me aftësi të kufizuara viktimat të dhunës në familje dhe dhunës

¹⁸⁹ Deklaratë nga fokus grupet e personave me aftësi të kufizuara

¹⁹⁰ K. Panajotova, E. Kočovska: Ndihmë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuar që largohen nga institucionet e përkujdesjes, 2020

¹⁹¹ Shih: E. Kočovska, J. Klimoska. Publikimi “Terra Incognita” – demistifikimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë me rishikim të së drejtës për mbrojtje sociale, 2018, Polio Plus, në dispozicion në: <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/terra-incognita-mk.pdf>

¹⁸⁸ Strategjia Kombëtare për Deinstitutionalizimin, 2018 – 2027, MPPS, e disponueshme në: https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/strategji/Strategji%202018/Strategjia_deinstitutionalizacija_Timjanik_2018-2027.pdf.

me bazë gjinore në formën e strehimit të sigurt dhe afatgjatë, asistencës dhe mbështetjes psikosociale dhe ndihmës juridike falas nuk janë parashikuar. Shërbimet ekzistuese të riintegritimit dhe qendrat e strehimit nuk janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu, qasja në shërbime është vështirësuar për shkak të kërkesave për sigurimin e dokumentacionit voluminoz. Të gjitha intervistat kishin dy gjëra kyçe të përbashkëta: njerëzit përballen me probleme me sigurimin e të gjitha dokumenteve, të cilat përsëriten për çdo të drejtë, dhe mungesën e kohës dhe financave. Ndihma dhe kujdesi në shtëpitë e personave me aftësi të kufizuara ofrohet vetëm në pesë-gjashtë komuna. Ky shërbim ofrohet përmes programit për shërbim në komunitet – punë e dobishme shoqërore (PDSH). Disa komuna theksojnë se problemi qëndron te stigma sociale dhe mospranimi i gjendjes së aftësisë së kufizuar nga familjet, pa pëlqimin e të cilave nuk mund të sigurohen asistentë.

Shumica e aktiviteteve që lidhen me aftësinë e kufizuar në nivel lokal janë vetëm pjesë e punës së departamenteve të përkujdesit social dhe mbështetja financiare më së shpeshti ofrohet për qendrat ditore. Ata nuk janë të njohur me KDPAK. Shërbimet kryesore në nivel vendor nuk janë të disponueshme për qytetarët me aftësi të kufizuara, përveç nëse ato kanë për qëllim personat me aftësi të kufizuara. Për shembull, hapja e një qendre të posaçme fitnesi për personat me aftësi të kufizuara që është mbështetur financiarisht nga komuna e Strumicës. Edhe në raste të tilla komunat nuk janë të vetëdijshme se me aktivitete të tilla promovojnë një model mjekësor dhe bamirësie për komunitetin me aftësi të kufizuara, që është shkelje e të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara dhe dispozitave të KDPAK.

Analiza e ofruar e kapaciteteve të shërbimeve sociale tregon se nevoja më e madhe për shërbime sociale është në fakt nevoja për ndërtimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore përpara se të mund të diskutohet për shërbimet e reja sociale dhe, natyrisht, përcaktimi i kostos së shërbimeve.

Gjithashtu, përfitime të ndryshme parashihen edhe përmes Ligjit për invalidët civilë të luftës¹⁹² dhe Ligjit për të drejtat e veçanta të pjesëtarëve të Forcave të Sigurisë së RM-së dhe anëtarëve të familjeve¹⁹³ të tyre, për personat me aftësi të kufizuara, por jo në bazë të aftësisë së kufizuar, por për arsyen e fitimit të aftësisë së kufizuar.¹⁹⁴ Me këto ligje shteti sërish ofron përfitime të

ndryshme për të njëjtën gjendje invaliditeti.

Jetesa e pavarur varet kryesisht nga rrjetet joformale të mbështetjes. Shërbimet e nevojshme mbështetëse nuk janë zhvilluar dhe janë kryesisht pjesë e qendrave ditore publike për fëmijët dhe OPAK-të dhe OSHC-të. Deinstitutionalizimi kuptohet gjerësisht si zhvendosje e personave me aftësi të kufizuara në shtëpi grupore të vogla dhe si ndryshim në natyrën dhe kujdesin institucional.¹⁹⁵ Ka raporte të shumta që kanë të bëjnë me procesin e deinstitutionalizimit. Edhe pse shumica e tyre nuk arrijnë të analizojnë dukuritë nga pikëpamja e aftësisë së kufizuar dhe duke iu referuar realisht dispozitave nga neni 19, narrativi i tyre dominohet nga deklaratat për cilësinë e shërbimeve (kushtet e jetesës dhe nivelin e kujdesit) në vend të cilësisë së jetës (qasja në shërbimet kryesore dhe perspektivat e ardhshme për personat me aftësi të kufizuara).

Palet e interesuara, OPAK-të dhe OSHC-të, përfshirë edhe vetë personat me aftësi të kufizuara dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk e kuptojnë konceptin e jetës së pavarur.¹⁹⁶ Pavarësisht Strategjisë Kombëtare për Deinstitutionalizim¹⁹⁷ të miratuar (2018-2027),¹⁹⁸ shteti ende nuk ka miratuar një plan veprimi për zbatimin e saj. Në fund të vitit 2019 nuk kishte më asnjë fëmijë në institucione, përfshirë fëmijë me aftësi të kufizuara. Deri më tani, pjesa më e madhe e financimit në procesin e deinstitutionalizimit – përveç shpenzimeve kapitale në raste të caktuara – është nga donatorët ndërkombëtarë. Mungesa e standardeve për shërbimet e zhvillimit dhe kalimi në jetë të pavarur e bën stafin të punojë si gjithmonë, pra të fokusohet në aktivitete për kujdesin bazë dhe ngjarje të herëpashershme kulturore. Nuk ka të dhëna të planifikimit individual për personat me aftësi të kufizuara që synon përfshirjen e tyre në komunitet.¹⁹⁹ Duke pasur parasysh se personat me aftësi të kufizuara të akomoduar në institucione dhe ata jashtë institucioneve kanë aftësi shumë të ulëta sociale, është e nevojshme që në këtë proces të ndërmerren masa për ngritjen e aftësive sociale të personave me aftësi të kufizuar që kanë përfunduar procesin e deinstitutionalizimit, si dhe

¹⁹⁵ K. Panajotova, E. Koçoska, Analizë: Ndihmë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara që largohen nga institucionet e përkujdesjes, 2020 K.

¹⁹⁶ K. Panajotova, E. Koçoska, Analizë: Ndihmë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara që largohen nga institucionet e përkujdesjes, 2020

¹⁹⁷ UNICEF, në koordinim me agjencitë e tjera të OKB-së dhe BE-së, ka marrë pjesë në përgatitjen e Strategjisë së Deinstitutionalizimit 2018-2027 "Timjanik" dhe Planit të Veprimit shoqëruar. Është analizuar situata dhe janë identifikuar sfidat dhe prioritetet dhe kjo është përfshirë në tekstin përfundimtar të Strategjisë. Procesi i deinstitutionalizimit është një proces i vazhdueshëm dhe UNICEF-i vazhdon ta mbështesë atë

¹⁹⁸ Shih: Strategjia Kombëtare për Deinstitutionalizim 2018 - 2027 "Timjanik", MPPS, e disponueshme në :<https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/strategji/Strategji%202018/Strategjia_deinstitutionalizacija_Timjanik_2018-2027.pdf >

¹⁹⁹ K. Panajotova, E. Koçoska, Analizë: Ndihmë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara që largohen nga institucionet e përkujdesjes, 2020

¹⁹² Ligji për Invalidët Civilë të Luftës, MPPS, në dispozicion në: <https://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/civilniinvalidi_konsolidiran.pdf >

¹⁹³ Ligji për të drejtat e veçanta të pjesëtarëve të Forcave të Sigurisë së Republikës së Maqedonisë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, MPPS, i disponueshëm në: <https://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/braniteli_precisten.pdf >

¹⁹⁴ Shih: Disability - Missing Jigsaw, Raporti i Statusit të Aftësisë së Kufizuar, Polio Plus, 2012.

të vendosen masa dhe aktivitete të detyrueshme për avokimin dhe vetë-përfaqësimin e personave që janë ende në institucione dhe që kanë përfunduar procesin. Në këtë duhet të parashikohet përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në proces. Koordinimi ndërmjet të gjitha palëve të interesuara është shumë i ulët. Mungesa e qasshmërisë i kufizon personat me aftësi të kufizuara që të marrin pjesë në komunitet. Mungesa e vetëbesimit kontribuon që disa nga personat e deinstitutionalizuar të ndihen të pasigurt në lidhje me rëndësinë dhe suksesin e vetë procesit.²⁰⁰

Përveç kësaj, deinstitutionalizimi i të rriturve me aftësi të kufizuara dhe shërbimet për të mbështetur jetesën në komunitet nuk janë në përputhje me KDPAK. Procesi nuk përfshin të drejtën e zgjedhjes së personave me aftësi të kufizuara për të vendosur nëse dëshirojnë të jetojnë jashtë institucioneve, se si të marrin një vendim të informuar për ta bërë këtë, se ku dhe me kë dëshirojnë të jetojnë në komunitet etj.

Faktori kryesor është se mes politikëbërësve, administratës qendrore dhe lokale dhe publikut nuk janë kuptuar aspak detyrimet që dalin nga KDPAK. Kjo kontribuon në ruajtjen e perceptimit ekzistues ndaj personave me aftësi të kufizuara në të gjitha nivelet. Kjo shoqërohet gjithashtu me heqjen e vazhdueshme të aftësisë juridike nga personat me aftësi të kufizuara. Paralelisht me këtë, një pjesë e madhe e personave me aftësi të kufizuara në përkujdesje institucionale, shtëpi grupore apo familje janë ende të privuar nga aftësia e tyre juridike dhe të vënë nën kujdestari. Edhe pse Qeveria nuk bëri asnjë konsultim me personat me aftësi të kufizuara dhe OPAK-të në përputhje me KDPAK, në kushtet e KOVID-19 ajo miratoi disa masa që kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek burrat dhe gratë me aftësi të kufizuara. Gjatë masave të kufizimit të lëvizjes, asistentët personalë nuk respektuan protokollet speciale, gjë që krijoi frikë si te marrësit e shërbimit, ashtu edhe te asistentët, në lidhje me infeksionin dhe transmetimin e mundshëm të sëmundjes, gjë që çoi në uljen e intensitetit të kujdesit.²⁰¹

²⁰⁰ K. Panajotova, E. Koçoska, Analizë: Ndihmë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara që largohen nga institucionet e përkujdesjes, 2020

²⁰¹ Shih: Analiza e Ndikimeve të KOVID-SARS-19 mbi Gjininë dhe Diferencat, Studim i Politikave nr. 40, OSBE, 2021, në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/1/9/480413.pdf>

3.2 Qasja në kujdesin shëndetësor dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor

Parimet themelore të Ligjit për Mbrojtjen Shëndetësore (LMSH)²⁰² nuk janë të detajuara mjaftueshëm nga këndvështrimi i KDPAK. Ligji për Sigurimet Shëndetësore (LSSH)²⁰³ rregullon shërbimet e kujdesit shëndetësor në kujdesin parësor, specialist-konsultativ dhe spitalor (afatshkurtër dhe afatgjatë) dhe shërbimet shëndetësore përmes programeve qeveritare për mbrojtjen parandaluese dhe kurative. 94% e personave me aftësi të kufizuara dhe prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara besojnë se janë të diskriminuar në fushën e kujdesit shëndetësor dhe besojnë se procedurat për marrjen e mbrojtjes parësore, dytësore dhe terciare nuk janë të qasshme dhe lehtësisht të disponueshme.²⁰⁴

Institucionet shëndetësore janë kryesisht të paqasshme fizikisht, duke përfshirë vetë MSH-në dhe departamentet rajonale të FSShRMV-së (Fondi i Sigurimeve Shëndetësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut)²⁰⁵, si dhe shumë ordianca mjekësore publike dhe private. Ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve (LMDP)²⁰⁶ rregullon të drejtën e informimit për pacientët me aftësi gjykim të zvogëluar përgjithmonë,²⁰⁷ por për shkak të mungesës së trajnimeve për komunikim dhe qasje ndaj personave me aftësi të kufizuara, realizimi i kësaj të drejte vështirësohet në praktikë. Ndryshe nga pacientët e tjerë, një i verbër, një i shurdhër që nuk di të lexojë, një memec që nuk di të shkruajë dhe një shurdhmemec duhet të pranojë ose të refuzojë një ndërhyrje të caktuar mjekësore me një deklaratë të dhënë para dy dëshmitarëve. Kjo metodë pasqyron përsëri qasjen mjekësore ndaj çështjeve të aftësisë së kufizuar.

Aftësia e kufizuar nuk është pjesë e kriterëve kur përgatiten dhe ofrohen programe për formimin

²⁰² Ligji për Kujdesin Shëndetësor. Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/2012, 145/2012, 87/2013, 164/2013, MSH. Në dispozicion në: http://mz.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-zdravstvena-zastita-2_12_2012.pdf

²⁰³ Ligji për Sigurimet Shëndetësore (tekst i integruar i konsoliduar Gazeta Zyrtare nr. 65/2012, 16/2013 dhe 91/2013), Fondi i Sigurimeve Shëndetësore. Në dispozicion në: [http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon%20za%20zdravstveno%20isguruvanje%20\(Interen%20precisten%20tekst\).pdf](http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon%20za%20zdravstveno%20isguruvanje%20(Interen%20precisten%20tekst).pdf)

²⁰⁴ Shih: Publikimi "KU LUNDRON KJO ANIJE" - demistifikimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë me rishikim të Ligjit për kujdesin shëndetësor, 2018, në dispozicion në: <http://poliplus.org.mk/margina/dokumenti/kade-plovi-ovoj-brod-en.pdf>

²⁰⁵ Shih: "Shëndeti seksual dhe riprodhues dhe personat me aftësi të kufizuara – Raporti i vlerësimit të nevojave dhe shërbimeve – Hera, faqe 20, 2012, <http://hera.org.mk/wp-content/uploads/2014/02/izvestaj_poprecenost_rz.pdf>. qasur më: 21.10.2014,

²⁰⁶ Shih: Ligji për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 82, 08.07.2008). Në dispozicion në: <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2018/01/ZAKON-ZA-ZASHTITA-NA-PRAVATA-NA-PATIENTITE-zakluchno-so-br.-150-od-2015.pdf>

²⁰⁷ Shih: "Të drejtat e pacientëve me fokus tek njerëzit me aftësi të kufizuara intelektuale" ESE, 2011, f. 6. <http://www.esem.org.mk/pdf/Publikacii/ESE%20Intelektualna%20poprecenost.pdf>.

profesional në fushën e shëndetit publik.²⁰⁸ Në bazë të Ligjit për Produktet dhe Pajisjet Medicinale,²⁰⁹ kriteret për vendosjen e produkteve dhe pajisjeve medicinale në treg nuk i parashikojnë standardet e qasshmërisë dhe disponueshmërisë.

Premisa për realizimin e shërbimeve shëndetësore është mosha dhe niveli i aftësisë së kufizuar dhe diagnoza. Qasja në mjete ndihmëse ortopedike dhe pajisje të tjera, të rregulluara me Rregulloren për indikacionet për realizimin e së drejtës për pajisje ortopedike dhe mjete²¹⁰ të tjera përcaktohet nga mosha, shumica e tarifës së pjesëmarrjes që i siguruari duhet të paguajë, si dhe koha për përdorimin e këtyre ndihmave. Sipas informacioneve të FSSHM-së,²¹¹ në vitin 2020 janë lëshuar rreth 193 mijë ndihma, shumica e të cilave i përkasin grupit të mjeteve ortopedike. Bazuar në të dhënat për pajisjet ortopedike të lëshuara, mund të konstatohet se shumica e pajisjeve të lëshuara i përkasin nëngrupit të pajisjeve të ndryshme dhe sanitare, ku përfshihen pelenat dhe qeset për urostomi, ileostomi dhe kolostomi. Shpenzimet për ndihmë ortopedike në nëntor 2019 përbënin 1,68% të buxhetit total.²¹² 95% e personave dhe prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara mendojnë se nuk ka transparencë dhe llogaridhënie nga ana e FSSHM-së lidhur me fondet e akorduara për mbrojtjen shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara.²¹³

E drejta për rehabilitim mund të përdoret si traumatologji e zgjatur dhe rikuperim postoperativ në kohëzgjatje prej 21 ditësh në periudhën 1-vjeçare për personat me aftësi të kufizuara, të përcaktuara me diagnoza që janë të shënuara në vetë rregulloren. Përgjatshim bëjnë fëmijët me paralizë cerebrale deri në 3 vjeç, ku rehabilitimi mund të zgjasë deri në 30 ditë dhe deri në katër herë në vit, ndërsa për fëmijët e moshës 3 deri në 14 vjeç mund të zgjasë deri në 30 ditë dhe deri në 2 herë në vit. Në vitin 2020, të drejtën e rehabilitimit mjekësor të specializuar, si trajtim i vazhdueshëm spitalor, me vendim të FSSHM-së, e kanë realizuar 2068 persona të siguar, që është afërsisht 62% më pak se në vitin 2019. Në vitin 2020 FSSHM ka ofruar pagesa kontraktuale

(buxhetore) në shumë të përgjithshme prej 83.000.000 denarë për institucionet private shëndetësore që kryejnë rehabilitim mjekësor si trajtim të zgjatur spitalor (banja). Kompensimi për rehabilitimin mjekësor të kryer në kujdesin shëndetësor publik përfshihet në tarifat totale.

²¹⁴

Pavarësisht nga shërbimet e sipërpërmendura të kujdesit shëndetësor, ka ende mungesë të shërbimeve të specializuara shëndetësore dhe programeve dhe shërbimeve për parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, trajtimin e hershëm dhe rehabilitimin e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara. Fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për stomatologji të përgjithshme mund ta realizojnë atë vetëm në Qendrën Klinike Stomatologjike në Shkup, gjë që i vë në pozitë krejtësisht të pafavorshme personat dhe fëmijët nga zonat rurale.

Punonjësit e shëndetësisë kanë njohuri të pamjaftueshme për të drejtat dhe detyrimet që dalin nga KDPAK. 99% e të anketuarve kanë dhënë notë negative për punën e punonjësve të shëndetësisë me qytetarë me aftësi të kufizuara.²¹⁵ Stereotipet dhe opinionet janë një pengesë shtesë në realizimin e të drejtave të mbrojtjes shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara dhe shpesh denigrohen dhe konsiderohen aсексуале.²¹⁶

Personat me aftësi të kufizuara janë lënë jashtë zbulimit dhe parandalimit të hershëm dhe programit për sëmundjet malinje, pa qasje në shërbime, për të cilat nuk përcaktohet kosto.

Në vitet e fundit, UNFPA, përmes programit të saj për shëndetin seksual dhe riprodhues (ShSR) dhe të drejtat dhe dhunën me bazë gjinore (DhGj), si dhe me qëllim të zbatimit të disa aktiviteteve nga plani i veprimit për shëndetin seksual riprodhues²¹⁷ ka ofruar trajnime për mjekë të përgjithshëm dhe punonjës socialë në të gjithë vendin. Personat me aftësi të kufizuara ishin pjesë e ekipit të trajnimit të UNFPA-së.

Këto trajnime zhvillohen në bashkëpunim me Qendrën për Mjekësi Familjare dhe kanë për qëllim forcimin e kapaciteteve të palëve të interesuara në lidhje me KDPAK, konceptin e DhGj-së për gratë me dhe pa aftësi të kufizuara, si dhe njohjen e tyre me konceptin e akomodimit të arsyeshëm. Me qëllim të forcimit të kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuar në lidhje

²⁰⁸ Ligji për Shëndetin Publik, nr. 136/2011 <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-javno-zdravje-precisten.pdf>

²⁰⁹ Ligji për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore, 11/2012 <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-lekovi-i-medicinski-pomagala.pdf>

²¹⁰ Rregullorja për indikacionet për ushtrimin e së drejtës për mjete ortopedike dhe mjete të tjera, FSSH MK, e disponueshme në: <http://www.fzo.org.mk/default.asp?ItemID=D42C5C3FA5A79548A0408B9FB59A9874>

²¹¹ Raporti Vjetor për vitin 2020 i FSSHM, i disponueshëm në: <http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Godisen%20izvestaj%202020.pdf>

²¹² Shih: Raportin për realizimin e mjeteve nga Buxheti i FSSHM për periudhën 01.01-30.11.2019, në dispozicion në: <http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Godisen%20izvestaj%202020.pdf>

²¹³ Shih: Publikimi "KU LUNDRON KJO ANIJE" - demistifikimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë me rishikim të Ligjit për kujdesin shëndetësor, 2018, në dispozicion në: <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/kade-plovi-ovoj-brod-en.pdf>

²¹⁴ Shih: Raportin Vjetor të FSSHM-së 2020, i disponueshëm në: <http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Godisen%20izvestaj%202020.pdf>

²¹⁵ Shih: Publikimi "KU LUNDRON KJO ANIJE" - demistifikimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Maqedonisë me rishikim të Ligjit për kujdesin shëndetësor, 2018, në dispozicion në: <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/kade-plovi-ovoj-brod-en.pdf>

²¹⁶ Shih: "Shëndeti seksual dhe riprodhues dhe personat me aftësi të kufizuara - Raporti i vlerësimit të nevojave dhe shërbimeve - Hera 2012, f. 61 - 62.

²¹⁷ <http://iph.mk/wp-content/uploads/2019/08/Nov-tekst-na-AP-usoglaseno-Sekretarijat-za-zakonodavstvo-11.09.2018.pdf>

me ShSR dhe me mbështetjen e agjencive të OKB-së, janë ofruar trajnime të ndryshme për personat me aftësi të kufizuara, OPAK dhe palët e tjera të interesuara dhe personat me aftësi të kufizuara që kanë përfunduar procesin e deinstitutionalizimit. Trajnime në kuadër të programit të OKB-së të menaxhuar nga UN Women u zbatuan për persona nga I.S. Banja Banskó dhe për palë të tjera të interesuara, mbi konceptin e dhunës me bazë gjinore, KDPK dhe konceptin e jetesës së pavarur. Trajnues me aftësi të kufizuara u përfshinë si pjesë e ekipeve të trajnuesve.

UNFPA, së bashku me punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe aktorë të tjerë, punon në planifikimin e familjes dhe kujdesit gjatë shtatzënisë (veçanërisht për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara), ndër fushat e mësipërme.

Lidhur me të drejtën e ndërprerjes së shtatzënisë, në zgjidhjen ligjore ekzistuese²¹⁸ vendimi, gjegjësisht deklarata me shkrim për gratë të cilave u është hequr aftësia juridike merret nga kujdestarët e tyre. Ligji nuk parashikon mënyra për të marrë pëlqimin nga gratë me aftësi të kufizuara, as nuk parashikon mënyra për komunikimin dhe këshillimin e grave të akomoduar në institucione dhe/ose shtëpi grupore dhe/ose në format e reja të jetesës së organizuar të mbështetur.

Pavarësisht detyrimit ligjor për mbajtjen e evidencës së fëmijëve me aftësi të kufizuara,²¹⁹ as institucionet shëndetësore dhe as Instituti i Shëndetit Publik nuk mbajnë regjistra të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Në kushtet e COVID-19, personat me aftësi të kufizuara deklaruan sepërballëshin me izolim më të madh social, gjë që ndikoi në shëndetin e tyre mendor.²²⁰ Informacionet në lidhje me COVID-19 të transmetuara përmes mediave nuk ishin në formate të qasshme.²²¹ Informacionet nga MSH për COVID-19 nuk ishin në formate të qasshme dhe të disponueshme. Faqja e internetit që përmban informacione në lidhje me COVID-19 është e paarritshme. Gjithashtu, faqja e internetit që fton qytetarët të aplikojnë për vaksinim nuk është gjithashtu në një format të qasshëm. Pikat e vaksinimit dhe pikat për testet PCR janë të paarritshme.

3.3 Qasja në arsim

Perceptimet në lidhje me arsimin inkluziv tregojnë se ka një rritje gjashtëfish të numrit të njerëzve që mbështesin idenë se fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të ndjekin shkollat e rregullta me bashkëmoshatarët e tyre (nga 4% në 2014 në 24%), megjithatë, 66% besojnë se përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin e rregullt do të nënkuptojë në mënyrë të pashmangshme që fëmijët e tjerë do të privohen nga vëmendja e mjaftueshme nga mësuesit.²²²

Sipas raportit të BB të vitit 2015. "Përfaqësimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor është nën 5%".²²³ Nga 58 kopshte në vitin 2017 dhe 2018, 39 kopshte (ose 68%) janë kujdesur për 415 fëmijë me aftësi të kufizuara. Përqindja e fëmijëve me aftësi të kufizuara është 1,19% e numrit të përgjithshëm të fëmijëve të përfshirë në kopshte.²²⁴

Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (LMF) ²²⁵ i mungojnë shumë masa që do të çonin në barazi gjithëpërfshirëse, si aplikimi i parimit të vullnetit dhe preferencave më të mira të fëmijëve me aftësi të kufizuara, parimi i promovimit të identitetit zhvillimor të fëmijëve me aftësi të kufizuara, qasja ndaj përkufizimit të fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara, si dhe përfshirja e tyre aktive në të gjitha proceset. Sipas LPP-së, si fëmijë konsiderohet çdo person deri në moshën 18 vjeçe, si dhe "personi me aftësi të kufizuara në zhvillimin fizik dhe mendor deri në moshën 26 vjeçe". Ligji është i ngarkuar me terminologji të ndryshme dhe ka një kuptim mjekësor të gjendjes së aftësisë së kufizuar. Me LPP, të rriturit me aftësi të kufizuara deri në 26 vjeç trajtohen si fëmijë.

LPP ofron mundësinë që brenda kopshtit të formohet një grup për fëmijët me aftësi të kufizuara, që sigurisht nuk shkon në drejtim të inkluzionit, d.m.th. përfshin vetëm integrimin fizik. Normativa e Rregullores²²⁶ nuk përcakton standardet për qasshmëri dhe komunikim në përputhje me KDKPAK. Procesi i zbulimit, identifikimit dhe raportimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara pengohet nga mungesa e

218 Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2018/01/ZAKON-ZA-PREKINUUVANE-NA-BREMENOSTA-zakluchno-so-br.-149-od-2015.pdf>

219 Ligji për mbajtjen e evidencës nga lëmia e shëndetësisë, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 20/09. Në dispozicion <http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon_z_a_evidencij_vo_oblasta_na_zdravstvoto_SL_Vesnik_na_RM_br_20_od_16.02.2009.godina.pdf

220 Shih: Analiza e Ndikimeve të COVID-SARS-19 mbi Gjirinë dhe Diferencat
Studimi i Politikave nr. 40, OSBE, 2021, në dispozicion në <https://www.osce.org/files/f/documents/1/9/480413.pdf>

²²¹ Raporti i të Drejtave të Njeriut 2021, Fra, EPi Në dispozicion në <https://fra.europa.eu/en/publication/2021/fundamental-rights-report-2021>

222 GFK, Anketa e dytë mbi njohuritë, qëndrimet dhe praktikat në lidhje me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara UNICEF (2018) Shkup op cit. https://www.unicef.org/northmacedonia/media/3186/file/MK_2018_DisabilityKapReport_MK.pdf

223 Banka Botërore. Zhvillimi i hershëm i fëmijërisë në Ish Republikën Jugosllave të Magedonisë: Raporti i vendit SABER 2015

224 PËRFSHIRJA e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor:
një raport kërkimor. – Shkup: Avokati i Popullit i Republikës së
Maqedonisë, 2018, UNICEF në dispozicion në [https://www.unicef.org/
northmacedonia/media/4386/file/MK_CWDInKindergarten_Report_
MK.pdf](https://www.unicef.org/northmacedonia/media/4386/file/MK_CWDInKindergarten_Report_MK.pdf)

225 Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve, MPPS, Teksti i konsoliduar, në dispozicion
në: <https://www.mtpa.gov.mk/content/pdf/zakoni%2018%20198%202018%20ZAKON%20ZA%20ASTITAJ%20NA%20DECATAJ%2020%20D0%B%20D0%BE%20D0%BD%20D1%81%20D0%BE%20D0%BB%20D0%B8%20D0%B4%20D0%B8%20D1%80%20D0%B0%20D0%BD%20D1%82%20D0%B5%20D0%BA%20D1%81%20D1%82-converted.pdf>

226 https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/pravilnicidetska/standardi_gradinki.pdf

procedurave të unifikuara sistematike kur bëhet fjalë për zbulimin dhe ndërhyrjen e hershme. Procesi nuk ofron mbështetjen e duhur për prindërit për të pranuar fëmijën e tyre me aftësi të kufizuara dhe ka një hezitim nga ana e edukatorëve për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara.²²⁷

Në vitin 2020, 0.34% e PBB-së ishte caktuar për arsimin parashkollor.²²⁸

Progresi më i madh në drejtim të arsimit inkluziv është në arsimin fillor. Arsimi fillor rregullohet me Ligjin për Arsimin Fillor (LAF)²²⁹ dhe mbështetet nga Koncepti i Arsimit Fillor²³⁰, si Koncepti për arsimin inkluziv.²³¹

Koncepti i arsimit fillor, përkundër të gjitha dokumenteve dhe strategjive ndërkombëtare, nuk i referohet as KDPAK-së, kështu që vetë koncepti nuk e përfshin këtë çështje nga aspekti i KDPAK. LAF²³² përfshin aftësinë e kufizuar në mbrojtjen nga diskriminimi. Për sa i përket përdorimit të gjuhëve (neni 10), ligjvënësi nuk ka parashikuar përdorimin e gjuhës së shenjave dhe as alfabetin Braj. Përdorimi i alfabetit Braj parashikohet vetëm në realizimin e kurrikulës dhe programeve dhe në notimin e nxënësve me aftësi të kufizuara. Mësimi i gjuhës së shenjave nuk parashikohet as si lëndë e detyrueshme dhe as si zgjedhore në Konceptin e Arsimit Fillor.²³³ Kjo qasje kontribuon në dyshimin dhe pakënaqësinë e personave me aftësi të kufizuara²³⁴ për përfshirjen e tyre në arsimin e rregullt. Përkufizimi se qasshmëria do të thotë "marrja e masave për t'u siguruar qasje nxënësve me aftësi të kufizuara" në LAF kuptohet, në kuptimin e ngushtë të fjalës, si një mjet për të kapërcyer barrierat fizike, në vend që të zgjidhet sistematikisht problemi i qasshmërisë në shkollë.

LAF rregullon përfshirjen e asistentëve arsimorë (AA) dhe asistentëve personalë (AP). Rregullorja për AA dhe

AP²³⁵ si dhe ulja e kufirit të moshës për AP nga 18 në 6 në LPP konfirmon se ligjvënësi nuk ka njohuri adekuate për konceptet e AA dhe AP dhe duhet theksuar se një selektivitet i tillë në ofrimin e shërbimeve është shkelje e nenit 19 të KDPAK. Gjetjet nga terreni tregojnë gjithashtu se asistentët personalë nuk janë të qartë për detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre ndaj nxënësve dhe profesionistëve të tjerë.²³⁶ Përqindja më e madhe e mësuesve (59.9%) barazojnë detyrat e punës së asistentit personal me detyrat e punës së asistentit arsimor.²³⁷

Në vitin 2019/2020 janë punësuar 321 asistentë (91-AP dhe 230-AA) në 35 komuna.²³⁸ Në vitin 2021, Ministria e Arsimit dhe Shkencës planifikon të punësojë 500 AA. Për këtë qëllim nga buxheti janë siguruar 59 milionë denarë.²³⁹

Sipas të dhënave të ESHS-së²⁴⁰ në fillim të vitit shkollor 2020/2021, numri i nxënësve në 42 shkollat fillore speciale ishte 706 nxënës me aftësi të kufizuara, prej të cilëve 256 ishin vajza. Në 4 shkollat e mesme speciale, numri i nxënësve është 232, nga të cilët 75 janë vajza me aftësi të kufizuara. Ekziston një mospërputhje në të dhënat ndërmjet bartësve të detyrave dhe ESHS-së. ESHS thekson se në vend janë nga 45 deri në 42 shkolla speciale, ndërsa sipas bartësve të detyrave janë vetëm 5 shkolla speciale të cilat sipas Konceptit të ri për Arsim dhe LAF bëhen shkolla fillore me qendër burimore. Me qëllim të përmirësimit të procesit inkluziv, në 14 institucione arsimore në mbarë vendin zbatohet Projekti për qasje të papenguar - 6 shkolla fillore, 4 shkolla të mesme dhe 4 fakultete përmes Programit Aksional 2019-IPA 2 - BE për përfshirjen për të cilin është përgatitur dokumentacioni teknik (projektet për përshtatje).

Ligji për Arsimin e Mesëm (LAM)²⁴¹ është i segreguar dhe i fragmentuar. Punët për të cilat aftësohen personat me aftësi të kufizuara nuk korrespondojnë me nevojat e tregut të punës dhe nuk janë në të njëjten shtrirje dhe cilësi si

²²⁷ PËRFSHIRJA e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor: një raport kërkimor. - Shkup: Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, 2018, UNICEF, në dispozicion në https://www.unicef.org/northmacedonia/media/4386/file/MK_CWDInKindergarten_Report_MK.pdf

²²⁸ https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/republic-north-macedonia/early-childhood-and-school-education-funding_en

²²⁹ Ligji për Arsimin Fillor. Në dispozicion në <https://mon.gov.mk/stored/document/Zakon%20za%20osnovnoto%20obrazovanie%20-%20nov.pdf>

²³⁰ Koncepti për arsimin fillor, MASH në dispozicion në: <https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20MK.pdf>

²³¹ Koncepti i arsimit inkluziv, i disponueshëm në <https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20za%20inkluzivno.pdf>

²³² Projektligji për Arsimin Fillor, MASH 2018, në dispozicion në: < http://www.mon.gov.mk/images/dokkumenti/4_1177161790%D0%9D%D0%B0%D1%86%D1%80%D1%82-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%B7%D0%B0%D0%BE%D1%81%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D0%BD%D0%BE%D1%82%D0%BE%D0%BE%D0%B1%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%BE%D0%B2%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D0%B5_1.1.doc

²³³ <https://360stepeni.mk/kako-ke-izleda-osnovnoto-obrazovanie-sporod-novata-kontseptsija/>

²³⁴ Deklarata e pjesëmarrësve në fokus grupe

²³⁵ https://mon.gov.mk/stored/document/2021_Pravilnik_Nachin%20na%20pobaraivanje%20asistenti.pdf

²³⁶ Hunt "Asistentë personalë dhe arsimorë - Tani dhe këtu, perspektiva të hapura", UNDP

²³⁷ Gjendja aktuale e fëmijëve me nevojat të veçanta arsimore në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2018, BZHA, E disponueshme në <https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2020/02/Aktuelna-sostojba-na-inkluzija-na-deca-so-posebni-obrazovni-MK.pdf>

²³⁸ Hunt "Asistentë Personal dhe Arsimor - Tani dhe Këtu, Perspektiva të Hapura, UNDP

²³⁹ <https://www.fakulteti.mk/news/23072021/vo-tek-e-oglas-za-vrabotuvanje-500-obrazovni-asistenti-za-poddrshka-na-decata-so-poprechenost-na-uchilishte-kje-zemaat-plata-od-24-000-denari>

²⁴⁰ Enti Shtetëror i Statistikave, shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut në fillim të vitit akademik 2020/2021, në dispozicion në: <https://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?id=17&br=13594>

²⁴¹ Ligji për Arsimin e Mesëm, tekst i konsoliduar, MASH, Në dispozicion në: http://www.mon.gov.mk/images/%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%B7%D0%B0_%D1%81%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%BE%D1%82%D0%BE_%D0%BE%D0%B1%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%BE%D0%B2%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D0%B507.pdf

në shkollat e mesme të rregullta.²⁴² Ligji për Arsimin e Lartë (LAL)²⁴³ nuk përmban dispozita për mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, nuk rregullon të drejtën e përshtatjes së duhur dhe as format e komunikimit. Trajnimi i personelit mësimor për çështjen e aftësisë së kufizuar zakonisht bëhet përmes projekteve dhe mbështetjes nga institucionet ndërkombëtare pa ndonjë strategji afatgjatë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe BZHA.²⁴⁴ Programet arsimore nuk përmbajnë dispozita që do të promovonin dhe zbatonin format e ndryshme, si dhe dispozita që do të përmbajnë detyrimin që ato të jenë në formate të qasshme.²⁴⁵

Asnjë institucion arsimor nuk mban evidencë dhe statistika për numrin e personave me aftësi të kufizuara të përfshirë në sistemin arsimor, duke pasur parasysh aspektin gjinor.

Vitet e fundit nuk është marrë asnjë qasje sistematike për rritjen e aftësive arsimore dhe sociale të personave të vendosur në institucione. Pjesa më e madhe e fëmijëve dhe të rinjve të deinstitutionalizuar nuk janë pjesë e asnjë skeme arsimore sepse perceptimi është se ata nuk mund të mësojnë sepse kanë "aftësi të kufizuara të rënda dhe të thella" të kombinuara me "probleme shëndetësore".²⁴⁶

Hulumtimi në terren tregon se qasja fizike²⁴⁷ dhe komunikuese, si dhe qasja në teknologjinë²⁴⁸ ndihmëse është një problem madhor. Shteti duhet të vendosë detyrimin që çdo institucion arsimor të mbajë evidencë dhe statistika për numrin e personave me aftësi të kufizuara.

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2018-2025²⁴⁹ ka një kornizë të rëndësishme edhe në sistemin arsimor. Strategjia

ofron terminologji të ndryshme (njerëz me aftësi të kufizuara, nevoja të veçanta arsimore, aftësi të kufizuara mendore ose fizike) si dhe një qasje mjekësore kundrejt aftësisë së kufizuar, ku aftësia e kufizuar mendore ose fizike përmendet si arsye që disa nxënës të kenë nevoja të veçanta arsimore (paragrafi 150); për edukimin qytetar në arsimin fillor dhe udhëzimet e zbatimit²⁵⁰ nuk mbulohet çështja e aftësisë së kufizuar.

Krahas bashkëpunimit mes shkollës dhe prindërve/kujdestarëve, koncepti nuk parashikon përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara, masa për të inkurajuar autonominë e organeve drejtuese në të cilat do të jenë vetë fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara të përfaqësuar, si dhe mungesën e mundësisë së nxënësve për të shprehur miratimin e tyre në lidhje me planin individual të arsimit. Raporti i aktiviteteve të realizuara nga Strategjia Kombëtare për 2019 dhe 2020 nuk përmban informacion për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Çështja e aftësisë së kufizuar nuk mbulohet në Konceptin për edukimin qytetar²⁵¹ në arsimin fillor dhe udhëzimet për zbatim. Për sa i përket edukimit seksual, UNFPA është e angazhuar në zhvillimin e zgjidhjeve të TI-së për edukimin gjithëpërfshirës seksual për personat që i përkasin spektrit autik dhe personat me aftësi të kufizuara intelektuale. Siç theksohet nga UNFPA, personat me aftësi të kufizuara (veçanërisht intelektualët) janë 3-4 herë më të ekspozuar ndaj mundësisë së dhunës dhe abuzimit, krahasuar me popullatën e përgjithshme.

Në vitin 2020 janë bërë ndryshime të caktuara në LAF dhe LAM, të cilat sigurojnë organizimin pa probleme të mësimin në vend dhe në raste urgjente, siç është rasti me pandeminë "Kovid-19". Ndryshimet ligjore janë përgatitur në bazë të studimeve të organizatave ndërkombëtare si OBSH, UNICEF. Në vitin shkollor 2020/2021, përmes BE-së janë siguruar fondet si bursa për fëmijët me aftësi të kufizuara në klasën e parë dhe të dytë të cilët do të regjistrohen në arsimin e rregullt.²⁵²

Për sa i përket pjesëmarrjes dhe konsultimit, duhet theksuar se as OPAK-të, as personat me aftësi të kufizuara, as fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara nuk janë konsultuar dhe nuk janë përfshirë aktivisht në hartimin e ndryshimeve ligjore në arsim.²⁵³

²⁴² Z. Shavreski, N. Amdiju, E. Koçoska, T. Ortakovski, J. Andonov, Ekipi i Asociacionit Juridika për Kërkime Juridiko-Ekonomike dhe Edukim, Publikim Lidhja që mungon "– Demitizimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Maqedonisë me rishikim të së drejtës për arsimin, 2018 Polio Plus. Në dispozicion në <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/Alkata-sto-nedostasuva-B5-mk.pdf>

²⁴³ Ligji për Arsimin e Lartë, MASH. Në dispozicion në: http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/ZAKON_VISOKOTO_OBRAZOVANIE-final.pdf

²⁴⁴ Shih: Raporti i Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuara dhe OShC-ve për zbatimin e KDPAK, dorëzuar për shqyrtim në sesionin e 20-të të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 2018. Në dispozicion në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=INT%2FCRPD%2fCSS%2fMKD%2f31979&Lang=en

²⁴⁵ Ligji për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm

²⁴⁶ K. Panajotova, E. Koçoska: Ndihmë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuar që largohen nga institucionet e përkujdesit, 2020

²⁴⁷ Shih: Raport hulumtues: Aplikimi i teknologjisë informative ndihmëse në shkollat fillore të rregullta në Maqedoni, situata dhe nevoja aktuale, Hap dritaret, Shkup, mars 2011, fq.9-15

²⁴⁸ Z. Shavreski, N. Amdiju, E. Koçoska, T. Ortakovski, J. Andonov, Ekipi i Asociacionit Juridika për Kërkime Juridiko-Ekonomike dhe Edukim, Publikim Halika që mungon "– Demitizimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Maqedonisë me rishikim të së drejtës për arsimin, 2018 Polio Plus. Në dispozicion në <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/Alkata-sto-nedostasuva-B5-mk.pdf>

²⁴⁹ <http://mrk.mk/wp-content/uploads/2018/10/Strategjia-za-obrazovanie-MAK-WEB.pdf>

²⁵⁰ Koncepti për edukimin qytetar, i disponueshëm në <https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2020/09/%D0%9A%D0%BE%D0%BD%D1%86%D0%B5%D0%BF%D1%82-%D0%B7%D0%B0-%D0%93%D1%80%D0%B0%D1%93%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%BE-%D0%BE%D0%B1%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%BE%D0%B2%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D0%B5-MK.pdf>

²⁵¹ Koncepti i edukimit qytetar, në dispozicion në: <https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2020/09/%D0%9A%D0%BE%D0%BD%D1%86%D0%B5%D0%BF%D1%82-%D0%B7%D0%B0-%D0%93%D1%80%D0%B0%D1%93%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%BA%D0%BE-%D0%BE%D0%B1%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%BE%D0%B2%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D0%B5-MK.pdf>

²⁵² https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/republic-north-macedonia/early-childhood-and-school-education-funding_en

²⁵³ Raporti i të Drejtave të Njeriut 2021, Fra, Epi. në dispozicion në <https://fra.europa.eu/en/publication/2021/fundamental-rights-report-2021>

3.4 Qasja në punësim

Sipas anketës së vitit 2017, popullsia mbi 15 vjeç në vend për vitin 2017 numëronte 1,679,935 individë, nga të cilët 56.8% janë aktivë dhe të regjistruar në tregun e punës ndërsa 43% janë joaktivë.²⁵⁴ Nga 725,723 individë joaktivë në tregun e punës, 59,701 janë joaktivë, kanë një lloj aftësie të kufizuar dhe nuk marrin pjesë në rrjedhat ekonomike.²⁵⁵ Nga ana tjetër, janë 31.781 persona pa aftësi të kufizuara, të cilët janë të aftë për punë, por të paaftë për të marrë pjesë në tregun e punës dhe në proceset ekonomike për shkak të mungesës së shërbimeve mbështetëse për të afërmit e tyre me aftësi të kufizuara – situatë që i detyron ata të qëndrojnë në shtëpi dhe të ofrojnë një lloj mbështetjeje për të afërmit e tyre ose të afërmit me aftësi të kufizuara.²⁵⁶ Nuk ka të dhëna për gjendjen e aftësisë së kufizuar dhe as të dhëna statistikore për personat me aftësi të kufizuara aktive, të punësuar dhe të papunë.

Legjislacioni nuk parashikon një sistem koherent për punësimin e personave me aftësi të kufizuara siç kërkohet nga KDPK e OKB-së. Duke patur parasysh se e gjithë infrastruktura është krejtësisht e paqasshme, duke përfshirë edhe sektorin e transportit, personat me aftësi të kufizuara përballen që në fillim me një mundësi të pabarabartë për të kërkuar një punë dhe për të gjetur një të tillë. Rastet e personave me aftësi të kufizuara të punësuar në tregun e hapur të punës janë mjaft të rralla. Ligji për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara²⁵⁷ rregullon kushtet specifike rreth punësimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuara, duke u fokusuar në punësimin e tyre në strehimore. Edhe pse ky ligj është miratuar si masë përkrahëse, ai deri më tani nuk ka arritur të japë rezultatet e nevojshme.²⁵⁸ Ligji parashikon një numër të madh stimulash për sa i përket pagave mujore që paguhen nga Fondi Special si grante.²⁵⁹ Megjithatë, duhet të ekzistojë mundësia që këto të rishikohen nga një gjykatë, në mënyrë që të mund të vlerësohet nëse ato janë të përshtatshme për qëllimin e synuar apo jo, veçanërisht në dritën e ekzistencës së një shqetësimi serioz për abuzime

të mundshme nga punëdhënësit, veçanërisht kompanitë e strehimit.²⁶⁰ Nga pikëpamja e antidiskriminimit, një dispozitë e diskutueshme është ajo që specifikon se "...një person me aftësi të kufizuar mund të jetë punëdhënësi ose të veprojë si person përgjegjës pranë një punëdhënësi me kusht që të ketë marrë një mendim pozitiv nga Komisioni nën MPPS". Kjo dispozitë është një shembull klasik i një diskriminimi të bazuar në ligj.

Një kapitull i veçantë në ligj rregullon të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për arsim dhe trajnim profesional. Personi i papunë me aftësi të kufizuara do të dërgohet në aftësim profesional përmes Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Trajnimi për punë mund të bëhet te punëdhënësi dhe te një punëdhënësi tjetër sipas programeve të veçanta/sipas kushteve të veçanta dhe në mënyrën e përcaktuar në Ligjin për Agjencinë e Punësimit. Personat me aftësi të kufizuar të referuar në formimin profesional nuk kanë statusin e të punësuarve tek punëdhënësi ku jepet trajnimi profesional, me përjashtim të rasteve kur punëdhënësi i ka punësuar.

E njëjta qasje është ruajtur në dispozitat për rehabilitimin profesional në Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor, ku aftësia e kufizuar është e lidhur me (i) gjendjen shëndetësore dhe (ii) aftësinë për punë. Vetë përkufizimet e shëndetit dhe aftësisë për punë janë në kundërshtim me parimet, vlerat dhe dispozitat e KDPK-së së OKB-së. Për sa i përket përfshirjes, barazisë dhe mosdiskriminimit, si Ligji për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara ashtu edhe Ligji për Sigurimin Pensional dhe Invalidor i mbajnë personat me aftësi të kufizuara jashtë sistemit për sigurimin pensional dhe invalidor dhe në vend që t'i bëjnë aktivë duke i çuar në rikualifikim, shteti i shtyn drejt pensionit familjar ose invaliditetit si mjet siguri social për jetën e tyre. Një nga kërkesat në Ligjin për punë praktike²⁶¹ që personat me aftësi të kufizuara të jenë praktikantë është që ata të kenë kryer së paku arsimin fillor. Nisur nga konteksti dhe kushtet në të cilat jetojnë personat me aftësi të kufizuar, kjo dispozitë është e pafavorshme dhe nuk u lë atyre hapësirë për përdorimin e praktikës si mjet për të hyrë në tregun e punës.

Koncepti i vetëpunësimit të personave me aftësi të kufizuara u promovua dhe u popullarizua fuqishëm në vitin 2015, në mënyrë që personat e papunë me aftësi të kufizuara të inkurajohen të hapin kompani të tyre. Deri më tani janë regjistruar 230 kompani të tilla. Në partneritet me OSHK-të dhe OPAK-të, UNDP-ja po punon në krijimin e modeleve për përfshirjen ekonomike të personave me aftësi të kufizuara dhe Qendrave për Rehabilitim Profesional. Dy qendra të tilla janë krijuar: njëra në institucionin publik të sigurimeve sociale në Shkup dhe e dyta në ndërmarrjen

²⁵⁴ Publikimi: Anketa e Fuqisë Punëtore, 2017, Rishikimi Statistikor 2.4.18.03, Enti Shtetëror i Statistikave. Në dispozicion në: <<http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.18.03.pdf>>

²⁵⁵ Publikimi: Anketa e Fuqisë Punëtore, 2017, Rishikimi Statistikor 2.4.18.03, Enti Shtetëror i Statistikave. Në dispozicion në: <<http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.18.03.pdf>>

²⁵⁶ Publikimi: Anketa e Fuqisë Punëtore, 2017, Rishikimi Statistikor 2.4.18.03, Enti Shtetëror i Statistikave. Në dispozicion në: <<http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.18.03.pdf>>

²⁵⁷ Ligji për punësimin e personave me aftësi të kufizuar "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.87/2005 (tekst i konsoliduar), 113/2005, 29/2007, 88/2008, 161/2008, 99/2009, 136/ 2011, 129/15, 147/15 dhe 27/16. Në dispozicion në: <<http://www.mtsp.gov.mk>> dhe <<http://www.slvsnik.com.mk>>

²⁵⁸ K. Panajotova, E. Koçoska: Ndihmë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuar që largohen nga institucionet e përkujdesit, 2020

²⁵⁹ Rregullore për kushtet dhe mënyrën e dhënies së granteve nga Fondi special për përmirësimin e kushteve të punësimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuara, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 156/2008.

²⁶⁰ Shih gjithashtu: Z. Poposka, publikim analitik "Udhëtim larg – duke çmitizuar çështjen e aftësisë së kufizuar në fushën e punësimit dhe marrëdhënieve të punës", 2018, Polio Plus, në dispozicion në: <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/patuvaj-daleku-mk.pdf>

²⁶¹ <https://uklo.edu.mk/filemanager/KREDO/Zakon-za-praktikanstvo-21-05-2019.pdf>

sociale "Izbor" në Strumicë. Kriteri ekzistues i gjendjes së përgjithshme shëndetësore kufizon qasjen dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në administratën publike dhe gjyqësorin. Duhet bërë dallimi ndërmjet gjendjes dhe aftësisë shëndetësore të personave me aftësi të kufizuara, nga njëra anë, statusit dhe aftësisë së tyre të punës, dhe këto të dyja nuk duhet të konsiderohen të njëjta. Masa 'ad hock' prej 300 punësimesh të personave me aftësi të kufizuara mundësoi një përfshirje më të fuqishme të personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik. Në raportin e Avokatit të Popullit thuhet se nga gjithsej 300 persona me aftësi të kufizuara që janë renditur/përzgjedhur pas thirrjes, 230 prej tyre kanë ushtruar të drejtën e punësimit duke u dërguar në një autoritet/institucion publik, ndërsa 33 nuk janë vendosur askund.²⁶²

Nivelet e punësimit të personave me aftësi të kufizuara janë shumë të ulëta në krahasim me ato të personave pa aftësi të kufizuara, pothuajse të padukshme. Sipas të dhënave të APRMV-së,²⁶³ vetëm 1282 persona me aftësi të kufizuara janë të regjistruar si të papunë (436 janë gra me aftësi të kufizuara). Sipas ndarjes në moshë, meshkujt e moshës 50-59 vjeç e lart përbëjnë shumicën e të papunëve; nga pikëpamja gjinore, shumica e grave të papuna janë të moshës 50-59 vjeçe.²⁶⁴ Për sa i përket gjendjes së aftësisë së kufizuar, shumica e të papunëve me aftësi të kufizuara janë ata me aftësi të kufizuara mendore²⁶⁵ (768 persona), të ndjekur nga personat me aftësi të kufizuara fizike (407) dhe personat e shurdhër (128).²⁶⁶ Mesatarisht, vetëm 1671 persona me aftësi të kufizuara janë regjistruar çdo vit gjatë dhjetë viteve të fundit.

Statistikat ekzistuese nuk japin informacion për numrin e personave me aftësi të kufizuara të vetëpunësuar, as për numrin e personave me aftësi të kufizuara të punësuar jashtë Ligjit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe të atyre të punësuarve në administratën publike. Sipas llojit të profesionit,²⁶⁷ 1205 persona me aftësi të kufizuara kanë disa profesione bazë; 360

kanë profesione me procese joindustriale në sektorin e prodhimit; 292 punojnë si përpunues dhe montues të makinerive dhe instalimeve; 94 punojnë në industrinë e shërbimeve dhe si punëtorë në dyqane dhe shitje në treg; 28 janë teknikë dhe profesione të ngjashme; 26 janë nëpunës; 4 janë të punësuar si anëtarë të organeve legislative dhe ekzekutive, nëpunës shtetërorë, nëpunës shtetërorë në poste drejtuese, diplomatë dhe drejtorë; 3 janë ekspertë dhe shkencëtarë; dhe 2 punojnë si fermerë dhe peshkatarë profesionistë.²⁶⁸ Për sa i përket gjendjes së aftësisë së kufizuar, shumica e të punësuarve me aftësi të kufizuara janë me "pengesa në zhvillimin e tyre intelektual" (891); aftësi të kufizuara fizike (461); dëgjim të dëmtuar (244); shikim të dëmtuar (115); aftësi të tjera të kufizuara (303); kjo kategori është e panjohur në sistemin e mbrojtjes sociale, pra nuk është e qartë se për çfarë lloj aftësie të kufizuar bëhet fjalë. 65% e personave me aftësi të kufizuara të anketuar mendojnë se Ligji për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara nuk është zgjidhja më e mirë për punësimin e tyre; në vend të kësaj, zgjidhja më e mirë sipas tyre është tregu i hapur i punës. Në mesin e personave me aftësi të kufizuara është i përhapur mendimi për inkorporimin e sistemit të kuotave për punësimin e tyre si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat (85%), gjë që nuk ndodh me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara ku diferenca konsiston në 30 pikë përqindjeje.²⁶⁹

Me mbështetjen e UNDP-së dhe në partneritet me MPPS, SDC dhe APRMV (Programi për punë të dobishme komunale), deri në mars 2020, janë punësuar 10 persona me aftësi të kufizuara, 4 prej të cilëve femra (40%), në 12 komuna (Manastir, Prilep, Ohër, Strugë, Shuto Orizarë, Kumanovë, Shtip, Koçan, Vinicë, Dellçevë, Berovë dhe Pehçevë). Në vitin 2018, me mbështetjen e UNDP-së, 147 persona të papunë me aftësi të kufizuara kanë ndjekur trajnime të përshtatura për sipërmarrjet dhe menaxhimin. Në vitin 2019, 43 persona me aftësi të kufizuara aplikuan për grante për vetëpunësim, 31 prej të cilëve morën certifikatë për përfundimin me sukses të trajnimit; 19 prej tyre krijuan një biznes të vetin dhe punësuan 4 persona të tjerë.

Koncepti i vetëpunësimit të personave me aftësi të kufizuara u promovua dhe u theksua fuqishëm në vitin 2015, me qëllim inkurajimin e personave të papunë me aftësi të kufizuara për të krijuar kompanitë e tyre. Masa e vetëpunësimit të personave me aftësi të kufizuara, si pjesë e Planit Operativ për programet aktive dhe masat për punësim dhe shërbime në tregun e hapur të punës, është duke u zbatuar nga UNDP. Deri më sot janë regjistruar 230 kompani të krijuara nga persona me aftësi të kufizuara, në kuadër të të cilave ata vetëpunësohen

²⁶² Shih: Raport i posaçëm i Avokatit të Popullit për masën 300 punësime për persona me aftësi të kufizuara. Në dispozicion në: <http://ombudsman.mk/upload/Istrazuvanja/2016/Istrazuvanje-Makedonski%20sumi.pdf>

²⁶³ Pasqyrë e personave të papunë të regjistruar me aftësi të kufizuara, APRMV, në dispozicion në: <https://av.gov.mk/voveduvanje-vo-evidencija.aspx>

²⁶⁴ Pasqyrë e personave të papunë të regjistruar me aftësi të kufizuara sipas strukturës së moshës, APRMV, në dispozicion në: https://av.gov.mk/content/Statisticki%20podatoci/%D0%94%D0%B5%D0%BA%D0%B5%D0%BC%D0%B2%D1%80%D0%B8%202019/p2_invalidni%20lica_vozrast_122019.pdf

²⁶⁵ Terma si aftësi e kufizuar mendore janë terma të përdorura në raportet e Entit Shtetëror të Statistikave

²⁶⁶ Pasqyrë e personave të papunë të regjistruar me aftësi të kufizuara sipas llojit të aftësisë së kufizuar, APRMV, në dispozicion në: https://av.gov.mk/content/Statisticki%20podatoci/%D0%94%D0%B5%D0%BA%D0%B5%D0%BC%D0%B2%D1%80%D0%B8%202019/p1_invalidni%20lica_vid_122019.pdf

²⁶⁷ Publikimi: Mbrojtja sociale e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve në periudhën 2012 - 2018; Pasqyrimi statistikore; Enti Shtetëror i Statistikave; në dispozicion në: <http://www.stat.gov.mk/PublikaciPoOblast.aspx?id=22&rbrObl=3>

²⁶⁸ Publikimi: Mbrojtja sociale e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve, 2018; Pasqyrimi Statistikor 2.4.19.03, faqe 31-33, Enti Shtetëror i Statistikës, në dispozicion në: <http://www.stat.gov.mk/Publikaci/2.4.19.03.pdf>

²⁶⁹ Shih: Zh. Poposka, botim analitik: "Udhëto larg - çmizimi i çështjes së aftësisë së kufizuar në fushën e punësimit dhe marrëdhënieve të punës", 2018, Polio Plus. Në dispozicion në: <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/patuvaj-daleku-mk.pdf>

si punëdhënës. UNDP-ja në partneritet me OSHC-të dhe OPAK-të ndërmerr aktivitete për krijimin e modeleve për përfshirjen ekonomike të personave me aftësi të kufizuara, si dhe aktivitete për krijimin e një qendre për mbështetjen e rehabilitimit dhe punësimit të orientuar drejt punës. Këto qendra ofrojnë një sërë shërbimesh që synojnë mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara për përfshirje në tregun e punës. Si pjesë e Projektit Krijimi i Mundësive të Punës për të Gjithë – faza kryesore, UNDP në partneritet me SDC, MPPS dhe APRMV formuan dy pilot modele, njëri prej të cilëve është zhvilluar në partneritet me ndërmarrjen sociale në kuadër të OJQ-së “Izbor” nga Strumica, ndërsa pilot qendra e dytë është pjesë e Institutit Publik Social për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve në Shkup. Si pjesë e të njëjtit projekt, në fazën e zbatimit është edhe themelimi i një qendre të tretë të tillë për të ofruar shërbime për njerëzit nga rajoni i Pollogut. Në kuadër të qendrës në Strumicë, me mbështetjen e UNDP-së, është themeluar qendra trajnuese për përpunimin, tharjen dhe paketimin e produkteve bujqësore, e cila ofron trajnime për fitimin e shkathtësive dhe kualifikimeve për profesionet në bujqësi. Kjo qendër trajnime është e hapur për trajnimin e të gjithë personave, dhe jo vetëm të personave me aftësi të kufizuara.

UNDP brenda punës po përpaket të inkuorpojnë inkluzionin social dhe standardet e punës së denjë në strategjitë kombëtare të punësimit. Në partneritet me Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale, SDC dhe Agjencinë e Punësimit në kuadër të komponentit shërbime me bazë komunitare (CBS) në një periudhë gjashtëmujore deri në mars 2020, në 12 komuna (Manastir, Prilep, Ohër, Strugë, Shuto Orizarë, Kumanovë, Shtip, Koçan, Vinicë, Dellçevë, Berovë dhe Pehçevë) janë të punësuar 10 persona me aftësi të kufizuara, nga të cilët 4 gra (40%). Gjithashtu sipas informacionit të UNDP-së në vitin 2018, 147 persona të papunë me aftësi të kufizuara kanë marrë trajnime të përshtatura për sipërmarrje dhe menaxhim. Në vitin 2019, 43 persona me aftësi të kufizuara kanë aplikuar për grante për vetëpunësim, nga të cilët 31 kanë marrë certifikata për përfundimin me sukses të trajnimit; 19 prej tyre krijuan biznesin e tyre dhe punësuan 4 persona të tjerë.²⁷⁰

Me mbështetjen e tyre, 23 personave me aftësi të kufizuara iu është ofruar shërbim rehabilitimi në punë, 20 prej të cilëve janë persona me aftësi të kufizuara fizike nga institucioni publik Banja BANSKO në Strumicë, dhe 3 persona me aftësi të kufizuara intelektuale të përfshirë në jetë të organizuar me mbështetjen e organizatës mëmë “Poraka” (Mesazhi) nga Negotina.

Niveli i regjistrimit të të papunëve me aftësi të kufizuara është shumë i ulët krahasuar me personat pa aftësi të kufizuara. Sipas Ligjit për Regjistrim të Punësimit,

aplikantët duhet të paraqiten personalisht. Personat që jetojnë në institucione, shtëpi grupore dhe forma të tjera të organizuara të jetesës së mbështetur, si dhe të rriturit me aftësi të kufizuara që shkojnë në qendrat ditore, nuk janë të regjistruar në APRMV. Sipas APRMV-së, ekipet e tyre nuk mund të shkojnë në shtëpitë e personave me aftësi të kufizuara; ata mendojnë se kjo është punë e qendrave për punë sociale.²⁷¹ Në këtë kontekst, duhet të kihet parasysh gjithashtu se ambientet e APRMV-së janë në përgjithësi krejtësisht të paqasshme për personat me aftësi të kufizuara.

Një problem tjetër serioz për sigurimin e punësueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara është çështja e aftësisë së tyre juridike. Shumë nga personat që kanë lënë kujdesin institucional janë vlerësuar si “të paafte”. Shteti duhet të merret me kthimin sa më të shpejtë të aftësisë së tyre të punës dhe të bëjë një vlerësim të ri të këtyre personave të e-institucionalizuar.

Në nivel lokal, punësimi i personave me aftësi të kufizuara nuk është adresuar në programet strategjike komunale dhe as çështja e aftësisë së kufizuar nuk është pjesë e planeve zhvillimore ekonomike të komunave.

Perceptimi është një nga barrierat kryesore me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara. Pjesa më e madhe e publikut ka një qëndrim negativ ndaj këtyre personave dhe këto qëndrime mbështeten nga një mungesë e përgjithshme e të kuptuarit të aftësisë së kufizuar dhe të personave me aftësi të kufizuara në përgjithësi. Qeveria duhet të vlerësojë efektivitetin dhe ndikimin e strategjive dhe fushatave të saj që synojnë ndërgjegjësimin e publikut.

²⁷²

²⁷¹ K. Panajotova, E. Koçoska, Analizë: Ndhimë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara që largohen nga institucionet e përkujdesjes, 2020

²⁷² K. Panajotova, E. Koçoska, Analizë: Ndhimë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara që largohen nga institucionet e përkujdesjes, 2020

²⁷⁰ K. Panajotova, E. Koçoska, Analizë: Ndhimë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara që largohen nga institucionet e përkujdesjes, 2020

Aneksi 5: Përgjigjet e marra nga agjencitë e OKB-së dhe një pjesë e komunitetit ndërkombëtar

Pyetje	UNFPA	IOM	UNHCR	
A kanë agjencitë e OKB-së dhe organizatat ndërkombëtare takime koordinuese me organizata të tjera ndërkombëtare në të cilat aktivitetet dhe programet do të mbështeteshin pa patur mbivendosje të aktivitetëve të njëjta?	Jo, por meqenëse ka koordinim të rregullt me partnerët kombëtarë, informacionet për aktivitetet ekzistuese ose të planifikuara nga organizata të tjera ndërkombëtare merren nga partnerët kombëtarë.	Në kuadër të IOM-it mbahen takime të rregullta konsultative me të gjitha institucionet, organizatat joqeveritare dhe palët e interesuara në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të koordinuar të projekteve dhe shmanjes së mbivendosjeve të aktivitetëve në fushën në të cilën IOM-i po zbaton aktivitetet.	Po, takime dhe konsultime të tilla koordinuese zhvillohen me pjesëmarrje të gjerë, veçanërisht gjatë hartimit, monitorimit dhe përgatitjes së raporteve për programet që kanë të bëjnë me promovimin e të drejtave dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, mbahen konsultime dypalëshe me organizata të tjera ndërkombëtare, ambasada dhe partnerë ndërkombëtarë.	
Si i përcaktojnë agjencitë e OKB-së dhe organizatat e tjera ndërkombëtare aktivitetet që do të mbështesnin dhe të cilat nuk çojnë në shkelje të të drejtave të komunitetit të aftësisë së kufizuar dhe nenit 3 të KDPAK?	UNFPA udhëhiqet gjithmonë nga besimi se askush nuk duhet të lihet jashtë. Të gjitha aktivitetet e zbatuara nga zyra janë bazohen në nevojat e grupit të synuar dhe në parimet e barazisë, mosdiskriminimit, qasshmërisë (gjatë zhvillimit të trajnimeve, eventeve etj.) dhe të drejtave të barabarta.	Në kuadër të IOM-it kemi një zyrë rajonale me ekspertë tematikë dhe gjatë çdo planifikimi programor ajo shqyrton dhe miraton të gjitha projektet, aktivitetet dhe programet. Për më tepër, gjatë programimit IOM merr parasysh të gjitha ligjet, strategjitë dhe konventat kombëtare dhe ndërkombëtare në fuqi. Në të gjitha aktivitetet, trajnimet dhe punën me organizatat e personave me aftësi të kufizuara, IOM zbaton modelin e aftësisë së kufizuar për të drejtat e njeriut, në përputhje me parimet e KDPAK.	Para përcaktimit të aktivitetëve të programit dhe projektit, bëhet një analizë e situatës dhe nevojave, identifikohen arsyet e cënueshmërisë, mosrealizimit të të drejtave, stigmës dhe përjashtimit të kësaj kategorie personash.	
Në çfarë mënyre agjencitë e OKB-së dhe organizatat e tjera ndërkombëtare bëjnë vlerësime për të përcaktuar nëse aktivitetet e tyre janë në përputhje me KDPAK?	UNFPA organizon takime me përfaqësues të organizatave që përfaqësojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe me grupin e synuar, ku secili pjesëmarrës nxjerr në pah të gjitha çështjet më urgjente, prioritetet dhe të ngjashme.	Gjatë realizimit të ndonjë projekti apo aktiviteti programor, IOM kryen një proces konsultimi me institucionet në vend për të përafuar programet me prioritetet e vendit. Për sa i përket vlerësimeve nëse aktivitetet janë në përputhje me KDPAK, organizatat tona kanë caktuar dy persona kontakti ekskluzivisht për aftësinë e kufizuar, të cilët përveç që janë përgjegjës për përfshirjen e aftësisë së kufizuar si fushë tematike, kryejnë edhe konsultime, monitorim dhe vlerësim të të gjitha aktivitetëve aktuale në agjenci.	Ndërmjet mjeteve të ndryshme. Kryesisht përmes konsultimeve të drejtpërdrejta dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të personave me aftësi të kufizuara, duke ofruar kushte për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në krijimin e politikave, ligjeve dhe vendimeve, hulumtimeve dhe ndërgjegjësimit të publikut.	
A përgatisin agjencitë e OKB-së buxhetim të bazuar në aftësi të kufizuara?	Jo.	Në IOM nuk ka buxhet specifik të bazuar në aftësi të kufizuara, por ne kemi programe që mbështesin kategoritë e cënueshme të migrantëve që përfshijnë personat me aftësi të kufizuara si një nga kategoritë për të cilat janë planifikuar buxhetet për aktivitetet.	Nuk kam njohuri të mjaftueshme.	

USAID	UNDP	UNICEF
USAID-i merr pjesë në strukturat formale, por gjithashtu shpesh koordinon joformalisht me organizata të tjera ndërkombëtare aktive si donatorë në Maqedoni. Fatkeqësisht, nuk ka asnjë organ vendor/kombëtar apo grup pune për koordinimin e programeve në fushën e zbatimit të KDPAK, përveç përmendjes së pjesshme të përfshirjes së grupeve të cënueshme në punën e grupit punues sektorial për arsim, punësim dhe përfshirje sociale të koordinuara nga APRMV, dhe përmes të cilit donatorët e tjerë koordinojnë programet e tyre me ato të mbështetura nga BE-ja.	Po, takime të tilla koordinuese mbahen me pjesëmarrje të gjerë, veçanërisht gjatë përgatitjes dhe planifikimit, përgatitjes dhe planifikimit të programeve dhe aktiviteteve të projektit, përfundimit të partneritetit dhe, natyrisht, gjatë prezantimit të raporteve dhe rezultateve të aktiviteteve të realizuara.	Po, takime dhe konsultime të tilla koordinuese mbahen me pjesëmarrje të gjerë, veçanërisht kur përgatiten projekte, raporte të përbashkëta, kur monitorohen dhe vlerësohen programet që kanë të bëjnë me promovimin e të drejtave dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, takime të tilla mbahen kur ka konsultime dypalëshe me organizata ndërkombëtare, ambasada dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë.
USAID ka një politikë për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara (Politika e përfshirjes së aftësisë së kufizuar https://www.usaid.gov/inclusivedevelopment/disability-rights/disability dhe https://usaidearninglab.org/sites/default/files/resource/files/Additional_help_for_ads_201_inclusive_development_180726_final_r.pdf) që është e detyrueshme për organizatat që zbatojnë projekte të financuara nga USAID, dhe të cilat mund të kenë qëllime të ndryshme zhvillimore dhe mund të mos jenë të fokusuara te personat me aftësi të kufizuara. Projektet janë gjithashtu të detyruara të raportojnë se si i zbatojnë këto rregullore.	Çdo programi dhe aktiviteti të projektit të caktuar i paraprinë një analizë e situatës faktike në lidhje me çështjen e synuar, krahasohen të dhënat me analizat e mëparshme në nivel kombëtar, përcaktohen nevojat dhe, në bashkëpunim me përfaqësuesit e komunitetit të aftësisë së kufizuar, përcaktohen dhe konfirmohen prioritetet me synimin për të krijuar kushte për përfshirjen e tyre më të madhe në rrjedhat kryesore të shoqërisë.	Para se të përcaktohen aktivitetet e programit dhe projektit, bëhet një analizë e situatës dhe nevojave dhe identifikohen arsyet e cënueshmërisë, mosrealizimit të të drejtave, stigmës dhe përjashtimit të kësaj kategorie personash. Merren në konsideratë përvojat e mëparshme dhe aktivitetet e kryera, si mësimet e nxjerra dhe shembuj të praktikës së mirë. UNICEF ka gjithashtu një të ashtuquajtur pikë fokale, d.m.th., një person që ka njohuri të shkëlqyera për të gjitha aktet ligjore, aktet nënligjore dhe konventat për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit të aftësisë së kufizuar. Ky person është i detyruar të mësojë vazhdimisht në këtë fushë dhe të sigurohet që aktivitetet e realizuara të jenë në përputhje të plotë dhe të çojnë në përmirësimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
Një vlerësim i tillë në kuadër të hartimit/përgatitjes së një projekti apo strategjie të re shumëvjeçare, për fat të keq, nuk është i detyrueshëm kur planifikohen projekte apo strategji të reja.	Duke angazhuar ekspertë ndërkombëtarë që punojnë në promovimin, zbatimin dhe analizimin e politikave që mundësojnë përfshirje më të mirë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri (jetesë e pavarur, arsim, shërbime sociale, mbështetje për punësim, strehim, etj.). Nëpërmjet organizimit të takimeve konsultative me persona me aftësi të kufizuara dhe organizata që përfaqësojnë të drejtat e këtij grupi qytetarësh në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe shkëmbimin e përvojave, informacionit dhe njohurive në terren me EASPD (Shoqata Evropiane për Shërbimet ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara) si organizata ombrellë, duke përfshirë 15,000 organizata të personave me aftësi të kufizuara, ofruesit e shërbimeve dhe ekspertët që marrin pjesë në krijimin e politikave në nivel të BE-së që synojnë zbatimin e KDPAK-së së OKB-së.	Përveç personave të emëruar në organizatë për të siguruar që aktivitetet të jenë në përputhje me KDPAK, në vlerësim janë përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe përfaqësues të organizatave që merren me këto tema. Sipas nevojës, në vlerësim përfshihen edhe këshilltarët rajonalë për inkluzion.
Jo, por ka një program të veçantë me një buxhet vjetor prej disa milionë dollarësh për projekte të reja/të dedikuara ose përshtatje më të mirë të projekteve ekzistuese për t'i bërë të qasshme aktivitetet/shërbimet/produktet e tyre dhe për të përfshirë në aktivitetet e tyre personat me aftësi të kufizuara.	Po, në nivelin e aktiviteteve të programit dhe projektit që më së shpeshti kanë të bëjnë me aksesimin e arsyeshëm dhe qasshmërinë.	Programi dhe sistemi financiar i përdorur nga UNICEF përmban disa lloje të kodimit të aktiviteteve për të shënuar qëllimin e tyre. Pra, ekziston një kodim specifik i aktiviteteve për fëmijët me aftësi të kufizuara në mënyrë që të përcaktohen rezultatet e pritura si dhe fondet e ndara për këtë qëllim.

Pyetje	UNFPA	IOM	UNHCR	
Cilat mekanizma i përdorin agjencitë e OKB-së për të korrigjuar mbështetjen e tyre për aktivitetet që u përcaktuan se ishin në kundërshtim me dispozitat e KDPAK?	Nuk kemi pasur një situatë të tillë në UNFPA deri më tani.	Në IOM, çdo projekt ka monitorim të rregullt nga agjencia për zbatimin e projektit dhe një nivel të dytë nga zyra rajonale që ka ekspertë të ndryshëm tematikë, duke përfshirë aftësinë e kufizuar. Monitorimi i rregullt i kryer sipas kriterëve të përcaktuara paraprakisht dhe në përputhje me rregullat e organizatës mundëson korrigjim nëse lind nevoja.	Dialogu me shfrytëzuesit, ndryshimi i aktiviteteve dhe mundësia për rialokim të mjeteve.	
Sa është shuma e fondeve që agjencitë e OKB-së (çdo agjenci e OKB-së individualisht) kanë ndarë në 3 vitet e fundit për çështjen e aftësisë së kufizuar dhe në cilat fusha?	Fusha: shëndeti seksual dhe riprodhues (ShSR) dhe të drejtat dhe dhuna me bazë gjinore (Dh-BGj) Inovacionet, krijimi i një zgjidhjeje dixhitale për edukimin gjithëpërfshirës seksual të personave me çrregullime të spektrit të autizmit dhe personave me aftësi të kufizuara intelektuale (2019-2021) – 80,141 USD UNPRPD (2018-2020), trajnime, ofruesit e shërbimeve sensibilizuese, krijimi i materialeve informative – 100,000 USD,	Përafërsisht 300,000 Euro për përmirësimin e kushteve për kategoritë e cënueshme të migrantëve, qasjen dhe mbrojtjen e kategorive të cënueshme të migrantëve.	Mbështetja e OHCHR-së është kryesisht këshilluese dhe teknike, nëpërmjet ekspertizës dhe nga zyra kryesore e Gjenevës në të gjitha fushat. Mbështetja financiare vjetore është modeste dhe është afërsisht 4-5000 USD këtë vit.	

USAID	UNDP	UNICEF
	Konsultimet me përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara, monitorimi i aktiviteteve në fazën e zbatimit dhe shkëmbimi i përvojave dhe konsultimi me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut.	Dialogu me shfrytëzuesit, ndryshimi dhe përshtatja e aktiviteteve dhe fleksibiliteti në rialokimin e fondeve për aktivitetet në mbështetje të realizimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
Nuk ka pasur aktivitete të fokusuara konkretisht në çështjen e aftësisë së kufizuar në vitet e fundit në Maqedoni. Projekti i fundit i tillë ishte "Projekti për praktikën dhe punësimin e të rinjve me aftësi të kufizuara në sektorin e TIK", i cili u mbyll në mars 2018 dhe u zbatua nga Fondacioni iVote në partneritet me Shoqatën e studentëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara dhe Open the Windows/Hapni dritaret.	UNDP në 3 vitet e fundit, në lidhje me promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, mbështetjen e zbatimit të KD-PAK-së dhe nxitjen e proceseve inkluzive në shoqëri, ka realizuar investime në zbatimin e aktiviteteve të mëposhtme të programeve dhe projekteve: -Programi për vetëpunësimin e personave me aftësi të kufizuara -Programet për punë në komunitet (krijimi dhe zbatimi i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara – asistent personal dhe arsimor për nxënësit e shkollave të rregullta dhe të mesme, shërbime të kujdesit dhe ndihmës në shtëpitë e personave me aftësi të kufizuara dhe personave të moshuar dhe të pafuqishëm) -Krijimi i vendeve të punës dhe mundësive për të gjithë – Faza kryesore – Pilotimi i shërbimeve në rehabilitimin e orientuar drejt punësimit dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara përmes qendrave për rehabilitim profesional dhe mbështetje në punësim në Shkup dhe Strumicë. -Program mentorimi dhe mbështetjeje për zhvillimin dhe menaxhimin e bizneseve të krijuara nga personat me aftësi të kufizuara -Ofrimi i përgatitjes së specializuar profesionale për deinstitutionalizimin e të rriturve në I.S. Demir Kapi. -UNPRPD – Ndërtimi i një modeli lokal për deinstitutionalizimin -Ekonomia e kujdesit – Krijimi i shërbimeve të reja sociale për asistencë dhe kujdes në shtëpitë e personave me aftësi të kufizuara, sëmundjeve kronike dhe personave në nevojë për kujdes paliativ. -Pajisja e qendrës për zëvendësimin e kujdesit familjar në Demir Kapi -Krijimi i një qendre regjionale për aktivitete profesionale, trajnime dhe ofrim të shërbimeve për zëvendësimin e shërbimeve të kujdesit dhe ndihmës familjare në shtëpinë e personave me aftësi të kufizuara në rajonin e Pollogut në Gostivar. -Krijimi i sintezës së të folurit – zërit (audi-olexues) në gjuhën maqedonase dhe shqipe për personat e verbër, personat me disleksi, autizëm dhe për të gjithë personat që kanë vështirësi në marrjen e informacionit dhe njohurive në formë të shkruar.	Në periudhën 2018-2020 zyra e UNICEF-it ka shpenzuar 2,000,000 USD për aktivitete që lidhen me aftësinë e kufizuar.

Pyetje	UNFPA	IOM	UNHCR	
Në çfarë mënyre agjencitë e OKB-së sigurojnë përfaqësimin dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, duke marrë parasysh aspektet gjinore dhe të moshës?	Për çështjet që lidhen me ShSR dhe DhBGj dhe zbatimin e të gjitha aktiviteteve të ndërlidhura, UNFPA deri më tani ka angazhuar gjithmonë konsulentë nga komuniteti (persona me lloje të ndryshme të aftësisë së kufizuar).	Në IOM ekziston Rjeti i IOM-it për Përfshirjen e Aftësisë së Kufizuar për përmirësimin e përfaqësimit dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara. Në rrjet marrin pjesë si personat e kontaktit përgjegjës për përfshirjen e aftësisë së kufizuar në rrjedhat kryesore ashtu edhe punonjësit me aftësi të kufizuara të IOM-it të interesuar në zbatimin e aktiviteteve për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara. Nga pikëpamja e punësimit, IOM ka zero tolerancë për diskriminimin në bazë të moshës, gjinisë dhe aftësisë së kufizuar, gjë që e komunikon qartë në të gjitha shpalljet e punësimit. Gjithashtu, në IOM ekziston një rregullore për sigurimin e kushteve të përshtatshme individuale për punonjësit me aftësi të kufizuara, të cilat i përshtaten nevojave të tyre individuale	Bëhen përpjekje për të siguruar diversitet, por sigurisht që ndërmerret një mbulim dhe promovim i gjerë ose i thelluar dhe informacion mbi aktivitetet që në rrethana të caktuara synojnë një grup të caktuar të nënpërfaqësuar.	
Cilat janë programet aktuale apo të mëparshme të përbashkëta të agjencive të OKB-së në vend?	UNPRPD	Në kuadër të projekteve aktuale të IOM-it, në partneritet me UNFPA dhe UNHCR, zbatohet projekti për përmirësimin e të dhënave të migracionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe tema ndërsektoriale është aftësia e kufizuar.	Programi i përbashkët për mbështetjen e de-institucionalizimit 2018-2020 dhe programi i ri 2021-2022, i cili është në fazën fillestare.	
Cilat janë partneritetet e krijuara si rezultat i këtyre programeve, në kuadër të ekipit të OKB-së në vend, me qeverinë dhe partneritetet me organizatat e personave me aftësi të kufizuara dhe aktorë të tjerë?	- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive të OKB-së, duke vepruar si një trup. - Përmirësimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Qendrën për Mjekësi Familjare - Përmirësimi i bashkëpunimit dhe përfshirja më e madhe e të gjitha organizatave të (dhe për) personave me aftësi të kufizuara, përmes fazave dhe aktiviteteve të ndryshme (konsultime, trajnime, etj.)	Ekziston një grup për përfshirjen e aftësisë së kufizuar brenda OKB-së ku të gjitha agjencitë kryejnë koordinim të rregullt dhe IOM ka 2 persona kontakti që janë anëtarë të grupit. Gjithashtu, në zbatimin e të gjithë projektit të IOM-it, partnerët tanë afatgjatë janë ministrinë dhe institucionet kompetente në vend që punojnë në fushën e migracionit.	Ato janë partneritete në kuadër të ekipit të OKB-së, me Qeverinë dhe ministrinë kompetente, me Avokatin e Popullit, diskutime janë zhvilluar edhe me Komisionin për Parandalimin e Diskriminimit, organizatat e personave me aftësi të kufizuara, organizatat e shumta të shoqërisë civile dhe komunitetin akademik.	

USAID	UNDP	UNICEF
	UNDP po bën përpjekje që informacioni të jetë i qasshëm dhe i shpërndarë për të gjitha grupet e personave me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga gjinia, mosha apo lloji dhe niveli i aftësisë së kufizuar. Gjatë realizimit të shumicës së aktiviteteve, UNDP angazhon drejtpërdrejt organizatat e personave me aftësi të kufizuara dhe angazhon konsulentë me aftësi të kufizuara, të cilët, në përputhje me ekspertizën dhe përvojën e tyre, kontribuojnë në realizimin e detyrave të projektit.	Përfshirja e vullnetarëve me aftësi të kufizuara përmes programit vullnetar të OKB-së dhe motivimi dhe dhënia e përparësisë personave me aftësi të kufizuara gjatë rekrutimit. Puna me organizatat që punësojnë persona me aftësi të kufizuara, identifikimi i synuar i personave me aftësi të kufizuara dhe përfshirja e tyre në aktivitetet e projektit. Ka një përpjekje të vazhdueshme për të siguruar diversitet, por sigurisht që ka një mbulim dhe promovim të gjerë apo të thelluar duke informuar për aktivitetet që në rrethana të caktuara synojnë një grup të caktuar të nënpërfaqësuar.
Nuk e di	UNPRPD	• UNICEF ka realizuar një projekt rajonal "Mbrotja e Fëmijëve nga Dhuna dhe Promovimi i Përfshirjes Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi", me mbështetjen e BE-së dhe në bashkëpunim me Forumin Evropian të Aftësisë së Kufizuar, në periudhën 2016-2018. . • Projekti i përbashkët i OKB-së "Puna nga poshtë lart – Krijimi i një modeli lokal deinstitutionalizimi" 2018-2020. • Projekti i përbashkët i OKB-së, faza fillestare "Ndërtimi i një shoqërie të larmishme – Barazia dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara përmes reformës sistemore" – në vazhdim 2021.
	Partneritetet në kuadër të ekipit të OKB-së, Qeverisë së RMV-së, MPPS-së, MASH-it, MSH-së, BNJVL-së, MVL-së, APRMV-së, 30 partneritete të QPS-ve me mbi 50 komuna, Organizatat e personave me aftësi të kufizuara, OJQ etj.	• Janë krijuar partneritete në kuadër të ekipit të OKB-së me Qeverinë dhe ministrinë kompetente, me Avokatin e Popullit, po ashtu janë diskutuar me Komisionin për Parandalimin e Diskriminimit, organizatat e personave me aftësi të kufizuara, organizata të shumta të shoqërisë civile dhe komunitetin akademik. • Aktivitetet e ndërmarra në kuadër të projektit rajonal të UNICEF-it kishin për qëllim zgjidhjen e fragmentimit të qenësishëm në lëvizjen e aftësisë së kufizuar dhe njohurive të pamjaftueshme mbi KDPK-në dhe të drejtat që rrjedhin prej saj, që përfshin monitorimin e zbatimit të saj. Aktivitetet u fokusuan në përmirësimin e të kuptuarit të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut ndaj aftësisë së kufizuar me organizatat e personave me aftësi të kufizuara (OPAK) dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet OPAK-ve.

Pyetje	UNFPA	IOM	UNHCR	
A ka ndonjë program të përbashkët ndërmjet agjencive të OKB-së dhe donatorëve të tjerë ndërkombëtarë për mbështetjen e reformës legjislative, për zhvillimin e politikave ose programe të tjera përkatëse kombëtare të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara?	Jo	IOM, në një program të përbashkët në partneritet me UNFPA dhe UNHCR po përgatit një politikë për migracionin, e cila është një nga dokumentet strategjike më të rëndësishme në lidhje me migracionin. Gjithashtu, programi i përbashkët përmban një komponent që trajton çështjen e aftësisë së kufizuar nga pikëpamja e përmirësimit të të dhënave të migracionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.	Nuk mendoj se ka programe të përbashkëta në kuptimin formal, por ka financim të programeve nga partnerët dypalësh, si dhe koordinim të aktiviteteve në këtë drejtim.	
A ka çdo agjenci e OKB-së një sistem të vendosur për ngritjen e kapaciteteve sistem-atike të punonjësve në lidhje me KDPK? Nëse po, sa shpesh zbatohet?	Jo	Në kuadër të zhvillimit profesional të punonjësve të IOM-it realizohen trajnime për forma të ndryshme të aftësisë së kufizuar. Në vitin 2020 u realizua një trajnim për përfshirjen e aftësisë së kufizuar në programimin e organizatës së ekipit të programit të IOM-it, ndërsaq në vitin 2021 u realizua një trajnim për punonjësit që punojnë në terren për përfshirjen e aftësisë së kufizuar në ofrimin e shërbimeve mbrojtëse. Gjithashtu, në kuadër të platformave tona të mësimi dixhital ka një trajnim të certifikuar për Akomodimin e Punonjësve me Aftësi të Kufizuara, si dhe webinarë të ndryshëm që mbulojnë aspekte të ndryshme të aftësisë së kufizuar, të cilët janë në dispozicion të punonjësve që zbatojnë projekte në fusha të ndryshme.	Ekipi i OKB-së (18 agjenci që operojnë në vend) ka përgatitur një plan veprimi për përmirësimin e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në përputhje me Strategjinë e miratuar globalisht, e cila përmban shumë segmente interesi, duke përfshirë ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të punonjësve të agjencisë së OKB-së, nëpërmjet trajnimeve online, trajnimeve fill-estare dhe të avancuara, punëtorive, burimeve, shpërndarjes së materialeve të trajnimit dhe shkëmbimit të përvojave.	
A përfshin menaxhmenti i agjencive të OKB-së në vend personat me aftësi të kufizuara dhe në cilin pozicion pune?	Në UNFPA, jo.	Në zyrën e IOM-it në Shkup nuk ka asnjë person me aftësi të kufizuara në kuadër të menaxhmentit, por ekipi i programit ka një punonjës me aftësi të kufizuar që punon si asistent i projektit.	Jo, akoma jo.	
Sipas jush, çfarë është organizata përfaqësuese e personave me aftësi të kufizuara?	Një organizatë që ka anëtarë dhe/ose drejtohet nga persona me aftësi të kufizuar (të llojeve të ndryshme), ku fjalën e fundit e kanë vetë personat, ku mund të adresohen qartë nevojat e personave, thjesht një organizatë që ofron përfshirje të plotë të personave. .	Një organizatë përfaqësuese e personave me aftësi të kufizuara është një organizatë e krijuar me një minimum prej 51% të personave me aftësi të kufizuara dhe struktura drejtuese përfshin persona me aftësi të kufizuar ose përfaqësues të tyre.	Një organizatë ku më shumë se gjysma e anëtarëve dhe punonjësve janë persona me aftësi të kufizuara.	

USAID	UNDP	UNICEF
		Në koordinim me agjencitë e tjera të OKB-së dhe BE-në, UNICEF-i mori pjesë në hartimin e Strategjisë për Deinstitutionalizimin 2018-2027 "Tim-janik" dhe planin shoqëruar të veprimit. UNICEF ishte pjesë e grupeve të punës, diskutimeve dhe debateve dhe organizoi konferenca. U përgatit një analizë e situatës, u identifikuan sfidat dhe kjo u transferua në tekstin përfundimtar të Strategjisë. Në fund të vitit 2019 nuk kishte më asnjë fëmijë në institucione, përfshirë fëmijë me aftësi të kufizuara. Procesi i deinstitutionalizimit është një proces i vazhdueshëm dhe UNICEF-i vazhdon ta mbështesë atë. • UNICEF-i po zbaton një projekt dyvjeçar të financuar nga BE-ja "Just(ice) Children" (Fëmijët e Drejtësisë) – BE-ja për drejtësinë për të miturit dhe fëmijët", 2020-2022. Vëmendje e veçantë në zbatim i kushtohet bërjes së sistemit të drejtësisë me inkluziv dhe të përshatatur me nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Aktivitetet do të synojnë gjithashtu që legjislacioni dhe praktikat të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, duke garantuar qasje të drejtë në drejtësi për fëmijët me aftësi të kufizuara.
Aktualisht, në platformën online të zhvillimit profesional për punonjësit, e titulluar Universiteti i USAID-it, janë në dispozicion dy programe trajnimi për të gjithë punonjësit e USAID-it, të cilat janë të fokusuara në përfshirjen më të madhe të personave me aftësi të kufizuara në të gjithë projektin e USAID-it, por nuk janë të detyrueshme. Trajnime të tilla shitesë dhe më të thelluara ekzistojnë në sektorin e arsimit, i cili harton dhe mbikëqyr programet e zhvillimit në të gjithë botën, të dedikuara për përmirësimin e sistemeve arsimore të vendeve në zhvillim.	Po. Që nga viti 2019 në UNDP, në përputhje me Strategjinë e OKB-së për përmirësimin e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara, kemi filluar sensibilizimin, trajnimin dhe planifikimin në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të punonjësve dhe partnerëve me të cilët realizojmë aktivitetet e projektit.	Ekipi i UNICEF-it ka mundësinë e ndjekjes së trajnimeve online përmes platformës së dedikuar Agora, si dhe webinarëve dhe diskutimeve tematike për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve. Ndër të tjera, ekziston një plan zhvillimi profesional në UNICEF, sipas të cilit çdo punonjës duhet të ofrojë një fushë në të cilën mund të transferojë njohuri të kolegët e tij ose të persona të tjerë jashtë organizatës. Një shembull i kësaj është sesioni i organizuar nga UNICEF për akomodimin e arsyeshëm dhe përdorimin e teknologjisë ndihmëse në arsim. Ky sesion u organizua në kuadër të grupeve punuese të OKB-së dhe morën pjesë përfaqësues të agjencive të OKB-së dhe përfaqësues nga ministrinë me qëllim të ngritjes dhe përmirësimit të vazhdueshëm të të kuptuarit të KDPAK-së dhe nevojave dhe mënyrës së komunikimit të personave me aftësi të kufizuara.
Në Maqedoni jo, por selia e USAID-it në Uashington ka një Koordinator të Agjencisë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe Specialist të Arsimit Inkluziv të Aftësisë së Kufizuar në Byronë për Zhvillim, Demokraci dhe Inovacion / Qendrën për Arsim (DDI/EDU).	Jo, akoma jo.	Përfaqësuesja e zyrës së UNICEF-it ka humbur plotësisht dëgjimin në njërën vesh.
Një organizatë e përbërë nga, dhe që përfaqëson dhe mbron të drejtat e personave me aftësi të kufizuara mbi baza të ndryshme.	Një organizatë në të cilën personat me aftësi të kufizuara marrin pjesë drejtpërdrejt në krijimin e politikave, marrjen e vendimeve dhe zbatimin e aktiviteteve që lidhen me promovimin e të drejtave të tyre, etj.	Sipas Ligjit për shoqata dhe fondacione, 97% e personave të përfshirë në organizatë duhet të jenë me aftësi të kufizuara dhe mbi 70% e personave në bordin drejtues duhet të kenë aftësi të kufizuara.

Pyetje	UNFPA	IOM	UNHCR
Sipas jush, cilat do të jenë sfidat prioritare në 3 vitet e ardhshme?	Aktivitetet dhe fushat e propozuara të punës: 1. Krijimi i një regjistri të personave me aftësi të kufizuara dhe krijimi i një aplikacioni softuerik për të integruar sistemin shëndetësor, social dhe arsimor (nëse janë fëmijë dhe të rinj). Kjo pjesë do të kërkojë rishikimin e formularit ekzistues të aplikimit në Institutin e Shëndetit Publik. 2. Krijimi i një regjistri për dhunën, sërisht në bashkëpunim me UNICEF-in dhe OBSH-në, dhe vënia në funksion e raportimit për fëmijët dhe të rriturit përmes një qasjeje shumësektoriale. 3. Vazhdimi dhe thellimi i trajnimeve ekzistuese për ngritjen e kapaciteteve të të gjithë aktorëve nëpërmjet përpunimit të detajuar të neneve 16 dhe 12 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Këto trajnime duhet të përfshijnë personelin e kujdesit shëndetësor, shërbimet sociale, vetëqeverisjen lokale, vetë komunitetin (me mundësinë e përfshirjes së institucioneve arsimore ku inkluzioni është i pranishëm), policinë, organizatat e qytetarëve, strehimoret (në trajnime për DhBGj), mësuesit dhe asistentët personalë, prokuroria publike, gjyqtarët dhe FSSHM. - Të punohet në rajone ku dimë se ka persona me aftësi të kufizuara, ku ndodhen shtëpitë etj. - Trajnim për DhBGj duhet të vazhdojë me qasjen ndërsektoriale dhe duhet të përfshijë detyrimisht policinë (edhe me trajnime bazë për DhBGj dhe trajnime bazë për punën me personat me aftësi të kufizuara). - Të merret në konsideratë zgjerimi i temës së trajnimeve duke përfshirë mbështetjen e shëndetit mendor. Në situatën e KOVID 19 një nga temat dhe mbështetja më e neglizhuar që kërkuar vetë personat dhe ndihmësit e tyre ishte pikërisht kjo pjesë (kush dhe ku mund ta japë këtë lloj mbështetjeje dhe a mund të jepet ajo në vazhdimësi). - Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve për mosdiskriminim. Të ketë mundësi për të zhvilluar Ligjin e ri për mosdiskriminimin dhe kompetencat e Komisionit. 4. Organizimi i trajnimeve për personat dhe shoqatat e qytetarëve për personat me aftësi të kufizuara. Këto trajnime kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin e vetë personave për tema që lidhen me komponentët shëndetësorë, dhunën, diskriminimin, të drejtat, konventat etj. 5. Vendosja në rend dite e çështjes së dhunës institucionale. Mundësia për të kryer një hulumtim, veçanërisht me institutet e destinuara për personat me aftësi të kufizuara. 6. Vendosja në rend dite e çështjes së krijimit të familjes, birësimi të fëmijëve etj., dhe ndryshimeve ligjore që rrjedhin prej tyre. 7. Rishikimi i rregullores ekzistuese të sistemit shëndetësor, standardeve (në krahasim me vendet e tjera), paketës së shërbimeve të marra nga personat me aftësi të kufizuar etj., me qëllim identifikimin e mundësive për përshtatjen e tyre me nevojat e vetë personave dhe në drejtimin e reduktimit të të gjitha llojeve të barrierave.	Në kuadër të mandatit tonë sfidë prioritare do të ishte njohja e migrantëve me aftësi të kufizuara si dyfish të cënueshëm dhe ofrimi i mbështetjes së duhur brenda sistemit në përputhje me Politikën e re të Migracionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe KDKPAK.	• Avansimi i qasshmërisë dhe disponueshmërisë së të drejtave (shëndetësia, kushtet sociale, arsimi, punësimi). Mosdiskriminimi dhe dukshmëria e personave me aftësi të kufizuara. • Qasja deri në drejtësi.

USAID	UNDP	UNICEF
Vendosja e qartë dhe e padiskutueshme e çështjes së aftësisë së kufizuar si çështje e (mos)respektimit të të drejtave themelore të njeriut në axhendën e partive politike; qartësimi ligjor i statusit dhe forcimi i kapaciteteve të organizatave të personave me aftësi të kufizuara për të lobuar/avokuar në mënyrë më efektive për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; kryerja e fushatave mediatike për (mos)qasshmërinë e hapësirave publike si një pengesë themelore për rritjen e pavarësisë dhe lëvizjes së lirë të personave me aftësi të kufizuara.	Qasshmëria dhe disponueshmëria ndaj të drejtave dhe shërbimeve në baza të barabarta me të gjithë qytetarët e tjerë. Qasje në drejtësi. Avokimi dhe vetë-avokimi.	• Zbatimi i Ligjit për Arsimin Fillor në lidhje me shndërrimin e shkollave speciale në shkolla fillore me qendër burimore. Forcimi i kapaciteteve të tyre për të mbështetur shkollat e rregullta në ofrimin e mjediseve plotësisht inkluzive për të mësuar, duke filluar nga qasja, pjesëmarrja aktive dhe arritjet. • Vënia në funksionim e nëntë qendrave rajonale të vlerësimit dhe ofrimit të rregullt të shërbimit, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve të tyre, si dhe ndërgjegjësimin e institucioneve që ofrojnë shërbimin, për nevojën e vlerësimit funksional dhe mënyrën se si kërkohet dhe si zbatohet i njëjti. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme të finalizohet procedura për ndryshimin e rregullores për të përfshirë vlerësimin funksional. Informim më i mirë i prindërve për mënyrën se si ata mund të kërkojnë dhe marrin shërbimin, si bëhet vlerësimi dhe cili është roli i tij. • Identifikimi dhe zhvillimi i shërbimeve shpesh për mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në fushën e kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjes sociale dhe arsimit. Mbyllja graduale e shtëpive grupore të vogla për fëmijët me aftësi të kufizuara, paralelisht me zhvillimin e mbështetjes për familjet dhe strehimin e specializuar. Sigurimi i qasjes së plotë në infrastrukturë në të gjitha nivelet.

Aneksi 6. Boshllëqe kritike, konkluzione dhe rekomandime

Boshllëku kritik 1 – Analiza e palëve të interesit dhe koordinimi

Konkluzione për boshllëqet:

- Qeveria ka krijuar kornizën më të gjerë tre-nivelëshe për zbatimin e KDPAK (TKK për zbatimin e KDPAK) brenda Qeverisë, pika qendrore e kontaktit caktohet në kuadër të Qeverisë dhe organi Monitorues i themeluar në vitin 2020 në kuadër të Avokatit të Popullit. Pavarësisht nga kjo përpjekje, kjo infrastrukturë e krijuar nuk është në përputhje me KDPAK
- Nuk ka pjesëmarrje efektive të OPAK-ve të ndryshme në procesin e krijimit të politikave.
- Ndërgjegjësimi i ulët i personave me aftësi të kufizuara për KDPAK dhe kornizë institucionale dhe kapacitete të dobëta organizative dhe financiare të OPAK-ve

Gjërat që duhet të ndryshojnë/ndodhin:

- Në përputhje me nenet 4 (detyrimet e përgjithshme), 31 (të dhënat) dhe 33 (monitorimi dhe zbatimi kombëtar) i KDPAK-së së OKB-së, dhe për të shmangur politikat kontradiktore që do të minonin efektivitetin e shpenzimeve dhe do të rrisnin komplementaritetin dhe sinergjitë e politikave dhe shpenzimeve publike, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe TKK për KDPAK-në në konsultim dhe pjesëmarrje të OPAK-ve duhet të sigurojnë koordinim efektiv ndërmjet ministrave të saj. Është e nevojshme të forcohet koordinimi nëpërmjet:
 - (Ri)emërimit të pikave të kontaktit të aftësisë së kufizuar në të gjitha ministritë, agjencitë publike dhe autoritetet lokale deri në vitin 2022
 - Zhvillimit të një mekanizmi efektiv kombëtar koordinues deri në vitin 2022.
 - Sigurimit të disponueshmërisë dhe qasjes në të dhënat cilësore në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes deri në vitin 2023
 - Sigurimit të shpenzimeve dhe shpenzimeve buxhetore të përshtatshme në lidhje me aftësinë e kufizuar në dokumentet buxhetore deri në vitin 2023
- Mbështetja e krijimit të një platforme joformale të aftësisë së kufizuar për të gjithë aktorët përkatës. Agjencitë e OKB-së do të iniciojnë dhe koordinojnë platformën përmes takimeve të rregullta koordinuese. Platforma do të punojë për bashkimin e zërit të organizatave të aftësisë së kufizuar në nivel kombëtar, përmes ngritjes së kapaciteteve dhe nismave të përbashkëta avokuese
- Mbështetja e zhvillimit të kapaciteteve të drejtuesve të OPAK-ve në çështjet e qeverisjes korporative, dispozitat dhe iniciativat e KDPAK-së për përfshirjen e fëmijëve, grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera të nënpërfaqësuar të PAK
- Mbështetja e avokimit për angazhimin e OPAK-ve në platformat SZHQ, KDPAK si dhe ndërmarrjen e masave për rritjen e kapaciteteve të OPAK-ve për avokim, ndikim, rrjetëzim dhe bashkëpunim, KDPAK të OKB-së, dhe infrastrukturë institucionale në vend
- Mbështetja efektive e përgatitjes dhe prezantimit të raportit hije të OPAK-ve dhe OSHC-ve të tjera përkatëse përpara Komitetit të OKB-së (2023 -2024)
- Mbështetja e përgatitjes së materialit të shkruar, në format të qasshëm, të fokusuar në të drejta të ndryshme të ofruara nga KDPAK (e drejta për arsim, punë dhe punësim, njohje e barabartë para ligjit, barazi dhe mosdiskriminim, qasje, jetesë e pavarur dhe përfshirje në komunitet)

Boshllëku kritik 2 – Barazia dhe mosdiskriminimi

Konkluzione:

- Kushtetuta dhe korniza ligjore ekzistuese që rregullon të drejtat e njeriut është mjaft e ngurtë, kufizuese dhe diskriminuese, siç perceptohet nga prizmi i KDPAK-së së OKB-së
- Integrimi i mëtejshëm i KDPAK-së së OKB-së brenda kornizës legislative kombëtare është një prioritet, siç është përafrimi thelbësor i ligjeve të ndryshme me qasjen e të drejtave të njeriut ndaj aftësisë së kufizuar
- Promovimi i dobët i KDPAK-së së OKB-së në vend. Qendrat e pushtetit, si dhe publiku i gjerë, përfshirë komunitetin e PAK nuk janë të njohur me dispozitat dhe detyrimet që dalin nga KDPAK
- Akomodimi i arsyeshëm ende nuk kuptohet si pjesë e barazisë.
- Bartësit e detyrave kanë nevojë për ngritjen e kapaciteteve për të kuptuar aftësinë e kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor dhe, rrjedhimisht, një çështje e të drejtave dhe barazisë.
- Të gjithë personat me aftësi të kufizuara përballen me sfida në lidhje me qasjen në drejtësi dhe kapacitetin e gjyqtarëve që të marrin në konsideratë KDPAK
- Kapaciteti ligjor është ende një pikë kritike në procesin e krijimit të një mjedisi për jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara janë ende të privuar nga aftësia ligjore/juridike.

Rekomandime:

- TKK për KDPAK dhe Ministria e Drejtësisë me pjesëmarrjen dhe konsultimin me OPAK duhet të mbështeten financiarisht dhe teknikisht për të hartuar një ligj të ri për të drejtat dhe dinjitetin e personave me aftësi të kufizuara (lex specialis) deri në vitin 2025
- TKK për zbatimin e KDPAK me pjesëmarrjen dhe konsultimin me OPAK në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe MPPS duhet të mbështetet financiarisht dhe teknikisht për të zhvilluar një strategji kombëtare për aftësinë e kufizuar bazuar në dispozitën e KDPAK, prej 3 deri në 5 vjet, me plan veprimi dhe kostoje mbi zbatimin me tregues të qartë, bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse të boshllëqeve. Strategjia kombëtare e aftësisë së kufizuar do të kontribuojë si në koordinimin e përgjithshëm kombëtar ashtu edhe në vendosjen e bazës së buxhetimit të bazuar në rezultate në baza vjetore deri në vitin 2023
- OKB-ja duhet të mbështesë dhe të bashkërendojë ngritjen e kapaciteteve të TKK-së për KDPAK, Trupit Monitorues të KDPAK-së dhe KPMD-së për KDPAK-në dhe zbatimin e saj
- Hartimi i një plani për ndërgjegjësimin e personave me aftësi të kufizuara për promovimin e mekanizmave ekzistues të mbrojtjes, veçanërisht të personave me aftësi të kufizuara që jetojnë jashtë kryeqytetit, në mjedise rurale
- Organi Monitorues i KDPAK dhe KPMD me OPAK-të duhet të zhvillojë udhëzime të përgjithshme në formate të qasshme në lidhje me konceptin e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përfshirë akomodimin e arsyeshëm sipas KDPAK deri në vitin 2020
- Trupi Monitorues për KDPAK dhe KPMD duhet të mbështetet për të siguruar që deri në vitin 2022 të mbulojë:
 - ⦿ Përfshirjen në ekipet e tyre edhe personat me aftësi të kufizuara
 - ⦿ Trajnime për stafin mbi aftësinë e kufizuar, barazinë dhe KDPAK
 - ⦿ Zhvillimin dhe ofrimin e akomodimit të arsyeshëm dhe mbështetjes së mëtejshme specifike për shfytëzuesit me aftësi të kufizuara në varësi të shërbimeve të entitetit
 - ⦿ Hartimin e planit për ndërgjegjësimin e personave me aftësi të kufizuara për mekanizmat ekzistues të mbrojtjes, veçanërisht të personave me aftësi të kufizuara që jetojnë jashtë kryeqytetit, në mjedise rurale.
- Qeveria dhe TKK për KDPAK duhet të mbështeten në nisjen dhe ndërmarrjen e Fushatës për 10 vitet e KDPAK-së 2022-2025
- OPAK të ndryshme duhet të mbështeten për rritjen e ndërgjegjësimit dhe realizimin e kampanjës për promovimin e KDPAK-së dhe rëndësinë e saj në nivel kombëtar dhe lokal 2022 – 2024
- Realizimin e fushatave të synuara për të portretizuar personat me aftësi të kufizuara në një mënyrë që është në përputhje me qëllimin e KDPAK-së dhe për të ndryshuar pozicionet e dëmshme në lidhje me personat me aftësi të kufizuara, si ato që në mënyrë joreale i portretizojnë ata si të rrezikshëm për veten dhe për të tjerët ose si njerëz që vuajnë dhe janë të varur nga institucionet e kujdesit pa autonomi, një barrë joproduktive politike, ekonomike dhe sociale e shoqërisë

- Qeveria, TKK për KDPAK në koordinim me OPAK duhet të mbështeten në nisjen dhe realizimin e një fushate të synuar me aktorë të ndryshëm në fusha të ndryshme, siç janë punësimi, arsimi, pjesëmarrja etj.
- Trupi Monitorues i KDPAK-së dhe KPMD-së në bashkëpunim me TKK-në për KDPAK dhe me bashkëpunim me MPPS-së e me pjesëmarrje të OPAK-ve të ndryshme duhet të mbështetet në procesin e zhvillimit të procedurave standarde të funksionimit për zbatimin e akomodimit të arsyeshëm në nivele të ndryshme
- Trupi Monitorues i KDPAK-së dhe KPMD-së me OPAK-të duhet të zhvillojë udhëzime të përgjithshme në formate të qasshme në lidhje me konceptin e barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përfshirë akomodimin e arsyeshëm sipas KDPAK deri në vitin 2022
- Qeveria me TKK-në për KDPAK, Organin Monitorues dhe KPMD-në me OPAK-të duhet të përcaktojnë detyrimet dhe mekanizmat përkatës të zbatimit të ministrive, agjencive publike, gjykatave, autoriteteve lokale dhe OSHC-ve për të ofruar akomodim të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara deri në vitin 2023
- Sigurimi i rritjes sistematike dhe progresive të shpërndarjes së burimeve për të gjitha ministrinë, agjencitë publike, gjykatat, prokurorët publikë, OSHC-të dhe autoritetet lokale deri në vitin 2023 për të mbuluar:
 - Aftësinë e kufizuar, barazinë dhe trajnimin e stafit për KDPAK për çdo vit
 - Vendosjen e kushteve të qasshmërisë për të gjitha investimet e reja
 - Zbatimin gradual të kushteve të qasshmërisë për të gjitha shërbimet dhe objektet ekzistuese
 - Zhvillimin dhe ofrimin e akomodimit të arsyeshëm dhe mbështetjen e mëtijshme specifike për shfrytëzuesit me aftësi të kufizuara në varësi të shërbimeve të entitetit.
- Ngritja e kapaciteteve të IPPG për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe avokimi i IPPG për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për t'u bërë komision formal brenda Kuvendit deri në vitin 2024
- Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë për të drejtat e PAK në bazë të KDPAK. Përfshirja dhe integrimi i aftësisë së kufizuar duhet të mundësohet përmes trajnimeve të detyrueshme në programin e punës së Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë në 2023 - 2024
- Ngritja e kapaciteteve të ofruesve të ndihmës juridike falas të institucioneve dhe organizatave për komunikim me personat me aftësi të kufizuara nga viti 2022 - 2024
- Gjykata dhe prokurorët publikë duhet të mbështeten në krijimin e provave të duhura dhe regjistrimin e rasteve për shkak të aftësisë së kufizuar, si dhe për shkeljen e të drejtave të PAK nga gjykatat
- OKB-ja duhet të mbështesë financiarisht dhe teknikisht hapjen e një debati duke marrë parasysh kapacitetin ligjor në vend në 2022 në koordinim me institucionet përkatëse (MPPS, MD) dhe platformën e OPAK-ve dhe OSHC-ve
- TKK për zbatimin e KDPAK me pjesëmarrjen dhe konsultimin me personat me aftësi të kufizuara dhe OPAK dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, MPPS, Akademinë e Gjyqtarëve dhe Trupin Monitorues të KDPAK dhe KPMD duhet të mbështetet për të vëzhguar vendet ku sistemi për vendimmarrje mbështetëse është vënë në praktikë 2022 - 2024
- Mbështetja e kryerjes së një analize mbi sistemet e mbështetura të vendimmarrjes, kuptimin dhe zbatimin përkatës
- MPPS në bashkëpunim dhe pjesëmarrje të OPAK-ve, palëve të interesuara nga Gjykata, MD duhet të zhvillojë mekanizma për të rikthyer kapacitetin ligjor të personave me aftësi të kufizuara, të vendosur në shtëpi grupore, institucione dhe në komunitet
- TKK për zbatimin e KDPAK me pjesëmarrjen dhe konsultimin me personat me aftësi të kufizuara dhe OPAK në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, MPPS duhet të mbështetet në procesin e shfuqizimit të të gjitha dispozitave diskriminuese që lejojnë heqjen e aftësisë juridike bazuar në dëmtim dhe zëvendësimin e tyre me mekanizma të vendimmarrjes së mbështetur që respektojnë autonominë, vullnetin dhe preferencat e personit në fjalë, si dhe kryejnë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët publikë për të drejtën për njohje të barabartë para ligjit të personave me aftësi të kufizuara dhe marrëveshjet e mbështetura për vendimmarrje

Boshllëku kritik 3 – Qasshmëria

Konkluzione:

- Shumica e bartësve të detyrave nuk janë fizikisht të qasshëm dhe as ndërtesat e tyre të reja nuk janë duke u ndërtuar për të qenë të qasshme. Agjencitë publike nuk janë të njohura me KDPAK dhe qasshmërine
- Standardet universale nuk njihen brenda legjislacionit, dhe barazia dhe mosdiskriminimi dhe qasshmëria nuk janë pjesë e aktit të prokurimit
- Gjuha e shenjave nuk njihet si gjuhë dhe ka një numër të vogël përkthyesish të gjuhës së shenjave. Alfabeti Braj nuk është i rregulluar brenda sistemit

Rekomandime:

- Të mbështetet Qeveria dhe OPAK-të, brenda administratës publike në nivel kombëtar dhe vendor për të krijuar një model të mekanizmit monitorues ndërtëknik të zyrtarëve publikë dhe OPAK-ve, deri në vitin 2025, që të:
 - Zhvillojë materiale trajnimi dhe udhëzime për agjencitë publike dhe shërbimet;
 - Organizojë trajnime të agjencive dhe shërbimeve publike dhe autoriteteve lokale;
 - Realizojë auditime mbi qasshmërisë dhe qasjen jodiskriminuese në të gjitha nivelet në të gjithë sektorët;
 - Vëzhgojë respektimin e kërkesave për qasje dhe mosdiskriminim në prokurimet publike;
 - Vlerësojë dhe raportoj mbi progresin vjetor në nivel kombëtar dhe lokal
- OPAK-të, TKK për KDPAK-në dhe Ministria e Financave, Zyra e Prokurimit Publik, duhet të mbështeten në avokimin për përfshirjen e kërkesave të qasshmërisë dhe mosdiskriminimit në rregulloret e prokurimit publik, si dhe mbështetjen për përfshirjen e OPAK-ve në komisionet e prokurimit publik në lidhje me infrastrukturën (mjedisin e ndërtuar, transportin dhe TIK-un) dhe shërbimet për të cilat qasshmëria është kritike, si dhe në lidhje me shërbimet në nivel kombëtar dhe lokal nga 2023 -2025
- OPAK-të, TKK për KDPAK dhe Ministria e Transportit dhe organet rregullatore dhe aktorët e tjerë përkatës duhet të mbështeten në avokimin për përcaktimin dhe zbatimin e standardeve universale si standard për të gjithë nga 2022-2023
- Mbështetja e zhvillimit të kapaciteteve të përbashkëta teknike dhe operacionale të organeve rregullatore dhe aktorëve të tjerë përkatës që lidhen me prokurimin, ndërtesat, banesat dhe hotelet dhe restorantet në nivel kombëtar dhe lokal duke marrë parasysh zbatimin dhe të kuptuarit e qasshmërisë sipas dispozitave të KDPAK
- Është e nevojshme të mbështeten nismat avokuese për rregullimin e mëtejshëm të gjuhës së shenjave dhe njihjen e saj në vend si gjuhë; Inkorporimi i masave që do të nxisin mësimin e gjuhës së shenjave deri në vitin 2025
- Është e nevojshme të mbështetet avokimi për rregullimin e mëtejshëm të alfabetit Braj (Braille) dhe të mbështetet MASH dhe MPPS për të krijuar një mekanizëm për rritjen e shkrim-leximit të të verbërve deri në vitin 2025

Boshllëku kritik 4 – Shërbime inkluzive

Vlerësimi i aftësisë së kufizuar si një portë për shërbime dhe përfitime dhe kornizë ligjore që rregullon shërbimet

Konkluzione:

- Vlerësimi aktual i aftësisë së kufizuar bazohet në modelin mjekësor. Nevojitet një sistem gjithëpërfshirës i modelit të ri të vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Sistemi i vlerësimit është i fragmentuar dhe shumë i burokratizuar. Ka mungesë të njohurive dhe të kuptuarit të dispozitave të KDPAK dhe modelit të të drejtave të njeriut nga stafi i përfshirë në komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar
- Korniza ligjore që rregullon shërbimet për komunitetin e aftësisë së kufizuar bazohet kryesisht në modelin mjekësor të aftësisë së kufizuar dhe nuk mbulon të gjithë PAK në përputhje me KDPAK

Rekomandime:

- Qeveria, MPPS dhe aktorë të tjerë me pjesëmarrjen e OPAK-ve duhet të mbështeten në procesin e forcimit të kapaciteteve të komisioneve ekzistuese dhe atyre të reja dhe të të gjitha komisioneve të tjera për vlerësimin e aftësisë së

kufizuar. Ajo gjithashtu duhet të finalizojë mjetet funksionale të vlerësimit për të mbështetur qasjen e të drejtave të njeriut dhe për të forcuar sistemet e referimit të aftësisë së kufizuar deri në vitin 2024. Ky sistem duhet të promovojë:

- Qasje të re nga fokusi në dëmtimin dhe diagnostikimin tek nevojat për mbështetje dhe barrierat me të cilat përbalen personat me aftësi të kufizuara
- Mbledhje të të dhënave për mbështetjen që njerëzit realisht kërkojnë dhe jo vetëm për të drejtën për përfitime dhe shërbime ekzistuese
- Të dhënat nga vlerësimi individual i aftësisë së kufizuar duhet të grumbullohen për të krijuar një ndjenjë nevojë për shërbime të ndryshme në të gjithë vendin (2022 -2025)
- Është e nevojshme të zhvillohen kapacitetet e stafit të përfshirë në Komisionin për vlerësimin e aftësisë së kufizuar me dispozitat e KDPAK (2022 -2025)
- Komisioni i ri për vlerësimin e aftësisë së kufizuar duhet të mbështetet për të siguruar përfshirjen dhe pjesëmarrjen e OPAK-ve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara në hartimin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar
- Qeveria, MPPS dhe aktorë të tjerë me pjesëmarrjen e OPAK-ve, duhet të mbështeten në procesin e përmirësimit të legjislacionit ekzistues duke marrë parasysh shërbimet për mbështetje me KDPAK, deri në vitin 2023
- Është e nevojshme të zhvillohen udhëzime në formate të qasshme për mënyrat e qasjes dhe realizimit të shërbimeve për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara deri në vitin 2024

Shërbime sociale inkluzive për sigurimin social dhe uljen e varfërisë

Konkluzione:

- Legjislacioni ekzistues në shërbimet sociale duke marrë parasysh fëmijët, familjet dhe të rriturit me aftësi të kufizuara është me bazë mjekësore
- Shërbimet ekzistuese të bazuara në komunitet janë të fragmentuara, të pakoordinuara, të paplota dhe të pazhvilluara dhe joinkluzive
- Ka shumë keqkuptime midis palëve të interesuara, përfshirë PAK, në lidhje me shërbimet. Duhet të zhvillohen lloje të ndryshme të mbështetjes së komunitetit
- Në të gjithë vendin, autoritetet vendore mund të mos kenë aftësitë dhe burimet për të rritur ndikimin e programit kombëtar dhe për të mobilizuar burimet për të krijuar shërbime të reja të kërkuara
- Procesi i deinstitutionalizimit nuk është në përputhje me nenin 19 të KDPAK. Procesi synon shpërndarjen/sistemimin e personave të akomoduar në institucione në shtëpi grupore ose në shtëpi me banim të organizuar me mbështetje
- Mungojnë shërbimet për punë me personat me aftësi të kufizuara para largimit nga institucioni

Rekomandime:

- Është e nevojshme të mbështetet MPPS për të rishikuar Ligjin për Mbrojtjen Sociale, Ligjin për Drejtësinë për Fëmijët, Ligjin për Familjen duke zgjeruar fushëveprimin e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me KDPAK (2023)
- Është e nevojshme të mbështetet MPPS, MASH, MSH me pjesëmarrje aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK për zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve rregullatore të shërbimeve për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë sistemin e licencimit dhe monitorimit si dhe zhvillimin e kapaciteteve të QPS-së për zbatimin e sistemit të menaxhimit të rasteve
- Është e nevojshme të mbështetet MPPS, komunitetet lokale me pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK-të për hartimin e shërbimeve ekzistuese në mënyrë që të jenë përfshirëse ndaj aftësisë së kufizuar dhe hartimin e programeve inkluzive të bazuara në komunitet që synojnë personat me aftësi të kufizuara
- Mbështetja e zhvillimit të shërbimeve të integruara për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara në komunitetet e tyre lokale. Shërbime të tilla si mbështetja e bashkëmoshatarëve ose këshillimi i bashkëmoshatarëve, vetë-përfaqësimi individual, mund të ndihmojnë personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë që largohen nga kujdesi ose që kanë filluar të jetojnë të pavarur, familjet në rrezik ose familjet e ribashkuara me fëmijët e tyre, për t'u fuqizuar dhe me vetëbesim të gjejnë rrugën e tyre përmes kulturës ose mjedisit. Për këtë është e nevojshme të mbështetet MPPS, MSH, komunitetet lokale me pjesëmarrje aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK 2022-2025
- Mbështetja e komunave lokale për të krijuar një strategji dhe plan lokal për aftësinë e kufizuar me tregues dhe alokime

buxhetore, si dhe mbështetje në zhvillimin e kapaciteteve të përbashkëta teknike dhe operacionale (2022-2025)

- Është e nevojshme të mbështetet MPPS me pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara (PAK) që janë deinstitutionalizuar, PAK dhe OPAK në procesin e përgatitjes së një plani veprimi për vitin 2022 për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Deinstitutionalizimit
- Është e nevojshme të mbështetet MPPS me pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara që janë të deinstitutionalizuar, personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK-ve për të krijuar një mekanizëm ku çdo projekt, duke marrë parasysh procesin e deinstitutionalizimit, të gjithë aktorët, përfshirë OSHC-të duhet t'i përfshijnë personat me aftësi të kufizuara në ekipet e tyre dhe të gjithë ata duhet të trajnohen sipas dispozitave të KDPAK dhe konceptit të jetesës së pavarur (2022)
- Mbështetja e MPPS me pjesëmarrjen aktive të PAK që janë deinstitutionalizuar, PAK dhe OPAK, për të krijuar një program trajnimi për avokim dhe vetë-përfaqësim, konceptin e jetesës së pavarur për njerëzit që jetojnë ende në institucione dhe shtëpi grupore, si dhe ofrimin e mekanizmave dhe shërbimeve për punësimin e tyre
- Është e nevojshme të mbështetet MPPS, MSH me pjesëmarrjen aktive të PAK që janë deinstitutionalizuar, PAK dhe OPAK për të krijuar një mekanizëm për fillimin e procesit të deinstitutionalizimit për personat me aftësi të kufizuara psikosociale të akomoduar në spitalet psikiatrike me një sistem të përshtatshëm tranzicioni dhe shërbimet e mbështetjes në komunitet

Shërbime inkluzive dhe arsim inkluziv

Konkluzione:

- Pavarësisht përpjekjeve të bëra për të krijuar arsimin fillor inkluziv, kapaciteti dhe njohuritë e palëve të interesuara në vetë procesin ende mungojnë. Personat me aftësi të kufizuara nuk janë mjaft të informuar dhe shumica e personave me aftësi të kufizuara ende nuk kanë mbaruar shkollën. Arsimi i mesëm është i segreguar dhe special. Programet që zbatohen dhe kualifikimet që fitohen në arsimin e mesëm special nuk përputhen me kërkesat e tregut. Mësuesit nuk janë të trajnuar për të mbështetur inkluzionin. Trajnimi shpesh përqendrohet në aftësi të kufizuara të ndryshme në vend të dizajnit universal të mësimin dhe strategjive pedagogjike që do të përmirësojnë cilësinë për të gjithë. Nuk ka pjesëmarrje të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në hartimin, proceset dhe politikat arsimore

Rekomandime:

- Të mbështetet MASH-i, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Akademia me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK për të hartuar një plan tranzicioni për arsimin inkluziv për PAK në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, përfshirë institucionet e arsimit të lartë, si dhe rishikimin e kurrikulave të arsimit të lartë, fakultetet për edukim special dhe rehabilitim, pedagogji, shkenca juridike, arkitekturë, punë sociale deri në vitin 2024
- Të mbështetet zhvillimi i kapaciteteve të administratës së arsimit, stafit mësimor dhe jo-mësimor në lidhje me aftësinë për punë efikase në mjedise arsimore inkluzive, të kualifikuar në gjuhën e shenjave dhe/ose alfabetin Braj (Braille) (2022 -2025)
- Të mbështetet MASH-i, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Akademia, Qendrat për Arsim Profesional dhe Trajnime, MPPS me pjesëmarrjen e PAK dhe OPAK për rishikimin e programeve të veçanta të arsimit të mesëm dhe kualifikimin sipas kërkesave të tregut (2022 -2025)
- Të mbështetet MASH-i, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Akademia, me pjesëmarrjen e PAK dhe OPAK për të krijuar një mekanizëm që do të garantojë pjesëmarrjen aktive të fëmijëve me aftësi të kufizuara në hartimin e planeve individuale arsimore, në procesin mësimor, në këshillat e shkollave, në hartimin e politikave dhe sistemeve shkollore, si dhe në zhvillimin e politikës më të gjerë arsimore (2022 -2025)
- Duhet të formulohet politika, dhe sistemi i arsimit teknik dhe profesional të bazohet në parimet e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit dhe barazisë midis burrave dhe grave 2022 -2024. Në këtë proces ka nevojë për mbështetje të MASH, MPPS, qendrave të arsimit profesional, dhe komunitetet lokale

Mbështetje për punësim

Konkluzione:

- Punësimi i personave me aftësi të kufizuara është relativisht i rrallë në tregun e hapur të punës dhe organizohet kryesisht në kompani të caktuara ("strehuese"). Ligji nuk promovon apo rregullon asnjë formë të punësimit të mbështetur të personave me aftësi të kufizuara. Përfitimet financiare të rregulluara përmes Fondit Special nuk kanë mekanizëm efektiv për transparencë. Rehabilitimi profesional nuk është në përputhje me qasjen në të drejtat e njeriut dhe nuk ofron qasje adekuate për personat me aftësi të kufizuara në sistemet ekzistuese të trajnimit, rikualifikimit ose praktikës

Rekomandime:

- Është e nevojshme të mbështetet MPPS, AP me pjesëmarrjen e gjerë të OPAK dhe PAK për të bërë rishikimin e Ligjit për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara me strategji të qartë për të kaluar në tregun e hapur të punësimit, futjen e sistemit të kuotave dhe mekanizmat e zhvillimit, të zgjerohet punësimi i mbështetur duke përfshirë komponentët e trajnimit dhe kalimin në punësim të mbështetur, i ndjekur nga konvertimi në punësim të rregullt në tregun e hapur të punës (2022 -2023)
- Është e nevojshme të mbështetet MPPS, AP me pjesëmarrjen e gjerë të OPAK dhe PAK, Qendrat APT për ngritjen e qendrave të rehabilitimit profesional (në varësi prej shtetit) duhet të ofrojnë trajnime të stafit dhe përmirësim të rregullt të aftësive, duke përfshirë trajnimin adekuat për trajnerët, instruktorët dhe asistentët e mësimdhënies për t'u mundësuar atyre të trajnojnë efektivisht PAK krahas personave pa aftësi të kufizuara. PAK në këtë proces nuk duhet të jenë vetëm përfutur, por duhet të përfshihen edhe në procesin e krijimit të sistemeve (2022 -2023)
- Ripërpunimi i strukturës së financimit për të përmirësuar fleksibilitetin e mbështetjes aktuale financiare dhe për të rritur disponueshmërinë dhe cilësinë e punësimit të mbështetur nëpërmjet rritjes së kapacitetit të financimit për mbështetje afatgjatë (2022 -2023)
- Mbështetja e transformimit të kompanive të strehimoreve (si pilot) në qendra që do të ofronin punësim me mbështetje. Kjo duhet të bëhet nga MPPS, Qendra e APT, AP, MASH dhe Dhomat e Kompanive të Strehimit

Shërbimet për gëzimin e të drejtës shëndetësore duke përfshirë rehabilitimin dhe të drejtën për lëvizshmëri personale

Konkluzione:

- Korniza ligjore dhe politikat që rregullojnë qasjen në shërbimet shëndetësore nuk janë në përputhje me KDPAK. Procedurat për qasjen në kujdesin shëndetësor parësor, sekondar dhe terciar nuk janë të qasshme dhe të disponueshme për personat me aftësi të kufizuara. Qasja në mjete dhe pajisje ortopedike është mjaft e kufizuar. Mungojnë shërbimet dhe programet për parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, trajtimin e hershëm dhe rehabilitimin
- Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara nuk mund të kenë qasje në shërbimet ekzistuese për DhBGj dhe ShSR si rezultat i infrastrukturës dhe informacionit të paqasshëm. Palët e interesuara përkatëse në fushën e ShSR dhe DhBGj nuk janë të njohur me dispozitat për ShSR dhe DhBGj të KDPAK-së.

Rekomandime:

- Është e nevojshme të mbështetet MSH me pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK për të rishikuar dhe përmirësuar kornizën ligjore në shëndetësi në përputhje me dispozitat e KDPAK (2023)
- Është e nevojshme të mbështetet MSH me pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK për të rishikuar dhe përmirësuar legjislacionin duke marrë parasysh rehabilitimin mjekësor dhe pajisjet e lëvizshmërisë personale për PAK të ndryshëm, duke siguruar që ato bazohen në qasjen e të drejtave të njeriut dhe KDPAK 2023 – 2025)
- Mbështetja e MSH, me pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK, për të përfshirë në kurrikulat e shëndetësisë trajnimin e detyrueshëm për profesionistët shëndetësorë mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara duke respektuar qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut ndaj aftësisë së kufizuar
- Mbështetja e MSH, me pjesëmarrjen aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK, për të filluar krijimin e qendrave me programe dhe shërbime për parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, trajtimin e hershëm dhe rehabilitimin e fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara
- Mbështetja e MPPS-së, MD-së, Qendrave të Strehimit, komuniteteve lokale, MSH-së, OSHC-ve me pjesëmarrje aktive

të PAK dhe OPAK-ve në procesin e zhvillimit të kapaciteteve të përbashkëta teknike dhe operacionale, duke përfshirë kurrikulat e trajnimit, për ofrimin e shërbimeve të qasshme dhe të disponueshme për DhBGj dhe ShSR për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara

- Është e nevojshme të mbështetet MPPS, Qendrat e Strehimit, komunitetet lokale MSH, OSHC-të me pjesëmarrje aktive të PAK dhe OPAK për zhvillimin e kurrikulave të trajnimit për DhBGj dhe ShSR (planifikimi i familjes, kujdesi gjatë shtatzënisë, amësia, parandalimi i kancerit të qafës së mitrës) në përputhje me dispozitat e KDPAK (2022 – 2025)
- Është e nevojshme të mbështetet MPPS, qendrat e strehimit, komunitetet lokale, MSH, OSHC-të me pjesëmarrje aktive të PAK dhe OPAK për përcaktimin e kostove specifike për shërbimet shëndetësore menstruale, shërbimet për ShSR për vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara dhe për shërbimet për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit, vezores, mitrës, testikujve dhe zorrës së trashë dhe shërbime për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit testikular për meshkujt me aftësi të kufizuara (2022 – 2025)

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në kuadër të politikave gjinore

Konkluzione:

- Politikat gjinore, si dhe politikat për fëmijët, të rriturit, HIV-in, nuk kanë dispozita për personat me aftësi të kufizuara sipas qasjes ndërsektoriale dhe dispozitave të KDPAK-së së OKB-së

Rekomandime:

- Është e nevojshme të mbështetet MPPS, Qendrat e Strehimit, komunitetet lokale, MSH, OSHC-të me pjesëmarrje aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe OPAK në procesin e rishikimit të të gjitha politikave gjinore dhe grupeve të tjera të cënueshme, si të moshuarit, pacientet me HIV, përkatësia etnike të përfshihet në dispozitat për personat me aftësi të kufizuara në bazë të qasjes ndërsektoriale dhe dispozitat e KDPAK-së së OKB-së. (2022 – 2025)

Boshllëku kritik 5 – Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara

Konkluzione:

- 5.1 Korniza ligjore ekzistuese për pjesëmarrjen politike nuk është në përputhje me KDPAK. Ekziston një mungesë e përgjithshme e vetëdijes në mesin e komuniteteve dhe palëve të interesuara për angazhimin politik të personave me aftësi të kufizuara. Personave me aftësi të kufizuara u mungon përfaqësimi adekuat politik në nivel kombëtar dhe përfaqësimi në nivel lokal
- Korniza ligjore dhe shpërndarja e fondeve shtetërore për OPAK-të tradicionale rregullohet me një ligj të posaçëm të veçantë “Ligji për organizatat e invalidëve”
- Mungojnë mekanizmat për të siguruar pjesëmarrjen e personave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara në proceset vendimmarrëse. Përfaqësimi dhe pjesëmarrja e PAK në OSHC-të, ofruesit e shërbimeve dhe organizatat ndërkombëtare është në një nivel shumë të ulët dhe pothuajse të padukshëm në shoqëri

Rekomandime:

- Ekziston nevoja për të mbështetur MD, Qeverinë, TKK për KDPAK, Parlamentin, për të inicuar dhe rishikuar legjislacionin zgjedhor në mënyrë që të përmirësohet me KDPAK, të identifikohen dhe të zbuten barrierat për pjesëmarrjen politike të PAK, duke përfshirë dhe dispozitat që kufizojnë ose ndalojnë pjesëmarrjen politike të PAK që kanë një kujdestar ligjor ose person mbështetës të caktuar nga gjykata (2022 – 2023). Legjislacioni i rishikuar në këtë fushë duhet gjithashtu të:
 - ⊙ promovojë një sistem kuotash për pjesëmarrjen politike të personave me aftësi të kufizuara
 - ⊙ ketë masa afirmative për gratë me aftësi të kufizuara
 - ⊙ përfshijë aftësinë e kufizuar përmes parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat në administratën publike
 - ⊙ sigurojë disponueshmërinë dhe qasjen në të dhëna cilësore në të gjithë procesin
 - ⊙ sigurojë shpenzime dhe kosto buxhetore të përshtatshme për aftësinë e kufizuar duke përfshirë dhe koston për akomodim të arsyeshëm

- Ekziston nevoja e zhvillimit të kapaciteteve të Partive Politike, MD për dispozitat e KDPAK-së si dhe për mbështetjen dhe ndërveprimin me votuesit dhe kandidatët me aftësi të kufizuara. Një pjesë e trajnimit mund të përfshijë një diskutim rreth paragjykimëve dhe qëndrimeve ndaj personave me aftësi të kufizuara. Ky proces mund të sigurohet nga OPAK
- Ka nevojë për zhvillim të vazhdueshëm të kapaciteteve të PAK, të rinjve, grave me aftësi të kufizuara për bazat e strukturave vendimmarrëse demokratike, politikat, degët e pushtetit dhe mekanizmat për krijimin e legjislacionit (2022 – 2023). Ky proces mund të sigurohet nga OPAK
- Mbështetja e fushatave ndërgjegjësuere për përfitimet e pjesëmarrjes aktive politike në çështje që lidhen drejtpërdrejt me personat me aftësi të kufizuara, por edhe për çështje të tjera publike, me qëllim që të kontribuojë në përfshirjen më të madhe të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në rrjedhat kryesore
- MD, TKK për KDPAK në bashkëpunim me PAK dhe OPAK duhet të inicojnë dhe rishikojnë kornizën ligjore për të drejtën e asociimit dhe veprimin të OSHC-ve në të cilën do të rregullohet edhe statusi i OPAK-ve. Programi për mjetet financiare në mbështetje të programeve dhe projekteve të OPAK-ve dhe OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë do të përfshijë kriterin që fondet që do të përdoren do të promovojnë ekskluzivisht modelin e të drejtave të njeriut për komunitetin me aftësi të kufizuara sipas KDPAK-së së OKB-së
- Mbështetja e masave dhe veprimeve të synuara për rrjetëzimin dhe bashkëpunimin e OSHC-ve, OPAK-ve dhe ofruesve të shërbimeve në fusha të ndryshme të veprimin social, si dhe për të motivuar dhe inkurajuar OSHC-të që të përfshijnë personat me aftësi të kufizuara në ekipet e tyre
- Agjencitë e OKB-së duhet të përfshijnë personat me aftësi të kufizuara në ekipet e tyre drejtuese dhe do të përpiqen të angazhojnë personat me aftësi të kufizuara si pjesë e ekipeve në zbatimin e aktiviteteve të tyre
- Organizatat ndërkombëtare do të përfshijnë personat me aftësi të kufizuara në ekipet e tyre drejtuese dhe do të përpiqen të angazhojnë personat me aftësi të kufizuara si pjesë e ekipeve në zbatimin e aktiviteteve të tyre

Boshllëku kritik 6 - Përgatitja e një buxheti të harmonizuar me KDPAK

Konkluzione:

- Rregulloret ekzistuese të zbatueshme ligjërish nëpër ministri dhe Menaxhimi i Financave Publike nuk përfshijnë çështjen e aftësisë së kufizuar që nënkupton se çdo vit fondet publike shpenzohen për shërbime që nuk janë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Ka kapacitete teknike dhe njohuri shumë të kufizuara brenda sektorit publik dhe ndërmjet donatorëve, duke përfshirë agjencitë e OKB-së për buxhetin inkluziv. Personat me aftësi të kufizuara kanë pak njohuri në lidhje me proceset e formulimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të buxhetit

Rekomandime:

- Është e nevojshme të avokohet dhe të inicohet që MF të bëjë rishikimin e Ligjit për Buxhetin ku do të inkorporohet çështja e aftësisë së kufizuar dhe të gjitha ministratë dhe autoritetet vendore do të kenë detyrimin për përgatitjen e buxheteve ku do të inkorporohet dimensionin i aftësisë së kufizuar dhe i njëjti do të jetë i përgatitur në format të qasshëm 2022 – 2023
- Mbështetja e përpjekjeve aktuale për zbatimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (nga UN Women), duke mbështetur një iniciativë pilot për zbatimin e buxhetit të përgjegjshëm ndaj aftësisë së kufizuar në disa komunitete lokale 2022 – 2024. Ky proces mund të bëhet me mbështetjen e OPAK-ve në bashkëpunim me OSHC-të e tjera dhe komunat lokale
- Është i nevojshëm zhvillimi i kapaciteteve të Qeverisë, MF-së, ministrive, OSHC-ve dhe OPAK-ve në lidhje me buxhetimin në përputhje me KDPAK si dhe trajnime të zhvilluara për PAK për proceset e formulimit, zbatimit dhe monitorimit dhe vlerësimit të buxhetit 2022 – 2024

Boshllëku kritik 7 - Qeverisja dhe Llogaridhënia

Konkluzione:

- Mungesa e madhe e të dhënave specifike për aftësinë e kufizuar dhe të dhëna të ndara për aftësinë e kufizuar tek të gjithë bartësit të detyrave, krahas mungesës së vullnetit për të përfshirë aftësinë e kufizuar në metodologjitë ekzistuese të mbledhjes së të dhënave, e bën të pamundur që aftësia e kufizuar të adresohet dhe t'i jepet prioritet asaj në politikë
- Regjistrimi kombëtar i popullsisë, familjeve dhe amvisërive në 2021 nuk do të sigurojë të dhënat e nevojshme për krijimin e politikave të qëndrueshme të aftësisë së kufizuar
- Personat me aftësi të kufizuara, OPAK-të dhe OSHC-të e bazuara në të drejtat nuk janë përfshirë në hartimin e raportit fillestar të vendit mbi zbatimin e KDPAK-së së OKB-së
- Ka kapacitete teknike dhe njohuri shumë të kufizuara në mesin e donatorëve për aftësinë e kufizuar dhe KDPAK duke përfshirë dhe alokimet e buxhetit për aftësinë e kufizuar. Sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit për programet e zhvillimit në sferat e komunitetit të donatorëve shpesh u mungojnë treguesit me ndarje të fokusuar në kontributin, rezultatet dhe ndikimet tek personat me aftësi të kufizuara

Rekomandime:

- Mbështetja e Entit Shtetëror të Statistikave në procesin e integritetit të aftësisë së kufizuar në operacionet e tyre statistikore të vazhdueshme, siç janë aktivitetet mujore, vjetore dhe tematike, përmes aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve
- Enti Shtetëror i Statistikave duhet të fillojë procesin e integritetit të aftësisë së kufizuar në operacionet e tyre statistikore të vazhdueshme, siç janë aktivitetet mujore, vjetore dhe aktuale
- ESHS përmes Qeverisë në bashkëpunim dhe pjesëmarrje të PAK dhe OPAK duhet të inicojë procesin e ndryshimit të Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Familjeve dhe Amvisërive, në mënyrë që të përfshijë siç duhet çështjet e aftësisë së kufizuar. Organizatat ndërkombëtare duhet të mbështesin strategjikisht ESHS-në gjatë gjithë procesit të vlerësimit të nevojave dhe hartimit të Programit për Hulumtime Statistikore 2023-2027, në mënyrë që të përfshijë siç duhet aftësinë e kufizuar në pyetësorët ekzistues dhe mjetet e tjera statistikore. Kjo mbështetje strategjike duhet të zgjerohet për të gjithë bartësit e detyrave që mbledhin të dhëna, në mënyrë që të integrojnë siç duhet aftësinë e kufizuar në metodologjitë e tyre
- Qeveria duhet t'i japë përparësi krijimit të pikave të kontaktit tek shumë bartës të detyrave dhe t'i sigurojë qëndrueshmëri këtij sistemi, mundësisht duke ndjekur shembullin e njësisë/departamenteve të krijuara për anëtarësim në BE brenda shumicës së bartësve të detyrave. Ky proces duhet të nisë dhe të finalizohet brenda një viti, duke filluar nga fundi i vitit 2021 ose fillimi i vitit 2022
- Me buxhetin e shtetit 2022, Qeveria duhet të ndajë fonde për ngritjen e Sekretariatit të Trupit Koordinues Kombëtar, për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të stafit dhe anëtarëve, si dhe të ndryshojë vendimin aktual për krijimin e TKK-së
- Mbështetja e krijimit të mekanizmit të pavarur monitorues si subjekt i pavarur në kuadër të Avokatit të Popullit, nëpërmjet ndarjes së burimeve financiare dhe njerëzore
- Ministria e Punëve të Jashtme duhet të fillojë procesin e forcimit të kapaciteteve teknike të Organit Ndërqeveritar për të Drejtat e Njeriut, duke kërkuar më shumë fonde buxhetore për punësimin e stafit teknik të përhershëm dhe të dedikuar për Sekretariatin e saj ku do të përfshihen PAK
- Agjencitë e OKB-së në vend dhe organizatat dhe donatorët e tjerë ndërkombëtarë aktivë në fushën e të drejtave të aftësisë së kufizuar, duhet të vazhdojnë të mbështesin OPAK-të dhe OSHC-të të bazuara në të drejta në forcimin e roleve të tyre mbikëqyrëse dhe raportuese dhe në rolin si kundërpeshë ndaj bartësve të detyrave
- Në përputhje me nenin 32 të KDPAK, Agjencitë e OKB-së duhet të përfshijnë aftësinë e kufizuar në përputhje me dispozitat e KDPAK në të gjitha programet dhe aktivitetet e tyre
- Agjencia e OKB-së duhet të sigurojë që të gjitha programet e financuara në formë të ndihmave të jenë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Përmes dialogut me OPAK-të, komuniteti i donatorëve, përfshirë Agjencinë e OKB-së, duhet të planifikojnë se si ndihma dhe mbështetja e tyre teknike dhe financiare mund të kontribuojnë më së miri në zbatimin e KDPAK dhe përfshirjen e PAK
- Donatorët dhe agjencia e OKB-së duhet të krijojnë një mekanizëm për monitorim dhe të ndërmarrin veprime për të revokuar të gjitha aktivitetet e tyre nëse ato nuk janë në përputhje me dispozitat e KDPAK

Boshllëku kritik 8 – KOVID – 19

Konkluzione:

- Korniza ligjore ekzistuese për krizat humanitare dhe gjendjen e jashtëzakonshme nuk është e harmonizuar me KDPAK-në e OKB-së dhe nuk siguron e as garanton pjesëmarrjen dhe konsultimin e aktorëve me personat me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e OPAK-ve

Rekomandime:

- Qeveria, TKK për KDPAK në bashkëpunim me PAK dhe OPAK, duhet të iniciojnë dhe rishikojnë ligjet e emergjencës, ku shtetet dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të reformojnë politikat dhe praktikatat e tyre në përputhje me nenet 11 të KDPAK
- Qeveria, TKK për KDPAK në bashkëpunim me PAK dhe OPAK duhet të përgatiten dhe të miratojnë kërkesat ligjore dhe të politikave në vend për të siguruar pjesëmarrjen e PAK në aktivitetet e gatishmërisë, vlerësimet e nevojave humanitare, proceset përkatëse monitoruese dhe në programet dhe projektet që lidhen me situatat e rrezikut dhe emergjencave humanitare, rreziqeve të lidhura me klimën dhe reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë (RRF)

Aneksi 7. Bibliografia

Të drejtat e pacientëve me fokus tek personat me aftësi të kufizuara intelektuale "ESE, 2011, faqe 6. <http://www.esem.org.mk/pdf/Publikacij/ESE%20Intelektualna%20poprecenost.pdf>.

Shëndeti seksual dhe riprodhues dhe personat me aftësi të kufizuara fizike - Raporti i vlerësimit të nevojave dhe shërbimeve - Hera, 2012, fq. 61 - 62, 2012, <http://hera.org.mk/wp-content/uploads/2014/02/izvestaj_poprecenost_rz.pdf>.. Në dispozicion në: 21.10.2014,

<http://www.nacionalnakomisija.gov.mk/sites/default/files/prikachyvanja/studija_mehanizmi_za_obebeduvanje_na_socijalni_uslugi_vo_makedonija.pdf>

Plani i Veprimit për vitin 2021 i KKT-së për zbatimin e KDPK-së, në dispozicion në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/akciski_plan_za_2021_godina_za_implementacija_na_konvencijata.pdf

Analiza e ndikimeve të COVID-SARS-19 në gjini dhe dallimet, studimi i politikave nr. 40, OSBE, 2021, në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/1/9/480413.pdf>

Analiza e ndikimeve të COVID-SARS-19 në gjini dhe dallimet, studimi i politikave nr. 40, OSBE, 2021, në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/1/9/480413.pdf>

Analizë e gjendjes me personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë, 2017, f. 63, 64

Aplikimi i teknologjisë informative ndihmëse në shkollat fillore të rregullta në Maqedoni, kushtet dhe nevojat aktuale, Hapni dritaret, Shkup, Mars 2011

Autor Marija Risteska, Hulumtuesit: Ana Avramovska-Nuskova, Gordana Micova-Nestorovska, Sashko Jovanov, Liljana Jonoska, Elena Koçoska. Analiza e ndikimit të COVID-SARS-19 mbi gjininë dhe dallimet, Studimi i politikës Nr. 40, faqe 47, 2021 OSBE, në dispozicion në: <https://www.osce.org/files/f/documents/1/9/480413.pdf>

Biljana Kotevska, Nesime Selioska, Magdalena Lembovska, Gordana Lexeetiќ, Aleksandra Bogdanovska, Simonida Kacarska, Maja Balsha, Vigjilenca Abazi, Elena Koçoska, Publikim, Raport për të Drejtat Themelore 2021, Instituti për Politika Evropiane dhe të Drejtat e Njeriut, : https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fr2021_north_macedonia-fr2021_en.pdf

Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. (2018). Vrojtmet përfundimtare mbi raportin fillestar të ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

Koncepti për arsimin inkluziv, i disponueshëm në: <https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20za%20inkluzivno.pdf>

Koncepti i arsimit fillor, i disponueshëm në: <https://mon.gov.mk/stored/document/Koncepcija%20MK.pdf>

Vëzhgimet përfundimtare për raportin fillestar të Republikës së Maqedonisë nga Komiteti i OKB-së, 2018. Në dispozicion në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD/C/MKD/CO/1&Lang=En

Teksti i konsoliduar i Ligjit për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor të Ministrisë së Brendshme, <<http://www.mvr.gov.mk>>

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë. Dekret me vendim nr.08-4642/1.

Keshilli i Europës. (2021). Raport për autoritetet e Maqedonisë së Veriut nga vizita e Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Degradues ose Poshtëruar (KPT) nga 2 deri më 10 dhjetor 2019.

Gjendja aktuale e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2018, BZHA, në dispozicion në: <https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2020/02/Aktuelna-sostojba-na-inkluzija-na-deca-so-posebni-obrazovni-MK.pdf>

Vendim për Themelimin e Organit Ndërqeveritar për të Drejtat e Njeriut (Gazeta Zyrtare 55/2012, 55/2015)

Vendim për themelimin e Trupit Koordinues Kombëtar për Zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (Gazeta Zyrtare 144/2012 - shfuqizuar; Gazeta Zyrtare 69/2018, 75/2019)

E. Koçoska Z. Shavreski. Publikim Analiza e politikave dhe gjendja në rajonin verilindor dhe të Pollogut, Hendikep Plus, 2020

Komisioni European. (2020). Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020

Komisioni European. (2020). Raporti i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020.

Për shembull, në korrik 2021, Qeveria ka transferuar 100.000.000 denarë nga Fondi Special për Përmirësimin e Punësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara në një program tjetër (Gazeta Zyrtare 166/2021); 30.000.000 MKD në shtator 2020 (Gazeta Zyrtare 218/2020); 100.000.000 MKD në qershor 2020 (Gazeta Zyrtare 156/2020)

Vendimet e Qeverisë Nr. 45-5503 / 1 më datë 20 gusht 2019, dhe Nr. 45-8738 / 1 më datë 26 Nëntor 2019.

Aftësia e kufizuar - enigma që mungon, Raport mbi gjendjen e personave me aftësi të kufizuara, Polio Plus, 2012, f.77, <www.polioplus.org.mk>

<http://www.mobilnost.mk/index.php/2011-10-26-09-10-24/396-sednica-na-nacionalnoto-koordinativno-telo-za-implementacija-na-konvencijata-na-on-za-pravata-na-licata-so-invalidnost>, në dispozicion në 24.07.2021

<http://www.nsiom.org.mk/konvencija/category/16-izveshtai-za-konvencijata>

https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/eurydice/republic-north-macedonia/early-childhood-and-school-education-funding_en

<https://www.un.org/ruleoflaw/files/PRINCI~5.PDF>, qasur më 22.07.21

PËRFSHIRJA e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor: një raport kërkimor. – Shkup: Avokati i Popullit në Republikën e Maqedonisë, 2018, UNICEF Në dispozicion në: https://www.unicef.org/northmacedonia/media/4386/file/MK_CWDInKindergarten_Report_MK.pdf

Jovanovska, B. (2020). Fugizimi ligjor në komunitet në procesin e deinstitutionalizimit: raport. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

Jovanovska B. dhe Petkovska. N. . (2021). Ndikimi i krizës KOVID-19 tek personat me aftësi të kufizuara në Maqedoninë e Veriut. Fondacioni Westminster për Demokraci.

K. Panajotova, E. Koçoska, Analizë: Ndhimë në punë dhe mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuar që largohen nga institucionet e përkuidesit, 2020

Kočoska E., Klimoska J. Publikim “Analiza e programeve politike për zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2020 në lidhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, Westminster Foundation dhe Polio Plus, 2020, në dispozicion në: < <https://poliopplus.org.mk/wp-content/uploads/2021/05/izgubenata-vrednost-niz-politichkoto-uchestvo.pdf>>

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve, MPPS në dispozicion në: <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/2018/198%202018%20ZAKON%20ZA%20ZASTITA%20NA%20DECATA%20%20%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D1%81%D0%BE%D0%BB%D0%B8%D0%B4%D0%B8%D1%80%D0%B0%D0%BD%20%D1%82%D0%B5%D0%BA%D1%81%D1%82-converted.pdf>

Liqji për Arsimin e Lartë, në dispozicion në:

http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/ZAKON_VISOKOTO_OBRAZOVANIE-final.pdf

Ligji për Arsimin e Mesëm, në dispozicion në: <http://www.mon.gov.mk/images/%D0%97%D0%B0%D0%BA%D0%BE%D0%BD%D0%B7%D0%BO%D1%81%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%BE%D1%82%D0%BE%D0%BE%D0%B1%D1%80%D0%B0%D0%B7%D0%BE%D0%B2%D0%B0%D0%BD%D0%B8%D0%B507.pdf>

Liqji për ndryshimin e Liqjit për Avokatin e Popullit (Gazeta Zyrtare nr. 181/2016)

Ligji për ndryshimin e Ligjit për Avokatin e Popullit (Gazeta Zyrtare nr. 35/2018)

Ligji për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizive, Gazeta Zyrtare nr. 184/13, 13/14, 44/14.

Ligji për invalidët civilë të luftës, MPPS, në dispozicion në: < https://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/civilniinvalidi_konsolidiran.pdf >

Ligji për Ndërtim, Gazeta Zyrtare nr. 130/09, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13.

Liqji për të dhënat në formë elektronike dhe nënshkrimin elektronik, Gazeta Zyrtare nr. 34/01, 6/02, 98/08.

Liqji për Organizatat e Invalidëve, MPPS, në dispozicion në: https://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/invorganizacii_konsolidiran.pdf

Ligji për qasje të lirë në informacione publike, Gazeta Zyrtare nr. 6/10.

Ligji për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese, i disponueshëm në: <http://www.ujp.gov.mk/mk/regulativa/opis/25>

Ligji për Sigurimet Shëndetësore (tekst i integruar i konsoliduar Gazeta Zyrtare nr. 65/2012, 16/2013 dhe 91/2013), Fondi i Sigurimeve Shëndetësore. Në dispozicion në: [http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon%20za%20zdravstveno%20oisguruvanje%20\(Interen%20precisten%20tekst\).pdf](http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon%20za%20zdravstveno%20oisguruvanje%20(Interen%20precisten%20tekst).pdf)

Ligji për kujdesin shëndetësor. Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/2012, 145/2012, 87/2013, 164/2013, MSH. Në dispozicion në: < http://mz.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-zdravstvena-zastita-2_12_2012.pdf>

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare nr. 5/02.

Ligji për Barnat dhe Pajisjet Mjekësore, 11/2012 <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-lekovi-i-medicinski-pomagala.pdf>

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. "Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 258/2020 nga 30.10.2020.

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 24 nga 29.1.2021. Neni 5.

Liqji për Mbrojtjen e Fëmijëve, Gazeta Zyrtare nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14.

Ligji për Shëndetin Publik, nr. 136/2011<http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2012/12/zakon-za-javno-zdravje-precisten.pdf>

Liqji për rrugët publike, Gazeta Zyrtare nr. 84/08, 52/09, 114/09, 124/10, 23/11, 53/11, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese: 10.03.2010.

Ligji për të dhënat nga lëmia e shëndetësisë, Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 20/09. Në dispozicion në: [http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon za evidenciju vo oblasti na zdravstvoto Sl. Vesnik na RM, br. 20 od 16.02.2009 godina.pdf](http://www.fzo.org.mk/WBStorage/Files/Zakon%20za%20evidenciju%20vo%20oblasti%20na%20zdravstvoto%20Sl.%20Vesnik%20na%20RM,%20br.%2020%20od%2016.02.2009%20godina.pdf)

Ligji për Transportin Rrugor, Gazeta Zyrtare nr. 68/04, 127/06, 114/09, 83/10, 140/10, 17/11, 53/11, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese: 01.02.2006; 14.05.2008; 10.11.2010.

Liqji për Mbrojtjen Sociale. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Magedonisë së Veriut" nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20 dhe 311/20.

Ligji për ndërprerjen e shtatzënisë <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2018/01/ZAKON-ZA-PREKINUUVANE-NA-BREMENOSTA-zakлучno-so-br.-149-od-2015.pdf>

Ligji për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm

Ligji për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 87/2005 (tekst i konsoliduar), 113/2005, 29/2007,

Ligji për përdorimin e gjuhës së shenjave, Gazeta Zyrtare nr. 105/09.

Ligjet dhe politikat në Republikën e Maqedonisë në fushën e aftësisë së kufizuar – Raport nga monitorimi sistematik i ligjeve dhe politikave, 2015, f. 14-17; Analizë

MAPP, Raport për varfërinë dhe përjashtimin social në Republikën e Maqedonisë, 2010, <http://bim.lbg.ac.at/de/socijalna-inkluzija-i-covekovite-prava-vo-makedonija/izveshta-za-siromashti-i-sotsi-alna-iskluchenost-vo-republika-makedoni-2010>

Mekanizmat për ofrimin e shërbimeve sociale në Maqedoni, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe GIZ, 2011, f. 24,

Unioni Kombëtar i të Shurdhërve në R. Maqedonia, <http://www.deafmkd.org.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=55&Itemid=80>

Strategjia Kombëtare për Deinstitutionalizim 2018 - 2027 "Timjanik", MPPS, në dispozicion në: <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/strategji/Strategji%202018/Strategjia_deinstitutionalizacija_Timjanik_2018-2027.pdf>

Kabineti i Kryeministrit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Kulturës, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Sekretariati për Çështje Evropiane, si dhe Unioni Kombëtar i Organizatave të "Aftësisë së kufizuar" dhe Qendra Burimore për Prindërit e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara "Nevoja të veçanta"

Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2020). *Raport i veçantë nga hulumtimi për gjendjen me realizimin e të drejtës për arsimim të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2021). Raporti vjetor për vitin 2020.

Paula Federica Hunt, Hulumtim Publik "Asistentë Arsimorë dhe Personal. Tani dhe këtu - Perspektivat e hapura "UNDP, në dispozicion në: https://www1.undp.org/content/dam/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/docs/Educational%20and%20personal%20assistants%20-%20MKD.pdf

Petrovska, N. dhe Avramovski, D. (2021) *Qasja juridike, financiare dhe fizike në drejtësi në gjykatat themelore në Republikën e Maqedonisë së Veriut*. Të gjithë për një Gjyqësor të Drejtë.

Programi i Qytetit të Shkupit për vitin 2018 < <http://ipserver1.skopje.gov.mk/e-skopje/sluzben%20glasnik%20so%20konverzija.nsf/82aa49069edfbbb780256a22004ba9e0/030cd9927ac366ecc1258370004336ce?OpenDocument>>

Shpallje publike për zgjedhjen e një anëtarë të TKK-së, <https://vlada.mk/node/14502>, qasur më 24.07.2021

Publikimi "KU LUNDRON KJO ANIJE" - demistifikimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë me rishikim të së drejtës për kujdes shëndetësor, 2018, në dispozicion në: <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/kade-plovi-ovoj-brod-en.pdf>

Publikimi. Agjenda e Humbur: Çmitizimi i çështjes së aftësisë së kufizuar në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, Polio Plus - 2018 Në dispozicion në: <<http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/izgubenata-agenda-mk.pdf>>

Raporti i të Drejtave të Njeriut 2021, Fra, EPI Në dispozicion në: <https://fra.europa.eu/en/publication/2021/fundamental-rights-report-2021>

Raport mbi aftësinë e vendeve për të zbërthyer treguesit e SZHQ sipas aftësisë së kufizuar, 2020, https://www.washingtongroup-disability.com/fileadmin/uploads/wg/Documents/WG_Implementation_Document_10_-_IQOP.pdf

Raporti i të Drejtave të Njeriut 2021, Fra, EPI Në dispozicion në <https://fra.europa.eu/en/publication/2021/fundamental-rights-report-2021>

Rosemary Reiter, Utopia e Humbur: Kombet e Bashkuara dhe Rendi Botëror, 1995, f. 281

Rregullorja për ndryshimin e rregullores për kushtet e kategorizimit të objekteve për kryerjen e veprimtarisë hotelierike, e disponueshme në: <https://dejure.mk/zakon/pravilnik-za-uslovi-za-kategorizacija-na-objektite-za-vrshenje-na-ugostitelska-dejnost>.

Rregullorja për standardet dhe normat e urbanistikës, <http://mtc.gov.mk/new_site/images/storija_doc/1353/Pravilnik%20za%20standardi%20i%20normativi%20za%20urb.planiranje%5B1%5D.pdf>

Rregullorja për indikacionet për ushtrimin e së drejtës për mjete ortopedike dhe mjete të tjera, FSSHRMV, në dispozicion në: <http://www.fzo.org.mk/default.asp?ItemID=D42C5C3FA5A79548A0408B9FB59A9874>

Rregullore për mënyrën e sigurimit të papenguar të hyrjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuar deri te dhe në ndërtesa, <http://www.mtc.gov.mk/new_site/images/storija_doc/115/pravilnici/25-2010.pdf>

Raport i shkurtër i përgjigjeve nga shteti në pyetjet për raportin e parë të Republikës së Maqedonisë për zbatimin e KDPAK, 2018, në dispozicion në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=INT%2fCRPD%2fCSS%2fMKD%2f31979&Lang=en

tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CRPD%2fC%2fMKD%2f1&Lang=en

Ligji për të drejtat e veçanta të pjesëtarëve të Forcave të Sigurisë së Republikës së Maqedonisë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, MPPS, në dispozicion në: https://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/braniteli_precisten.pdf>

Mandati i përbërjes së mëparshme të Komisionit ka përfunduar më 22.08.2019

MPSP ka renditur ndryshimet e planifikuara ligjore në këtë fushë në Planin e Angazhimit të Palëve të Interesit, të publikuar në www.mtsk.gov.mk.

Banka Botërore. Zhvillimi i hershëm i fëmijërisë së Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë: Raporti i vendit SABER 2015

Komiteti i OKB-së, Komenti i Përgjithshëm nr. 1 për nenin 12 të KDPAK, 2014 Në dispozicion në: <https://undocs.org/en/CRPD/C/GC/1>

KDPAK e OKB-së, neni 35 paragrafi 4 në përputhje me nenin 4 paragrafi 3

Z. Shavreski, E. Koçoska, V. Lazovska, V. Jovanovska. Analiza e gjendjes së personave me aftësi të kufizuara fizike, Komiteti i Helsinkit, 2017. Në dispozicion në:

<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/05/%D0%90%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%BE%D1%98%D0%B1%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%BB%D0%B8%D1%86%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D1%81%D0%BE-%D1%84%D0%B8%D0%B7%D0%B8%D1%87%D0%BA%D0%B0-%D0%BF%D0%BE%D0%BF%D1%80%D0%B5%D1%87%D0%B5%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82-%D0%B2%D0%BE-%D0%A0%D0%B5%D0%BF%D1%83%D0%B1%D0%BB%D0%B8%D0%BA%D0%B0-%D0%9C%D0%B0%D0%BA%D0%B5%D0%B4%D0%BE%D0%BD%D0%B8%D1%98%D0%B0.pdf>

Z. Shavreski, H. Amdiu, E. Koçoska, T. Ortakovski, ekipi i Juridikës. Publikim - Lidhja që mungon “- Demitizimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë me rishikim të së drejtës për arsim, 2018 Polio Plus. Në dispozicion në <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/Alkata-sto-nedostasuva-B5-mk.pdf>

Zh. Poposka, Analizë, ANALIZË E SHKALLËS NË TË CILËN PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA I NJOHIN TË DREJTAT E TYRE, UNICEF, Polio Plus, 2018

Zh. Poposka, botim analitik “Udhëtoni larg – çmitizimi i çështjes së aftësisë së kufizuar në fushën e punësimit dhe marrëdhënieve të punës”, 2018, Polio Plus, në dispozicion në: <http://polioplus.org.mk/margina/dokumenti/patuvaj-daleku-mk.pdf>

Zh. Poposka, E. Koçoska, Z. Shavreski. Raport holistik për personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë, 2015. Hapni dritaret, në dispozicion në: https://civicamobilitas.mk/wp-content/uploads/2018/02/O_holisticki_izvestaj_za_licata_so_poprecenost_vo_makedonija-mk.pdf



northmacedonia.un.org

www.facebook.com/1un.mk

www.twitter.com/1UN_MK